

XHEVAT LLOSHI



RRETH  
ALFABETIT  
TË SHQIPES



## RRETH ALFABETIT TË SHQIPES

*Xhevat Lloshi*

© L O G O S - A  
2 0 0 8



S H K U P  
P R I S H T I N Ë  
T I R A N Ë



*Xhevat Lloshi*  
RRETH ALFABETIT TË SHQIPES

*Boton: Logos-A*  
*Biblioteka: Fjala*

*Për botuesin: Adnan Ismaili*  
*Kryeredaktor: Husamedin Abazi*  
*Redaktor biblioteke: Zekerija Ibrahim*

*Redaktor gjuhësor: Xhevat Lloshi*  
*Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi*  
*Redaktor teknik: Afrim Gashi*

*Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup*  
*Shtypi: Focus - Shkup*

*Copyright©Logos-A, 2008*

*Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet në*  
*Bibliotekën Kombëtare Universitare*  
*ISBN 9989-58-268-8*

*[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)*

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.*  
*Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.*  
*Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit*  
*apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.*  
*Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi*  
*pa lejen paraprake të Logos-A.*

# RRETH ALFABETIT TË SHQIPES

*ME RASTIN E 100-VJETORIT TË  
KONGRESIT TË MANASTIRIT*

*Xhevat Lloshi*







## *Përmbajtja:*

<i>Përpyekjet për alfabetin e përbashkët</i>	7
<i>Përgatitja e kongresit të alfabetit</i>	21
<i>Pjesëmarrësit në Kongresin e Elbasanit</i>	59
<i>Përdorimi i shkronjave të greqishtes për alfabetin e shqipes</i>	77
<i>Alfabetet</i>	77
<i>Shkrimi në trevat shqiptare</i>	83
<i>Periudha e antikitetit</i>	86
<i>Përhapja e krishterimit</i>	90
<i>Teksti i parë shqip</i>	96
<i>Shekulli i tetëmbëdhjetë</i>	100
<i>Librat shqip me shkronja të greqishtes</i>	106
<i>Alfabeti i përkthimit të Dhiatës së re 1824-1827</i>	112
<i>Histori e përkthimeve</i>	115
<i>Gjuha shqipe</i>	115
<i>Arbëreshët e Italisë</i>	146
<i>Shekulli XIX</i>	156
<i>Arbëreshët e Greqisë</i>	169
<i>Kundërshtimi i shkronjave greke</i>	179
<i>Pas Kongresit të Manastirit</i>	183
<i>Përdorimi shkencor</i>	186
<i>Alfabetet e Kristoforidhit</i>	201
<i>Alfabeti i arumanishtes për shkrimin e shqipes</i>	273
<i>Alfabeti i shqipes për shkrimin e gjuhëve të tjera</i>	309





## *Përpyjekjet për alfabetin e përbashkët*

Shkrimi i një gjuhe është dukuri kulturore, që zakonisht mund përcaktohet se cilës kohë i takon si datë, sepse me shkrimin nis jo vetëm historia e asaj gjuhe, por edhe vetë historia e dokumentuar e popullsisë. Ata që fillojnë ta shkruajnë për herë të parë një gjuhë menjëherë ndeshen me çështjen e alfabetit. Popujt që kanë krijuar alfabetet e njohura të njerëzimit janë fare të paktë, rrjedhimisht, gjithë të tjerët kanë përdorur shkronjat e një gjuhe të huaj ose i kanë përshtatur në ndonjë mënyrë. Në këtë rast nënkuptohet se autorët e teksteve të zanafillës kanë qenë dygjuhësh, madje e njihnin shkrimin në një gjuhë tjetër dhe e kanë përshtatur për gjuhën e vet apo edhe anasjelltas. Edhe për shqipen do të themi atëherë se ka nisur të shkruhet me alfabetet e marra prej gjuhësh të tjera, të cilat i kanë njohur autorët tanë të kulturuar si dygjuhësh.

Arsyet që e kërkojnë shkrimin e një gjuhe janë të ndryshme, por shtysat më vepruese vijnë nga kërkesat e ekonomisë, të tregtisë, të shtetit dhe të fesë. Ndërkaq, këto kërkesa është e nevojshme të gjejnë edhe mbështetjen e faktorëve të tjerë, që të sjellin te përpunimi i shkrimit konkret të një gjuhe. Gjuha shqipe gjithashtu do të shkruhej atëherë kur shkrimi shqip do t'u shërbente kërkesave ekonomike, tregtare, shtetërore dhe fetare të popullsisë shqiptare, dome-



thënë kur gjuha e shkruar e sunduesve të huaj nuk arrinte ta mbante e ta mbulonte tërësisht komunikimin e shkruar me shqiptarët dhe mes shqiptarëve. Popullsia e në veçanti shtresat vepruese në jetën e tij ekonomike-shoqërore kishin marrëdhënie me sundimtarët e huaj e me një varg popujsh të tjerë dhe prej atyre do të merrnin edhe alfabetin përkatës. Në shek. XIX, kur u mbryjt vetëdija kombëtare e shqiptarëve, madje si edhe për kombet e tjera – në dallim e ballafaqim me popujt rreth e rrotull, tashmë ishin në përdorim disa alfabete. Komunikimi në shkallë kombëtare, të cilin e nxori në plan të parë Rilindja Kombëtare, e bënte të nevojshme ngulitjen e një alfabeti të vetëm. Edhe më i nevojshëm do të ndihej një alfabet i përgjithësuar, kur në kapërcyell të atij shekulli, pas ngjarjeve të periudhës së Lidhjes së Prizrenit, po shihej gjithashtu perspektiva e një shteti shqiptar. Megjithatë, e quaj të domosdoshme të vë në dukje, se përveç këtyre faktorëve madhorë, marrin pjesë edhe disa aspekte më të ngushta kulturore e drejtpërdrejt gjuhësore, që e përshpejtojnë vendosjen e një alfabeti të vetëm.

Për ta ndriçuar këtë anë, mund të përmend ecurinë e hapit të dytë të menjëhershëm pas alfabetit, domethënë të drejtshkrimit. Edhe drejtshkrimi, që më pas i shërben ngulitjes së gjuhës standarde, nuk mund të shihet veçan nga nevojat e veprimtarive në një shtet, që zhvillohet nga ana ekonomike e kulturore, e sidomos në kohët e reja kur zgjerohen mjetet e komunikimit publik deri te mjetet e komunikimit masiv. Njëkohësisht në këtë ecuri kanë pjesën e tyre **kërkesat për punën arsimore dhe ato mirëfilli gjuhëso-**

**re.** Deri më sot janë trajtuar shpesh rrethanat shumëplanëshe, që sollën te Kongresi i Drejtshkrimit më 1972, por kanë mbetur pa u përmendur shtysat e drejtpërdrejta të punës gjuhësore. Ndër to *vendin themelor e zë hartimi i fjalorëve*. Arsyeya madhore është kjo: kur hartohet një fjalor, detyrimisht do të paraqitet një sasi e gjerë fjalësh e shprehjesh, shumë më e gjerë sesa në çfarëdo shkrim ose libër të veçantë. Hartuesi i fjalorit përballet me zgjidhjet që duhet të ndjekë si për alfabetin, ashtu edhe për drejtshkrimin e fjalëve e të thënieve. Rrjedhimisht, në historinë e alfabeve dhe të drejtshkrimeve të shqipes është e nevojshme të përfshihet edhe puna leksikografike, që i ka shoqëruar ato drejtpërdrejt.

Kongresi i Manastirit është paraprirë nga ngjarje me rëndësi në leksikografinë shqipe. Më 1904 më në fund u botua *Fjalori i gjuhës shqipe* i K. Kristoforidhit, pas vdekjes së autorit dhe i hartuar një çerek shekulli më parë me një alfabet të mbështetur në shkronjat greke. Siç e kam shtjelluar hollësisht në punime të tjera për këtë fjalor, ky fakt jo vetëm ndikoi mbi perceptimin e veprës, por nuk kaloi pa u lidhur me mprehtësinë e një problemi qenësor ndaj alfabetit të shqipes. Katër vjet më vonë, domethënë në vitin e Kongresit të Manastirit, do të dilte vepra që njihet me emërtimin *Fjalori i Bashkimit*. Ai jo vetëm ndoqi rrugën e Kristoforidhit, por edhe e shtroi përsëri çështjen e alfabetit në këtë ballafaqim që përftohej vetvetiu. Pavarësisht nga diskutimet, që e pranojnë ose e mohojnë se alfabeti i Kongresit të Manastirit në thelb ka qenë ai i Shoqërisë "Bashkimi" me disa ndryshime, mbetet dome-

thënës fakti që pikërisht botuesit e një fjalori janë në qendër të pikëpamjeve të ndryshme lidhur me caktimin e alfabetit.

Të njëjtën dukuri vëmë re me drejtshkrimet. Vepërimtaria e dendur për ortografitë e shqipes që nga viti 1948 është e pandarë nga puna leksikografike e kësaj kohe. Meritojnë të shënohen veçan *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 1954 dhe *Fjalori rusisht-shqip* i po atij viti. Mund të duket se pastaj kjo ndërlidhje e ngushtë e dyanshme nuk ka më peshë. Mirëpo menjëherë më 1955 nisi vështrimi kritik i Fjalorit të vitit 1954 pikërisht lidhur me kërkesën për hartimi e një fjalori tjetër të shqipes.<sup>1</sup> Rregullat e drejtshkrimit të shqipes si projekt u botuan më 1967. E quaj të nevojshme të vë në dukje se më 1965 ne tashmë kishim nisur të përzgjidhim fjalësin për fjalorin e ardhshëm të madh të gjuhës shqipe.<sup>2</sup> Ndërkaq ishte ndërtuar një Kartotekë e leksikut të shqipes me një punë të madhe të punonjësve të atëhershëm të Sektorit të Leksikologjisë e të Leksikografisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë. Fjalësi dhe Kartoteka ishin mbështetja e mirëfilltë shkencore për rregullat e drejtshkrimit. Sesa rëndësi vendimtare patën ato, e tregojnë zhvillimet e mëtejshme. Në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 u vendos me Rezolutë, që “brenda vitit 1974 të hartohet “*Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*”. Dihet se kjo pikë nuk u zbatua dhe Fjalori drejtshkrimor<sup>3</sup> doli më 1976. Ky fjalor u botua dhe mundi të botohej vetëm e vetëm sepse tashmë kishte përparuar puna për hartimin e veprës që më pas do të dilte më 1980 si *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*. Pa fjalësin e gatshëm të kësaj vepre dhe pa Kartotekën e Lek-

sikut të ngritur për atë vepër, asnjë lloj fjalori i vërtetë drejtshkrimor nuk do të ishte botuar me aq pak vonesë. Madje disa të meta që i ka Fjalori drejtshkrimor kanë si shkak të drejtpërdrejtë punën e papërfunduar të leksikografëve tanë, që nuk kishin arritur në atë kohë ta përpunonin tërësisht fjalësin. Dhe anasjelltas, nuk është vënë re se madje Fjalori i vitit 1980 për disa fjalë nuk e ka zbatuar Fjalorin drejtshkrimor. Vlerën e paçmuar të lëndës së mbledhur në Kartotekën e leksikut të shqipes e vërteton edhe një fakt tjetër: vepra madhore e prof. E. Çabejt deri në mesin e shkronjës F (Bleu IV, 1996) ka një pasuri referimesh nga skedat e asaj Kartoteke, ndërsa për shkronjat e mëtejshme vërehet një rënie dramatike e kësaj lënde pikërisht sepse nuk është shfrytëzuar më tej Kartoteka e leksikut të shqipes.

Madje edhe rendi i shkronjave në alfabet, ndonëse është konvencional, pasqyron një traditë, një orientim kulturor. Para Kongresit të Manastirit në mënyrë sistematike e ka paraqitur alfabetin në botimet e veta K. Kristoforidhi. Por ka ndryshime në renditje jo vetëm ndërmjet alfabetit latin të përshtatur sipas Lepsiusit dhe alfabetit grek të përzier, por edhe në rastin e këtij të fundit. Kështu, shtypja e Fjalorit të gjuhës shqipe më 1904 ka ndjekur rregullisht rendin e alfabetit të greqishtes, me shtesat e heqjet përkatëse. Shtesat janë bërë menjëherë pas shkronjës përkatëse të greqishtes. Ndryshe e ka ai autor renditjen në botimet me alfabetin grek të përzier më 1872, kur në fund ka shutar edhe 4 dyshkronjësha. Fjalori i Bashkimit, i botuar më 1908 ka ndjekur rendin e alfabetit latin dhe ka zbatuar po atë parim të Kristoforidhit: shtesat janë

bërë menjëherë pas shkronjës përkatëse latine. Një pamje krejt tjetër gjejmë te Fjalorthi i ri i N. Gazullit, i botuar shumë vjet më vonë pas Kongresit të Manastirit (1941). Ai e ka nxjerrë në krye, në vendin e katërt shkronjën "q", siç ndodhte në disa fjalorë të serbo-kroatishes; p.sh. Fjalori serbokroatisht-shqip, i botuar në Prishtinë më 1974, e jep në vendin e pestë. Kjo është e kuptueshme për autorë që ishin përgatitur në Jugosllavinë e mëparshme, por këtu ka diçka tjetër të papritur. Gazulli e ka përjashtuar nga rendi alfabetik i veprës shkronjën "ë", ndërsa brenda trupit të fjalëve e ka vënë pas shkronjës "e" në fjalët përkatëse (p.sh. *vejë, vëjesë, vektuer*). Ndryshe nga fjalorët europianë, që e kanë shkronjën "z" si të fundit (prej nga vjen shprehja italiane: *dall'a alla z*), Gazulli ka vënë në fund shkronjën "xh". Ndërkaq, ai ka shtuar dy shkronja të veçanta: "nd" dhe "ng", duke u nënkuptuar dy fone-ma të tjera. Rrjedhimisht, N. Gazulli i është kundërvënë Kongresit të Manastirit, por shmangia e tij nuk ka gjetur pasues dhe sot vetëm e vështirëson përdorimin e veprës së tij.

Pas këtyre ffillimeve do të kthehem te tema kryesore. Shkurt, autorët shqiptarë kishin nisur ta shkruanin shqipen me alfabetë të ndryshme për arsye të orientimeve të tyre kulturore, që konkretisht lidheshin me njohjen e një gjuhe tjetër për secilin rast përkatës. Por në shekullin XIX prania e alfabetëve të ndryshme e pengonte punën e Rilindjes Kombëtare dhe tashmë është trajtuar prej kohësh një shumësi faktorësh historikë e kulturorë, që e shtronin si domosdoshmëri arritjen te një alfabet i vetëm në përdor-



rim të përgjithshëm të shqiptarëve. Megjithatë, kemi përpara një pyetje kryesore: **Kur nisën përpjekjet e shqiptarëve për të arritur te një alfabet i përbashkët?** Vetëm faktorët historikë, politikë, shoqërorë e kulturorë nuk mund të japin një përgjigje të qartë. Prandaj më poshtë do të përpiqem ta plotësoj përgjigjen, duke përfshirë edhe anën e drejtpërdrejtë gjuhësore.

Pyetjes së mësipërme studiuesit i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme. Si viti i herës së parë është mbajtur 1864-ra edhe në historinë akademike.<sup>4</sup> Thuhet se u mbloodhën në Stamboll Ismail Qemali, Konstandin Kristoforidhi, Hasan Tahsini dhe Pashko Vasa. Ky kombinim ka qenë fryt i një dëshire të historianëve për të pasur një përfaqësim fatlum të gjithë krahinave e besimeve të Shqipërisë, por për fat te keq, ai nuk i përgjigjet së vërtetës dhe duhet mënjeluar si një mit. Ismail Qemali kishte qenë për herë të parë në jetën e tij në Stamboll më 1860, por më 1864 ishte në shërbim të guvernatorit të përgjithshëm të Janinës. U kthye në Stamboll në pranverën e vitit 1865. H. Tahsini nuk ka qenë në Stamboll deri në fillim të vitit 1864. Kristoforidhi erdhi atje gjithashtu në maj 1865. Pashko Vasa nuk duhet të ketë qenë në Stamboll nga mesi i vitit 1863 e deri në fund të 1864, rrjedhimisht, nuk i kishte njohur ende të tjerët. Si mund të takoheshin atëherë? Nuk është ndonjë shkelje e rëndë prania e gabimeve të tilla, por këtë herë nuk mund t'u falet historianëve që të japin data të paqena lidhur me disa nga figurat më të shquara të gjithë historisë sonë.

Duke rënë ky vit, çështja bëhet edhe me kureshtarë: **kur** atëherë? Megjithatë, unë besoj se ka një pyetje

tjetër, që duhej të shtrohej para saj: përse do të mbli-dheshin disa shqiptarë në Stamboll për një alfabet të përbashkët para mesit të viteve 60? Nuk kishte as shkolla shqipe, as shtypshkronja, as gazeta, as radio e televizion, as një infrastrukturë për përhapjen e librave, as dhe një librari. Edhe sikur disa shqiptarë të ndritur ta hartonin alfabetin e përbashkët, si do ta realizonin praktikisht përdorimin e tij? Si do ta fusnin në gjithë Shqipërinë? Duke e nisur gjurmimin nga kjo rrugë tjetër, me pyetjet: **kujt i duhej, përse dhe si**, do të gjejmë një përgjigje, që e rishikon gjithçka është shkruar deri më sot për këtë pikë me rëndësi të historisë sonë kulturore.

Vetëm në fund të majit 1865 Kristoforidhi erdhi nga Tunisi në Stamboll me një përkthim në dorëshkrim të Dhiatës së re. Botimin do ta bënte Aleksandër Tomsoni, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (BFBS). Ai donte një version gegërisht, sepse toskërisht përkthimi ishte botuar më 1827 nga puna e V. Meksit. Më tej në këtë libër lexuesi do ta gjejë me hollësi dhe të dokumentuar ecurinë e kësaj ndërmarrjeje pike-rishtë nga pikepamja e alfabetit si për Meksin, ashtu edhe për Kristoforidhin.

Sipas praktikës së zakonshme, përkthimi kërkonte një redaktim. Tomsoni kishte gjetur në Shkodër një të ri të arsimuar, Nikolla Serreqin. Edhe ai erdhi në Stamboll dhe ia nisën punës së bashku me Kristoforidhin. Por menjëherë lindi problemi i alfabetit. Tomsoni donte që për gegërishten të zbatohet alfabeti i bazuar mbi shkronjat latine i egjiptologut K. R. Lepsius. Por Serreqi u tregoi se në Shkodër përdorej një alfabet

i prejardhur nga tradita e autorëve të vjetër. Kristoforidhi kjo jo vetëm i pëlqeu, por pasi e mendoi mirë, e quajti zgjidhjen më të përshtatshme. Në shtator 1865 u mbledhën të tre dhe Kristoforidhi e mbrojti me forcë, duke pasur mbështetjen e plotë të Sereqit.

Kështu dy shqiptarë në Stamboll më 1865 hapën një diskutim për alfabetin e shqipes. Arsyeja ishte se do të bëhej një botim i rëndësishëm nga Bibla, një libër që me mbështetjen e fuqishme të Shoqërisë Biblike do të përhapej gjerësisht. Tomsoni e mori çështjen seriozisht. Kjo nuk do të mbetej e mbyllur midis tre vetave, Tomsoni do ta rrihte me njerëz të ditur të Londrës dhe me miqtë shqiptarë në Stamboll; edhe Kristoforidhi do të kërkonte mendimet e tyre. Në fund të fundit, Tomsoni ishte botuesi dhe u zbatua kërkesa e tij. Me këtë alfabet do të dilnin më 1866-1867 disa libra të Kristoforidhit: Ungjijtë, Abetarja gegërisht dhe Katekizmi. Menjëherë pas tyre do të dilte edhe Abetarja toskërisht, me alfabet sipas greqishtes, por gjithnjë me sistemin e Lepsiusit. Debati do të ndizej kudo, ku do të arrinin këto botime. Sidomos në Stamboll shqiptarët e shihnin se çfarë roli luanin botime të tilla edhe për kulturën e popujve të tjerë fqinjë. Do t'i shtjelloj në shkrimin e përfshirë në këtë libër për Kristoforidhin gjithë të dhënat interesante, që gjenden në letrat e Tomsonit. Ndërkaq, më 1867 tashmë përveç Pashko Vasës, ishin në Stamboll edhe I. Qemali, H. Tahsini e të tjerë atdhetarë.

Kishte edhe faktorë të tjerë, që e vatërzuan nevojën e një alfabeti të përbashkët dhe i ushqyen përpjekjet. Sundimi i sulltanëve po përjetonte një krizë, andaj

frynte një erë reformash. Ndër të tjera, do t'u bëheshin disa lëshime kulturore kombeve të ndryshme të Perandorisë Osmane. Për fat të keq, historia jonë akademike nuk i përmend këto anë, sikur atdhetarët shqiptarë nuk ishin brenda Perandorisë Osmane por jashtë zhvillimeve ligjore e administrative të saj, madje edhe jashtë ngjarjeve bashkëkohëse mes popujve të tjerë ballkanikë, që po ashtu luftonin për të njëjtat të drejta. Në këto rrethana, atdhetarët tanë përpunuan më tej planet për një gazetë javore në Shkodër. (Në të vërtetë, ajo doli shumë më vonë, më 1879 dhe me alfabet arab). Tomsoni mendoi ta shfrytëzonte këtë rast, që gazeta të dilte me alfabetin e përshtatur të Lepsiusit dhe kështu do ta lehtësonte leximin e përhapjen e botimeve të Shoqërisë. Ai e thirri shqiptarin, që mendohej të ishte botuesi i gazetës, dhe i shprehu dëshirat e veta. Nga ana tjetër, ai takoi ambasadorin e Perandorisë Britanike, H. Eliot, dhe i kërkoi që të njoftonte qeverinë osmane për botimet biblike dhe për alfabetin e përdorur në to. Çështja e alfabetit të shqipes po i paraqitej Portës së Lartë nga përfaqësuesi i fuqisë më të madhe të kohës, madje Porta e Lartë kishte marrë detyrime për botimet e Shoqërisë Biblike. As atëherë, as deri më sot këto fakte nuk kanë qenë të njohura, por tregojnë qartë, se autoritetet më të larta osmane nuk u interesuan rastësisht për alfabetin e shqipes, siç është paraqitur në mënyrë anekdotike edhe nga Shahin Kolonja më pas.

Kryetar i Këshillit të Shtetit më 1867 u thirr Mithat Pasha. Në kuadrin e reformave ai dekretoi edhe shkollën fillore të detyruar. Ismail Qemali ka

qenë mik i ngushtë i tij dhe bashkë me atdhetarët e tjerë ka menduar për shkollën fillore shqipe. Kjo mënyrë trajtimi është përjashtuar nga historianët tanë në punimet e tyre, duke mohuar të vërtetën fillestare, se edhe për të ndihmuar çështjen kombëtare veprimtarët tanë duhej të jetonin, të mësonin, të punonin e përfundimisht të bëheshin të njohur brenda rrethanave të pushtimit të huaj e në marrëdhënie me të. Konkretisht, një Ismail Qemali i panjohur, pa qenë funksionar i lartë e deri deputet, kurrë nuk do të kishte mundur të fitonte peshë në sytë e bashkatdhetarëve dhe të kancelarive europiane, domethënë kurrë nuk do të arrinte të kryente gjestin historik për shpalljen e pavarësisë sonë. Kristoforidhi sapo kishte botuar abetaret dhe librat e leximit pikërisht duke synuar shkollën shqipe. Besoj se tani lexuesi e sheh, sesi po ndërthureshin shumë faktorë, që e bënin të domosdoshëm alfabetin e përbashkët të shqipes: shkollat, gazetatat, abetaret, përkthimet. Ishin edhe njerëzit e aftë e tashmë të pjekur për t'i vënë shpatullat një ndërmarrjeje të tillë. Kështu e kemi gjetur përgjigjen e pyetjes: përse? Po piqej konkretisht ideja për një mbledhje të përfaqësuesve nga vise të ndryshme të Shqipërisë. Nëse në fillim do të ishte një komision për alfabetin, më tej ai do të shndërrohej në një hap vendimtar për organizimin e lëvizjes kombëtare. Nuk duhet harruar se shqiptarët ndodheshin edhe nën ndikimin e shembullit të shumë organizmave të tillë ndër popujt e tjerë të Perandorisë Osmane, madje edhe të rrymës rilindëse midis vetë turqve, që çoi në Shoqatën e Osmanëve të Rinj më 1867. Nuk ka vend këtu të shtjellohet me hollësi edhe

përvoja e arbëreshëve të Italisë, ndërkohë që ajo nuk duhet harruar. Ngjarjet e mëdha përgatiten në një kontekst të madh historik dhe prandaj nuk ka ndodhur kështu, që tre-katër shqiptarë na u mblodhën rastësisht, të shtyrë nga një ide e bukur: "Hajde të bëjmë një alfabet për gjithë Shqipërinë!".

Në vjeshtën e vitit 1869, në vazhden e po asaj krize qeveria osmane shpalli një plan për arsimin në gjuhët kombëtare. Duke përfituar nga kjo, edhe shqiptarët e ngritën menjëherë komisionin për shqipen, sepse çdo gjë ishte e përgatitur nga koha. Kështu saktësohet edhe kjo datë me rëndësi: **Komisioni për alfabetin e shqipes është ngritur në nëntor 1869**. Tomsoni na njofton se u zgjodh anëtar edhe Kristoforidhi, si një letrar i shquar, ndërsa më 10 nëntor ka marrë vesh prej tij se qëllimi ishte të krijohej një alfabet i ri për gjithë vendin. Në janar 1870 Komisioni e përfundoi punën.<sup>5</sup> Në planet e tij ishin edhe kërkesat për të përgatitur libra shkollorë, për të hapur shkolla dhe për të siguruar mësues. I gjithë ky plan u permbys, sepse qeveria natyrisht ishte e paaftë t'i përballonte shpenzimet. Ndërkaq, ne tani mund të shpjegojmë edhe një fakt që dihej. Kryeministri turk, Ali Pasha, kishte qenë tolerant për Komisionin, ishte interesuar drejtpërdrejt për mbledhjet e tij dhe e kishte shqyrtuar çështjen deri në Këshillin e ministrave. Tani ne e dimë cila ishte arsyeja prapa kësaj dukurie krejt të pazakontë, që qeveritari më i lartë i një perandorie u interesua për mbledhjen e disa anëtarëve të një komisioni për shkronjat: ai nuk ia prishte dot ambasadorit britanik. Më pas Ali Pasha u tërhoq jo vetëm sepse në kabinetin e tij kishte



kundërshtarë zyrtarë të një alfabeti të njësuar për shqipen, por edhe sepse ai nuk mund ta pranonte, që në këtë nismë lidhur me botimet biblike sipas tij, të bashkoheshin shqiptarët e të gjitha krahinave dhe të gjitha besimeve.

Me përjashtim të disa njoftimeve të tjera, si burim themelor për këto përpjekje të shqiptarëve ka shërbyer dorëshkrimi i Jani Vretos "Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe". Duke e rilexuar tashti paraqitjen e tij, ne mund t'i vëmë gjërat në vend. Është interesante, që studiuesit deri më sot nuk i kanë vënë re kontradiktat në vetë shkrimet e Vretos, që i kanë përshtjelluar datat e ngjarjeve. Kështu p.sh., Vretoja në një rast thotë se gjithë emrat i ka nga goja e Kristoforidhit, në një tjetër se ka qenë vetë pjesëmarrës. Është fare e dukshme, se ka qenë puna për dy faza të ndryshme, njëra i takon vitit 1869 dhe tjetra vitit 1872. Shkoqitjet e tjera do të jepen në faqet vijuese, prandaj do ta mbyll këtu, duke ritheksuar se Komisioni i parë për alfabetin e përbashkët të shqipes ka punuar në fund të vitit 1869. Përpjekjet e mëtejshme vijuan përmes shumë vështirësive e peripecive, derisa u arrit të kurorëzimi historik me Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip më 1879.

### Shënimet:

1. KOSTALLARI, A. (1955): *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, në: Buletin për shkencat shoqërore, nr. 4. Si një prej kërkesave më të rëndësishme për fjalorin normativ aty përcaktohet: “të jepet drejt ortografia e çdo fjale ose e variantit të saj letrar”. (f. 19)
2. LLOSHI, XH. (1991): *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*, në: SOT, nr. 5-6; ribotuar në: *Mbështetje për gjuhën letrare*, Tiranë, 1997, shih f. 34 dhe 37.  
3. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1976.
4. Në *Historinë e Shqipërisë*, vëllimi II, ribotim më 1984 thuhet: “Qysh në vitin 1864, sapo kishte vajtur në Stamboll, në bashkëpunim me bashkatdhetarë të tjerë që ndodheshin atje, si Pashko Vasa nga Shkodra, Ismail Qemali nga Vlora, Hoxha Hasan Tahsini nga Filati i Çamërisë, Konstandin Kristoforidhi kishte organizuar një varg mbledhjesh për ringjalljen e shoqërisë kombëtare...” etj. Është për të ardhur keq kjo këmbëngulje e vazhduar nga ana e disa historianëve për të përsëritur po ato gjëra historikisht të shtrembëruara, sepse lidhur me këtë rast dhjetë vjet më parë unë tashmë kisha botuar dokumentimin e këtyre ngjarjeve, që kanë rrjedhur krejt ndryshe.
5. Studiuesi turk Agâh Sırrı Levend në librin e përkthyer shqip *Sami Frashëri*, DITURIA, Tiranë, 2004, faqe 82 citon fjalët e botuara në një vepër të vetën më 1960 me titullin *Etapat e zhvillimit dhe të purizimit të gjuhës turke*, Instituti Turk i Gjuhësisë, Ankara 1960, botimi II, f. 160: “Shqiptarët, në një takim me Ministrin Osman të Arsimit, më 1869, kërkuan një alfabet të veçantë për gjuhën shqipe. Komisioni prej tre vetash i ngritur për këtë qëllim, pas një pune të gjatë hartoi për shqipen një alfabet me germa latine.” Ky pohim përputhet kështu me të dhënat tona dokumentare, por i mungon shtjellimi i hollësishtëm dhe do të ishte me vlerë nëse citimi do të jepte emrat e anëtarëve të tjerë dhe çfarëdo informacioni tjetër prej burimeve arkivore osmane.

## *Përgatitja e kongresit të alfabetit*

Një ngjarje si Kongresi i Alfabetit të Shqipes u përgatit nga rrjedha e historisë, në të cilën çështja e njësimimit të trajtës së shkruar për gjuhën u bë pjesë e lëvizjes së madhe për njësimin e ndërgjegjes kombëtare si parakusht dhe sfond i luftës për pavarësinë. Vendimet e tij përcaktuan jo thjesht shkronjat, por një orientim kulturor, që do të mbetej i përhershëm si tipar shquës i profilit të kombit.

Është e natyrshme që njoftimet rreth kësaj ngjarjeje si për periudhën e gjatë të parapërgatitjes, ashtu edhe më pas, do të ishin të shumta. Më 1972 janë botuar kumtesat e mbajtura në Seminarin shkencor në Tiranë (nëntor 1968) kushtuar 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit,<sup>1</sup> duke u shoqëruar me materialet më të rëndësishme të shtypit (vitet 1897-1910), bashkë me një përmbledhje dokumentesh arkivore (1880-1912). Kështu janë përvijuar dy rrathë njoftimesh: shtypi dhe arkivat.

Pas këtij vëllimi njoftimet nga shtypi janë pasuruar në shkrime të veçanta e sidomos në përzgjedhjen e botuar në dy vëllime për mendimin politik e shoqëror të Rilindjes.<sup>2</sup> Me interes janë, për shembull, artikujt nga "Yll'i Shqipërisë" (1898), "Kalendari i shoqërisë DIJA" (1906), "Kombi" (1907), "Kalendari Afërdita" (1910) e sidomos "Lirija" (1908-1909). Në rrethanat e njohura të kohës, më 1972 nga artikujt janë hequr pje-

së të caktuara për arsye politike, prandaj nevojiten botime të reja pa gjymtime të teksteve origjinale.

Ndërkaq, lënda arkivore e botuar më 1972 ishte mjaft e pasur dhe plotësimet për të gjatë tridhjetë e pesë vjetëve të kaluar, rrjedhimisht, kanë qenë të pakta. Lënda përbëhej kryesisht nga letra të atdhetarëve e materiale prej klubeve kombëtare të kohës dhe pothuaj tërësisht (me përjashtim të dy materialeve franceze) nga dokumente prej arkivave austro-hungarezë. Siç thuhet në Parathënien e botimit, kjo pasuri dokumentesh shpjegohet me interesat e njohur të Austro-Hungarisë në Ballkan e në Shqipëri. Ka njoftime të fundit se në arkivat austro-hungarezë ka mijëra faqe të tjera, që presin të dalin në dritën e botimit dhe kjo do të ishte shumë e mirëpritur. Ndërkaq e quaj të dobishme të paraqes disa thërrime të tjera, që janë jo pa interes.

Më 1999 kam botuar një dokument të ri për Kongresin e Alfabetit,<sup>3</sup> që vjen nga një burim tjetër: nga arkivat britanikë. Është përfshirë këtu në shkrimin më poshtë. Ai theksonte se Kongresi e tejkalonte cakun e miratimit të një alfabeti dhe ishte një hap i ngjashëm me bashkimin kombëtar. Më parë dëshiroj të jap disa njoftime të tjera nga burimet britanike, si dhe dy nga burimet austriake, që vijnë më parë sipas radhës kronologjike. Ndërkaq, që në fillim e vlen të nënvizohet, se interesimi i anglezëve për këto çështje nuk ishte i njëjtë me synimet gjeostrategjike të Austro-Hungarisë. Buronte nga një drejtim krejt tjetër, siç do ta shpjegoj shkurt menjëherë më poshtë.

Që në dhjetëvjetëshin e dytë të shek. XIX Shoqëria Biblike për Britaninë dhe Vendet e Huaja (BFBS) u in-

teresua për të bërë një përkthim shqip nga Bibla.<sup>4</sup> Fryt i kësaj ishte botimi më 1824 i Ungjillit të Mateut dhe më 1827 i së parës Dhiatë të re shqip prej përkthimit të Vangjel Meksit. Shqipja është dhënë aty me shkronjat e greqishtes. Në mesin e viteve 1860 në këtë fushë hyn me autoritet K. Kristoforidhi, i cili i botoi përkthimet e tij për jugun me alfabetin e mëparshëm mbi bazën e shkronjave të greqishtes, të përshtatura sipas zgjidhjes së K. Lepsiusit, dhe me alfabetin mbi bazën e shkronjave latine, përsëri sipas zgjidhjes së Lepsiusit, për veriun. Nevojat e këtyre botimeve dhe të materialeve për mësimin e shqipes Kristoforidhi vijoi t'i plotësonte duke përdorur të dy alfabetet. Por kur erdhi puna për ta zgjeruar rrethin e botimeve shqipe, e sidomos për daljen e një gazete shqip, çështja e alfabetit u bë shumë e mprehtë. Arkivi i BFSB na ka ruajtur materiale të vlefshme për këtë problematikë, nga të cilat saktësohen edhe hollësitë se kur, si dhe përse u bënë këto mbledhje, si e parashtrova në artikullin e parë më sipër. Prej tyre del se njoftimet e "Historisë së popullit shqiptar" edhe në botimin e fundit akademik (vëllimi II, Tiranë 2002), e natyrisht edhe të punimeve të tjera, janë në mjaft pika të gabuara e, për fat të keq, siç e vura në dukje nuk janë ndrequr, ndonëse i kam paraqitur prej kohësh të dhënat dokumentare përkatëse.<sup>5</sup>

Shfaqja në hapësirën shqiptare e alfabetit të Stambollit në fund të viteve 1870 e rishtroi në përmasa mbarëkombëtare çështjen e shkronjave. Tashmë këtë nuk mund të mos e merrte parasysh edhe përfaqësuesi i njohur i Shoqërisë Biblike në Stamboll, Aleksandër

Tomsoni. Kishte lindur problemi se me çfarë alfabeti do të botoheshin më tej përkthimet e Kristoforidhit ose libra të rinj. Në maj 1888 Tomsoni i ka parashtruar hollësisht rrethanat e reja, që e bënin të nevojshme ndërrimin e alfabetit pas punës me sukses të Shoqërisë së Stambollit (Dokumenti Nr. 1). Në maj 1889 i kërkoi Gjerasim Qiriazit të merrej me shtypjen e Mateut e të Psalmeve me alfabetin e Stambollit. Me ndërhyrjen e Naim Frashërit, në vend të Psalmeve u vendos të botohej Gjeneza (Të bërët). Të dy librat u shtypën në Bukuresht dhe janë të parët, në të cilët ndryshoi alfabeti i Kristoforidhit, i përdorur deri më atëherë. Por botimet e tjera me ndryshim të alfabetit, me të cilat u morën Gjergj Qiriazit dhe Athanas Sina, u ndaluan nga pushteti i asaj kohe. Nuk mund të mos nxjerr në pah një pohim të Tomsonit në këtë dokument: *“nëse do të jetë toskërishtja, që do të zbatohet, e cila është dialekti më i përpunuar i Shqipërisë.”* Kjo thënie është 17 vjet përpara se A. Xhuvani të shkruante gjithashtu për bazën dialektore të gjuhës letrare dhe e vlen të përfshihet në qarkullimin shkencor edhe në diskutimet e sotme mjaft të nxehta për këtë pikë. Në shtator 1895 Tomsoni i ka shpjeguar Komitetit në Londër që “nuk duhet të shtypim më gjë me alfabetin e greqishtes dhe gjithçka këtej e tutje duhet ta shtypim me alfabetin shqiptar.” Kjo shënonte një kthesë në botimet shqipe.

Emrat e Qiriazit dhe të Sinës na lejojnë të vendosim një lidhje ndërmjet njoftimeve austriake dhe atyre angleze. Më 14 korrik 1901 nënkonsulli i njohur A. Kral nga Manastiri (Dokumenti Nr. 2), pasi e vlerëson alfabetin e Shoqërisë së Stambollit si “një zbulim i lar-



të, një krenari kombëtare që nuk mund të preket”, parashtron për herë të parë idenë se “alfabeti i ardhshëm i përbashkët do të vendosej në një kuvend atdhetarësh të shquar, me delegatë të dërguar prej tyre vetë.” Besoj se kjo ide i është thënë nga atdhetarët shqiptarë në Manastir dhe ndoshta **korriku 1901 do të quhej zanafilla e projektit për Kongresin e vitit 1908**. Është interesante që gjashtë muaj më vonë (3 shkurt 1902) po A. Krali ka dhënë njoftime të hollësishme për punën e Kristoforidhit lidhur me zhurmën e madhe për botimin e Fjalorit të tij dhe përmend për herë të parë dorëshkrimin e “Gjahut të malësorëve”, që iu dërgua “Albanisë” për ta botuar atë vit.

Një mbështetje të tërthortë për këtë e gjejmë te një artikull i botuar më 18 tetor 1902 në gazetën “La Nazione Albanese” të Katanzaros, me sa duket nga pena e Gaspër Jakovës. Ndër të tjera aty thuhet: “... të delegohet një person i ngritur e i arsimuar që të shkojë për ta shqyrtuar këtë çështje në Bukuresht, në Sofje dhe në kolonitë italo-shqiptare për një tubim të ri të përgjithshëm, në të cilin të vendoset mbi ortografinë që duhet të pranohet në mënyrë universale nga të gjithë, me qëllimin e frytshëm që, mirë apo keq, kombi të unifikohet së paku në pikëpamje ortografike.”<sup>6</sup>

Pas A. Tomsonit detyrën e përfaqësuesit për BFBS në Perandorinë Osmane e mori T. R. Hodgson-i (Hoxhson). Në mes të vitit 1903 ai iu drejtua ambasadorit britanik në Stamboll lidhur me shkrimet shqip, që kishin tre vjet në shtyp, por botimi u refuzua. Prandaj do të pritej Kongresi i vitit 1908, që interesimi

i shërbimeve informative konsullore të zgjohej menjëherë me forcë.

Konsulli austriak në Manastir, P. Postlin, ka dërguar një raport më 14 dhjetor nga Manastiri (Dokumenti Nr. 3). Në vëllimin e vitit 1972 të përmendur më lart, dokumentet nr. 73, 74 dhe 75 janë botuar, duke shënuar në fund "Firmë e palexuar". Besoj se tashti mund të thuhet pa ngurrim, që janë raportime po ashtu të P. Postlinit. Është me rëndësi të veçohen radhët, në të cilat, vetëm një muaj pas vendimeve të Kongresit të Alfabetit, shprehet qartë që, ndonëse u pranuan dy alfabetet, "do të përkrahet kalimi në alfabetin latinisht si i vetmi alfabet për gjuhën shqipe, gjë që është paraparë nga një parti e rëndësishme atdhetarësh shqiptarë (siç janë: Fehim bej Zavalani, Dhimitraq Buda, Grigor Cilka, at Fishta, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi etj.)." Sërish si emër qendror del ai i Gjergj Qiriazit.

Dy muaj pas Kongresit e ka radhën T. R. Hoxhsoni, që të dërgojë njoftimet e tij nga Stambolli për Alfabetin e gjuhës shqipe (Dokumenti Nr. 4). Është e qartë që burimi për të ka qenë *relacioni i Gjergj Qiriazit*, i datës 20 janar 1909, të cilin e ka marrë dy ditë më pas dhe që i ishte përcjellë edhe konsullatës austriake në Manastir, e prandaj ndodhet në arkivin e Vjenës (H.H.St.A, P.A.A). Gjergj Qiriazi na del kështu figurë kryesore jo thjesht si nënkryetar i Kongresit, por si burimi i njoftimeve më të plota dokumentare për Kongresin, madje edhe për diplomacinë e opinionin e huaj.<sup>7</sup> Sipas Hoxhsonit, edhe atë vetë e kishin ftuar të merrte pjesë në Kongres dhe për më tepër, sipas tij, Qiriazi aty vajti si përfaqësues i Shoqërisë Biblike, po-

him që nuk mbështetet nga kriteret e caktuara për delegatët. Relacioni ka qenë i gjatë, prandaj përmbledhja e nxjerrë nga Hoxhsoni nxjerr në pah idetë qendrore. Për Hoxhsonin *“nuk ka dyshim se alfabeti latin, i cili i vë shqiptarët më afër në kontakt me jetën moderne dhe mendimin e Europës Perëndimore, ngadalë por në mënyrë të qëndrueshme ka çarë rrugë dhe në fund të fundit do t'i zëvendësojë të tjerët pak nga pak. Gjithashtu nga shumica e shqiptarëve të arsimuar ai mbahet si mjeti më i përshtatshëm për të paraqitur tingujt zanorë e bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe.”*

Pas Kongresit, mesazhet e të cilit ishin të qarta edhe për qarqet antishqiptare, këto ndërmoren një fushatë të ethshme për të penguar ndikimin e tij dhe zbatimin e vendimeve. Çështja e alfabetit përsëri doli ashpërsisht e lidhur me politikën. Nga ana e burimeve britanike është me interes një shkrim i gazetarit Charles H. Woods (Vudz), i botuar në shtator 1910 (Dokumenti Nr. 5). Vudzi në atë kohë quhej autoritet për çështjen shqiptare. Në periudhën e Konferencës së Ambasadorëve në Londër ai përfitoi nga qëndrimi i Ismail Qemalit në Londër dhe i mori një intervistë të posaçme, me titullin *“Çfarë thonë shqiptarët”*, e cila u botua në gazetën *“The Evening News”*.<sup>8</sup> Në disa raste ai e kishte ndihmuar Shoqërinë Biblike me informacione rreth Shqipërisë. Për këtë arsye, më 17 maj 1913 ndërmjetësoi pranë BFBS, që I. Qemali të bënte një vizitë jozyrtare në selinë e kësaj Shoqërie. Kjo është arsyeja që dokumentacioni për këtë ngjarje ndodhet në arkivin e BSFBS. Pas kësaj vizite, më 20 maj 1913, Vudzi ka botuar artikullin *“Për zgjidhjen e çështjes shqiptare”* po

në atë gazetë.<sup>9</sup> Ndër të tjera, ai ngulte këmbë, se duhej “të krijohej dhe të ngrihej në këmbë një Shqipëri me të vërtetë e pavarur.”

Nuk është e rastit, pra, që Vudzi botoi më 1910 artikullin me titull “Alfabeti dhe çështja gjuhësore në Shqipëri”. Alfabetin ai e quante pjesën përbërëse të parë të çështjes arsimore në Shqipëri, ndërsa si pjesë tjetër po aq me rëndësi quante vendin që zinte gjuha shqipe në shkollë. Kështu, rrjedhimet më të drejtpërdrejta të Kongresit të Alfabetit ishin për luftën që të fitonte shkolla shqipe. Për gazetarin anglez, Kongresi i rëndësishëm shqiptar kishte pasur si qëllime kryesore diskutimin e alfabetit dhe të çështjeve arsimore. Shqiptarët vendosën zbatimin e shkronjave latine, sepse ato mësohen më lehtë prej popullit dhe janë më të përshtatshme për ta shprehur gjuhën. Ky sistem shkrimi e leximi në fund të fundit jo vetëm do të sillte bashkimin e fiseve dhe të krahinave me anë të një literature të përbashkët për të gjithë, por kështu do të bëhej e mundur edhe që librat shqip të shtypeshin në Europë. Pasi vinte në dukje, se osmanët kishin ndjekur një kundërshtim të vjetër e të thellë kundër zbatimit të shkronjave latine në Shqipëri, autori nënvizonte: *“Meqenëse shqiptarët janë ‘shqiptarë’ përpara se të jenë qoftë myslimanë, qoftë të krishterë, këto përpjekje nga ana e turqve deri më sot kanë pësuar dështim të plotë.”*

Për Shoqërinë Biblike natyra e shkronjave të shqipes kishte pasojë vendimtare për veprimtarinë e mëtejshme në Shqipëri, domethënë për të ardhmen. Interesi i Perandorisë Austro-Hungareze do të zhdukej vetëm pak vjet më pas bashkë me zhdukjen e vetë peran-

dorisë dykrerëshe. Kurse për BFBS puna do të vazhonte deri në ditët tona (kur ka një Shoqëri Biblike Shqiptare në Tiranë). Pas fillimit në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XIX të botimeve me alfabetin e Stambollit, tashmë duhej bërë një kthesë tjetër.

Ndërkaq, një faktor i ri ndërlikohet në këtë punë. Hoxhsoni ishte përfaqësuesi i një tradite të gjatë prej pothuaj një shekulli të Shoqërisë Biblike (BFBS) me punën për gjuhën shqipe. Ai ishte këmbëngulës për ta mbrojtur emrin e shoqërisë së vet dhe, me sa duket, ishte xheloz përballë përpjekjeve të ndërhyrjes nga ana e të tjerëve në këtë fushë. Fjala është për Misionin e Seksionit Amerikan në Turqinë Europiane (European Turkey Mission of American Board). Ata iu drejtuan atij me një letër nga Selaniku më 25 prill 1911 (Dokument Nr. 6). Letra është me frymë mirësjelljeje dhe vlerësimi, por bie në sy se është një kërkesë që Hoxhsoni të bënte ndryshime të thella në drejtimet e punës së vet. Dy gjëra e vlejné të theksohen veçan. Së pari, edhe në perceptimin e të huajve shquhet se Kongresi i Manastirit nuk është parë thjesht si hap vendimtar për një alfabet të përbashkët, por edhe për njësimin e shqipes si gjuhë standarde. Duke u njohur pesha e punës së Martin Luterit në përcaktimin e gjermanishtes standarde nëpërmjet përkthimit të Biblës, shprehet mendimi se edhe për gjuhën shqipe do të ndodhë e njëjta gjë. Në rrjedhat tona të diskutimeve për këtë çështje janë përdorur terma të ndryshëm, kurse këta përfaqësues të huaj pa asnjë mëdyshje e kanë shprehur qartë se është fjala për një gjuhë standarde dhe nuk kishte si të pritej ndryshe nga njerëz që e dinin

mirë çfarë ishte anglishtja standarde. Por ata e quanin se edhe baza tashmë ishte vendosur: dialekti i Elbasanit do të jetë standardi kombëtar.

Kërkesa sado me mirësjellje nuk i ka pëlqyer Hoxhsonit. Kështu vijmë te pika e dytë. Ai e ka përcjellë letrën në Londër, por me një shënim të shkurtër në fund. Vlerësimet e tij janë një kundërshtim i hapur, duke e ngritur lart toskërishten, me të cilën ai punonte në vijimin e përkthimeve, dhe duke u përpjekur t'i zhvlerësonte gegërishten përgjithësisht dhe elbasanishten në veçanti. Në këtë mënyrë me zemërim të përmbajtur i është shprehur Londrës, që të mos i merrte para sysh fjalët e misionarëve amerikanë. Nuk e kam gjetur, por në "Procesverbalet e Nënkomitetit të Botimeve", vëllimi 38, f. 14, përmendet letra që Hoxhsoni do ta ketë dërguar bashkë me kërkesën e Misionit Amerikan. Përmbledhja e letrës thotë: "Dërgon një letër nga European Turkey Mission of the American Board, i cili kërkon që Ungjijtë shqip të jenë në dialektin e Elbasanit. Megjithatë, vë në dukje se ky Mision nuk ka arritur të hapë ndonjë punë në Shqipëri, as nuk i njohin mirë ata dialektet e shqipes. Çështja kryesore është të nxirren Shkrimet në alfabetin kombëtar të propozuar tashti dhe të mos ngatërrohem pikërisht tashti me dialektet."

Një muaj më pas Hoxhsoni i shkruan përsëri Londrës lidhur me botimet në gjuhën shqipe. Hoxhsoni më së fundi e ka bërë vizitën në Manastir, ku botimet e BFBS do të bëheshin të gjitha me alfabetin e ri. Po sjell të përkthyer këtu pjesën që ka të bëjë me shtypshkronjën e Manastirit dhe me botimet atje (Doku-



menti 7). Bie në sy se Hoxhsoni e ka vijuar diskutimin e problemit për variantin e gjuhës së shkruar shqipe dhe e ka rimarrë idenë e misionarëve amerikanë, duke theksuar: *“Shkrimet që po botojmë do të bëjnë më shumë punë se çfarëdo mjet tjetër drejt shkrirjes dhe formimit të gjuhës shqipe.”*

Ndërkaq, besoj se këto dokumente mundësojnë që të arrihet në një përgjithësim tjetër: ato vërtetojnë se vendimet e Kongresit të Manastirit jo vetëm ishin shprehje e vullnetit mbarëshqiptar për një zgjidhje përfundimtare të çështjes së alfabetit, por edhe se **vendimet e Kongresit të Manastirit u pranuan menjëherë edhe në shkallë ndërkombëtare** e pa asnjë vonesë u vunë në zbatim.

Pikërisht kësaj i kushtohet dokumenti i fundit, që dëshiroj ta përfshij me të tjerët, si rrjedhimi përmbyllës i vendimeve të Kongresit të Alfabetit (Dokumenti Nr. 8). E përmend edhe letrën e majit, që vetë kishte dërguar nga Manastiri. Shtypshkronja, sipas tij, ishte mjete më i madh për të mirat, për të cilat kishte nevojë Shqipëria. Kështu, pas botimit të disa ungjijve të veçantë më 1909, doli Dhiata e re e plotë toskërisht më 1910 në Manastir. Pas kësaj deri më 1914 po në këtë shtypshkronjë do të shtypeshin edhe gjashtë libra të Dhiatës së vjetër me alfabetin e sotëm.

Dëshiroj ta mbyll me një incident kureshtar. Më 1899 ishin kthyer në alfabetin e Stambollit dhe do të shtypeshin Psalmet. Siç e tregon Hoxhsoni në dokumentin e fundit, dy fashikuj kishin mbetur për t’u plotësuar nga Bojaxhiani në Stamboll, por ai nuk pati mundësinë ose nuk deshë t’i plotësonte, prandaj do të

përfundoheshin në shtypshkronjën e Manastirit. Kështu, më 1911 doli një libër i botuar me alfabetin e Stambollit. Për të mos u krijuar përshtypja se me këtë kundërshtojë vendimi i Kongresit të vitit 1908, A. Sina në faqen II ka bërë një shënim shpjegues, se kjo nuk ishte një kundërvënie me Abecenë e Kongresit të Manastirit.<sup>10</sup> Kemi një tregues bindës, se pavarësisht nga fakti që formalisht më 1908 u lanë në përdorim të dy alfabetet, njerëz si atdhetarët e letrarët në Manastir e kishin të qartë se duhej përdorur besnikërisht alfabeti i ri. Materialet nga arkivi i BFBS na tregojnë se rrjedhimet e Kongresit të Alfabetit ishin të menjëherëshme e madje me ndikim të drejtpërdrejtë edhe në arsimin e në botimet shqipe, duke u pranuar pa mëdyshje gjithashtu nga të huajt që lidheshin me këto veprimtari.

Dokumentet e reja angleze e austriake i kam sjellë të plota të përkthyer, meqë nuk kanë qenë të botuara deri më sot.

*Shënimet:*

1. *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*. Studime, materiale, dokumente. Tiranë, 1972.  
*Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*. (Përmbledhje artikujsh nga shtypi). Vëllimi I (1879-1908), Tiranë 1971; Vëllimi II (1908-1910), Tiranë 1976.  
 LLOSHI, XH. (1999): *Një dokument për Kongresin e Manastirit*, në: Studime historike, nr. 1-2, f. 185-192.  
 Shih trajtimin e hollësishëm dhe dokumentet kryesore përkatëse në: Xh. Lloshi, Të dhëna dokumentare të reja mbi vepërimtarinë e V. Meksit, G. Gjirokastritit dhe K. Kristoforidhit, në: Studime filologjike, 1973, nr. 4, f. 167-185; 1974, nr. 1, f. 97-144; nr. 2, f. 127-161; nr. 3, f. 173-193; ribotuar në: Kristoforidhi përmes dokumentimit. Bota Shqiptare, Tiranë 2005.  
 LLOSHI, XH. (1995): *Kur u mblohdën shqiptarët për alfabetin e përbashkët?*, në: Lajmi i ditës, 10 dhjetor dhe 12 dhjetor.  
 PLLANA, SH. (1981): *Dokumente arkivore të Vjenës mbi alfabetin dhe arsimin shqiptar (1898-1905)*, në: Vjetar, f. 497.  
 Në referatin e prof. M. Domit, mbajtur në sesionin shkencor të vitit 1968, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vërehet qartë një qëndrim negativ kundrejt Gjergj Qiriazit. Rrjedhim i kësaj është mospërfshirja në dokumentet e botuara më 1972 e Relacionit të Gj. Qiriazit të datës 20 janar 1909, gjë që përbën një mangësi të rëndë të vëllimit.  
 WOODS, CHARLES H. (1913): *What the Albanians say*, në: The Evening News, 29 prill.  
 WOODS, CHARLES H. (1913): *For the solution of the Albanian question*, në: The Evening News, 20 maj.
9. *Me-qënë-që të 10 kollët' e para ishin shtypurë ndë Konstantinopojë që mbë 1899, prej nevoje u shtrënguemë të përdorimë gjithatë Abecce edhe ndë të 2 format' e fundit që u shtypnë siojet ndë Manastir. Le të mos pandehujë pra ndonjë, se dyke bërë kështu nukë presimë Abecet' e Kongresit të Manastirit*. A. Sina, në: *Psalltiri, kthyerë shqip ndë të folë toskërisht*. Manastir, Shtypëshkronja tregëtare Ndërkombëtare, 1911, f. II, Shënim.



## *Dokumentet*

### *1. Letër e A. Thomsonit,*

*Londër, 30 maj 1888.*

Komiteti [i BFBS] është në dijeni që Dhiata e re toskërisht e gegërisht dhe disa libra të Dhiatës së vjetër janë botuar me alfabetet grek e latin përkatësisht, por shoqëruar me pika e theksa për të treguar tingujt e veçantë e të shumtë të shqipes. Unë jam i bindur se kjo mënyrë e zbatuar që më 1820 në Dhiatën e re toskërisht ka qenë e arsyeshme. Njerëz me pak shkollë dhe që kishin dëshirë për të mësuar fjalën e Zotit kështu me pak përpjekje u aftësuan për ta plotësuar atë. Por kjo mënyrë doemos ishte vetëm e përkohshme dhe mund të parashikohej me lehtësi, që kur të ngrihej fryma kombëtare dhe kur të kapërceheshin rivalitetet e ushqyera nga qeveria midis toskëve e gegëve, do të ishte shumë e dëshirueshme, që të vendosej një mënyrë e vetme shkrimi për gjithë vendin. Siç duket, kjo kohë tashti ka ardhur ose të paktën po agon.

Është formuar një Komitet shqiptar, i përbërë nga gegë e toskë, të krishterë e myslimanë, që ka hartuar një alfabet, i cili është në fakt latin, duke shtuar disa

shkronja të shpikura, dhe në këtë alfabet ata kanë botuar disa libra fillestarë shkollorë e po i vazhdojnë përpjekjet. Gjithashtu kanë hapur të paktën një shkollë në qytetin e rëndësishëm të Korçës, një ditë rrugë nga Manastiri, e janë menduar edhe shkolla të tjera.

Anëtarët e këtij Komiteti shprehin falënderimet për Shoqërinë, e cila ka paraprirë dhe u ka dhënë dijet më të mira njerëzve në gjuhën amtare, si dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë me ne. Natyrisht, përfaqësuesi juaj kishte dëshirë gjithashtu që ky Komitet të mbante një qëndrim të favorshëm ndaj Biblës dhe për këtë qëllim, lidhur me vizitën e fundit të z. Qiriazi në nëntor 1887 në Korçë, e autorizoi ta furnizonte shkollën me aq kopje të ungjillit të Mateut sa të kërkoheshin. Ato u pranuan me falënderime dhe e gjithë vizita e tij pati shumë sukses.

Ky Komitet ka ardhur tashti me kërkesën që të botojmë Ungjillin e Mateut e Psalmet në njërin nga përkthimet që kemi, por me alfabetin e ri, dhe ata premtojnë se do t'i përdorin në shkollat e tyre e njëkohësisht midis bashkatdhetarëve do t'i nxitin shitjet e shkrimeve në alfabetin grek e latin, që Shoqëria tashmë i ka të gatshme. Unë u thashë se nuk mund t'i kërkoja Komitetit tonë të pranonte ndonjë propozim të tillë, që do të përfshinte ndonjë pjesë tjetër të Shkrimeve, derisa stoku që kemi të mos mbarohet ose të zvogëlohet mjaft, dhe e autorizova z. Qiriazi të diskutonte me këtë Komitet në Bukuresht, të merrte vlerësimet e çmimeve dhe të llojeve të letrës e të shkronjave, si dhe të rregullonte ndreqjet e shtypit. Unë i kam tekste, toskërisht e gegërisht, apo dhe një ndërthurje

të arsyeshme të të dyve si një çështje me rëndësi, që do të kërkojë mjaft studim. Nuk i kam parë vlerësimet e komitetit të Bukureshtit, as vendimin e tyre lidhur me dialektin përkatës që duhet përdorur, por sa për propozimin vetë, nuk ngurroj të them se e përhëndes me mirënjohje.

Z. Qiriazhi propozon t'i rishikojë vetë me kujdes fletët gjatë shtypjes, por po të autorizohet shtypja, duhet bërë në Bukuresht, ku Komiteti Shqiptar shtyp librat e vet. Meqë midis anëtarëve të këtij Komiteti ka letrarë, do të ishte mirë të dëgjonim propozimet e tyre mbi tekstin që duhet pranuar, e ndoshta nëse do të jetë toskërishtja, që do të zbatohet, e cila është dialekti më i përpunuar i Shqipërisë, do të dalë e nevojshme për z. Qiriazhi t'i kushtojë vëmendjen më të madhe përgatitjes së tekstit për Mateun e Psalmet para se të ndërmerren hapa të tjerë. Për këtë pikë unë nuk mund të jap një përgjigje të prerë, megjithëse shqyrtimi i faqeve mostër mund të tregojë nëse është zbatuar toskërishtja apo gegërishtja, siç i ka botuar Shoqëria jonë.

*Arkivi i Shoqërisë Biblike (BFBS).  
Editorial correspondence. Inwards.  
Nr. 23, f. 259-260.*

## 2. Njoftim i nënkonsullit A. Kral,

*Manastir, 14 korrik 1901.*

Qiriazi dhe Sina, të cilët nuk janë aspak të varur në mënyrë fanatike pas alfabetit të Frashërit, do të ishin të lumtur ta përdornin këtë tjetrin edhe në shkollën e tyre, po të mos ndruheshin se me këtë do të shkaktonin keqkuptime dhe zemërim të bashkatdhetarëve të tyre të afërt, pasi të parin dikur një kuvend atdhetarësh e ka shpallur si të thuash në mënyrë zyrtare dhe që prej më tepër se njëzet vjetësh është në përdorim, e prandaj shihet si një zbulim i lartë, si një krenari kombëtare, që nuk mund të preket. Brezi i vjetër nuk do ta pranonte një ndryshim të kësaj gjendjeje, ndërsa brezi i ri vetëm atëherë, nëse alfabeti i ardhshëm i përbashkët do të vendosej në një kuvend atdhetarësh të shquar, me delegatë të dërguar prej tyre vetë.

*Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Wien.  
Politisches Archiv. Albanien, XIII, 1-21.  
Faszikel XIV, 20.*



### *3. Raport i konsullit Posfai Postlin,*

*Manastir, 14 dhjetor 1908.*

Në raportin tim mbi prirjet e klubit të këtushëm shqiptar "Bashkimi" pata nderin të prekja edhe synimet e atdhetarëve të këtushëm shqiptarë për të ngritur një shtypshkronjë, e cila do të bënte të mundur shtypjen e një gazete, botimin e librave shkollorë dhe librave të tjerë, që kanë të bëjnë me frymëzimin e aspiratave kombëtare.

Pas bisedimeve të gjata, për arsye praktike u themelua një Shoqëri shqiptare për botime letrare, krejt e pavarur nga Klubi, e cila përbëhet nga Fehim bej Zavalani - kryetar, Gjergj Qiriazi - nënkryetar, Ferid bej Ypi Starja - sekretar, si dhe nga Sotir Peci - redaktor i "Kombit" dhe Athanas Sina - agjent i BFBS në Rustçuk.

Sipërmarrja në të vërtetë është menduar si shoqëri aksionare, por për të thjeshtuar kushtet paraprake ligjore, në vend të aksioneve do të emetohen dëftesa dhe bono me emër, konkretisht 1500 copë me nga 20 franga me 3 për qind interes.

Sotir Peci do të sjellë shtypshkronjën e "Kombit" nga Bostoni në Manastir dhe ndërkohë do të ndërmarrrë një udhëtim për Egjipt e Rumani, me qëllim që të shpërndajë bonot.

Shtypshkronja do të shtypë një gazetë, e cila do të mbajë titullin "Kombi"; tani për tani ajo do të përdorë të dy alfabetet e pranuar nga Kongresi, alfabetin latin dhe atë të Stambollit, sidomos do të përkrahet ka-

limi në latinin si i vetmi alfabet për gjuhën shqipe, gjë që është paraparë nga një parti e rëndësishme atdhetarësh shqiptarë (siç janë: Fehim bej Zavalani, Dhimitraq Buda, Grigor Cilka, at Fishta, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi etj.).

Njëkohësisht shtypshkronja do të pajiset me germa greke, bullgare e turke, me qëllim që të mund të botohen edhe veprat në këto gjuhë, të cilat nuk janë në kundërshtim me frymën e Shoqërisë dhe për ta zgjeruar ndërmarrjen në këtë rrugë. Edhe botimi i shkrimeve të reja të BFBS, të përkthyer nga Bibla, ose shkrime të tjera fetare do të kihet parasysh nga shtëpia botuese.

50% të fitimeve neto duhet të shkojnë për shpërndarjen falas të botimeve, që përkrahin qëllimet kombëtare, dhe 50% (me përjashtim të interesit 3%) duhet të kalojnë si dividende për të hollat e bonove.

Duke marrë parasysh faktin se kjo Shoqëri letrare përbëhet prej elementësh të shquar atdhetarë e shkrimtarësh shqiptarë, ndjenjat miqësore të të cilëve për monarkinë janë absolutisht të sigurta, besoj se mund ta përkrah lutjen e z. Qiriazi, që Shkëlqesia juaj të keni mirësinë ta ndihmoni materialisht ndërmarrjen, duke blerë një numër bonosh.

Qëndrimet kryesore për një ndihmë energjike sipërmarrjes në fjalë do të ishin në veçanti:

Një simpati mjaft e qartë për monarkinë, siç është shprehur nga gazetatat shqiptare, të cilat subvencionohen prej nesh, mund të kishte si pasojë sulme diskredituese të raporteve të ndryshme, që vijnë jo vetëm nga jashtë – deri tani nga ana e Italisë dhe Rusisë,

tashti së fundi edhe nga ana e xhonturqve – por edhe në qarqet shqiptare, për shkak të shtimit të vazhdueshëm të mosbesimit kundrejt ndërhyrjes së huaj, që do të kishte pasoja të papëlqyeshme.

Pikërisht kohët e fundit kanë treguar qartë, se ndjenjat e miqësisë për Italinë dhe monarkinë e mposhtën pak egoizmin e shëndoshë kombëtar të atdhetarëve shqiptarë.

Prandaj, për mendimin tim jokompetent, duhet synuar më përpara për krijimin e një gazete shqiptare me të vërtetë të mirë, sipas modelit të gazetave të huaja të përditshme, përderisa nuk ekziston ende një e tillë.

Kjo gazetë do të kultivonte prirjet thjesht kombëtare e atdhetare dhe do të shmangte me kujdes çdo shfaqje simpatie ndaj shteteve të huaja, kështu që me mendësinë e saj dhe duke mos pasur paragjykime, do të fitonte besim të plotë në një rreth të gjerë lexuesish shqiptarë.

Me këtë mënyrë do të përjashtohej *a priori* të paktën një ndikim i padëshirueshëm i gazetës më të madhe shqiptare dhe do të përftohej një drejtim i përshtatshëm e i shqiptuar i gazetës.

Megjithatë, bonot paraqesin vlera në të holla dhe në vend të ndihmave të Shkëlqesisë suaj të dhëna në të holla për interesat shqiptarë, ato mund të gjejnë përdorim të gjithanshëm, po edhe mund të shlyhen pak nga pak, sipas përpjesëtimeve të zhvillimit të sipërmarrjes, kështu që blerja e një numri bonosh mund të derdhej vetëm si një hua.

Prandaj do të lutesha të më lejohet që t'i propozoj Shkëlqesisë suaj të keni mirësinë të autorizoni z.

Gjergj Qiriaz, që të nënshkruajë në emër të tij ose të një bashkëpunëtori të vet, siç është p.sh. Fehim bej Zavalani, 300 bono baras me shumën 300 nap. ar, por në këtë rast me kusht që subvencionimet e siguruara më parë të kenë arritur shumën e 700 bonove dhe nga kjo të sigurohet sukcesi i ndërmarjes.

Besoj se nuk është e nevojshme të theksoj me këtë rast posaçërisht, që brenda një afati të shkurtër a të gjatë Italia do të kërkojë të bëjë një ndërhyrje të ngjashme. Një shenjë e dukshme për këtë është fakti, që atdhetarit shqiptar në Dibër, Jusuf bej Zades, iu bë një ofertë nga ana e qeverisë italiane prej 3000 lirash turke për hapjen e një shkolle shqipe në Dibër. Por oferta që u bë para pak kohësh, nuk u pranua, kështu kemi njëherazi një dëshmi të re për qëndrimin refuzues të mbajtur nga shqiptarët kundrejt përpjekjeve të të huajve për ndërhyrje.

Një kopje të raportit po e dërgoj në Stamboll me nr. 71 dhe një tjetër Agjencisë civile me nr. 87.

Pranoi etj.

*(Konsulli) Posfai Postlin.*

*Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Wien.*

*Politisches Archiv. Albanien. Nr. 81.*

#### *4. Raport i T. R. Hodgson-it,*

*Agjencia e Stambollit, 22 janar 1909.*

##### *Alfabeti i gjuhës shqipe*

Sapo kam marrë raportin e Kongresit kombëtar shqiptar për zgjidhjen e çështjes aq shqetësuese të alfabetit. Deri më sot Shoqëria Biblike i ka botuar versionet e veta në tre alfabete të veçanta: gegërisht me shkronja latine për krahinat gege të Shqipërisë së Veriut, toskërisht me shkronja greke dhe me alfabetin e ashtuquajtur kombëtar, i cili është një përshtatje e dy të tjerëve. Përveç kësaj, kanë qenë në përdorim rreth katër alfabete të tjera për atë literaturë të varfër, që ka nxjerrë Shqipëria. Gegërishtja që u përmend më lart, e cila është futur nga priftërinjtë jezuitë të Shkodrës në Shqipërinë e Veriut rreth 300 vjet më parë, jo vetëm e ka kaluar këtë provë të kohës, por edhe ka dalë më e pranueshme për shqiptarët, sesa të tjerat, për shkak të përdorimit të shkronjave latine. Disa nga botimet e Shoqërisë Biblike janë shtypur paralelisht toskërisht e gegërisht, por nuk ka dyshim se alfabeti latin, i cili i vë shqiptarët më afër në kontakt me jetën moderne dhe mendimin e Europës Perëndimore, ngadalë por në mënyrë të qëndrueshme ka çarë rrugë dhe në fund të fundit do t'i zëvendësojë të tjerët pak nga pak. Gjithashtu nga shumica e shqiptarëve të arsimuar ai

mbahet si mjeti më i përshtatshëm për të paraqitur tingujt zanorë e bashkëtingëllore të gjuhës shqipe, që me vështirësi dallohen nga një i huaj.

Kongresi, i cili u hap në Manastir më 14 nëntor, u ndoq nga rreth gjashtëdhjetë delegatë prej të gjitha anëve të Shqipërisë. Më vjen shumë keq që nuk pata mundësinë të përfitoja nga ftesa e dërguar prej organizatorëve të Kongresit, Klubit shqiptar që sapo është formuar i ri në Manastir. Megjithatë Shoqëria Biblike u përfaqësua në mënyrë të denjë nga z. Gjegj Qiriazi, depozitari ynë në Manastir, i cili në mbledhjen e parë të Kongresit u caktua nënkryetar dhe kryesoi në mungesë të kryetarit, Mithat Beut, që erdhi më vonë. Guvernatori i përgjithshëm i krahinës, Hivzi Pasha, dhe gjithë zyrtarët e lartë civilë e ushtarakë ishin të pranishëm në hapjen e mbledhjes, e cila u ndoq nga një shumicë njerëzish; numëroheshin rreth 400 veta nga kombësi të ndryshme. Mbledhja u pasua prej një demonstrate entuziaste më vonë pas dite, kur shqiptarët e mbledhur dhanë "besën" kombëtare (një formë betimi) për të dhënë jetën për atdheun. Me të vërtetë gjatë gjithë vargut të mbledhjeve shpirtrat e zjarrtë të shqiptarëve dukej sikur ishin ndezur në kulm, duke gjetur më në fund një rast për të shprehur lirisht zjarrin atdhetar në lirinë e mbledhjes e të fjalës, që sapo i kanë fituar.

Mbledhjet e Kongresit u mbajtën çdo ditë nga 14 deri më 22 nëntor. Ditën e tretë u caktua me fuqi të plota një komision për të vendosur çështjen e alfabetit dhe për t'i raportuar Kongresit. Tri ditët e tjera u zunë me mbledhje të veçanta të komisionit, i cili paraqiti

raportin ditën e shtatë të Kongresit. Raporti është një dokument pak teknik për një të huaj, i cili nuk mund të hyjë në hollësitë e shqiptimit të shqipes dhe përfaqëson një punë të madhe, të rëndë e të ndërgjegjshme drejtshkrimore, e cila të habit, po të mbahet parasysht natyra e materialeve me të cilat kishte të bënte Komisioni. Përfundimi është praktikisht ky, që Komisioni ka hequr dorë nga shqyrtimi i alfabeve ekzistuese: ata kanë pranuar alfabetin latin si bazë, duke ua përshtatur çdo shkronjë kërkesave fonetike të gjuhës. Vlera e secilës shkronjë është shënuar me kujdes dhe aty ku 25 shkronjat latine nuk dilnin të mjaftueshme, tingujt e mbetur do të jepeshin duke bashkuar dy shkronja të alfabetit. Bashkangjitur janë alfabetet e ndrequra, jepen dy lista alternative, e para përmban tingujt e dyfishtë me shkronja greke për shkronjat me dyshim interpretimi. Kjo tabelë e parë, me sa duket, është bërë si një lëshim për përkrahësit e toskërishtes dhe rekomandohet që mund të përdoret atje, ku ende parapëlqehet toskërishtja. Raporti përfundon me një propozim, që një kongres tjetër të mbahet brenda dy vjetësh, në një vend dhe në një kohë që do ta caktojë ky Kongres, me qëllim që të vendosen çështjet e tjera lidhur me drejtshkrimin dhe literaturën shqipe.

Kongresi e pranoi Raportin njëzëri dhe miratoi dy rezoluta:

1. Gjithë klubet dhe shoqëritë shqiptare të dërgojnë një raport mujor në klubin e Manastirit, me qëllim që ky klub të ketë mundësinë të mbajë kontakte me të gjitha këto shoqëri.
2. Pas dy vjetësh, më 10 korrik 1910, të mbahet një kongres tjetër në Janinë për të diskutuar më tej çështjen e gjuhës e të letërsisë shqipe.

Kongresi u zhvillua në harmoninë dhe entuziazmin më të madh, u mbajtën shumë fjalime të gjata e patriotike dhe pati shumë festime e gëzime shoqërore. Qyteti i vogël e i këndshëm i Manastirit i harroi analet e zymta të viteve të fundit aq të shqetësuara dhe përkohësisht u bë qendra e shpresave dhe aspiratave të reja e të papenguara, për të cilat as mund të ëndërrohej deri atëherë. Akti i fundit i Kongresit që përkujtimi i gjithë shqiptarëve të shquar dhe i atyre që i kishin shërbyer atdheut. U përmendën shumë emra, që meritonin gjithë nderimet, e midis tyre Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja u dallua se meritonte një përmendje të veçantë. Raporti zyrtar mbaron me këto fjalë: “Kështu u bë ky Kongres dhe mbaroi pasi hodhi themele të forta për një Shqipëri të ardhme.”

Për Shoqërinë Biblike koha dhe rasti janë shumë të përshtatshme. Botimet shqipe të Shoqërisë, të bëra tridhjetë a dyzet vjet më parë me punën, kushtimin dhe parashikimin e të ndjerit dr. Thomson, paraardhësi im në Agjenci, ca nga ca por pa ndërprerje janë pakësuar dhe ka ardhur koha për t’i zëvendësuar ato me botime të reja, të cilat do të nevojiten për t’u dalë përpara kërkesave në rritje dhe një qarkullimi më të gjerë. Deri në kohën e regjimit të ri në Turqi nuk shihnim ndonjë mundësi për të nxjerrë botime të reja: përpjekjet tona tetë vjet më parë u mbytën që në djep nga refuzimi i censurës turke për të na lejuar shtypjen me të ashtuquajturin alfabet “kombëtar” ose të ri të botimeve shqipe të Psalmeve e të Katër Ungjijve, që i kishim përgatitur për t’u dalë përpara kërkesave. Një nga kujdesjet tona të para pas agimit të ditës së re në



Turqi ishte të vijonim me këto botime dhe tashti po presim daljen e tyre nga shtypi. Sigurimi i versioneve të reja shqipe është një çështje e gjerë dhe do të kërkojë kujdes të madh, mundim e përgatitje. Rruga është rrafshuar në mënyrë të ndjeshme me pranimin e një alfabeti të vetëm, por çështjet më të mëdha të rishikimit e të përkthimit mbeten, kurse vështirësi të reja lindën nga fakti se mund të gjenden shumë pak studiues të kualifikuar me njohje të gjuhës shqipe. Për fat të mirë, kemi në dorë shërbimet e dy studiuesve më të mirë shqiptarë të kohës, z. Qiriaz, depozitari ynë në Manastir, dhe z. Sina, depozitari ynë në Rusçuk. Shpresoj t'i takoj të dy këta zotërinj sa më parë, sapo detyrat e mia do të më lejojnë të nisem nga Stambolli për një vizitë në Manastir. Shpresoj se atëherë do të bëhet e mundur t'i parashtrij Shoqërisë planet e propozimet tona për versionet e reja shqip, që priten me aq padurim e që kërkohen aq shumë nga gjithë shqiptarët, të cilët kaq shpesh e kanë dëshmuar nderimin dhe dashurinë për Shoqërinë Biblike, që u ka dhënë në gjuhën e tyre Shkrimet e shpresës e të ngushëllimit në ditë e tyre të errëta.

*Arkivi i Shoqërisë Biblike (BFBS).  
Translation Department Correspondence.  
Albanian, I.*

5. *Charles H. Woods: The Alphabet and Languagequestion in Albania.*

*Westminster Gazette, 8 shtator 1910.*

Shtetasit shqiptarë të sulltanit, të cilët arrijnë afërsisht nga 1.000.000 deri në 1.200.000, ndahen në dy grupe kryesore: gegët dhe toskët. Gegët përbëhen nga një numër fisesh të egra malësorësh, që banojnë në Shqipërinë veriore, ndërsa toskët, të cilët gjatë mjaft viteve kanë qenë më të shtruar ndaj sundimit të sovranit turk sesa gegët, zënë Shqipërinë e jugut. Ata që janë të krishterë (rreth 100.000) midis gegëve i përkasin kishës katolike, ndërsa ata që nuk janë myslimanë në jug – ndoshta arrijnë 380.000 veta – i përkasin kishës ortodokse.

Nën regjimin e vjetër në pak nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë kishte shkolla fillore e të dyta turke dhe fëmijët mësonin ta lexonin Kuranin nëpër xhami. Në Shkodër një kolegji dhe një seminar mbaheshin nga jezuitët nën mbrojtjen dhe me ndihmën e Austrisë. Para rreth tetë vjetëve edhe italianët janë përpjekur ta rrisnin ndikimin e tyre në Shqipëri me anë të pak shkollave në Shkodër, një tjetre në Vlorë dhe në Janinë. Megjithatë përpara se të shpallej Kushtetuta, ishte kisha ortodokse që merrej kryesisht me ngritjen e arsimit të popullit, veçanërisht në jug, me anë të shkollave, që ishin hapur dhe mbaheshin nën privilegjet e përfituara nga patriarkana greke.

Çështja arsimore në Shqipëri sot mund të ndahet në dy pjesë: diskutimi mbi alfabetin, në të cilin duhet të shkruhet gjuha, dhe diskutimi mbi mënyrën e shkallën në të cilën shqipja do të përdoret ose do të mësohet në shkollat e ndryshme, që ekzistojnë nëpër krahinat ku banojnë shqiptarët mikpritës.

Përpara mesit të shekullit XVII nuk ka ndonjë të dhënë, që shqiptarët të kenë kërkuar ta lexonin ose ta shkruanin gjuhën e tyre. Në rast se dikush kishte nevojë të komunikonte me një njeri në një krahinë tjetër të vendit, gjithmonë mund të gjente një letërshkrues turk profesionist ose ndonjë prift gjysmë të shkolluar, i cili ia hartonte letrën. Megjithëse përpara rivendosjes së Kushtetutës janë bërë përpjekje të ndryshme për të krijuar një alfabet me të ashtuquajturat shkronja 'kombëtare', dhe ndonëse në Romë, Sofje ose Bukuresht janë shtypur pak libra, kryesisht Bibla, që sillshin fshehurazi në Turqi, përsëri për të gjitha nevojat praktike deri më 1908 gjuha shqipe shkruhej nga gegët me alfabetin latin dhe nga toskët me shkronja greke.

Si pasojë e Revolucionit të turqve të rinj, gjatë vjeshtës së vitit 1908 u mbajt në Manastir një Kongres i rëndësishëm shqiptar, i pari që u lejua nga turqit. Qëllimet kryesore të mbledhjes ishin diskutimi i alfabetit dhe i çështjeve arsimore. Në shtator 1909, në Kongresin e dytë që u mbajt në Elbasan, ndoshta qyteti më i rëndësishëm në Shqipëri, nga delegatët e mbledhur prej të gjitha anëve të Shqipërisë u vendos të pranohej një alfabet, i cili praktikisht niset nga alfabeti latin dhe ka disa shenja të shtuara e një a dy shkronja më tepër. Këto ndryshime janë bërë me qëllim që të jepen

në shkrim gjithë tingujt e gjuhës në mënyrë më të saktë. Njëkohësisht, ndonëse pati kundërshtime, u vendos nga delegatët në Kongres që toskët mund të vijonin ta shkruanin gjuhën me shkronjat greke.

Qëllimi i shqiptarëve duke zbatuar shkronjat latine është i dyfishtë: në radhë të parë, ato mësohen më lehtë prej popullit; së dyti, ato janë më të përshtatshme për ta shprehur gjuhën. Turqit nga ana e vet kanë një kundërshtim të vjetër e të thellë kundër zbatimit të shkronjave latine në Shqipëri jo vetëm sepse ky sistem shkrimi e leximi në fund të fundit do të sjellë te bashkimi i fiseve e krahinave me anë të një letersie të përbashkët për të gjithë, por edhe sepse kështu do të bëhet e mundur që librat shqip të shtypen në Europë. Nga ana tjetër, nëse do të imponoheshin shkronjat arabe, autoritetet osmane e kuptojnë fare mirë që do të lindnin vështirësi shumë më të mëdha për të siguruar mjetet e arsimit dhe të zhvillimit të aftësive mendore për shqiptarët.

Megjithëse tashti zyrtarisht kundërshtimi i turqve ndaj shkronjave latine ose kombëtare është tërhequr, përsëri ka shumë arsye të mendojmë, se qeveria po përpiqet ta kundërshtojë përdorimin e këtij alfabeti, duke u rropatur t'i shtyjë shqiptarët myslimanë të besojnë se shkronjat arabe janë të shenjta. Nëpër xhamitë janë bërë mbledhje me qëllim që të nxitet fanatizmi i njerëzve, duke thënë se shkronjat kombëtare janë të rrezikshme për fenë myslimane. Janë bërë përpjekje për t'i bindur 'besimtarët e vërtetë', se Kurani duhet të lexohet e të shtypet vetëm me shkronjat e shenjta arabe dhe se këto shkronja duhet të përdoren nga ata

që duan t'i qëndrojnë besnikë fesë. Meqenëse shqiptarët janë 'shqiptarë' përpara se të jenë qoftë myslimanë, qoftë të krishterë, këto përpjekje nga ana e turqve deri më sot kanë pësuar dështim të plotë.

Duke përjashtuar institucionet e ndryshme arsimore greke dhe të tjera të huaja, që janë në Shqipëri, shkollat e vendit tashti përbëhen nga ato që financohen prej shtetit (siç e thashë më sipër, disa të pakta ekzistonin edhe para Kushtetutës) dhe nga shkollat shqiptare, që janë ngritur të gjitha pas revolucionit.

Sot për sot shkollat turke mund të ndahen në tri shkallë pak a shumë të dalluara: fillore, të dyta dhe të mesme. Në shkollat fillore turqit përpiqen ta bëjnë turqishten gjuhën e vetme të shkollës, ndërsa në shkollat e dyta e të mesme autoritetet osmane duan që turqishtja të jetë gjuha e shkollës dhe shqipja të mësohet si gjuhë e huaj. Shqiptarët ngulin këmbë që në shkollat fillore mësimet të bëhen shqip, por shprehin gatishmërinë që fëmijët të mësojnë vazhdimisht turqishten. Për më tepër, në shkollat kombëtare ku mësohet shqipja, turqit po përpiqen e ngulin këmbë që shkrimi dhe leximi të bëhen me shkronjat arabe. Ndjenjat e shqiptarëve kundër kësaj janë aq të forta, saqë të paktën në një shkollë nxënësit këto kohët e fundit i grisën librat e shkruar me shkronjat e përbuzura. Në Korçë, e cila ka qenë gjithmonë dhe ende quhet një qendër arsimore për gjithë Shqipërinë, 38 nxënës e braktisën një kolegji të lartë shtetëror dhe shkuan në shkollën e Klubit shqiptar në shenjë proteste kundër alfabetit arab. Shembulli i këtyre nxënësve menjëherë u

pasua nga shumica e fëmijëve, që ndiqnin shkollën përgatitore turke në atë qytet.

*6. Letër e Seksionit Amerikan për T. R. Hodgson  
Agjent i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për  
vendet e huaja, Stamboll,*

*Selanik, 25 prill 1911.*

I nderuari Zotëri,

Mësuam me interes të madh dhe me kënaqësi për qëllimin e Shoqërisë suaj që t'i sigurojë kombit shqiptar Shkrimet e Shenjta në gjuhën e tij. Ju e njihni mirë luftën që kanë bërë ata për të ruajtur nga prishja këtë gjuhë të lashtë dhe e pranoni, ne jemi të sigurtë për këtë, rastin e shkëlqyer që na jep ky fakt për t'i bërë një shërbim të madh kombit, duke u shërbyer njëkohësisht interesave të lartë të mbretërisë së Zotit.

Udhëheqësit shqiptarë kanë punuar me zell për të njësuar gjuhën dhe janë marrë vesh për një alfabet kombëtar. Kuptohet që ata tashmë janë marrë vesh që dialekti i Elbasanit do të jetë standardi kombëtar dhe ka mundësi që do të merren vesh për alfabetin latin me ndryshime fare të vogla. Ne ju sugjerojmë me respekt që ju t'i mbani para sysh këto fakte me rëndësi gjatë përkthimit tuaj dhe rishikimit të veprës.

Ne pranojmë me kënaqësi shërbimet e paçmueshme që keni bërë ju si bashkëpunëtorët tanë në këto fusha dhe urojmë që ju të keni nderin të përcaktoni

standardin e gjuhës për këtë popull, ashtu siç është  
bërë për shumë kombe të tjera me Librin e librave.

Duke ju shprehur nderimet tona, me respekt

*Misioni i Seksionit Amerikan në Turqinë Europiane  
(Nënshkruar) Robt. Thomson –  
Kryetar i mbledhjes vjetore*

*W. C. Cooper – Sekretar i Misionit*

*Shënim i shtuar nga imzot T. R. Hodgson*

Gegërishtja: përzierje e parregullt dialektesh.

Toskërishtja: e njësuar, me rregulla gramatikore,  
kuptohet përgjithësisht kudo në Shqipëri.

“Elbasanishtja”: një përzierje e të dyjave, më  
shumë gegërishte se toskërishte.

*Arkivi i BFBS.  
Translation Department Correspondence.  
Albanian, I.*

*7. Letër e T. R. Hodgson për R. Kilgour,*

*Manastir, 30 maj (10 qershor) 1911.*

**Shtypshkronja shqiptare.** Kjo shtypshkronjë  
shumë e mirë tashti është duke punuar me ngarkesë  
të plotë. Botimi ynë i ri i Katër Ungjijve shqip me alfa-  
betin e ri praktikisht ka përfunduar. Psalmet shqipe,

të cilat me sa duket Bojaxhiani nuk kishte ndër mend t'i përfundonte, do të plotësohen këtu, sepse vetëm dy fashikuj mbeten për t'u bërë. Tashti ne propozojmë të vijojmë me pjesën që mbetet të Dhiatës së re me alfabetin e ri. Nuk ka ndonjë nevojë për ndonjë llogaritje të re, pasi kushtet do të jenë të njëjta me ato për Katër Ungjijtë. Do të kemi nevojë për një sasi letre; po ju dërgoj bashkangjitur faturën. Shpresoj se fundi i vitit do ta shohë Dhiatën e re të ketë ecur mjaft përpara dhe pas përfundimit të saj, ne propozojmë të vijojmë me Dhiatën e vjetër, duke nisur me disa libra që kërkohen më shumë, si Jobi, Fjalët e urta, Isaia etj. (Psalmet i kemi) dhe të shkojmë përpara pa ndalim, në sajë të Zotit, derisa të arrijmë që Biblën shqipe të plotë ta vëmë në duar të shqiptarëve, e kjo do të jetë një ditë e madhe dhe e lavdishme për Shqipërinë.

Natyrisht, e gjitha kjo do të kërkojë shumë mund e disa ndryshime në punën tonë, për të cilat duhet të vëmë forcat që t'i kryejmë: pa dyshim, ne mbështetemi në Komitetin tuaj për gjithë përkrahjen dhe ndihmën e nevojshme, pa të cilën nuk mund të bëjmë asgjë. Tashti për tashti, pas shumë diskutimesh, ne propozojmë këtë: z. Sina, i cili është këtu me mua, do të presë dhe do të ndjekë shtypjen e Katër Ungjijve e të Psalmeve dhe pas nja dy javësh do të kthehet në depozitën e tij në Rusçuk, i shoqëruar nga z. Kartalis, një nga librashitësit tanë këtu, njeri i aftë dhe i arsimuar, të cilin z. Sina e ka lënë si zëvendës tashti në depozitën në Rusçuk. Pasi të mbyllë llogaritë e veta, z. Sina do të kthehet këtu, i shoqëruar nga familja dhe së bashku me z. Qiriaz, si edhe me një të tretë, për të



cilin ende nuk kemi vendosur gjë, do të formojë komisionin për rishikimin e shqipes për shtyp. Sidoqoftë, z. Sina njihet si autoriteti më i mirë për gjuhën shqipe dhe ka shumë përvojë në punën e shtypjes. Edhe z. Qiriazhi njihet si studiues i shqipes; gjithashtu e kemi në mend një “ekspert” të shqipes, i cili do të jetë i treti në grup. Për këtë të fundit do të jetë i nevojshëm një shpërblim i vogël; z. Sina dhe z. Qiriazhi do të vijojnë të marrin pagën e zakonshme. Me këtë mënyrë shpresojmë se puna do të vijojë pa ndërprerje ose pa pengesa gjatë shtypjes; në të vërtetë nuk kemi kohë ta humbasim, sepse botimet tona shqipe gegërisht e toskërisht po shterojnë. Gjithashtu përse i përket gjuhës shqipe, nuk mund ta ndërpresim punën derisa dialektet të shkrihen në një gjuhë “kombëtare”, por do të bëjmë çfarë të mundemi me materialin që kemi në dorë dhe, ndoshta, Shkrimet që po botojmë do të bëjnë më shumë punë se çfarëdo mjet tjetër drejt shkrirjes dhe formimit të gjuhës shqipe, që është mjaft kaotike.

*Arkivi i BFBS.*

*Translation Department Correspondence.*

*Albanian, II.*

*Paraqitur e përmbledhur në: Minutes of Editorial Subcommittee, vol. 38, f. 34.*

### 8. Letër e T. R. Hodgson për R. Kilgour,

*Stamboll, 10 qershor 1911.*

Letrën tuaj të 26 majit mbi shqipen e mora në Selanik. Po atë ditë po i shkruaja Ritson-it dhe i kërkova që t'jua dërgonte letrën time nga Manastiri lidhur me shtypshkronjën e shtypin shqip. Shpresoj se do ta ketë bërë këtë, por në rast se ka ndonjë pengesë, më mirë po ju shkruaj dy radhë tashti, që kam rastin t'u përgjigjem pyetjeve tuaja.

Katër ungjijtë shqip në shtypshkronjën shqiptare në Manastir praktikisht janë të plotë dhe do të dalin si ungjij të veçantë e pas pak kohësh edhe në një vëllim. Psalmet shqip, nga të cilat dy fashikuj kishin mbetur për t'u plotësuar nga z. Bojaxhian, por që ai nuk pati mundësinë ose nuk deshë t'i plotësonte, do të përfundohen në shtypshkronjën e Manastirit: unë tashmë u kam dërguar letrën nga Stambolli dhe libri do të mbarojë brenda një muaji. Këto botime janë të gjitha me alfabetin e ri ose kombëtar dhe janë përgatitur për shtyp nga z. A. Sina me ndihmën e z. Gj. Qiriazit, që të dy janë në shërbimin tonë si depozitarë. Do t'ju dërgoj kopje të këtyre librave, kur t'i marrim nga libralidhësi.

Kemi ndër mend të vijojmë me Dhiatën e re derisa të bëhet e plotë dhe meqë do ta kemi z. Sina në Manastir për këtë punë, shpresoj se gjithë Dhiata e re do të dalë nga shtypi nga fundi i këtij viti ose aty afër. Pastaj do të vazhdojmë me librat e Dhiatës së vjetër

dhe shpresoj se do të kemi lejen të vijojmë pa ndërprerje, derisa të arrijmë t'u japim shqiptarëve Biblën e plotë në gjuhën e tyre. Shpresoj se do të kemi një komision pak a shumë të përhershëm të rishikimeve në Manastir për librat që kemi tashmë në shtyp e në dorëshkrim, kurse për punën e përkthimeve do të bëjmë marrëveshje të veçanta kur të vijë koha.

Në letrën për Ritson-in i bëja një thirrje për shtypshkronjën shqiptare në Manastir. Unë e shoh këtë shtypshkronjë si mjetin më të madh për të mirat që ka nevojë Shqipëria ose që mund të ketë, ndërsa për qëllimet tona është e paçmueshme. Ajo është tërësisht në dispozicionin tonë, pa pasur ne asnjë barrë ose shpenzim, porse një ndihmë e vogël financiare sot për sot do të sillte dobi të madhe. Kjo mund të jepet si paradhënie ose duke blerë bonot e mia që kanë mbetur; investimi është mjaft i mirë dhe e vetmja vështirësi që del është mundësia, por jo e sigurtë, që të ketë përsëri ndërhyrje nga qeveria. Pronarët janë të shqetësuar për ta shmanhur këtë, duke më bërë mua si pronar përgjegjës (në dukje). Shtypshkronja punon me ngarkesë të plotë dhe ka një personel prej 17 vetash, të gjithë të zënë me punë.

Ne bëmë një udhëtim përmes Shqipërisë së jugut mjaft interesant e të këndshëm, kur isha mirë e mund të kënaqesha. U kthyem përsëri te qytetërimi dhe komforti i tij, një ndryshim gjithashtu i këndshëm. Tashti unë e njoh mjaft mirë Shqipërinë time, gjë që përbën një satisfaksion.

Uroj që të jeni mirë, të fala, juaji

*T. R. Hodgson.*

*Arkivi i BFBS. Translation Department  
Correspondence. Albanian, I.*



## *Pjesëmarrësit në Kongresin e Elbasanit*

Me rastin e 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit u mbajt një sesion shkencor në Tiranë, punimet e të cilit, siç e kam shënuar në shkrimin e parë të këtij libri, u botuan më 1972 në vëllimin *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit* (më poshtë do të citohet shkurt: *Alfabeti 1972*). Pjesa e tretë e librit përmban një permbledhje të pasur dokumentesh arkivore dhe nga burimet diplomatike të jashtme, ku janë përfshirë kryesisht raporte të konsujve austro-hungarezë në Shqipëri. Prej asaj kohe janë gjetur edhe dokumente të tjera nga burime të huaja, të cilat besoj se ka interes të botohen edhe këtu.

Dokumentet e mëposhtme janë nxjerrë prej historianit Ramiz Abdyli nga Arkivi Qendror Britanik (Public Record Office) mes materialeve që i përkasin Ministrisë së Jashtme (Foreign Office) dhe janë përkthyer prej meje.

Njoftimet janë përgatitur nga të ngarkuarit britanikë në Manastir: konsulli W. S. Edmonds dhe nënkonsulli W. D. W. Matthews, të cilët i kanë nisur për ambasadorin britanik në Stamboll. Nga Stambolli Sir Gerard Lowther i ka dërguar njoftimet për ministrin e jashtëm britanik në Londër. Vetë rruga e përshkuar nga këto dokumente, ndonëse të pakta, tregon për rëndësinë e madhe që i është dhënë ngjarjes në qarqet diplomatike britanike.

Dokumenti **Nr. 1** merret me Kongresin e Manastirit. Është shkruar menjëherë pas përfundimit të punimeve dhe vetëm një ditë pas raportit nr. 73 (Alfabeti 1972, f. 353), dërguar nga Manastiri për Ministrinë e punëve të jashtme në Vjenë. Për Vjenën është dërguar edhe një raport tjetër i datës 30 nëntor me nr. 75 (Alfabeti 1972, f. 356). Bie në sy që konsullatat e huaja pranojnë njëzëri, se Kongresi kishte rëndësi të madhe, pasi e tejkalonte cakun e miratimit të një alfabeti dhe ishte “një hap i ngjashëm me bashkimin kombëtar”. Për historianët madje ka interes theksimi, se një bashkim i tillë kishte ndodhur në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Pohohet se delegatët përfaqësonin gjithë shtresat e shqiptarëve. Në të dy drejtimet zë vend të ndjeshëm shqetësimi i turqve të rinj për këtë veprim të vendosur të shqiptarëve. Burimi austriak e thotë qartë, se mbledhjet e komisionit për alfabetin u mbajtën të fshehta. Është pak i çuditshëm njoftimi i Edmond-sit, se në këto mbledhje të fshehta është diskutuar për një përkthim shqip të Kuranit. Një gjë e tillë nuk del asgjëkundi më vonë lidhur me përkthimin e Kuranit shqip dhe aq më pak mundësi ka, po të mendohet se delegatët shqiptarë u përkisnin të tre besimeve dhe nuk ishin vetëm myslimanë. Dokumentet e tjera (**Nr. 2**) tregojnë se kjo mund të jetë thënë me qëllim ngatërrimi nga vetë shqiptarët.

Lidhur me çështjen qendrore të Kongresit, dokumenti britanik e quan se u pranua alfabeti i Stambollit dhe një variant me disa ndryshime për dialektin e Shkodrës, ndërsa në një kongres të dytë në Janinë do të arrihej mendimi për marrëveshjen e plotë. Doku-

menti austriak flet për një periudhë kalimtare dhe për dy alfabete. Besoj se këto mospërputhje lidhen me vlerësimet ose keqkuptimet, që kanë shprehur ata shqiptarë, të cilët kanë qenë informuesit për agjentët konsullorë përkatës. Së fundi, në çdo rast del lidhja e ngushtë e çështjeve të gjuhës shqipe me shkollat dhe arsimin shqiptar.

Për shkak të rrjedhës historike të ngjarjeve, me Kongresin e Manastirit 1908 janë lidhur ngushtë edhe Kongresi i Elbasanit, edhe Kongresi i Dytë i Manastirit. Këtu kemi dy dokumente britanike për Kongresin e Elbasanit, madje pas afër një viti është po ai ambasador, që ia ka përcjellë Londrës. Dokumenti britanik Nr. 2 është përgatitur dy javë pas përfundimit të ngjarjes, domethënë pak më vonë se dokumentet austriake nr. 65 dhe nr. 72 të vitit 1909 (Alfabeti 1972, f. 381 dhe 384). Nga 15 pikat e Vendimeve të Kongresit, raporti britanik ka paraqitur 4 si kryesoret. Është interesante, se dy pikat e para i ka zgjedhur po ashtu edhe raporti përkatës austriak. Shuma e të hollave është dhënë me saktësi dhe përputhet plotësisht me të dhënat austriake. Pika e tretë për zgjedhjen e Klubit të Manastirit si qendra e klubeve shqiptare është trajtuar hollësisht në dokumentet austriake, për shkak të qëndrimit antiaustriak të Mithat Frashërit. Dialekti i Elbasanit quhet si gjuhë letrare në njoftimin britanik dhe thuhet se u është rekomanduar ta përdorin gjithë shqiptarët.

Në Vendimet e botuara që më 1909 të Kongresit të Elbasanit nuk përmendet çështja e alfabetit, madje nuk trajtohet as në artikujt e kumtesave të sotme, as në dokumentet austriake. Ndërsa Matthews-i e për-

fundon njoftimin e tij me pohimin se kanë mbetur vetëm dy alfabete. Ka të ngjarë atëherë që, duke e ditur lidhjen e këtij Kongresi me atë të një viti më parë, Matthews-i do ta ketë diskutuar me informantët e tij shqiptarë dhe e ka marrë këtë përgjigje si konstatim për gjendjen në përdorimin real të alfabetit.

Dokumenti Nr. 2 është hartuar pas dy javësh. Nënkonsulli britanik nuk e ka shkëputur nga vëmendja këtë ngjarje dhe ka mbledhur një informacion më të plotë për diskutimet rreth alfabetit dhe për arsyet përse është zgjedhur dialekti i Elbasanit që të bëhej gjuhë kombëtare. Shumë më e pasur është tashmë paraqitja e aspekteve të ndryshme të lëvizjes kombëtare dhe e përparimit të shkollës shqipe.

Në dokumentet austriake të botuara në Tiranë më 1972 është censuruar lista e pjesëmarrësve (Alfabeti 1972, f. 384, Manastir, 20 shtator 1909, Shtojca 1). Prandaj besoj se është me interes botimi i të dhënave nga burimi britanik, që mund të shërbejnë për krahasime në studimet e mëtejshme. Prej listës mund të përcaktohet se kanë marrë pjesë 8 klube e shoqata të shpërndara në 23 qendra të banuara. Klubi Bashkimi del me degë në 16 qendra, Klubi Vllazënia me degë në 3 qendra, kurse të tjerat në një qendër secila. Këto të dhëna duhen ndrequr me dy raste që janë dhënë nën emrin e Misionit Amerikan në Korçë e në Tiranë, që në të vërtetë i përkasin njëri Klubit Dituria dhe tjetri Klubit Bashkimi. Janë gjithsej 35 përfaqësues të klubeve e shoqatave, por një delegat përfaqëson më shumë se një klub apo shoqatë, dhe anasjelltas, nga secila qendër janë dërguar një ose më shumë përfaqë-



sues. Më poshtë jepen listat me këto të dhëna, ndërsa për klubet jepet edhe numri i përfaqësuesve që i kanë caktuar dhe për delegatët sa klube i kanë ngarkuar. Mithat Beu është i deleguar i 7 klubeve dhe prandaj kishte barrën më të gjerë si përfaqësues. Pas tij vjen Osman Joraja i 4 klubeve, Teki Beu i 2 shoqatave dhe gjithë të tjerët përfaqësues vetëm të një klubi. Ndër klubet ai Bashkimi është me 27 zëra përfaqësues (7 prej tyre i përkasin Mithat Beut), Klubi Vllazënia 4 zëra përfaqësues, Klubi Dituria 4 zëra përfaqësues, Durrësi ka 3 përfaqësues. Del e qartë se Klubi Bashkimi përbënte shumicën dërrmuese dhe kishte zërin kryesor me Mithat Frashërin

*Klubet:*

*Klubi Bashkimi* – Berat, Elbasan, Frashër, Gramsh, Janinë, Jenije-Vardar, Karaferia, Leskovik, Manastir, Ohër, Peqin, Selanik, Starovë, Strugë, Shkup, Tiranë: 27 zëra përfaqësues  
*Klubi Dituria* – Korçë: 4 zëra përfaqësues  
*Klubi Drita* – Gjirokastrë: 2 zëra përfaqësues  
*Klubi Pellazg* – Skrapar: 1 zë përfaqësues  
*Klubi Vllazënia* – Elbasan, Filat, Kocanë: 4 zëra përfaqësues  
*Shoqata Bashkimi* – Përmet: 2 zëra përfaqësues  
*Shoqëria Afërdita* – Elbasan: 2 zëra përfaqësues  
*Shoqëria Vllazënia* – Kocanë: 1 zë përfaqësues.  
 Durrësi (pa degë klubi) – 3 zëra përfaqësues

*Qendrat me klubet e tyre:*

Berat	Klubi Bashkimi
Durrës	
Elbasan	Klubi Vllazënia, Klubi Bashkimi, Shoqëria Afërdita
Filat	Klubi Vllazënia
Frashër	Klubi Bashkimi
Gramsh	Klubi Bashkimi
Gjirokastër	Klubi Drita
Janinë	Klubi Bashkimi
Jenije-Vardar	Klubi Bashkimi
Karaferia	Klubi Bashkimi
Kocanë	Shoqëria Vllazënia [duhet të jetë: Kozani i sotëm]
Korç	Klubi Dituria, Misioni Amerikan
Leskovik	Klubi Bashkimi
Manastir	Klubi Bashkimi
Ohër	Klubi Bashkimi
Peqin	Klubi Bashkimi
Përmet	Shoqata Bashkimi
Selanik	Klubi Bashkimi
Skrapar	Klubi Pellazg
Starovë	Klubi Bashkimi
Strugë	Klubi Bashkimi
Shkup	Klubi Bashkimi
Tiranë	Klubi Bashkimi, Misioni Amerikan.

*Pjesëmarrësit me klubet që përfaqësonin:*

Abdullah Bej Koprencka	Klubi Pellazg – Skrapar
Abdullah Reshidi	Klubi Bashkimi - Strugë
Abdurrahim Kavaja	Shoqëria Vllazënia – Kocanë

Ahmet Dakli	Klubi Bashkimi – Strugë
Andrea Ikonomi	Klubi Drita - Gjirokastrë
Dervish Beu	Klubi Vllazënia - Elbasan
Dom Kaçorri	Durrës
Emin Haxhi	Klubi Bashkimi - Elbasan
Grigor M. Cilka	Misioni Amerikan - Korçë
Gjergj D. Qiriazi	Klubi Bashkimi – Manastir
Hafiz Ibrahim	Klubi Bashkimi - Tiranë
Hamdi Beu	Klubi Bashkimi - Ohër
Haxhi Bajram Beu	Shoqata Bashkimi – Përmet,
	Klubi Bashkimi - Leskovik
Idromeno Kosturi	Klubi Dituria – Korçë
Irfan Beu	Klubi Bashkimi – Ohër
Jahja Efendiu	Durrës
Josif Haxhi Mima	Shoqëria Afërdita - Elbasan
Kahreman Beu	Klubi Bashkimi - Berat
Kristaq A. Dako	Misioni Amerikan – Tiranë
MihalGjuraskovici	Durrës
Mithat Beu	Klubi Vllazënia – Filat,
	Klubi Bashkimi – Selanik,
	Klubi Bashkimi – Shkup,
	Klubi Bashkimi – Janinë,
	Klubi Bashkimi – Jenije-Vardar,
	Klubi Bashkimi - Karaferia
Orhan Beu	Klubi Dituria – Korçë,
	Klubi Bashkimi - Frashër
Osman Joraja	Klubi Vllazënia – Filat,
	Klubi Bashkimi – Selanik,
	Klubi Bashkimi – Jenije Vardar,
	Klubi Bashkimi - Karaferia
Qemal Beu	Klubi Bashkimi – Berat
Refik Beu	Klubi Bashkimi - Tiranë
Sabri Beu	Klubi Bashkimi – Peqin
Selman Blloshmi	Klubi Bashkimi - Starovë
Sevasti Qiriazi	Misioni Amerikan – Korçë
Simon Shuteriqi	Shoqëria Afërdita - Elbasan
Sulejman Leka	Klubi Bashkimi – Starovë
Taqi Buda	Klubi Bashkimi - Elbasan

Teki Bej Reshiti	Shoqata Bashkimi – Përmet, Klubi Bashkimi - Leskovik
Telha Beu	Klubi Bashkimi – Gramsh
Thoma Papapano	Klubi Drita – Gjirokastër
Xhemil Feza	Klubi Vllazënia - Elbasan

Gjetja e këtyre dokumenteve dëshmon se ka mundësi të gjurmohen burime të tjera për këtë ngjarje me peshë në historinë e gjuhës dhe të arsimit shqiptar, duke sjellë ndihmesë për ndriçimin më të plotë e më të saktë të tablosë së përgjithshme.

## *Dokumentet*

*Nr. 1. Sir G. Lowther për Sir Edward Grey.  
(Marrë më 9 dhjetor).*

(Nr. 827). *Stamboll, 4 dhjetor 1908.*

Zotëri,

Kam nderin t'ju dërgoj bashkangjitur një njoftim nga i ngarkuari Konsull britanik në Manastir, që raporton për Kongresin Shqiptar, i cili sapo u mbajt në atë qytet.

*Kam nderin etj.*

(Nënshkruar) GERARD LOWTHER

*Bashkangjitur Nr. 1.*

*I ngarkuari konsull Edmonds për Sir G. Lowther.*

(Nr. 65) *Manastir, 24 nëntor 1908.*

Zotëri,

Kam nderin t'i raportoj Shkëlqesisë suaj, se gjatë javës së kaluar u mbajt këtu një Kongres Shqiptar, rëndësia e të cilit ndoshta ishte më e madhe sesa mund të mendohej nga emërtimi i objektit të tij: pranimi i një alfabeti të përbashkët për gjithë Shqipërinë.

Lidhur me çështjet praktike, sukcesi i Kongresit që i madh, por jo i plotë. Pesëdhjetë delegatët e pranishëm përfaqësonin gjithë shtresat e shqiptarëve: gegët, toskët, katolikët dhe ortodoksët. Ndërsa kleri ortodoks ishte kundër Kongresit, sepse ka të ngjarë që do ta dobësojë ndikimin e alfabetit grek dhe të kishës ndërmjet shqiptarëve ortodoksë, disa priftërinj katolikë nga Shkodra ishin ndër përkrahësit më aktivë të tij. Si përfundim, u mënjanuan katër ose pesë alfabete dhe njëri, i ashtuquajtur i alfabeti i Stambollit me shkronja latine, u pranua për përdorimin e përgjithshëm, me përjashtim të disa ndryshimeve që do të zbatohen për dialektin e Shkodrës. Një kongres i dytë duhet të mbahet në Janinë më 1910 dhe ekziston besimi, se atëherë do të jetë pjekur mendimi për një marrëveshje të plotë.

Pati disa mbledhje me dyer të mbyllura dhe nuk është e pamundur, që si temë diskutimi të ketë qenë njohja e një përkthimi shqip të Kuranit, që thuhet se tashmë ekziston në fshehtësi.

Delegatët ishin shumë të kënaqur me përfundimet e Kongresit. Ata me të drejtë e shohin atë si një hap të ngjashëm me bashkimin kombëtar dhe si çështjen e parë që i ka bashkuar shqiptarët që prej ditëve të Ali Janinës.

Është domethënëse, që arsimit shqiptar ka fituar ndoshta më shumë nga çdo gjë tjetër prej ndryshimit të qeverisë. U hap një shkollë shqipe në Elbasan (siç njoftohet në Nr. 54 të z. Heathcote të 22 gushtit). Në Korçë dy shkolla të mbyllura nga qeveria e mëparshme u rihapën, duke shtuar kurse të dyta. Autoritetet e

vilajetit e kanë përfshirë shqipen në lëndët e shkollave të dyta turke dhe kanë bërë kërkesë për tridhjetë mësuës shqiptarë.

Turqit e rinj e përshëndetën Kongresin shqiptar. Shumë prej tyre ishin të pranishëm dhe delegatë të Komitetit mbajtën fjalime. Bisedat që kam bërë unë me anëtarë të Komitetit nuk e mbështesin pikepamjen, se ata e shohin me shqetësim këtë lëvizje shqiptare. Duket se ata e pranojnë inteligjencën eprorë dhe temperamentin e gjallë të shqiptarëve, ndërsa shprejnë se me një trajtim të arsyeshëm do t'i bëjnë këta më tepër një element force sesa rreziku. Megjithatë, ata e dinë se do të ketë vështirësi për t'u imponuar efektivisht shqiptarëve detyrime të tilla, si nxjerrja e ushtarëve dhe pagesat e taksave. Për më tepër, ka një lidhje ndërmjet shqiptarëve dhe thelbit të regjimit të ri të personat e shumë udhëheqësve të revoltës ushtarake, të tillë si Enver Beu, Selahedin Beu dhe Njazi Beu, si dhe të një numri të madh oficerësh të ushtrisë këtu, të cilët ndonëse kanë marrë arsim turk, janë me fafëfis shqiptar dhe u përkasin kazave shqiptare.

*Kam nderin etj.*  
(Nënshkruar) W. S. EDMONDS

*Nr. 2. (Nr. 788). Ambasada Britanike në Stamboll,  
29 shtator 1909.*

Zotëri,

Kam nderin t'i raportoj Shkëlqesisë suaj informata të në Elbasan u mbajt një Kongres shqiptar nga 2 deri më 10 shtator. Lidhur me këtë dëshiroj të vë në dukje se informatat janë fare pak nga ata që janë të angazhuar në lëvizjen shqiptare, me përjashtim të simpatizuesve të njohur ose të bashkatdhetarëve, dhe po citoj fjalët e përdorura nga një informues shqiptar: "Ne, shqiptarët, kemi njoftime të mjaftueshme për Kongresin, nuk ishte nevoja të jepeshin informata për të tjerët." Në këtë rast organizuesit e Kongresit sigurisht që nuk e kishin të vështirë t'u jepnin të jashtëmëve informata të sakta.

Meqë kam ndër mend t'i jap Shkëlqesisë suaj hollësi për lëvizjen shqiptare në një datë më vonë, tashti po kufizohem duke paraqitur një përmbledhje të vendimeve kryesore të miratuara nga Kongresi. Këto janë:

1) Themelimi i një Shkolle Normale në Elbasan, qëllimi kryesor i së cilës do të jetë të sigurojë mësues të kualifikuar për shkollat, që po hapen në gjithë vendin. Vlerësohet se do të jenë të nevojshme 1000 lira turke në vit për të mbuluar shpenzimet, për vitin në vijim do të mjaftojnë 700 lira dhe për shumën prej 563 lirash tashmë janë marrë nënshkrimet.

2) U caktua një komision me qendër në Korçë, i cili është autorizuar për të mbledhur para me qëllime arsimore dhe në veçanti për Shkollën Normale të Elbasanit.



3) Klubi i Manastirit "Bashkimi" është zgjedhur si qendra e klubeve shqiptare.

4) Dialekti i Elbasanit është zgjedhur si gjuha letërore dhe autorëve shqiptarë u kërkohet ta përdorin e ta popullarizojnë sa më gjerë të jetë e mundur.

Numri i alfabeve është zvogëluar në dy:

- alfabeti i Stambollit, d.m.th. alfabeti latin me disa ndryshime dhe
- alfabeti i "Bashkimit", d.m.th. alfabeti latin i pastër.

*Kam nderin etj.*  
W. D. W. Matthews

*Nr. 3. Sir G. Lowther për Sir Edward Grey.*  
*(Marrë më 18 tetor).*

(Nr. 835). *Stamboll, 11 tetor 1909.*

Zotëri,

Kam nderin t'ju dërgoj bashkangjitur një njoftim nga i ngarkuari nënkonsull në Manastir, që raporton më tej për Kongresin e Elbasanit dhe lëvizjen shqiptare.

*Kam nderin etj.*  
GERARD LOWTHER.

*Bashkangjitur Nr. 1. I ngarkuari nënkonsull  
Matthews për Sir G. Lowther.*

(Nr. 56). Manastir, 6 tetor 1909.

Zotëri,

Në vijim të raportit tim Nr. 54 të datës 23 të muajit të fundit, kam nderin t'i transmetoj Shkëlqesisë suaj një listë të delegatëve për Kongresin e Elbasanit dhe të nënshkruesve për Shkollën Normale. Nga kjo listë shihet se lëvizja shqiptare ka fituar mbështetjen e shqiptarëve me influencë të të gjitha besimeve.

Kjo lëvizje është në dukje arsimore dhe nga kjo pikëpamje duket si një fillim i ri. Dy shkollat e para u hapën në Korçë më 1888, por u mbyllën më 1902 nga qeveria bashkë me të tjerat, që ishin hapur në këtë ndërkohë. Me shpalljen e Kushtetutës më 1908 shkollat e Korçës u rihapën, u ngritën shkolla të tjera gjatë dhe tashti tridhjetë shkolla janë në veprim. Veç kësaj, ka shkolla katolike e të Misionit Amerikan, të cilat i bëjnë mësimet në gjuhën shqipe.

Gjatë vitit të kaluar janë themeluar nga tridhjetë e pesë deri dyzet klube. Elbasani ka dy dhe nga një ka në secilën qendër të madhe në Shqipërinë e jugut e të mesme. Kryeqendra e këtyre klubeve është Klubi "Bashkimi" në Manastir.

Zgjedhja e dialektit të Elbasanit, me synimin që të bëhet gjuha kombëtare, u bë pas një shqyrtimi të hollësishëm. Elbasani që gjendet në vijën ndarëse – lumi Shkumbin – ndërmjet gegëve e toskëve, ndonëse për

emër është gegë, në fakt është po aq toskë sa edhe gegë, prandaj është në pozitë të përshtatshme për t'u bërë pika e bashkimit të dy degëve të racës shqiptare.

Ngushtimi i numrit të alfabeve në dy nuk u arrit pa vështirësi. Në Shkodër disa myslimanë ishin kundër përdorimit të alfabetit latin, por tashti po e ndryshojnë qëndrimin e tyre. Megjithatë, ka të ngjarë që shumë veta nuk do të pajtohen për disa kohë në të ardhmen. Një nga hoxhallarët kryesorë në Dibër u përpoq ta shkruante shqipen me një variant të alfabetit arab, por kur e pa pas disa muajsh se shpesh nuk e lexonte dot as vetë shkrimin e tij, hoqi dorë nga ky eksperiment dhe tha se do të bëhej përkrahës i shkrimit latin. Një dervish bektashi e ka përdorur alfabetin latin për të shkruar një poemë shqipe me rreth 2000 vargje, e cila paraqet parimet e urdhrat të tij.

Shqiptarët kanë shpresuar se do të mbështeteshin nga Komiteti Bashkim e Përparim. Megjithatë ngjarjet e fundit i kanë zhgënjyer. Ata ankohen se turqit e rinj kohët e fundit kanë bërë një lojë të dyfishtë në të gjitha rastet, janë përpjekur ta shtinin në dorë Kongresin e Dibrës dhe, megjithëse nuk qenë në gjendje t'i impononin shumicës me forcë pikëpamjet e tyre, arritën t'u hiqnin rezolutave të miratuara gjithë efektshmërinë. Shqiptarët po marrin ndihmë të vlefshme nga bektashinjtë, të cilët bëjnë propagandën e tyre të tolerancës fetare me energji të madhe në Shqipërinë e Mesme. As bektashinjtë dhe as përkrahësit e lëvizjes shqiptare nuk duket të jenë kundër parimeve të përkrahura nga turqit e rinj, por ata ankohen se sjellja e

zyrtarëve dhe e oficerëve, që i përkasin Komitetit, shpesh është në përputhje me profesionet e tyre.

Tashti nacionalistët shqiptarë duket se janë në marrëdhënie të mira me bullgarët dhe vllehtë. Ka një armiqësi në rritje kundër grekëve, të cilët po punojnë kundër lëvizjes së tyre gjuhësore në Korçë e gjetkë. Lëvizja shqiptare po fiton truall në kurriz të grekëve, e vetmja pengesë për të është mungesa e fondeve. Mjaft nga përkrahësit e saj janë në gjendje, kanë prona të mëdha, por kanë vetëm sasi të kufizuara parash në dorë. Shqiptarëve të kamur në Rumani, Egjipt dhe Amerikë u bëhet thirrje që ta ndihmojnë çështjen financiarisht.

Jam informuar se katolikët e Shkodrës dhe katolikët e arsimuar të Mirditës po punojnë me forcë për lëvizjen, porse ndërmjet fiseve të egra katolike natyrisht që ka më pak entuziazëm. Në verilindje duket se lëvizja ka përparuar fare pak, pasi njerëzit janë kaq shumë grabitqarë sa nuk mund të ndikohen nga një lëvizje gjuhësore e arsimore. Disa prej qendrave në Veri janë fanatike për shkak të ndikimit turk.

*Kam nderin etj.*  
W. D. W. MATTHEWS

LISTA e delegatëve për Kongresin Shqiptar të mbajtur në Elbasan nga 2 deri më 10 shtator 1909.

Elbasan	Klubi Vllazënia – Dervish Beu dhe Xhemil Feza.
Berat	Klubi Bashkimi – Qemal Beu dhe Kahreman Beu.
Elbasan	Klubi Bashkimi – Emin Haxhi dhe Taqi Buda.

Filat	Klubi Vllazënia – Mithat Beu dhe Osman Joraja.
Selanik	Klubi Bashkimi – Mithat Beu dhe Osman Joraja.
Shkup Elbasan	Klubi Bashkimi – Mithat Beu. Shoqëria Afërdita – Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhi Mima.
Strugë	Klubi Bashkimi – Abdullah Reshidi dhe Ahmet Dakli.
Kocanë	Shoqëria Vllazënia – Abdurrahim Kavaja.
Ohër	Klubi Bashkimi – Hamdi Beu dhe Irfan Beu.
Përmet	Shoqata Bashkimi – Haxhi Bajram Beu dhe Teki Bej Reshiti.
Leskovik	Klubi Bashkimi - Haxhi Bajram Beu dhe Teki Bej Reshiti.
Manastir Korçë	Klubi Bashkimi – G. D. Qiriazi. Misioni Amerikan – G. M. Cilka dhe Sevasti Qiriazi.
Skrapar	Klubi Pellazg – Abdullah Bej Koprencka.
Janinë	Klubi Bashkimi – Mithat Beu.
Jenije-Vardar	Klubi Bashkimi – Mithat Beu dhe Osman Joraja.
Karaferia	Klubi Bashkimi – Mithat Beu dhe Osman Joraja.
Korçë	Klubi Dituria – Orhan Beu dhe Idromeno Kosturi.
Gjirokastër	Klubi Drita – Andrea Ikonomi dhe Thoma Papapano.
Starovë	Klubi Bashkimi – Selman Blloshmi dhe Sulejman Leka.
Tiranë	Klubi Bashkimi - Refik Beu dhe Hafiz Ibrahim.
Tiranë	Misioni Amerikan – Kristaq A. Dako.
Peqin	Klubi Bashkimi – Sabri Beu.
Frashër	Klubi Bashkimi – Mithat Beu.

Gramsh Klubi Bashkimi – Telha Beu.  
Durrës Jahja Efendiu, Mihal Gjuraskovici dhe  
Dom Kaçorri.

Letra dhe telegrame urimi janë marrë nga Dibra, Shkodra dhe vende të tjera.

U zgjodhën kryetar Dervish Beu, nënkryetar Mithat Beu, ndërsa Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhi Mima u caktuan sekretarë të Kongresit.

Përveç klubeve, që nënshkruan gjerësisht, më poshtë janë disa nga kontribuesit kryesorë për Fondin e Shkollës Normale të Elbasanit.

lira turke

Dervish Beu	50
Ymer Pashë Vrioni	18
Shqiptarët e Bukureshtit	36
Qemal Beu	15
Aqif Pasha nga familja	
Kristo Meksi	13
fisnike e Elbasanit	25
Refik Beu	9
Shefqeti	20
Dom Kaçori	3
Emin Mysliu, Prevezë	25
Idromeno Kosturi	3
Teki Bej Rusi	25
G. M. Cilka	2

*Manastir, 8 tetor 1909.*

## *Përdorimi i shkronjave të greqishtes për alfabetin e shqipes*

<i>Alfabetet</i>	<i>Alfabeti i Dhiatës së re 1824-1827</i>
<i>Shkrimi në trevat shqiptare</i>	<i>Arbëreshët e Italisë</i>
<i>Periudha e antikitetit</i>	<i>Shekulli XIX</i>
<i>Përhapja e krishterimit</i>	<i>Arbëreshët e Greqisë</i>
<i>Teksti i parë shqip</i>	<i>Kundërshtimi i shkronjave greke</i>
<i>Shekulli i tetëmbëdhjetë</i>	<i>Pas Kongresit të Manastirit</i>
<i>Librat shqip me shkronja të greqishtes</i>	<i>Përdorimi shkencor</i>

### *Alfabetet*

E vlen të thuhet dy fjalë në fillim për alfabetin përgjithësisht dhe për alfabetet e para, që ndeshen në trevat tona.

Përkufizimet për alfabetin në radhë të parë vënë në dukje se ai është tërësia e shkronjave, që shërbejnë për të shkruar një gjuhë, domethënë për të dhënë me shkrim tingujt e saj. Për qëllime praktike kjo tërësi vihet në një rend të caktuar. Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* 1980 prandaj përkufizimi është ky: “Tërësia e shkronjave të një gjuhe, të radhitura sipas një rendi të caktuar”. Ndërkaq, kjo bashkësi shkronjash edhe kur përputhet me tërësinë e tingujve të gjuhës, për shkrimin e së cilës shërben, nuk është e vetëmjaftueshme.

Shkronjat e veçanta, në kuptimin e germave, me zhvillimin e shtypshkrimit priteshin për shtypshkronjat, pastaj u bënë matrica për linotipin dhe monotipin, u vendosën në tastierën e makinës së shkrimit dhe më në fund u bënë ikona për programet kompjuterike dhe mjetet e tjera elektronike. Bashkimet e tyre janë fushë e fonologjisë dhe e drejtshkrimit. P.sh. “xh” nuk është germë, por një shkronjë dyshe e alfabetit të shqipes dhe e kemi pranuar për një fonemë të shqipes, duke u nisur nga mendimi se në sistemin tonë fonetik asnjëherë nuk ndodh që të dalë një tingull “h” pas një tingulli “x”. Kongresi i Manastirit nuk e kishte parashikuar se në gjuhën e shkrimit do të dilnin raste të veçuara, si për *mes-hollë*, ndonëse që në atë kohë njiheshin emra të përveçëm si: Mithat, Ethem.

Alfabeti i shqipes ka 27 shkronja dhe me to jepen 36 fonema, duke shtuar dyshkronjësia. Kanë qenë të domosdoshme disa parime, të zbatuara për bashkësinë 27, që të shkruhej gjuha me të.

Praktikisht kjo do të thotë se alfabeti i një gjuhe lidhet edhe me pozicionin që do të kenë shkronjat në fjalët e gjuhës, edhe me parimet e drejtshkrimit të saj. Përkufizimet e tjera të alfabetit për këtë arsye *tërësisë* i shtojnë edhe nocionin e *sistemit*. Abeceja është një bashkësi shenjash grafike të një sistemi shkrimi, ose është një sistem shkronjash për të dhënë me shkrim tingujt e një gjuhe. Gjatë punimit më poshtë do t'i përmbahem rregullisht këtij dallimi ndërmjet një *tërësie shkronjash* dhe një *sistemi shkronjash*. Del më qartë nevoja e këtij dallim nëpërmjet një shembulli. Llojet e ndryshme të alfabeve përgjithësisht janë tërësi të



dalluara shkronjash, të marra të shkëputura prej gjuhëve përkatëse. *Alfabeti latin* është një tip shkronjash, të cilat përdoren nga gjuhë të ndryshme. Ai dallohet prej *alfabetit grek*. Në tastierën e kompjuterit ai është vendosur pas një studimi, që ka marrë para sysh dendurinë e shkronjave për gjuhën angleze dhe përshtatshmërinë për të punuar me dhjetë gishta. Kjo tastierë, me ndonjë përjashtim të vogël, ka dalë shumë e përshtatshme edhe për gjuhën shqipe. Me këtë kemi një provë se zgjidhja e Kongresit të Manastirit ka qenë shumë e mirë dhe qëndron edhe në epokën e elektronikës. Ndërsa *alfabeti i latinishtes* është përdorimi i atij tipi si një sistem shkronjash për një gjuhë të caktuar, për latinishten, nga e cila edhe e ka prejardhjen emërtimi i alfabetit latin. Sot alfabeti i gjuhës sonë është alfabet latin si tërësi shkronjash, por pyetja shtrohet, a është përdorur ky lloj alfabeti për ta shkruar shqipen, për shembull, me sistemin e alfabetit të latinishtes apo me sistemin e alfabetit të italishtes? Këtë pyetje përgjithësisht autorët që kanë shkruar për alfabetin e shqipes nuk e kanë mbajtur ndër mend dhe, rrjedhimisht, kanë pasaktësi, të cilat nuk e vlen të vihen në pah.

Alfabeti grek është krijuar në Azinë e Vogël rreth vitit 900 para e.r. dhe gjeti përdorim të përgjithshëm në Athinë rreth mesit të shek. V para e.r. Përbëhej prej 24 shenjash, ndër të cilat 14 u huazuan prej alfabetit më të lashtë fenikas, që përmbante 22 shenja vetëm për bashkëtingëlloret. Grekët i përshtatën për tinguj të tjerë 8 shkronja fenikase dhe dy i krijuan për *psi* ( $\Psi$ ) dhe *ksi* ( $\Xi$ ). Deri më sot dëshmia më e vjetër me atë alfabet i përket një mbishkrimi mbi një shtambë me një

vegjë të vitit 740 para e.r. Shkronjat aty janë mjaft afër me ato të alfabetit fenikas. Mbishkrimet e kulturës më të lashtë kreto-mikene nuk kanë lidhje me këtë alfabet, ndonëse gjuha është greqishtja arkaike. Alfabeti i J. Ksilandrit, për të cilin do të flitet më poshtë, ka 33 shkronja, por katër prej tyre janë thjesht shenja të greqishtes: ζ, ψ, ω, ç. Alfabetet e përdorura për shkrimin e shqipes, në të cilat janë përfshirë këto katër shenja, do t'i quaj alfabetet të greqishtes, jo alfabetet greke, sepse nuk kanë të bëjnë me nevojat e shqipes, por kanë ndjekur alfabetin e greqishtes. Edhe te Dh. Kamarda janë përfshirë këto katër shenja, por ndërkaq të fundit prej tyre ai e ka shfrytëzuar për dyshkronjëshat (xh, zh, sh dhe ç), siç bëjmë sot me shkronjën "h", e cila në këtë rast është e njëjtë me një shenjë diakritike. Kështu, për të njëjtin tingullin "sh" janë përdorur dy "s", zgjidhja e Kamardës, vënia e dy pikave mbi një "s", si dhe e shenjës poshtë saj. Kamarda ka ndjekur greqishten dhe, atje ku nuk i ka dhënë zgjidhje të plotë, ka bërë kombinime të vetat.

Prej 24 shkronjave greke, vetëm 18 mund të shërbejnë për alfabetin e shqipes. Do të shtohen edhe "dh" dhe "th", për dyshkronjëshat tanë, domethënë gjithsej 20. Katër shkronjat që mbeten nuk përputhen me shqipen, sepse dy janë për dallime historike dhe dy kanë vlerë të përbërë. Përdorimi i kërtre 4 shkronjave, si dhe i "s" të veçantë greke në fund të fjalëve dëshmon se autori përkatës ka ndjekur parimet e drejtshkrimit të greqishtes. Për ta përdorur për alfabetin e shqipes shfaqet kërkesa për 7 shenja të tjera (20+7), që shqipja të jepet me alfabetin e përshtatur

grek. Me këtë problem janë ndeshur gjithë autorët që kanë dashur ta japin shqipen me shkronjat greke. Zgjidhja ka qenë duke ndryshuar vlerat e shenjave, me shtimin e shenjave diakritike, duke i përmbysur ose kthyer mbrapsht dhe më së fundi me dyshkronjësha. Por shpesh janë marrë edhe parimet e alfabetit të greqishtes, duke e pakësuar përputhjen shkronjë për shkronjë. Kështu palatalizimi i “k” përpara –i dhe –e ka sjellë që tingulli “q” të dalë në tekst, pa u numëruar ndonjë shkronjë “q”. Në alfabetin e greqishtes nuk përfshihet ndonjë shenjë për tingullin “c”, sepse në tekst del me bashkimin “t+s”. Rrjedhimisht, nuk ka përse të quhet pjesë e alfabetit të shqipes grupi τ+σ, kur janë marrë parimet e greqishtes. Mjafton të shihet se si del e njëjta fjalë në të dy gjuhët: τσοχα dhe *coha*. E njëjta gjë vlen për tingullin “u”, i cili jepet me dy shkronja të greqishtes dhe shpesh autorët e teksteve shqipe nuk janë menduar gjatë për të. Për krahasim, po përmend se edhe anglishtja e ka fonemën “sh”, por nuk ka ndonjë “shkronjë sh” në alfabetin e saj.

Ndërlikime sjellin parimet e greqishtes për shkronjat që paraqesin “g”, “j” dhe “i”. Për shembull, g+k të greqishtja shqiptohen si “ng” në fjalët greke, por thjesht si “g” në fjalët e huazuara (γκολ = gol). Përgjithësisht 18 shenja greke dhe 6 dyshkronjësha të ndërtuar me to i vlejné shkrimit të shqipes pa ndonjë problem.

Autorëve, që kanë bërë tekste shqip me ndihmën e shkronjave të greqishtes, u kanë dalë probleme me këto raste të para pikërisht në ndërlidhjet brenda një sistemi:

**b** që nuk e ka alfabeti grek;

**c** që greqishtja e jep me dy shkronjat **ts**;

ç që i mungon;  
**d** për t'u dalluar nga **dh**;  
**g** për t'u dalluar nga **gj**;

**j** që nuk e ka alfabeti grek dhe e jep nëpërmjet zgjidhjeve pozicionale me shkronja të tjera, ndërkohë që edhe në shqipen është i pranishëm problemi në çiftin J-I;

**ll** për t'u dalluar nga **l**;  
**nj** që nuk e ka greqishtja;  
**q** për t'u dalluar nga **k**;

**rr** që ka zgjidhje të thjeshtë duke e dyfishuar;  
**sh** që nuk e ka greqishtja dhe për t'u dalluar nga **s**;  
**x** dhe **xh** e **zh** që mund të jepen nëpërmjet dyshkronjëshave,

si dhe shkronjat për zanoret **ë**, **u** dhe **y**.

Për shumë kohë është menduar se alfabeti latin e kishte prejardhjen nga alfabeti grek, por sipas pikepamjes së shkencës së sotme ai është sjellë drejtpërdrejt prej etruskëve nga Azia e Vogël, kur u shpërngulën në Gadishullin Italik rreth vitit 900 para e.r. Etruskët ruajtën prej fenikasve edhe shkronjat Q, H e digamën, që nuk i kishin ashtu grekët e lashtë. Këtë alfabet e përpunuan latinët dhe në shek. VII para e.r. zetën e zëvendësuan me G. Sot ai përcaktohet si një alfabet me 25 shkronja. Alfabeti i sotëm i shqipes i ka të gjitha shenjat latine dhe u ka shtuar dy të tjera me shenja diakritike: ç dhe ë. Për 9 tingujt e tjerë janë përdorur dyshkronjësha dhe përfundimisht ky është një alfabet latin i përshtatur, por jo alfabet i latinishtes.

### *Shkrimi në trevat shqiptare*

Tashmë dihet se historia e alfabetit të sotëm të shqipes është e gjatë dhe e ndërlikuar; për të është shkruar shumë, kurse bibliografinë më të plotë deri më tani e ka dhënë Tomor Osmani<sup>1</sup> në librin e tij të njohur *Udha e shkronjave shqipe*, kështu që e quaj të pa-nevojshme ta përsëris këtu. Në të gjitha shkrimet kushtuar historisë së alfabetit të shqipes bie në sy se deri më sot ajo është gjurmuar duke nisur nga dëshmitë e para të shkrimit të saj. Ky trajtim do të ishte i përligjur, në rast se shqipja do ta kishte pasur alfabetin e vet të veçantë që në zanafillë. Të gjitha hamendësimet për një mundësi të tillë nuk qëndrojnë, duke përfshirë edhe fantazitë e mjegullta për alfabetin pellazgjik. As J. G. fon Hani nuk u kishte shpëtuar fantazive të tilla.

Gjurmimi shkencor e ka për detyrë të tregojë se cilat kanë qenë traditat shkrimore më të hershme në trojet ku flitet gjuha shqipe dhe se si në mjedisin e tyre stërgjyshët tanë zgjodhën, ndërtuan e përdorën alfabetet për shkrimin e gjuhës amtare. E quaj të domosdoshme një qasje të tillë jo vetëm sepse kështu bëhet i qartë përdorimi i disa alfabeve për shqipen, por sidomos edhe për të dëshmuar se **në këtë trevë të Ballkanit jugperëndimor kultura e shkruar europiane ka qenë e pranishme që në lashtësi dhe paraardhësit e shqiptarëve të sotëm kanë qenë pjesë përbërëse e kësaj kulture**. Nuk është nevoja të shtoj këtu me hollësi, se shqiptarët kanë shkruar edhe përpara se të hartonin tekste në gjuhën shqipe, kanë bërë

vepra për shembull, në gjuhën e përbashkët europiane të kohës, siç ishte latinishtja. E quaj të domosdoshme një qasje të tillë gjithashtu, sepse shpërfillja e saj ka sjellë që të përjashtohet interesimi shkencor për zanafillat e shkrimit në trojet tona.

Mosinteresimi për shkrimin përpara *Formulës së pagëzimit* (1462) kufizohet te gjuhëtarët. Arkeologët e historianë të tjerë përkundrazi, e kanë quajtur pjesë të natyrshme të punës së tyre të gjurmonin monumentet e shkrimit në trevat shqiptare, pavarësisht se në cilën gjuhë ishin, dhe i kanë botuar e interpretuar.<sup>2</sup> Arsyeja e këtij mosinteresimi është e shpjgueshme. Ai i ka rrënjët në qasjen nacionaliste të periudhës së krijimit të kombet europiane, e më ngushtë të kombet ballkanike, sipas së cilës ka rëndësi të nxirren në dukje aspektet e identitetit kombëtar, që i shërbejnë mbrojtjes së kombit, ndërsa gjithçka tjetër është e huaj dhe rrjedhimisht, është e drejtë të shpërfilllet. Qëndrimi të cilit i jam përmbajtur në këtë punim, i sheh kulturat në lidhje e bashkëveprim të përhershëm, që do të thotë se edhe për kulturën e shkruar shqiptare të shkuar e të sotme nuk ka përse të hesitet se ka pasur lidhje të ngushta me kulturat e tjera, se ka pësuar ndikimin e tyre e madje edhe se ka qenë e sunduar dhe nën tryshninë e tyre gjatë periudhave të caktuara. Përpunimi dhe mbijetesja e saj në këto rrethana lidhjesh, herë të frytshme e herë të dëmshme, do të dilnin me vlerë më të plotë duke i ndriçuar të gjitha aspektet historike me aq sa mundemi.

Përsa i përket gjuhës, trajtimi i kufizuar është marrë vetëm me shqipen dhe me botimet e shkollat

shqipe, në një kohë kur njohja e botimeve në gjuhë të huaja, të përdorura nga shqiptarët, dhe e shkollave në gjuhë të huaja për shqiptarët, të cilat kanë funksionuar në viset tona, na jep shpjegimin për një pjesë të proceseve historike në leksikun e shqipes, na dëshmon praninë e dygjuhësisë si gjendje të zakonshme për shtresa të caktuara të shoqërisë e krahinat ndëretnike, si dhe i jep kuptim luftës për librin dhe shkollën shqipe. Në periudhat e mëparshme si edhe për shumicën e kombeve të sotme europiane, ka qenë gjendje normale që të përdorej në shkrim një gjuhë tjetër dhe që shkollat të mos ishin në gjuhën amtare. Mjafton të përmendet historia e përkthimeve të Biblës, e një botimi me kaq përhapje dhe ndikim, për të dëftuar se gjuhët amtare të kombeve europiane po ashtu kanë kaluar procese të ndërlikuara derisa kanë gjetur rrugën për t'u mbrujtur si shprehëse të pakontestueshme të kulturës së vet. Veprimtarët europianë që nga Rilindja, duke e vështuar gjuhën si vlerën më të lartë të popullsisë e më pas të kombit, bënë të gjitha përpjekjet për të provuar se gjuhët amtare, që mbaheshin deri atëherë si të palëvruara e sidomos të varfra, të shndërrroheshin në të barasvlefshme me gjuhët klasike, domethënë me greqishten e vjetër dhe me latinishten. Po në këtë vazhdë europiane, me njohjen e saj dhe sipas shembullit të saj, ecën edhe rilindësit tanë. Nëse do të përmendnim emra, Naim Frashëri nga kjo pikëpamje do të renditej me D. Aligierin për italishten dhe me A.S. Pushkinin për rusishten. Më së fundi, nga këndvështrimi thjesht praktik, pa përmendur të huajt, **shqipen nisën ta shkruanin në secilin rast ata shqip-**

**tarë ose paraardhësit e tyre, që dinin të shkruanin në një gjuhë tjetër të huaj, domethënë që zotëronin një alfabet të një gjuhe të huaj** dhe e përshtatën atë për shqipen (duke përjashtuar rastet e rralla kur krijuan diçka origjinale, që përsëri do të thotë se njihnin shkrimin e gjuhëve të huaja dhe iu kundërvunë), me bindjen se do të kishte lexues që do t'i kuptonin me atë alfabet. Kur shqyrtojmë një tekst të shkruar gjatë historisë, është vetëm gjysma e punës të flitet për autorin, pasi ai autor ka shkruar për të pasur lexues, dhe kjo përbën gjysmën tjetër, domethënë u drejtohej njerëzve të gjuhës së vet, të cilët të paktën do të njihnin alfabetin e tij, domethënë kishin përvojë më së paku me shkrimin e një gjuhe tjetër.

### *Periudha e antikitetit*

Vetëm në shek. III para e.r. romakët arritën ta shtinin në dorë gjithë Gadishullin Italik dhe atëherë nisën luftimet jashtë tij. Rrjedhimisht, në trevat ilire nuk mund të kishte ndikime të alfabetit latin përpara shek. II para e.r., qoftë edhe duke e pranuar se etruskët mund të kishin lidhje me ilirët si një lloj fisi ilir. Prandaj të gjitha pohimet se ilirët e bregdetit lindor të Adriatikut kanë shkruar me alfabetin latin përpara shek. II para e.r. nuk kanë asnjë mbështetje historike.<sup>3</sup>

Sipas arkeologëve tanë, në trevat ilire shkrimi ndeshet për herë të parë në ngulimet helene të bregdetit që në shekullin V para erës së re:



Në gjysmën e parë të shek. V, pra në periudhën protourbane, shkrimi ndeshet për herë të parë edhe në mjediset ilire. Në një enë të gjetur në një varr në Kondas të Beratit ishte realizuar me gërvishje një mbishkrim nga pronari ilir i kësaj ene, duke përdorur gjuhën dhe alfabetin arkaik grek. Periudha e përdorimit të gjerë të shkrimit në Ilirinë e Jugut është shek. III p.e.r. Kjo është e lidhur me zhvillimin e vrullshëm ekonomik shoqëror, që paraqiste nevoja të gjithanshme për përdorimin e shkrimit në jetën e përditshme. Gjithashtu fuqizimi i shtetit ilir dhe i njësive të tij administrative autonome, koinoneve, bëri të nevojshëm përdorimin e gjerë të shkrimit në administratë. Të dhënat arkeologjike tregojnë se shkrimi mësohej në qytetet ilire në mënyrë sistematike.

Mbishkrimet e gjetura deri më sot janë të gjitha në gjuhën greke, që ishte gjuha e kulturës për kohën. Shkrimi grek, më i përparuar dhe me formula të gatshme për institucionet politike, juridike ose fetare ishte më praktik për t'u shkruar në gur. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia që ilirët të kenë shkruar edhe gjuhën e tyre në materiale që nuk na janë ruajtur, siç janë papiruset ose pergamenet.<sup>4</sup>

N. Ceka dhe M. Korkuti vënë në dukje se zhvillimi i veprimtarive ekonomike, shoqërore e politike bëri të domosdoshëm edhe krijimin e një sistemi arsimor në qendrat qytetare ilire. Mbi tabela druri, të lyera me dyllë, fëmijët shkruanin duke gërvishur sipërfaqen me mjetin e njohur stilo, prej të cilit e ka marrë emrin stili e më pas stilistika. Në Dimal, Amantie, Bylis, Selcë, Belsh etj. janë gjetur stilo dhe prova shkrimi të bëra nga fëmijët nxënës. Në Dyrrah dhe Apoloni janë gjetur mbishkrime të rralla, në të cilat del dialekti dorik, domethënë i prejardhjes së kolonëve nga Korinti e Korkyra. Vulat mbi enët, që shfaqen nga shek. V p.e.r., gjenden në amfora të ardhura nga Rodosi e gjetkë.

Mësimi i shkrimit nga shtresat e lira qytetare dha mundësi për përdorimin e gjerë të tij në jetën e përditshme. Kështu gjatë shek. III-II p.e.r. u bë e zakonshme që të vuloseshin prodhimet e qeramikës së ndërtimit me emrat e pronarëve të punishteve, qoftë këta persona privatë ose nëpunës shtetërorë. I zakonshëm u bë edhe shënimi nëpërmjet gërvishtjes i emrave të pronarëve të enëve prej balte, kryesisht të enëve të pijes, të quajtura grafitë.

Përdorimi i shkrimit gjeti vend në jetën e përditshme, duke na fiksuar aspekte të ndryshme të saj nëpërmjet mbishkrimeve. Duke u shkruar në materiale të forta, këto shpesh janë shkurtime të mendimeve të shënuara në letër. Gjuha e tyre është gjithmonë greqishtja e vjetër, që si gjuha e kulturës për kohën, u përdor edhe nga ilirët si gjuhë zyrtare. Në pjesën zotëruese të mbishkrimeve të gjetura në qytetet ilire, ajo është një gjuhë e thjeshtë, me formula të përcaktuara, që i drejtohen një publiku, që e njihje atë si gjuhë të huaj vetëm në vijat më të përgjithshme.<sup>5</sup>

Për shkakun se lëndët e tjera shkatërrohen gjatë kohës, lloji më i përhapur i mbishkrimeve që gjejnë arkeologët janë gurët e varreve. Në këto rrethana kuptohet që na kanë ardhur kryesisht emra ilirësh, krahas emrave prej onomastikës greke. Të tillë emra janë: Agron, Bato, Dasi, Epikadi, Genti, Praugi, Preurati, Skerdilaidi, Traisi, Teuta etj., ndërsa ende nuk është gjetur asnjë fjalë a fjali e shkruar prej dialekteve ilire. Arkeologët tanë kanë shënuar një ndryshim me kalimin në shek. II p.e.r., sepse përdoren shenja lunare për shkronjat sigma dhe epsilon, si dhe ndryshon forma e germës omega.

Si përfundim, dëshiroj të vë në dukje, se ngulimet e grekëve të lashtë në bregdetin ilir krijuan kushtet për dygjuhësinë e vendësve dhe për përhapjen e alfabetit grek te këta vendës. Ena e shek. V p.e.r. e për-

mendur nga Ceka e Korkuti përbën dëshminë e parë të një iliri, i cili përdor shkrimin në viset tona. Nga shek. III p.e.r. gjejmë emra ilirë të shkruar me alfabetin e greqishtes.

Pas plotësimit të pushtimit romak në shek. II p.e.r., proceset u përsëritën: u krijuan koloni romake në Ilirinë e Jugut, u vendos administrata provinciale romake, tregtia dhe mjeshtëritë sollën sende të reja në përdorim, u bënë ndërtime qytetare e ushtarake si dhe mjedise argëtimi tipike romake e, rrjedhimisht, te vendësit u përftua dygjuhësia tashmë me latinishten, e kështu zuri vend edhe latinishtja e shkruar. Mirëpo këto procese do të ndodhnin në kushte të tjera, sepse gjuha e sundimtarëve të rinj e gjente greqishten me traditë të hershme dhe prandaj tabloja shfaqet e ndërlikuar. Madje edhe emra romakësh në Apoloni dalin mbi epitafe me shkronja greke. N. Ceka dhe M. Korkuti nënvizojnë:

Krijimi i kolonive romake në Ilirinë e Jugut, kalimi në sistemin e principatit dhe vendosja e plotë e administratës provinciale romake u shoqërua me përdorimin e gjerë të gjuhës latine. Vetëm në qytetet e lira, si Apolonia e Amantia, vazhdoi të përdorej greqishtja si gjuhë zyrtare. Në Dyrrah, Shkodër, Lis, Bylis, Butrot etj. gjatë shek. I p.e.r. ndeshen pothuaj vetëm mbishkrime në gjuhën latine. Numri i mbishkrimeve latine të gjetura në vendin tonë është mjaft më i kufizuar se i atyre në gjuhën greke (rreth 300).<sup>6</sup>

Krahas zhvillimeve të tjera historike, që nga shek. III e.r. latinishtja nis të tërhiqet si mjeti kryesor i dygjuhësisë dhe hap pas hapi ia zë vendin përsëri greqishtja me një ndarje të veçantë ndërmjet këtyre dy

gjuhëve për trevat e tyre të mbizotërimit, siç e ka vënë re më së pari K. Jireçeku. Më konkretisht edhe në kolonitë romake, si Bylisi i Butroti, nisin të bëhen gjithnjë e më të rralla mbishkrimet latinisht.

### *Përhapja e krishterimit*

Për shkak se fetë e mëdha monoteiste mbështeten në një libër themelor, përhapja e tyre përbën një risi me pasoja të gjera jo vetëm për botëkuptimin, por edhe për gjuhën e re në të cilën mishërohet ky botëkuptim, edhe për shkrimin e gjuhëve.<sup>7</sup> U përftua një tablo e re, për të cilën ka pështjellime në trajtimet e sotme kushtuar këtij faktori historik. Del e nevojshme të jepen shkurt disa shpjegime.

Në Koncilin e Jerusalem të vitit 49 të erës sonë Shën Pali mori përsipër të ungjillëzonte paganët në Azinë e Vogël dhe në Ballkan, si dhe të tërhiqte në sektin e ri çifutët e sinagogave. Në letrën e tij të vitit 59 ka shkruar, se e kishte sjellë ungjillin e Krishtit, në kuptimin e "lajmit të mirë", deri në Ilirik. Në këto fillime gjuha e krishterimit ka qenë greqishtja helenistike. Shën Pali, që natyrisht njihnte edhe latinishten, ka punuar në ngulimet me grekë e romakë, atje ku gjente sinagoga të hebrenjve, dhe jo me banorët që flisnin gjuhën e vendit, domethënë dialektet e ilirishtes jugperëndimore. Janë pa asnjë mbështetje shkencore pohimet e disave sot, se ilirët qenkan kthyer në të krishterë qysh prej shekullit të parë. Këto pohime kanë të

njëjtën frymë, si rrëhimet e historianëve leninistë-stalinistë për t'i gjetur sa më thellë rrënjët e lëvizjes komuniste në Shqipëri ose të miqësisë shqiptaro-ruse. Nga viti 112 e deri më 313 të krishterët u përdoqën nga tetë perandorë romakë, prej Trajanit e deri te Diokleciani.. Për arsye të tilla objektive, duke shtuar edhe atë që preket më poshtë lidhur me gjuhën e Biblës, nuk mund të pranojmë se krishterimi do të depëronte në gjuhën e paraardhësve të shqiptarëve i shprehur me gjuhën greke. Me këtë shpjegohet përse nuk kemi një shtresë të vjetër të huazimeve fetare nga greqishtja. Siç ishte thënë më parë nga historianë të huaj dhe pastaj e ka provuar gjuhësisht prof. E. Çabej, terminologjia kristiane me gurrë latine përbën shtresën më të moçme të gjuhës fetare për shqipen, shtresë më e moçme se shtresa greke dhe me përdorim edhe nga ortodoksët e vendit.<sup>7</sup> Me Ediktin e Milanos më 313 të krishterët fituan të drejtat qytetare dhe fetare. Si rrjedhim, kur u shfaq krishterimi në viset tona si fe zyrtare, e qendrës, tashmë vinte nga perëndimi dhe ishte mbizotërueshëm në gjuhën latine.

Krishterimi erdhi për vendësit si një gjuhë e re në dy kuptime: edhe si mënyrë e re të shprehuri për botën e njeriun, por edhe si gjuhë e re e huaj për një fushë të caktuar, madje vijoi të ishte i tillë për më tepër se një mijëvjeçar te besimtarët katolikë. Po përmend një shembull me interes. Ndër emërtimet e ditëve të javës shqipja ka *e diel*, e cila pasqyron lat. *dies solis*. Ky kalkim i takon periudhës pagane para shek. IV të erës së re, sepse vetëm në shek. IV me krishterimin u ngulit *dies dominica*, sipas greqishtes κυριακη, por as latinishtja

dhe as greqishtja nuk arritën ta zëvendësonin te vendësit emërtimin e mëparshëm të ngulitur: *e diel*.

Deri në shek. IV Bibla njihej për pjesën e parë në greqishten e vjetër sipas përkthimit të Septuagintës që në shek. III para e.r. Do të ishte jashtë çdo hamendësimi të pranohej se ajo lexohej dhe kuptohej në atë greqishte prej banorëve të trevave ilire jugperëndimore. Nuk del i pranueshëm as pohimi i N. Cekës, se: “Bibla predikohej në greqisht dhe në latinisht, por shpjegimi i saj mund të bëhej i kuptueshëm vetëm në gjuhët lokale”.<sup>9</sup> Numri i madh i huazimeve latine në këtë fushë dëshmon të kundërtën, domethënë se gjuha e fesë për një periudhë të gjatë vijoi të ishte e huaj dhe konkretisht latinishtja, përndryshe do të kërkonim predikues tepër të ngritur gjuhësisht, njerëz shumëgjuhësh që edhe njihnin dialektet ilire, edhe ishin në gjendje ta përpunonin ligjërimin e krishterë në të folmet vendëse. Në të vërtetë kemi fjalë, si: *bekoj, mallkoj, shëndërtat* etj., të cilat kanë hyrë në shqipen si togfjalësh, gjymtyrët e të cilëve nga vendësit nuk kuptoeshin veç e veç. Dukuria bëhet e qartë po të krahasojmë *Kërshëndellat*, huazim i vjetër i drejtpërdrejtë nga togfjalëshi i latinishtes, me *Krishtlindje*, i cili është një përkthim shumë më i vonë, kur shqiptarët i kuptonin veç e veç fjalët e huaja të *Christi Natale*.

Pjesa e dytë, Dhiata e re, është hartuar në greqishten koine helenistike dhe nuk ishte një tekst i përkthyer. Ungjijtë u shkruan greqisht midis viteve 70 dhe 120 të erës sonë. Vetëm në vitin 405 Eusebius Hieronimi redaktoi në variantin përfundimtar prej tekstesh të ndryshme një përkthim latinisht, të mbështetur edhe

te Septuaginta. Veçantia për viset tona ndërlikohet prej rrethanës së përmendur më sipër, që krishterimi si "gjuhë e re" u predikua në dy gjuhë konkrete të huaja: latinisht dhe greqisht. Në shekullin e katërt të erës së re kështu problemi gjuhësor i krishterimit u ndesh për ne me praninë e ndikimit të dy zonave të mëdha kulturore e gjuhësore në trevat shqiptare, domethënë edhe të dy zonave me alfabete të ndryshme, njëra prej të cilave ishte e greqishtes. Me gjithë ndarjen e Perandorisë Romake në fund të shek. IV (viti 395) nga Teodosi, nuk mund të përcaktohet një vijë e qartë ndarëse ndërmjet këtyre zonave sipas mbishkrimeve. Aq më pak mund të thuhet se kjo vijë ndarëse kalonte afërsisht sipas lumit Shkumbin, siç shkruajnë pa asnjë mbështetje historike disa autorë sot. (Vija ka qenë shumë më në veri, aq sa në ditët e sotme me synime politike është përmendur edhe si vijë për zhvillimet e mëtejshme të Europës së Bashkuar, që do të ishte në kufijtë jugorë të Kroacisë). Ndeshen në shek. II-III edhe raste, kur qytetarë me prejardhje romake i shkruajnë greqisht mbishkrimet e varreve në Apoloni e në Dyrrah.

Më pas, vija e përafërt gjuhësore lidhur me fushën administrative e fetare zbatohet kështu në antikitetin e vonë (shek. IV-VI): Prevalitania ishte tërësisht nën latinishten, Epiri i Vjetër ishte tërësisht nën greqishten, Dardania ishte me mbizotërim të latinishtes, ndërsa Maqedonia me mbizotërim të greqishtes. Epiri i Veriut ishte ende pjesërisht nën latinishten. Duke hyrë në periudhën bizantine, jo vetëm gjuha e administratës, por edhe gjuha e krishterimit në pjesën

më të madhe të trojeve shqiptare u bë greqishtja. Nga fundi i antikitetit të vonë ruhet te ne dokumenti i çmueshëm Kodiku i Purpurt (Codex purpureus beratinus) i shek VI (të cilin, me sa duket, nga peshkopata e Bylisit e sollën në kryepeshkopatën e Beratit në shek. XI). Teksti i dytë kishtar më i lashtë greqisht që ruhet në Shqipëri është Kodiku i Artë (Codex aureus Anthimi) i shek. X. E quaj me rëndësi të vë në dukje edhe një herë, se kemi të bëjmë me tekste të Dhiatës së re dhe jo të Dhiatës së vjetër.

Rivendosja pas një epoke të errët e pushtetit bizantin në shek. IX, kur në dokumentet greke *alvanoï* – arbëreshët dëshmohen me emrin e tyre, solli te përhapja e gjerë e greqishtes në fushën administrative, në jetën kishtarë dhe kulturore të vendit. Është me rëndësi fakti që në varrezën e Komanit (shek. X) është gjetur unaza me mbishkrimin që përmban një lutje bizantine, domethënë me alfabetin e greqishtes, të dëshmuar kështu edhe në thellësi të Veriut të Shqipërisë. Studiuesi Th. Popa i ka gjurmuar mbishkrimet e kishave në një varg punimesh të thelluara.<sup>10</sup> Sipas tij, mbishkrimi më i vjetër i përket vitit 866 në gërmadhat e kishës së Ballshit (nga vjen njëri prej Kodikëve). I vitit 1250 është një mbishkrim i dëmtuar në kishën e manastirit të Pojanit (Fier) dhe i vitit 1350 është mbishkrimi tjetër po në Pojan. Shekullit XIV i përkasin mbishkrimet e kishës së Maligradit në Prespë (1345 dhe 1369), të kishës së Mborjes në Korçë (1390). Me rëndësi të veçantë për historinë shqiptare janë mbishkrimi i vitit 1373 në Epitafin e Gllavinicës (nga Ballshi), që flet për Gjergjin dhe Ballshin, dhe i vitit



1381 në Shën Gjon Vladimir të Elbasanit, që flet për princin mesjetar shqiptar Karl Topia.

Menjëherë pas ardhjes së turqve numri i mbishkrimeve greqisht bie, por në shek. XVI shfaqet një faktor i ri: në kisha pikturojnë artistë të shqur si Onufri, dhe më pas nxënësit e tij: Nikolla Onufri (i biri), Onufër Qiprioti (shek. XVI-XVII) dhe të tjerë. Edhe për këto mbishkrime ka shkruar gjerësisht Th. Popa.<sup>11</sup> Prej Onufrit janë ruajtur 10 megalograme (në kishat e Valshit, të Shelcanit dhe në ikonat e Beratit), në të cilat janë vërejtur gabime drejtshkrimi. Një nga datat e pikturimit prej Onufrit është 1554. Nga i biri, Nikolla, njihet data 1578 e pikturimit të Shën Mërisë Vllaherne në Berat; ai ka pikturuar dhe në Kurjan të Fierit. Më të hershme janë mbishkrimet: në Peshkëpinë e Dropullit (1511) dhe në kishën e Leshnicës së epërme të Delvinës (1525). Përgjithësisht mbishkrimet e shek. XVI në kishat ortodokse janë me paleografinë bizantine të kohës.

Më 2003 Arkivi i Shtetit botoi një Katalog me 100 kodikë ungjillorë, që ruhen te ne. Në këtë traditë krahas jetës fetare ka edhe aspekte laike e madje etnike. Ata tregojnë se këtu ka ekzistuar një shkollë e shkruarve profesionistë, ka pasur veprimtari kulturore, e cila ecte paralelisht me atë të vendeve të tjera europiane dhe, natyrisht, shprehej në dy gjuhët perandorake mbisunduese për 15 shekuj në Europë.

### *Teksti i parë shqip*

Rrethanat historike prej shek. XVI shfaqin disa veçori. Deri para ardhjes së osmanëve kishat ndërtoheshin vetëm nga perandorë, fisnikë e peshkopë, tashmë kjo nuk është e mundur nën sundimin e ri. Si rrjedhim, në mbishkrimet dalin emrat e piktorëve dhe të atyre që japin të hollat për ndërtimin, rindërtimin e zbukurimet. Nga fundi i shek. XVII në mbishkrimet do të zënë vend gjerësisht anëtarët e bashkësisë së krishterë, të cilët japin ndihmesat, duke përfshirë gjithnjë e më shumë emra shqiptarësh, të shkruar me alfabetin e greqishtes. Piktorët shpesh punojnë në kisha të qendrave të vogla, larg autoriteteve sunduese osmane. Por kryesorja është se në shek. XVI nis islamizimi i shqiptarëve, i cili do të arrijë në më shumë se gjysmën e popullsisë gjatë shekullit pasues. Shkurt, këto rrethana e vënë në rrezik të ardhmen e krishterimit. Për të mbrojtur traditën fetare dalin përfaqësuesit e popullsisë vendëse, sepse pushtuesit bashkë me ndryshimin fetar preknin edhe elementë themelorë të kombësisë, e në radhë të parë gjuhën shqipe. Pikërisht në këto kushte u përftua domosdoshmëria për të pasur në gjuhën amtare të paktën pjesë të shërbesave që u duheshin shërbestarëve për rutinën e jetës kishtare.

Në trevën e përdorimit të greqishtes si gjuhë e fesë kështu do të hartoheshin natyrshëm shkrime shqipe me alfabetin e greqishtes. Siç doli tashmë e qartë, shkronjat e greqishtes ishin të pranishme në mjedise publike dhe me përdorime publike në treva të gjera shqiptare.

Teksti i parë shqip me shkronja të greqishtes është e ashtuquajtura Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve, një fletë e gjetur brenda një kodiku greqisht të shek. XIV në Bibliotekën Ambroziane të Milanos. Fleta nga njëra anë ka një copë nga Ungjilli i Mateut (XXVII, 62-66) dhe nga ana tjetër një këngë pashkësh, me alfabetin e greqishtes dhe në dialektin e jugut. Vështrimi i mirëfilltë gjuhësor më bën të besoj se datimi nuk është para shek. XVI. Kodiku ku është gjetur është greqisht, ndërsa fletën shqip aty mund ta kenë futur njerëz, që e kanë kujtuar greqisht. Ajo ka vajtur në Itali nga krahinat e shqiptarëve të shpërngulur pas vdekjes së Skënderbeut. Kjo periudhë përputhet me rrethanat që u përcaktuan më sipër.

Ndërkaq, edhe studimi i tekstit jep argumente të tjera. Teksti i fletës është hartuar për t'u përdorur në shërbesë ditën e pashkëve, madje i kënduar, prandaj shoqërohet me notat muzikore, me numrat sipas muzikës bizantine. Notat janë për t'u kënduar vargjet, rrjedhimisht, vargjet shqip kanë qenë pikënisja dhe objekti kryesor. Kënga gjuhësisht shfaqet e stabilizuar, është e përpunuar nga ana stilistike, e përshtatur ritmikisht. Kjo mund të ndodhte vetëm nëse ishte regjistruar me shkrim duke u nisur nga përdorimi i gjallë në kishë, për pasojë, nuk është përkthim i këtij autori. Kënga përfaqëson gjuhën e vërtetë të kohës, e cila nuk ka tipare të një lashtësie para shekullit XVI. Pjesa nga Mateu është e përkthyer, për të shërbyer si parapërgatitje e këndimit të vargjeve, siç e kërkon rituali i shërbesës. Madje paraprihet nga një fjali hyrëse, e cila tregon se nga është marrë copa, ndërsa në

fund është një formulë urimi, gjithashtu e përkthyer pikë për pikë nga formula përkatëse e greqishtes. Ishte përshëndetja që kori ia thoshte priftit, pasi dhia-ku këndonte. Fjalja paraqitëse është greqisht, po ashtu si i ka latinisht Buzuku, duke e shndërruar tekstin në dygjuhësh. Përkthimi është i dobët, madje autori as e ka vënë re, që vargu i këngës mund ta ndihmonte për përkthimin më të mirë. Është një përkthyes i dështuar, porse kur riprodhon fjalët e veta dhe ato që i ka marrë nga vargjet e kënduara, teksti është më i rrjedhshëm. Shkurt, gjuha e ngathët e pjesës së përkthyer të tekstit nuk përbën dëshmi për ndonjë lashtësi më të madhe të saj.

Një meshtar shqiptar ka dashur ta ngulitë traditën e ritit shqip të kishës lindore në rrethanat, kur ajo po kërcënohej pas ardhjes së osmanëve. E ka regjistruar atë, duke e plotësuar me përkthimin e vet për ta përdorur edhe të tjerë njësoj në shërbesat. Ky autor është në përmasa fare të vogla Buzuku i Shqipërisë së mesme e jugore dhe vepra e tij është përfutur në po ato rrethana, si edhe te kolegu i tij madhor i Veriut.

Në tabelën e alfabetit të Perikopesë, të ndërtuar prej T. Osmanit,<sup>12</sup> lihet me pikëpyetje shkronja përkatëse për "b" të shqipes, por në të vërtetë te dorëshkrimi del me  $\mu\pi$ , siç është e zakonshme për greqishten. Shkronjat e shqipes *c, ç, h, nj, x, xh, y, zh* nuk paraqiten në alfabet, për arsyen e thjeshtë se nuk ka rastisur në dorëshkrim asnjë fjalë shqipe me këta tinguj. Gjithashtu  $\gamma\kappa$  nuk u përgjigjen shqipes NK, por janë thjesht për "g", sipas parimeve të greqishtes. Teksti ka edhe disa probleme të tjera, të lidhura me fjalët e përdoru-

ra, por që ndriçohen nëpërmjet krahasimit me origjinalin greqisht, kundrejt të cilit përkthyesi është shmangur në ndonjë rast që të dilte më e qartë shqipja. Nuk është vendi këtu për të hyrë më hollësisht në këtë shqyrtim, por si përfundim del se përkthyesi ka përshtatur drejtpërdrejt alfabetin e greqishtes, madje ka brenda tekstit ndonjë fjalë të lënë thjesht greqisht. Si përfundim, nuk kemi një tekst me alfabetin grek, por me alfabetin e greqishtes.

Dëshminë deri tani të vetme për shkrimin e shqipes me alfabetin grek gjatë shek. XVII e kemi nga dorëshkrimet e Nilo Katalanos (1637-1694), misionar italian në Himarë, që e kishte mësuar shqipen ndër arbëreshët e Mexoiusos. Dorëshkrimi ka një këngë arbëreshe dhe dy faqe të P. Bogdanit me shkronja të greqishtes, disa prej të cilave kanë shenja diakritike. Ky është një alfabet grek i përshtatur. Nga ana tjetër, mbishkrime greqisht të kësaj periudhe gjenden në kishën e Maligradit të Prespës (1604 e 1607), në kishën e Dushanit të Oparit (1610), në kishën e Shën Kollit të Beratit nga Onufër Qiprioti (1615), në kishën e Shën Kollit të Shelcanit (1625), në një enë temjani në kishën e Shën Todrit të Beratit (1660), në manastirin Kameno afër Delvinës (1662), në manastirin e Kakomesë afër Nivicë Bubarit prej piktorit Mihal nga Jerma e Delvinës (1672) dhe në një ikonë të Shën Gjon Vladimirit të Elbasanit (1693). Teksti i Shelcanit (1625) ka gabime, por është me interes prania e emrave të shqiptarëve, shoqëruar me vështirësitë e paraqitjes së tingullit “gj” (për emra, si: Gjika, Gjergji), i cili është dhënë nëpërmjet γγ ose γκ.

### *Shekulli i tetëmbëdhjetë*

Shekulli XVIII hapet me praninë e lamdës greke në titullin e Kuvendit të Arbrit (1706): Concili Provinciali. Mendimi se për botimin e tekstit shqip është kujdesur F. M. da Leçe gjen mbështetje te kjo shkronjë. Ai e ka përdorur te Gramatika (1716) dhe në dorëshkrimin e fjalorit të tij italisht-shqip. Vetë da Leça thotë se e ka marrë nga P. Bogdani, i cili e kishte përdorur në veprën “Çeta e profetëve” të shtypur pak vjet më parë (1685). Ndërkaq, nuk qëndron mendimi i J. Kastratit, se: “Sa për shkronjën lamda, veç Bogdanit e Da Lecces nuk ka të tjerë ta kenë përdorur.”<sup>13</sup> Këtë lamda do ta gjejmë edhe në fillim të veprës “Doktrina e krishterë” të Gj. Kazazit (1743), por jo brenda tekstit, si dhe në një dorëshkrim shkodran (1744),<sup>14</sup> madje dorëshkrimi e ndjek Bogdanin edhe për shkronja të tjera të alfabetit. Ndërsa kërkon një shqyrtim të posaçëm për t’u shpjeguar përdorimi i shenjës tjetër të greqishtes κ (krahas c latine në fjalë të tjera) prej P. Bogdanit. Gjithashtu lamda do të dalë më 1710 edhe në dorëshkrimin e gramatikës së shqipes, e cila quhet e hartuar prej misionarit Diego da Dezio. Jak Jungu (1837-1889) e ka ruajtur lamdën e Bogdanit në një gramatikë e në fjalor (1881 dhe 1885).

Gjatë shekullit XVIII u shënua një ngritje ekonomike e tregtare në viset shqiptare, qytetet u rritën dhe u bënë qendra me peshë administrative, fetare e kulturore, kurse nga ana politike u shfaqën pashallëqet e mëdha shqiptare. U zgjeruan edhe lidhjet me botën përtej kufijve të Perandorisë Osmane. Pati shqiptarë,

të cilët mësuuan në shkolla europiane, duke iu hapur rruga kështu ndikimit të Iluminizmit e madje në fund edhe të Revolucionit Francez. Brenda kësaj kornize më të larmishme u shtua prodhimi i autorëve shqiptarë, i shoqëruar me një varg procesesh, të cilat patën pasojë edhe në veçoritë e shkrimit të shqipes.

Përhapja e kulturës orientale mbi bazën e një arsimi të organizuar, tashmë edhe si një rrymë për letërsinë vendëse, shkaktoi që krahas alfabeve të tjera të zërë vend për shqipen edhe alfabeti arab-osman. Letërsia e bejtexhinjve me këtë alfabet dokumentohet që më 1724 në Gjirokastrë. Ndonëse botimet shqip të kishës katolike shkuan duke rënë për këtë periudhë, puna mësimore fetare dhe përpjekjet për shkollat, si domos nga rregulltarët françeskanë, e zgjeruan njohjen e alfabetit latin. Po t'u shtohen këtyre jo vetëm marrëdhëniet tregtare në zgjerim me brigjet italiane, si edhe përtëritja e lidhjeve fetare e madje diturore me arbëreshët e Italisë, atëherë do të kuptojmë një dukuri të përsëritur: praninë e të dy alfabeve, të latinishtes e të greqishtes, në shkrimet e trevave shqiptare. I kësaj kohe është një mbishkrim me shkronja të përziera greke e latine në kambanën e kishës së manastirit në Krorëz, në veri të Sarandës. Përballë ishte ishulli i Korfuzit, i cili bashkë me Ishujt Jonianë qëndroi nën Venedikun deri më 1797. Së fundi, një gjallërim kulturor nisën të përjetonin edhe arbëreshët e Italisë, duke ecur drejt vetëdijes se prejardhja e tyre kërkonte tashmë një mbështetje në kulturën e shkruar, gjë që pati si rrjedhim interesimin e shprehur për gjuhën shqipe.

Përdorimi i alfabeve përkatëse për shqipen e shkruar gjatë shekullit XVIII përvijohet si orientim kulturor jo vetëm nga tradita, nga afërsia territoriale e lidhjet me kulturat e tjera, por edhe nga politikat sunduese, fetare e asimiluese, që i frymëzonin ato. Përdorimi i alfabetit përkatës këtej e tutje do të varej nga **orientimi kulturor i vetë qarqeve shqiptare**, natyrisht, brenda një tabloje të ndërlikuar.

Mbishkrimet e kësaj kohe greqisht nëpër kisha u përkasin piktorëve të shquar e madje familjeve të tëra të piktorëve shqiptarë, si Kostandin Shpataraku, David Selenicasi, familjes së Katrove (Grabovarëve që nga 1774 deri më 1866) dhe Zografëve (që nga 1744 deri më 1782), të cilët na kanë lënë prodhimin më të pasur. Ndërmjet mbishkrimeve interes të veçantë paraqet ai i vitit 1731 mbi gravurën e Shën Mërisë prej manastirit të Ardenicës, i botuar nga Nektar Tërpoja në Venedik te libri i tij. Meqë ky kërkon një interpretim krejt të ri, do të trajtohet veçan në artikullin tjetër këtu lidhur me *alfabetin e arumanishtes për gjuhën shqipe*, si dhe me rrethanat e Voskopojës. Mbishkrime greqisht ka në kishat e Voskopojës që më 1703 (në një ikonë) dhe më pas më 1712, 1715, 1726, 1758 etj.

Për zgjerimin e përdorimit të alfabetit të greqishtes gjatë shek. XVIII dha një shtysë të madhe çelja e shkollave greqisht në qytete të tilla, si Elbasani, Berati, Korça, e madje edhe në qendra më të vogla, me mbështetjen e kishës greke dhe për qëllimet e saj. Ndërkaq, islamizimi nuk i preku vllëhtë dhe prandaj kisha e shkolla greke mbështetej gjerësisht tek ata, duke u dhënë mundësinë për të përparuar në hierar-



kinë fetare e arsimore. Pa dyshim, qendra rrezatuese e kohës u bë Voskopoja dhe me të lidhen shumë fije të shtrira në gjithë trevën e Shqipërisë jugore. Nuk është nevoja të përmendet këtu historia e qytetit, mjafton të thuhet se aty u ngritën kisha me mbishkrime greqisht nga piktorët e përmendur më lart. Më 1710 u ngrit një kolegji grek dhe më pas shkolla e mesme me personel shqiptar e arumun, që më 1750 u quajt Akademia e Re, si dhe shtypshkronja e vitit 1720, kurse pranë saj edhe një bibliotekë. Tashmë është e njohur lidhja e kësaj qendre me iluminizmin europian, prandaj A. Heceri e ka titulluar një artikull të vetin “Greqishtja në Shqipërinë jugore gjatë periudhës së Iluminizmit”.<sup>15</sup>

Veprimtaria arsimore e botuese në Voskopojë i dha hapësirë një përbërëseje tjetër për historinë e shkrimit të shqipes. Deri në këtë kohë përpjekjet për shkrimin e shqipes kishin më tepër qëllime jashtëgjjuhësore, ndër të cilat me rol të veçantë ka qenë synimi për të mbështetur shërbesat fetare shqip. Tashmë zgjerohet qëllimi për t’i shërbyer gjuhës shqipe në vetvete, për ta ngulitur atë si gjuhë të shkruar, duke përgatitur mjetet gjuhësore, siç do të ishin gramatikat e fjalorët. Nëpërmjet këtij procesi shqipja hap pas hapi do të bëhej mjeti universal i kulturës shqiptare. E quaj me rëndësi të vë në dukje, se ky proces përftohet i lidhur me mësimin e shqipes (qoftë dhe nga të huajt), me shkollën. Hartimi i një fjalori ose gramatike të shqipes është prova bindëse, që **është ngulitur vetëdija, se kjo është një gjuhë më vete, se ka nevojë për lëvrimin si e tillë, se është ajo në qendër të vëmendjes, domethënë nuk është thjesht mjet shërby-**

**es i një veprimtarie, por ka statusin e vet si subjekt, si veprimtari.** Këtë vetëdije e gjejmë të shprehur te vepra e Frang Bardhit, e cila zakonisht quhet *Fjalori latinisht-shqip*, por që në të vërtetë është libri i parë për mësimin e shqipes, një vështrim ky të cilin e kam shtjelluar gjetkë dhe nuk do të merrem me të hollësisht këtu.

Për shkak të rrethanave historike ky proces mori jetë në kushte dygjuhësie ose në lidhje të ngushtë me praktikën e gjuhëve të tjera të huaja. Nuk është puna për ndonjë përjashtim të rrallë, sepse kështu ka ndodhur edhe me gjuhë të tjera. Sipas kësaj mënyre vështrimi, marrin tjetër vlerë fjalorët dhe gramatikat e hershme të shqipes. Fjalori i F. Bardhit nuk është thjesht një fjalor dygjuhësh, si ata që botojmë sot. Ai ishte dëshmi e rëndësishme, se gjuha shqipe radhitej me gjuhët e tjera europiane të lëvruara, ishte në gjendje të përballonte pranëvënien me një gjuhë klasike, aq sa puna e autorit tregon jo vetëm për një vetëdijë, por edhe për një guxim të mirëfilltë. Gramatika e Da Dezios ose e da Leçes u përgatitën, sepse nuk bëhej pa e njohur shqipen me gramatikë, domethënë si një strukturë gjuhësore të qëndrueshme e të mëvetësishme. Qoftë edhe interesimi i G. Lajbnicit ishte interesim për shqipen si gjuhë më vete, si vlerë në vetvete, si pjesëtare e bashkësisë së gjuhëve europiane dhe, nëse e shtjellojmë metaforën e familjes së gjuhëve, do të thosha se ishte interesimi për një anëtar të familjes. Si përfundim të përgjithshëm kemi se edhe alfabeti i shqipes tashmë del si problem më vete, i lidhur me njërin ose tjetrin orientim kulturor. Këtej e tutje nuk

do të jetë parësore çështja e vendosjes së shkronjave për tingujt e veçantë, pra jo çështja teknike, por zgjidhja tërësore. Dhe kështu shfaqen alfabetet origjinale, si të tjera zgjidhje tërësore, të cilat burojnë prej një tjetër vetëdijeje. Më në fund, kështu gjejmë edhe zanafillën e **luftës për alfabetin e shqipes**. Lufta nuk do të bëhet për përcaktime teknike, por për natyrën e themeleve të një kulture. Tabloja do të bëhet e ndërlikuar, e mbi të gjitha duhet theksuar se ky proces e përfshiu punën për shqipen e shkruar në të gjitha trevat shqiptare, si edhe në diasporë.

Shembullin më të mirë na e jep puna e Theodor Haxhifilipit (1730-1805). Rreth alfabetit të tij është shkruar mjaft që nga hamendësimi i albanologut J. G. Han, i cili kujtonte se kishte bërë një zbulim të veçantë. Përveç gjykimit të alfabetit të tij si glagolitik, është dhënë mendimi nga Gj. Pekmezi (1901) se ishte një alfabet kursiv i shek. XVIII i stilizuar. T. Osmani gjen aty disa germa greke, ndonëse më tepër mund të flitej për ngjashmëri me to, sepse edhe në një alfabet origjinal autori ndërton disa shenja të thjeshta, të cilat natyrshëm përkojnë me ndonjë alfabet ekzistues. Kështu shenja *v* mund të merret si “n” greke, por edhe si shenja e përmbysur për “d” në alfabetin e autorit. Ndërkaq, te përdorimi i dyshkronjëshave me të drejtë T. Osmani vëren ndikimin e një parimi të alfabetit të greqishtes dhe kjo ka të bëjë edhe me grupet *mb*, *nd*, *ng*, që Osmani përpiqet t’i lidhë me dukuritë fonetike të shqipes së kohës.

Datime të ndryshme janë dhënë për një kodik beratas, të cilit i ka mbetur emri si punë e Kostë Beratit.

Është një tekst tipik dygjuhësh, në të cilin shqipja është dhënë me alfabetin e greqishtes, të përshtatur, me disa zgjidhje të papërpikta. Ka nevojë për një shqyrtim tërësor, sepse luhatjet e alfabetit vijnë edhe për shkak të duarve të ndryshme, domethënë alfabeti do të ndriçohet bashkë me autorësinë. Është një dorëshkrim që e vlen të transkribohet e të botohet, sepse ka edhe një fjalorth greqisht-shqip me mbi 1500 fjalë, domethënë vjen njëkohësisht me Th. Kavaliotin dhe krahasimi do të kishte interes të veçantë.

### *Librat shqip me shkronja të greqishtes*

Veçan nga Voskopoja, një drejtim tjetër në përdorimin e shkronjave të greqishtes për shqipen pati si vatër Janinën, duke përfshirë shqiptarë e arbëreshë në jug e në perëndim të saj dhe në veri deri në Gjirokastrë e Bregun e Detit. Ndërkaq, në qendrën e pashallëkut kishte edhe shqiptarë dygjuhësh, edhe grekë që e kishin shqipen si gjuhë të dytë. Ali Pasha në fund të shek. XVIII e në fillim të shek. XIX i nxori në qendër të vëmendjes ndërkombëtare shqiptarët e bashkë me ta edhe gjuhën e tyre. Ai e nxiti interesimin për shqipen dhe në një mënyrë ose një tjetër me Janinën lidhen disa gramatika e fjalorë të shqipes. Përsa i përket alfabetit, mund të përmenden disa nga të huajt. Xhon Hobhauzi përdor shkronjën greke θ. Për Martin-Likun do të flas hollësisht në shkrimin tjetër këtu,

ngaqë është rasti i *përdorimit të alfabetit të shqipes për shkrimin e gjuhëve të tjera*.

Dy dukuri të lidhura me Janinën janë gramatika e Stefan Postenanit dhe gramatika e Jan Vellarait. Postenani para vitit 1822 ka bërë një gramatikë të greqishtes, shkruar shqip me alfabetin e greqishtes dhe me disa shkronja latine, si rrjedhim do të quhej i përzier alfabeti i tij. Ndërsa Vellarai i dërgoi për Janinë shënimet rreth gramatikës së shqipes, të shkruara me një alfabet origjinal. Këto do të dukeshin dukuri të çuditshme, por kanë shpjegim të thjeshtë në qoftë se vihen në kornizën e dygjuhësisë. Megjithatë bën përshtypje që Vellarai nuk përshtati alfabetin e greqishtes e, ndoshta, ka pasur mëtime më të gjera për të dhënë ndihmesë në shkrimin e shqipes, që t'i mbetej emri.

Shekulli XIX hapet me Dhanil Voskopojarin, për të cilin do të flas në faqet pasuese, dhe me një fjalorth greqisht-shqip, të shkruar me dorën e Marko Boçarit. Ndonëse që më 1991 e kam vërtetuar se ky nuk është fjalor i Marko Boçarit, në studimet tona ai vijon pa të drejtë të quhet i tillë, duke mos marrë parasysh qoftë edhe faktin e thjeshtë se i ashtuquajtimi autor ishte në atë kohë vetëm 18 vjeç,<sup>16</sup> si dhe shënimin e qartë të F. Pukëvilit, se lënda është shkruar sipas diktimit të të atit, xhaxhait dhe vjehrrit të ardhshëm të Markos. Ky nuk ishte asnjë lloj fjalori, as nuk ka renditje fjalori e qoftë edhe emrat e ditëve të javëve nuk i ka të plota. Ishte lëndë gjuhësore për shqipen, që i nevojitej Pukëvilit për punën e vet të mëtejshme. Me termat e sotëm, ishte materiali i një ekspedite gjuhësore, të cilin Pukëvili nuk ishte në gjendje ta regjistronte vetë me

shkrim. Ndërkaq, do ta pranojmë se alfabeti është vërtet i Markos, i cili kishte mësuar në shkollën greke, por në kushtet e ndikimit të italishtes në Korfuz. Ai ka jo thjesht shkronjat, por ndjek parimet pozicionale të germave të greqishtes, p.sh. për  $\mu\tau$ ,  $\nu\tau$ ,  $\sigma$  dhe  $\zeta$ ,  $\alpha$ ,  $\omicron$ ,  $\varphi$  dhe  $\upsilon$  pozicionale. Ka bërë dallimin ndërmjet “ç” dhe “c”, duke e quajtur “ç” një “c” të palatalizuar, domethënë  $\tau\zeta$  përpara  $\iota$ ,  $\eta$ . Është një alfabet i greqishtes i përzier, sepse ka përfshirë edhe shkronja latine: përdor “gn” për “nj” dhe në këtë rast si të thuash, kalon tërësisht te tastiera me shkronja latine për gjithë fjalën: *gneri*, *gnam*. Këto nuk janë gabime, por duan të thonë se Markoja e kishte shprehinë e të shkruarit me alfabetin latin në rrethanat e Korfuzit për aq shekuj nën sundimin venedikas. Në regjistrimin që ka bërë nga gjuha e folur, nga komunikimi gojor ndërmjet pjesëmarrësve të bisedës rreth sofrës me Pukëvilin, drejtshkrimi i shqipes del me një shkallë të lartë qëndrueshmërie, sidomos po të mbahet parasysh se biseda zhvillohej njëkohësisht në dy gjuhë dhe të rriturit ia diktonin atij të shkruante. Luhatjet dhe pasaktësitë janë të natyrshme, sepse dorëshkrimi është përgatitur gjatë disa ditëve, sa herë uleshin rreth sofrës për të pirë verë, dhe nuk është bërë ndonjë rishikim me ndreqje më pas. Pasaktësi ka edhe për fjalë të greqishtes. Dorëshkrimi i Markos, bashkë me zgjidhjet gjuhësore që burrat Boçarë kanë dhënë për përkthimin e fjalëve shqip, përbën një hap të ndjeshëm përpara në paraqitjen e shqipes me shkronjat greke.

Vetë Pukëvili gjithashtu iu është drejtuar shkronjave greke dhe kjo është e kuptueshme, sepse ai pu-

nonte në marrëdhënie të ngushta me Ali Pashën. Një vepër e tij doli kur Ali Pasha ishte ende në fuqi dhe ndër të tjera, ai shkruan: "Shqiptarët ortodoksë përdorin shkronjat greke, mirëpo meqë gjithë alfabetet e tjera nuk janë të mjaftueshme, ndërsa alfabeti i klerikëve katolikë nuk ka përdorim të përgjithshëm, mua m'u duk më i përshtatshëm alfabeti i mëposhtëm aq më tepër për një francez, për të përmbushur kushtet e domosdoshme me qëllim që të shkruhet gjuha shqipe."<sup>17</sup> Ali Pasha dhe i biri, Veliu, e mbanin letërkëmbimin greqisht. I kam njoftuar 9 letra të Ali Pashës kryesisht drejtuar Martin-Likut dhe 13 letra të Veli Pashës, që ruhen në arkivin e Hertfordit në Angli. Martin-Liku e ka vënë në dukje se Ali Pasha, "kur donte që shkresat e tij të lexoheshin në publik shqip, atëherë ato shkruheshin në atë gjuhë me shkronja greke."

Pukëvili ka pasur nevojë të jepte një alfabet dhe ka shënuar 26 shenja e një dyshkronjësh "ch". Ndër to vetëm 2 mund të quhen të marra nga alfabeti grek. Mirëpo paraqitja e lëndës shqipe prej tij gjatë tekstit dhe në ato pak shënime gramatikore, është plot gabime, domethënë Pukëvili e njihte fare dobët shqipen, rrjedhimisht prandaj ka kërkuar më 1809 që të shkruante Markoja, sepse vetë nuk do ta bënte dot. Nuk mund të pritej që ai t'i përmbahej ndonjë alfabeti. Kur ka ardhur puna për tekstin e Djalit plangprishës, të përkthyer më 1813 me urdhër të Ali Pashës sipas kërkesës së Pukëvilit, kemi dy alfabete. I pari është i greqishtes dhe teksti vetëm është kopjuar keq nga Pukëvili për botimin. Pukëvili nuk ishte në gjendje ta shkruante shqipen me alfabetin grek, prandaj nuk ek-

ziston asnjë alfabet grek i Pukëvilit. Këtë tekst e kanë përkthyer shqiptarët më 1813, ndërsa Pukëvili vetëm e ka përfshirë me gabime në librin e vet si lëndë ilustruese, aq sa mund të thuhet se jo vetëm nuk e shkruante shqipen me alfabet grek, por as ka qenë në gjendje ta lexonte. Prandaj është e çuditshme, se si T. Osmani shkruan: “F. Pukëvili nuk përdori një alfabet, por tre, në ato 15 faqe që botoi me materiale për shqipen. Njërin alfabet, që është kryesori, e zbatoi në shënime gramatikore, në glosarin shqip-frëngjisht dhe në përshëndetjet familjare. Ai përdori edhe dy alfabetet e tjerë: njëri për toskët dhe tjetri për gegët. Kështu përkthimin e parabolës që e bëri toskërisht dhe gegërisht...” Është vërtet e çuditshme, se si mund të pohohet, që Pukëvili na paska qenë në gjendje të përkthente nga greqishtja toskërisht dhe gegërisht, madje edhe me dy alfabetet!! Është meritë e tij e pavënë në dukje, që për herë të parë na jep një përkthim në dy variante të dialekteve të shqipes pranë e pranë, ideja e tij ka qenë e shkëlqyer, por të quhen ato tekste përkthim i tij e me dy alfabetet është jashtë çdo koncepti shkencor. Së fundi, në fjalorthin vijues frëngjisht-shqip e shënon se i ka hequr edhe ato dy shkronja greke, që i kishte përmendur vetë, sepse ishte në gjendje vetëm t’i kthehej alfabetit latin për fjalët shqipe. Pa u zgatur më tej, po shtoj se për më tepër Pukëvili nuk ka qenë në gjendje as të shfrytëzonte lëndën e parabolës së përkthyer me porosi për fjalorthin e vet. Mjafton të shënohet, se as fjalën “ditë” nuk e ka në fjalorth. Do të ndalem pak te fjala “père”, të cilën e ka dhënë: “tatt, prink.” Sinonimin e parë në tekstin me alfabetin e



greqishtes e ka: *tatë, atë, i ati*, ndërsa në tekstin e gegërishtes: *bab, at, i jatti, i tati*. Kjo është ndër fjalët themelore të asaj parabole dhe qartas nuk përputhet me trajtën e fjalorthit, ndërsa sinonimi i dytë aty është gabim për “prind”. Pukëvili nuk ka qenë në gjendje të vendoste lidhjet më elementare në lëndën që kishte mbledhur për të dëshmuar shqipen; nuk e kuptonte se përkthimin e “père” e kishte disa herë te parabola. E gjithë përpjekja e Pukëvilit për të dëshmuar shqipen ka dështuar, sepse ai nuk e dinte shqipen në atë nivel, që të ndërmernte një punë të tillë. Kjo shfaqet edhe më keq për të, po të kujtojmë se Martin-Liku tashmë i kishte botuar shënimet e veta për gjuhën shqipe me një njohje të pakrahasueshme me të. Kam dyshim, se edhe datën 1813 e ka vënë për t’u treguar se kishte bërë diçka përpara datës 1814 të Martin-Likut.

Besoj se rasti i Pukëvilit e bën të nevojshëm një nocion tjetër, të cilin shkurt do ta quaj: *alfabetet e dështuara*. Nuk kanë vend në historinë e alfabetit tonë gjithfarë përpjekjesh nga autorë, që jo vetëm nuk i ka ndjekur askush, por edhe që nuk kanë lënë asnjë gjurmë në atë histori. Aq më tepër nuk mund të flitet për tre alfabete të një autori, i cili brenda pak faqesh nuk ka ditur vetë t’i përmbahej një alfabeti, sepse as nuk e zotëronte shqipen, as ishte në gjendje të shfrytëzonte punën e traditës, as çka kishte para syve.

Sipas T. Osmanit, alfabetin e Boçarit e zbatoi edhe V. Meksi. As ky pohim nuk qëndron, madje vetë autori bie në kundërshtim disa faqe më pas, kur e quan zgjidhje origjinale dhe një alfabet të ri. Nuk është i pranueshëm nga asnjë vështrim historik apo shkencor

edhe pohimi tjetër i tij, se alfabeti i M. Boçarit “ndihmoi në përhapjen e gjuhës dhe të shkrimit shqip.”<sup>18</sup> Dihet se Pukëvili e dorëzoi në Paris dorëshkrimin e Markos dhe ai u bë i njohur për shqiptarët vetëm afër tri të katërta shekull më vonë. Ribotimi më 1996 në revistën “Hylli i Dritës” është plot gabime dhe i pavlefshëm për të punuar me të.

Më 1973-1974 kam botuar një varg dokumentesh për veprimtarinë e V. Meksit, G. Gjirokastroit dhe K. Kristoforidhit. Me sa duket, ose nuk kanë qenë të mjaftueshme për të formuar studiuesit një ide të drejtë, ose as nuk i kanë lexuar dhe kanë vijuar të përsërisin pohimet e gabuara të mëparshme. Prandaj këtu po sjell gjerësisht dokumentet nga arkivi i Shoqërisë Biblike të Londrës, të cilat e ndriçojnë historinë e alfabetit në përkthimet e Vangjel Meksit.

### *Alfabeti i përkthimit të Dhiatës së re 1824-1827*

Vangjel Meksi ishte nga Labova e Odries në Gjirokastrë dhe shkollën e mesme e kishte bërë në Janinë. Më 1803 vajti për të mësuar mjekësinë në Napoli, u kthye në oborrin e Ali Pashës, por më 1810 ra në mërinë e tij, u largua dhe më 1814 ka botuar dy përkthime në Venedik. Më pas ishte mësues në Seres, ku përpiloi një gramatikë të shqipes. Në fillim të vitit 1819 u takua në Stamboll me përfaqësuesin e Shoqërisë Biblike, Robert Pinkertonin dhe pasi nënshkroi me të marrëveshjen, nisi përkthimin e Dhiatës së re shqip. E

përfundoi në fillim të vitit 1821, u kthye në Selanik dhe vdiq më 1823.

Robert Pinkertoni ishte caktuar përfaqësues i Shoqërisë Biblike në Shën Petërburg të Ruisë, ku ishte ngritur dega e saj më 1813. Më 1816 ishte në Vjenë dhe atje ka hyrë në kontakt me bashkësinë e shqiptarëve, e cila duket se ka qenë me peshë. Kështu, në Vjenë kishte studiuar për mjekësi edhe Lluka Vaja, i vëllai i Thanas Vajës nga Tepelena, gjeneral i Ali Pashës. Pinkertoni ka shkruar më 28 gusht 1816 një letër, e cila do të jepet e plotë më poshtë. Fjalët te letra e Pinkertonit besoj se janë marrë nga goja e shqiptarëve që jetonin ose studionin në Vjenë dhe disa ndër ta kanë qenë prej pashallëkut të Janinës. Diskutimi i parë ka lindur për alfabetin që duhej të zgjidhej: latin apo grek. Ata i kanë dhënë argumentet gjuhësore dhe praktike përse duhej të përdorej jo alfabeti grek për këtë pjesë të Shqipërisë, por një alfabet i përzier. Kur erdhi në Stamboll, Pinkertoni u njoh me doktor Meksin dhe klerikë të lartë të bashkësisë fetare greke, të cilët e quajtën të pranueshme të shtypej një përkthim shqip, duke e dhënë në shtylla paralele me tekstin e përkthimit të arkimandritit Hilarion. Më 27 tetor 1819 Pinkertoni nënshkroi marrëveshjen me V. Meksin. Para se të largohej nga Stambolli, ia paraqiti patrikut Grigor marrëveshjen dhe ky i premtoi se do t'i jepte gjithë mbështetjen e vet kësaj pune, të cilën e quante shumë të nevojshme.

Meksi e përfundoi përkthimin dhe në shkurt 1821 njoftohet se me të po merrej përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike në Stamboll. Ky e dërgoi më 1823 në Korfuz

dorëshkrimin e Ungjillit të Mateut për t'u redaktuar dhe për t'u shtypur. Redaktimin e bëri Grigor Gjirokastriti, peshkop shqiptar në Eube. Ka qenë kërkesë e Grigorit që teksti të shtypej me shkronja të qarta e në letër të mirë, sepse shqiptarët do t'i kuptonin me vështirësi shkronjat e vogla, meqë nuk ishin të mësuar mirë me këtë të lexuar. Do mbajtur parasysh se më 1824 u shtyp si provë veçan Ungjilli i Mateut dhe më 1827 dolën Katër ungjijtë e punët e apostujve

Një punonjës shumë i kujdeshëm dhe kompetent i BFBS, bibliotekari T. P. Platt, ka përgatitur një punim për historinë e përkthimeve shqip. Po e jap të përkthyer për herë të parë tërësisht këtë lëndë të gjerë me interes.

## *Histori e përkthimeve*

### *Gjuha shqipe*

Botimi i parë i Shkrimeve të Shenjta në gjuhën shqipe për herë të parë iu rekomandua Komitetit nga ana e dr. Pinkertonit, duke bërë njoftimin e mëposhtëm, që e përmban një letër e shkruar prej tij nga Vjena më 28 gusht 1816.

Pajisja e shqiptarëve të paktën me Dhiatën e re në gjuhën e tyre është një objekt që e meriton në shkallën më të lartë të tërheqje vëmendjen e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Ky komb zë një pjesë të madhe të llikumit të lashtë dhe të Epirit, ndërsa flet një gjuhë, e cila duket se nuk ka asnjë afëri gramatikore me sllavishten, turqishten, greqishten ose latinishten. Shumica e shqiptarëve janë të besimit të krishterë dhe i përkasin kishës lindore; pjesa tjetër janë zhytur në një padituri kaq të thellë për parimet e krishterimit, sa që kanë përqaftuar besimin muhamedan. Shërbesat i kryejnë në gjuhën greke, e cila është krejt e pakuptueshme për popullin, madje edhe për shumicën e priftërinjve. Ata ende nuk kanë asnjë pjesë të fjalës së Zotit në gjuhën e vet amtare; nuk është llogaritur me përpikëri numri i tyre, por pranohet se mund të jenë nga 8 deri në 900.000 frymë. Pasi kam bërë shumë hetime, më del se një përkthim i Dhiatës së re në gjuhën shqipe mund të kryhet prej një njeriu ose prej disa vetave në Ishujt Jonianë. Nga bisedat që kam patur me disa shqiptarë të zotë këtu, nuk kam dyshim se mund të gjenden atje njerëz kompetentë për këtë dety-

rë. Puna duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e njërit prej peshkopëve shqiptarë më të ditur dhe të respektuar; shpenzimet si për përkthimin dhe për shtypjen duhet të sigurohen prej Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Ndërsa po të ngrihej një Shoqëri Biblike në ndonjërin prej Ishujve Jonianë, dhënia e Dhiatës së re shqiptarëve në gjuhën e tyre amtare me siguri do të përbënte një objekt që do t'ua vlente përpjekjeve më të para e më të zellshme të saj. Është e vërtetë se krahasimisht shumë pak prej këtyre njerëzve mund të lexojnë, por edhe po të mos përmendim se kështu ata do të nxiteshin për të mësuar, çfarë thesari i paçmuar do të ishte një Dhiatë shqip qoftë vetëm për priftërinjtë e tyre të shumtë, pjesa më e madhe e të cilëve janë të dënuar t'i lexojnë shërbesat në kishat e tyre, gjatë gjithë jetës, në një gjuhë të cilën ata nuk e kuptojnë! Në rast se kjo punë do të ndërmerrej, duhet të shtypet me shkronja të greqishtes, mbasi alfabeti grek, duke iu shtuar vetëm pak tinguj, është më i miri për të shprehur gjuhën shqipe, dhe duke përdorur alfabetin grek në vend të latinut, gjithë ata midis tyre që dinë të lexojnë, do të jenë në gjendje menjëherë ta përdorin Dhiatën tuaj shqip.

*[Reports of the BFBS. Vol. IV, 1816-1817.*

*13<sup>th</sup> report, 1816, f. 93]*

Hapat e parë që u bënë për këtë punë nga dr. Pinkertoni pas një intervali prej tre vjetësh janë paraqitur nga ai vetë si më poshtë:

*Stamboll, 25 tetor 1819.*

Gjatë vizitës sime të shkurtër në këtë qytet njëra punë e rëndësishme më zuri tjetrën saqë më është dashur të punoja pothuaj ditë e natë, me qëllim që të ndiqja me qetësi dhe me sy të paanshëm çështjet e ndryshme, të cilat më janë paraqitur për t'i shqyrtuar. Midis tyre këto dy janë ndër jo më pak të rëndësishmet: e konkretisht, e para – një përkthim i Dhiatës së

re në gjuhën shqipe më është lidhur në zemër në këta disa vjet të shkuar aq fort, sa me të vërtetë nuk mund të shpëtoja prej tij. Ndonëse në Korfuz filloi të hapej perspektiva dhe gjithë shpresat e realizimit po gjenin përshëndetje, përsëri nuk u bë asgjë vendimtare. M'u desh në fillim të vizitoja Athinën, të njihesha me shtrirjen e madhe të popullsisë shqiptare, të vuaja prej trajtimit shumë të keq, madje të egër, nga shqiptarët e Parosit, që ta kuptoja thellë rëndësinë e kësaj pune dhe *nevojën* e madhe që është për të mos humbur kohë në fillim e saj, për hir të fiseve të shumta të shqiptarëve, të cilët janë përhapur anë e kënd krahinave të lashta të Ilirisë, Epirit, Maqedonisë e Greqisë. Tashti kam gjetur njeriun, i cili, shpresoj, është paracaktuar t'u dhurojë bekimin e madh vëllezërve të vet, duke u dhënë Dhiatën e re në gjuhën e tyre. Emri i tij është *Vangjel Meksikoi*. Atë ma kanë rekomanduar fort disa prej krerëve më të lartë të bashkësisë fetare greke këtu, si një njeri me cilësi të shquara për këtë punë. Ai tashmë ka shkruar një gramatikë në gjuhën e vet, të cilën ma tregoi.

Atë e njeh mirë patriarku grek i Stambollit, i cili gjithashtu e ka miratuar fort këtë ndërmarrje dhe premtoi të gjente një ose dy ekleziastë të ushtruar mirë në gjuhën shqipe, me qëllim që ta ndihmojnë dr. Meksikoin në përpjekjet e tij, dhe ta bëjnë versionin sa më të përkryer, përpara se të shkojë në shtyp. Ne propozojmë ta shtypim bashkë me tekstin e përkthimit të Hilarionit në shtylla paralele. Kjo do ta bëjë më të dobishëm në fillim, sepse ka një numër shqiptarësh që e njohin por jo mirë greqishten e re, ashtu si edhe grekësh, që e kuptojnë por jo mirë shqipen. Këta do të mësojnë të lexojnë dhe të kuptojnë të vërtetat e sakta të Ungjillit, kur t'u paraqitet në të dy gjuhët, më lehtë sesa po t'u jepet në secilën gjuhë veçan. Ai tashmë ka përkthyer kreun e 5-të të Mateut dhe kreun e parë të Ungjillit të Shën Joanit, dhe më paraqiti një kopje të tyre si frytet e para të kësaj ndërmarrjeje të rëndësishme.

Përpara se të largohet prej Stambolli, dr. Pinkertoni ia paraqiti patriarkut marrëveshjen me dr. Meksikoin. Patriarku "i premtoi" siç thotë dr. P., "t'i jepte

gjithë ndihmën e mundshme kësaj pune, të cilën e quante tejet të nevojshme”.

Në fillim të vitit 1821 z. Leeves, pasi arriti në Stamboll si përfaqësues i Shoqërisë, mori në dorë kryerjen e punëve të nisura nga dr. Pinkertoni. Lidhur me Dhiatën shqip, ai shkruan më 8 shkurt: “Përktimi ka përfunduar por dr. Meksikoi ka shkuar në Selanik; sapo të kthehet, siç i ka shkruar Hilarioni duke i shprehur këtë dëshirë, ne duhet të bëjmë marrëveshjen me një rishikues. Një njeri mjaft kompetent është sot në manastirin e patriarkut të Jerusalemit.

Në vitin 1822 dorëshkrimi u dërgua në Maltë, për t’u ruajtur te i përnd. W. Jowett, i cili i shkroi Komitetit për të njoftuar arritjen në rregull, dhe pas kësaj më 12 korrik 1822 u vendos, që “z. Jowett t’i kërkohet të nxjerrë një kopje të gjithë dorëshkrimit shqip dhe të informojë Komitetin kur kjo gjë të mbarohet, duke pritur udhëzimet.”

Në maj 1823 z. Leeves u udhëzua të dërgonte një kopje të Ungjillit të Sh. Mateut shqip në Korfuz për t’u shtypur atje nën drejtimin e Shoqërisë Biblike Joniane. Kur u bë kjo, i përnd. J. Lowndes, sekretari i asaj Shoqërie, më 16 mars 1824 ka shkruar si më poshtë:

“Sot ne patëm një mbledhje të Komitetit të Shoqërisë Biblike Joniane, ku u paraqit Ungjilli i Sh. Mateut në gjuhën shqipe, lidhur me të cilin ju kam shkruar më parë. Në letrën e fundit ju njoftoja se arkimandriti nga Negroponti, i cili është vendës nga Shqipëria, e kishte mbaruar rishikimin dhe Komiteti ynë, pasi dëgjoi letrën tuaj dhe e shqyrtoi punën, mori këtë Vendim:

“U vendos që Ungjilli i Sh. Mateut në gjuhën shqipe të shtypet, pasi është rishikuar me kujdes nga arkimandriti Grigor i Negropontit, vendës nga Shqipëria. Të shtypet në shtylla



paralele me greqishten e re, sepse arkimandriti ka thënë që shqiptarët do të jenë në gjendje ta kuptojnë këtë më mirë se greqishten e vjetër. Të shtypet me shkronja të qarta e në letër të mirë, meqë shqiptarët nuk janë mësuar mirë me leximin dhe do t'i kuptojnë me vështirësi shkronjat e vogla."

Unë kam shprehur më parë mendimin tim, se do të ishte më mirë që teksti shqip të shtypej në kolona paralele me tekstin në greqishten e vjetër, por nuk mund të bëj qëndresë përpara arsyeve të dhëna në Vendimin e mësipërm në të mirë të greqishtes së re. Ndoshta shkronjat pak më të mëdha se ato, me të cilat janë shtypur Raportet tona të fundit, do të përshtateshin për shtypjen e kësaj vepre dhe do të mjaftonte po të ishin pak më të mëdha. Kemi një sasi të mirë të shkronjave që sapo na kanë ardhur dhe unë do të kujdesem të përcaktohen përmasat e shkronjave, të cilat do të përshtateshin më mirë si nga ana e dobisë, ashtu edhe për kursim.

Shuma që mori Meksikoi për gjithë Dhiatën e re më del se ka qenë 6000 piastra, për Ungjillin që kemi në dorë ajo do të arrinte rreth 100 dollarë spanjollë.

Komiteti ynë pranoi t'i paguante arkimandritit 60 dollarë për rishikimin dhe për ndreqjen e bocave. Do ta prisnim me gëzim mendimin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja lidhur me këtë pikë.

Pak kohë më parë kam marrë një letër prej z. Leeves, në të cilën më njofton se ka ndër mend me rastin më të parë të dërgojë në Korfuz gjithë Dhiatën shqip. Në këtë rast shpresoj se Komiteti i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja do ta angazhojë arkimandritin për rishikimin e saj. Ai i kush-ton vëmendje të madhe kësaj dhe duket se është mjaft i përshtatshëm për këtë punë, pavarësisht se vetë është *ekleziast*. Punën e tij ua kam treguar të tjerëve vendës nga Shqipëria, të cilët e kanë miratuar shumë."

*I. Lowndes.*

Lindën disa vështirësi gjatë përshtatjes së alfabetit grek për të shprehur disa tinguj të shqipes, të cilët nuk i ka greqishtja. Në këtë gjuhë janë botuar më parë

vepra të ndryshme nga misionarët katolikë, por ato kanë qenë me shkronja latine, të cilave u ishin shtuar disa shkronja të reja për të shprehur tingujt që alfabeti i latinishtes ose i italishtes nuk i ka. Kështu ka ndodhur me Gramatikën e Maria da Lecce-s, shtypur në Romë më 1716, si edhe me Fjalorin e Bardhit, shtypur atje më 1635.

Fletët e para të Ungjillit u dërguan në Angli si model sapo u shtypën. Shkruesi i kësaj trajtese, pasi i shqyrtoi, nisi një letërkëmbim me z. Lowndes për këtë çështje. Ky letërkëmbim nuk është nevoja të jepet këtu plotësisht, madje do të ishte edhe e vështirë ta jepje, për shkak të shkronjave të pazakonshme që dalin aty shpesh. Megjithatë letra ime e parë dërguar z. Lowndes dhe përgjigja e tij po përfshihen këtu, meqë nuk janë të rënduara nga këto vështirësi dhe mund të japin një ide mbi pikat kryesore, që duheshin shqyrtuar lidhur me këtë çështje

Të përnd. J. Lowndes, Korfuz.

*Londër, 30 qershor 1824.*

“E kam shqyrtuar me vëmendje fashikullin e Ungjillit shqip që më keni dërguar. Meqë ende ju nuk jeni i vendosur për disa pika dhe po e studioni gjuhën me qëllim që ta përmirësoni më tej, ndoshta nuk do të ishin të padobishme ose të papranueshme disa vërejtje lidhur me këtë çështje.

Lidhur me *greqishten*, do të vë në dukje se ne kemi përfunduar këtu një botim të ri greqisht të Dhiatës së vjetër e të re, në të cilin janë bërë disa përmirësime në gramatikë e drejtshkrim për greqishten e re, ndoshta kur të shtypni ndonjë pjesë më të madhe të punës suaj do të keni dëshirë të konsultoheni me këtë

botim, në rast se botimi i Hilarionit nuk do të jetë gati, ashtu si edhe kam frikë. Më lejoni të shënoj se në greqishten e fashikullit që na keni dërguar, ka disa gabime të rënda. Më i rëndi është se në 6 vargjet e para të kreut të parë ne kemi vazhdimisht  $\epsilon\gamma\epsilon\nu\eta\sigma\epsilon$  dhe jo  $\epsilon\gamma\epsilon\nu\nu\eta\sigma\epsilon$  siç duhej të ishte. Unë e di nga përvoja se është e vështirë të arrihet përpikëria gjatë ndreqjeve në shtyp. Jua them se nuk shoh ndonjë arsye të mjaftë pse të mos jenë të dyja kolonat me të njëjtin tip shkronjash.

Por ndoshta pika kryesore është paraqitja me shkronja greke e tingujve të veçantë për shqipen. Për këtë i kam shqyrtuar me kujdes librat që kemi në bibliotekën tonë të shtypura turqisht me shkronja greke, meqë po këta tinguj ndeshen gjithashtu në këtë gjuhë. Më del se nuk ka aq njëtrajtësi sa do të ishte e dëshirueshme për paraqitjen e tyre. Mund të udhëhiqemi nga praktikat që janë zbatuar më të shumtën e herëve. Lidhur me "sh" nuk duket të ketë një zëvendësim më të mirë sesa  $\sigma\zeta$  (ose ndoshta  $\sigma\sigma$ ) që keni përdorur ju; por për "b" dhe "d" nuk gjej asnjë gjurmë të shkronjave dyfishe  $\beta\beta$  dhe  $\delta\delta$ . E para shprehet me  $\mu\pi$  ose  $\pi$ , e dyta me  $\nu\tau$  ose  $\tau$ , siç duket, si e ka kërkuar rasti. Dhe në rast se ata, të cilët lexojnë një gjuhë tjetër me shkronjat greke janë mësuar me këto shkronja të përdorura në këtë mënyrë, a nuk do të ishte më mirë t'i prananim ato, në vend që të përdornim kombinime të reja, si  $\beta\beta$  ose  $\delta\delta$ ? Porse për një vepër më të gjerë, nga ana ime do të pëlqejja b ð [me vizë ndërprerëse në mes], që keni propozuar ju, në rast se shkronjat do të mund të pritëshin të pastra, që të mos shëmtohej paraqitja tipografike e veprës.

Lidhur me aspiraten  $\chi$ , ajo përdoret në ato vepra turqisht e, ashtu siç thoni ju, e ka bërë edhe dr. Mexsi. E pranoj se nuk kam ndonjë kundërshtim për këtë, është aq e sanksionuar nga përdorimi, saqë do të ishte me vend ta ndiqnim edhe ne. Shkronja e vetme që mbetet është  $\ddot{u}$ . Më duket me gjithë mend se  $\epsilon$  e kthyer mbrapsht  $\epsilon$  në fashikullin tuaj shqip ka një pamje mjaft të papëlqyeshme. Zakonisht gjithashtu ajo del mbi shkronjat e tjera dhe, me sa duket, germa ka nevojë për t'u rregulluar që të renditet më mirë në këtë pozicion të përmbysur; porse mua nuk më pëlqen pamja e saj. Më duket se në ato veprat turqisht, ndonëse  $\alpha$  dhe  $\epsilon$  në ndonjë rast përdoren për këtë

Iloj tingulli, përsëri në një rën prej tyre përgjithësisht është paraqitur me një formë të veçantë të ε, ashtu si përdoret shpesh në greqishten, kur epsilon bashkohet me një shkronjë tjetër, si εν për ἐν. A nuk mund të përshtatet kjo shenjë për të paraqitur këtë zanore? Duhet kujdes që të mos përdoret kur duhet të paraqitet vetë epsilon.

Por më duket se ju keni përfshirë një shkronjë të re, të cilën nuk e përmendni dhe tingullin përkatës unë nuk e njoh, ndonëse pamja e saj më pëlqen më shumë sesa ε. E kam fjalën për një farë eta të përmbysur, η, si te λεηετε, kap. 2, vargu 16 κοηεηε, ibid. 16. Për më tepër, ka disa kombinime bashkëtingëlloresh mjaft të këqija, të cilat do ta ngatërronin mjaft një njeri, për mënyrën se si do të shqiptoheshin, si për shembull, τζδδο, 3.10, ζββην ibid. ζσδδο 4.4. Po ju pa dyshim i dini këto.

Ka edhe një tjetër gjë, që më çudit. Në Gramatikën shqipe dhe Fjalorin që kam përmendur në letrën e fundit, kam ndeshur shkronjat italian "c, cc", të përdorura si "c, ci" etj., të cilat me sa duket, kanë tingëllimin e zakonshëm italian, ashtu si "ch" e anglishtes. Në rast se ky tingull gjendet realisht në shqipen, si do të shprehej me shkronjat greke?

(Nënshkruar) T. P. Platt.

[I. Laundzi për T. P. Platin]

Korfuz, 2 gusht 1824

Letrën tuaj të nderuar të 30 qershorit e mora dy ditë më parë dhe vërejtjet tuaja lidhur me Dhiatën shqip jo vetëm i pranoj me kënaqësi, por edhe ju shpreh falënderimet më të mëdha. Shpresoj se do ta keni marrë tashmë me kohë letrën time të fundit, të datës 2 qershor, që do t'u tregojë cilat janë mendimet e mia lidhur me tipin e shkronjave etj. për shqipen, dhe shpresoj sinqerisht që Komiteti i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja do të merret me prerjen e shkronjave.

Qëllimi im këtë radhë është t'u përgjigjem disa çështjeve që keni shënuar në letrën tuaj të fundit dhe për mua do të ishte e pafalshme të mos provoja të paktën të sqaroja vështirë-

sitë, të cilat do t'ju lindnin në mënyrën më të natyrshme. Po ndjek rendin e letrës suaj.

Ishte tepër vonë kur zbulova se së pari kishin mbetur pa u vënë re disa gabime të vogla, dhe më doli e nevojshme më pas që të mos kënaqesha me tri ose katër boca, përpara se ta fusja veprën në shtyp, por të paktën të *ndiqja shtypjen*, me qëllim që të shihja nëse ishte bërë secila ndreqje. E kam parë disa herë se nuk ishin bërë. Ju do ta shihni se ka ndryshim nga kjo anë ndërmjet fashikullit të gjashtë, që ju kam dërguar me letrën e mëparshme, dhe fashikullit të parë. Megjithatë ka disa gjëra në të gjashtin, të cilat mendoj se meritojnë të vihen në dukje. Aty ju do të gjeni shpesh, ashtu si në të gjithë veprën,  $\alpha\omega$  në rasën kallëzore në vend të  $\alpha\omega$ , ashtu si në greqishten e re të shtypur në Londër; gjithashtu  $\alpha$  në rasën emërore në vend të  $\alpha\omega$ . Ndonëse ka shumë vulgarizma në versionin e tanishëm të greqishtes së re, unë i kam ndryshuar disa, por ato të mësipërmet janë vënë në rasat e veta, meqë janë gabime të plota gramatikore në greqishten e re, ashtu si edhe në të vjetrën. Këto janë gabime, por janë të pashmangshme, sepse shhtypshkronjës këtu i mungon theksi i rëndë për këto raste dhe nuk kishte tjetër mundësi zgjidhjeje.

Ju thoni: "se nuk shoh ndonjë arsye të mjaftë pse të mos jenë të dyja kolonat me të njëjtin tip shkronjash." Vërejtja ime kryesore për greqishten e re është se shkronjat janë tepër të vogla. Nuk ka qenë ideja ime fillestare të përdoshin dy tipa të ndryshëm shkronjash, por kur ma sugjeruan, e zbatova dhe arsyet janë këto: 1. Meqë janë dy gjuhë, dy tipa do të binin më mirë në sy. 2. Greqishtja e re del me më shumë shkronja sesa shqipja dhe po të përdorej e njëjta madhësi shkronjash, kjo do të shkaktonte rritjen e shpenzimeve, gjë që ndoshta nuk është edhe arsyeja më e rëndësishme. 3. Shkronja e përdorur për shqipen është e vetmja që do të përshtatej për  $\epsilon$  të përmbysur dhe për këtë tip nuk ka një numër të mjaftueshëm shkronjash për 16 fashikuj, nëse do të përdorej në të dy kolonat.

Lidhur me paraqitjen e tingujve të shqipes me anë të shkronjave greke, nuk çuditem prej mendimeve që do t'ju lindnin vetvetiu dhe do të më bënit një të mirë të madhe, duke më vënë kurdoherë në dukje çfarëdo vërejtjeje që të keni, sep-

se dëshiroj të bëj përmirësime për çdo gjë sipas mundësisë. Letra që ju përmenda do t'ju ketë bindur tashmë se për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj vepre unë kam po aq kundërshtime sa edhe kushdo tjetër kundrejt sistemit me shkronjat dyfishë. Këtë Ungjill unë e shoh, ashtu siç është shprehur në vendimin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, si një provë, por edhe si provë e quaj krejt të nevojshme të ketë një shenjë të veçantë për çdo tingull të veçantë. Kur e paraqita për herë të parë për shtyp, drejtori i shtypshkronjës më tha: "Oh, nuk janë të nevojshme kaq hollësi, sepse gjatë shtypjes së librave turqisht etj. me shkronja greke asnjëherë nuk pritet që tingujt të jepen me saktësi, mjafton diçka e përafërt." Megjithatë unë kam qenë i vendosur të *synoj* drejt përsosurisë dhe jam i kënaqur që kam vepruar kështu.

Ju flisni për "b" e "d" dhe vëreni se në veprat që keni në dorë janë shprehur me  $\mu\pi$  ose  $\pi$  dhe  $\nu\tau$  ose  $\tau$ . Unë e di se kështu është, po ashtu si në greqishte, kur janë të nevojshme "a", "b" ose "d" për të shkruar emrat e përveçëm. Një nga gjërat e para që më ra në sy kur e kam parë veprën e dr. Meksikoit, ishte përse ai kishte përfshirë ital. "b", kur mund të bënte punë greq.  $\mu\pi$  dhe ital. "d", kur do të shkonte  $\nu\tau$ , ndërsa në vende të tjera kishte  $\mu\pi$  dhe  $\nu\tau$ ? Megjithatë shpejt nisa të dyshoja se ai kishte pasur ndonjë arsye. Në fletën e parë ne kemi në rreshtin e parë  $\beta\beta\iota\epsilon\tau$ , që shqiptohet "birit", dhe në rreshtin e gjashtë gjejmë  $\mu\pi\epsilon\pi\epsilon\tau\nu\epsilon$ . Në rastin e parë shqiptimi është si i "b" te *table*, në tjetrin  $\mu\pi$  dallohet plotësisht në shqiptim si "mb" te *tremble*. Ky është një shembull ndër shumë të tjerë, që tregon se  $\mu\pi$  nuk bën për "b". Kreu 1, rreshti 9 gjejmë  $\delta\delta\omicron$  ose "do" dhe po në atë rresht  $\nu\tau\theta$  – e para ka tingullin "d" si në "do" ose *day*, kurse tjetra ka "nd" si në *handy*, prandaj  $\nu\tau$  nuk shërben për "d".

Lidhur me aspiraten ju shkruani: "χ përdoret në ato vepra turqisht ashtu siç thoni ju që e ka bërë edhe dr. Meksi. E pranoj se nuk kam ndonjë kundërshtim për këtë, duket se është aq e sanksionuar nga përdorimi, saqë do të ishte me vend ta ndiqnim edhe ne." Në rast se do të ecim sipas parimit të përmendur nga drejtori i shtypshkronjës këtu, domethënë mjafton të jemi afër, unë do të thosha se mund ta ndiqnim dhe ne.

Por shqipja e ka një  $\chi$  po ashtu si greqishtja dhe ka një aspirate "h" po ashtu siç e kemi ne. Prandaj tingujt janë mjaft të ndryshëm dhe që të paraqitet "h" e mirëfilltë, duhet të përdoret një germë tjetër. Ju me siguri tashmë e keni parë, se unë e kam shprehur me  $\eta$  të përmbysur, pra  $\upsilon$  që duket mjaft mirë. Duke e shqyrtuar disa herë punën e Meksikoit, kam gjetur diçka që më kishte shpëtuar më parë: në disa raste kur duhej të shprehej "h", ai ka përdorur një pikë mbi  $\chi$  dhe në raste të tjera ka dy pika; herë të tjera, kur ka qenë e nevojshme "h" dhe në fjalë, në të cilat i ka shënuar në pjesë të tjera të veprës, nuk ka asgjë mbi  $\chi$ . Këtë mungesë uniformiteti unë ia atribuoj faktit që dorëshkrimi nuk është me dorën e tij, por ndoshta është kopjuar nga një njeri, i cili nuk e kuptonte shqipen. Dorëshkrimi ka gjithashtu shumë mungesa të theksimit, të cilat besoj se vijnë për shkak po të kësaj rrethane. Megjithatë kjo tregon se Meksikoi, ashtu si edhe shqiptarë të tjerë, e njeh dallimin e shkoqur ndërmjet "h" të aspiruar dhe  $\chi$ .

Lidhur me  $\varepsilon$  për "u" të shkurtër, ju thoni: "Nuk më pëlqen pamja e saj." As mua nuk më pëlqen, por ishte absolutisht e nevojshme një shkronjë e veçantë për ta shprehur këtë tingull dhe nuk munda të gjeja tjetër e as kam gjetur ndonjë të përshtatshme, përveçse po të presim një shkronjë të posaçme. Shkronjat mund të ulëshin poshtë për ta sjellë atë në rrafsh me të tjerat, por kjo do t'i prishte ato kur të shtypej greqishtja më pas, gjë që nuk mund të bëhet. Do të kisha dëshirë të gjendej një formë e shkronjës më e mirë se ajo e propozuar prej jush në letrën e fundit për  $\upsilon$ , ose se ajo që kam propozuar në letrën time, pasi edhe kjo nuk më pëlqen.

Kombinimet e bashkëtingëlloreve nuk janë edhe aq të çuditshme nga pamja, besoj, për një njeri i cili nuk e kupton gjuhën, në krahasim me ato që ndeshim te disa të tjera, si për shembull në gjuhën e Uellsit ose mohokishten.

Italishtja "ce" del në shqipen dhe mund të shprehet fare mirë me "tsh", τς, ashtu si jepet po ky tingull në gjuhën tonë me "ch", në fjalë si *fetch, church* etj.

Po i dal përpara një pyetjeje, e cila ka të ngjarë t'u lindë juve lidhur me tingullin e veçantë v dhe κ, që kam përmendur në letrën e fundit. Pavarësisht nga çka thotë majori Leake për

këtë çështje dhe sipas dëshmisë së shqiptarëve vendës, unë nuk u binda me lehtësi se ishin të nevojshme dallime të tilla, por mendoja se njëri nga tingujt v dhe κ, ishte me vend përpara disa zanoreve, kurse tjetri përpara disa zanoreve të tjera, ashtu siç gjejmë në anglishten dallime ndërmjet “c” dhe “k” në *corn* dhe *king*. Mirëpo nuk munda për idenë time të parapëlqyer të sillja një shqyrtim të rreptë e të përshtatshëm dhe prandaj u detyrova të hiqja dorë.

Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja do ta këtë kuptuar përpara se të arrijë kjo letër, se pjesa tjetër e veprës së dr. Meksikoit është këtu. Ajo ka qenë për disa kohë në Zante dhe kur u shkrova ma dërguan menjëherë. Bashkë me të ishte një letër për mua nga z. Leeves, në të cilën ai më njofton se përkthimi i Hilarionit është gati dhe se kishte ndër mend të ma dërgonte në Korfuz për ta shtypur. Në këtë rast besoj se do të ishte më e dëshirueshme që të merrnim këtë në vend të botimit të ri, të shtypur prej jush.

Në fillim të kësaj pune gjuha shqipe më nxori mjaft telashe; ndonëse i kishte ndarë fjalët siç duhej në përkthimin e tij, kryepeshkopi nuk ishte aq i kujdesshëm në ndreqjet gjatë shtypit, sepse kurrë më parë nuk kishte ditur gjë nga kjo punë, por tashti po i kushtojmë më shumë vëmendje shtypjes, edhe ai gjithashtu, kështu që mua më mbetet vetëm pak gjë për të bërë, përveçse të ndjek greqishten. Në vazhdimin e mëtejshëm të veprës do të ishin të dëshirueshme shkronja pak më të mëdha, sepse këto tani janë shumë të vogla.

Lutem me zell që urtësia të na udhëheqë këtë radhë dhe çdo herë tjetër në përpjekjet për të përhapur fjalën e Zotit. Dëshira ime më e madhe është që puna të bëhet sa më mirë të jetë e mundur dhe shpresoj se do të heq dorë me lehtësi nga çdo gjë që kam propozuar vetë për hir të një zgjidhjeje më të mirë, të cilën mund ta paraqiste dikush tjetër. Në këtë punë asnjë nga format e zbatuara të shkronjave nuk është imja, me përjashtim të σç dhe η së përmbysur. Prandaj nuk i kam mbajtur sepse janë të miat, por sepse pasi u rekomanduan, ato ishin dhe vazhdojnë të jenë më të përshtatshmet në këto rrethana dhe me këto mjete që kemi. Në letrën time të fundit për



ju të gjitha format janë vizatuar prej meje, me përjashtim të digamës dhe të  $\sigma$  me dy pika përsipër.

*I. Lowndes.*

Më në fund z. Lowndes zbatoi për tingujt më të shpeshtë germa të greqishtes, duke vendosur mbi to pika diakritike, siç del nga letra e mëposhtme:

*Korfuz, 27 gusht 1824.*

Më datën 2 të këtij muaji ju shkrova lidhur me Dhiatën shqip dhe gjashtë ditë më vonë mora letra nga z. Leeves prej Stambolli. Unë i kisha dërguar fashikullin e parë të Ungjillit me një letër. Në përgjigje ai më thotë: "Më duket se ju keni gjetur zgjidhjen më të mirë në këto rrethana për të plotësuar të metat që paraqet alfabeti grek gjatë shprehjes së tingujve të shqipes. Ndonëse për të gjithë veprën, siç e thoni ju, është më mirë të priten shkronja të reja, ose më mirë pika të veçanta, të cilat të vihen mbi shkronjat gjatë radhitjes ku të jetë e nevojshme.

Z. L. më dërgoi si model një pjesë nga Dhiata turqisht me shkronja greke Aty kam gjetur të zbatuara këto shkronja: për "b" – π me pikë sipër, për "d" – δ me pikë sipër, për "sh" – σ me dy pika sipër. Meqenëse këto janë në përdorim për të shprehur këta tinguj, e quaj një arsye të mjaftueshme për t'i përdorur në shqipen në vend të atyre, të cilat i kisha propozuar dhe kryepeshkopi po i zbaton në rishikimin e tij.

Fashikulli i fundit i Ungjillit është në shtyp.

*I. Lowndes.*

Më 5 shtator z. Lowndes shkruan se "ka përfunduar Ungjilli i Sh. Mateut." Shpenzimet për këtë botim i ka përballuar Shoqëria Biblike Joniane, ashtu si dhe për gjithë Dhiatën e re, për të cilën është angazhuar tashti kryepeshkopi i Negropontit.

Z. Lowndes në të njëjtën kohë bëri një propozim, që të vizitonte Shqipërinë në emër të Komitetit për t'u

siguruar lidhur me paraqitjen e punës dhe për të parë mundësitë e qarkullimit të saj, propozim të cilin Komiteti e pranoi.

Në dhjetor 1824 u përfundua rishikimi i gjithë Dhia-tës së re nga Grigori dhe në fillim të vitit 1825 u bënë përgatitjet për të nisur shtypjen. U vendos që për të parandaluar vonesat, në kolona paralele me të, të shtypej versioni ekzistues në greqishten e re, pa pritur versionin e ri të Hilarionit, i cili do të shtypej tani në Londër.

Z. Lowndes shkruante si më poshtë më 6 maj 1825:

Shqipja është gati. Kisha ndër mend të vizitoja Shqipërinë këtë pranverë, me qëllim që të verifikoja më mirë saktësinë dhe vlerat e punës, por nuk më lejoi gjendja e vendit, sepse turqit po ngrinin ushtarë atje. Një njeri që ka ardhur nga ato anë ditë e fundit në Korfuz më siguroi se asnjë udhëtar nuk mund ta kishte të garantuar jetën, veç në rast se bëheshin një grup së bashku. Megjithatë shpresoje me një anije të vizitoj ndonjë prej qyteteve në bregun përballë. Nuk e kam lënë rastin të më kalojë pa bërë mjaft hetime në drejtime të ndryshme për këtë çështje, e gjithashtu kam shkruar letra për në Miso-longji, ku ka shqiptarë. Njëri që e përmenda më sipër, më ka thënë se gëzimi e kënaqësia e njerëzve ishin kaq të mëdha, sa kur bie dita që të lexohet Ungjilli i Mateut, ai lexohet rregullisht shqip nëpër kisha.

Një burrë i quajtur Kastro, çifut, erdhi këtu para ca kohësh dhe më solli një letër nga z. Leeves, e cila ma prezantonte si tipograf me përvojë, që e njeh mjeshtërinë e prerjes së shkronjave dhe që mund të ishte i dobishëm për përgatitjen e shkronjave të shqipes. Kjo më duket shumë në rregull. Përpara se të vinte ai, shkronjat për shqipen pothuaj kishin përfunduar dhe ndoshta do të ishin vënë në punë, por nuk qenë bërë mirë. Megjithatë me ardhjen e tij unë e ndërpreva gjithçka dhe ai pati mirësinë ta ndërmerre punën dhe po na bën shërbime të mëdha. Besoj se brenda tri-katër ditëve ai do ta ketë përfunduar dhe geramat që ka prerë janë po aq të mira, sa ato që kemi

marrë nga Stambolli dhe po me ato përmasa. Më vjen keq që alfabeti nuk është gati sot.

Format që zbatuam përfundimisht janë këto:

për **b** – π me pikë sipër  
 për **d** – δ me pikë sipër  
 për **g** – Γ  
 për **h** – χ me pikë sipër  
 për **q** – κ me pikë sipër  
 për **sh** – σ me pikë sipër  
 për **nj** - ν me pikë sipër  
 për **ll** - λ me pikë sipër  
 për **ë** - ε me vizë poshtë

Brenda pak kohësh do t'i kemi të gjitha gati për ta filluar punën, meqë shkronjat nga Stambolli i kemi këtu dhe ato shtesë për shqipen janë pothuaj të gatshme.

*I. Lowndes.*

Z. Londes ka shkruar përsëri për këtë:

*Korfuz, 31 tetor 1825*

Në letërn time për ju të datës 7 janar 1825 shkruaja se shpresoja, që do të isha në gjendje së shpejti t'ju dërgoja alfabetin e shqipes të përfunduar, por më penguan çrregullime të ndryshme dhe vetëm disa ditë më parë ai përfundoi. Po jua dërgoj tashti, që po e shoh të përfunduar pas kaq pune të madhe mendore e me duar. Shkronjat i kemi prerë këtu dhe jam i bindur se do të shërbejnë për të gjitha nevojat e shqipes. Germat e reja ju mund t'i dalloni me lehtësi nga të tjerat prej shenjave, pikave etj.

Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja mund të jetë e sigurtë që përsa varet nga mundësitë e mia, nuk do të lë asgjë mangët, me qëllim që puna të arrijë një përfundim të shpejtë e me sukses. Afatet për shtypjen etj. nuk mund të përcaktohen plotësisht derisa të mos jenë radhëtur nja dy faqe. Një çështje që e quaj të nevojshme ta përmend, është ndreqja e bocave. Para disa kohësh ju kam informuar se drejtori i shtypshkronjës më ka thënë se mund të gjendej një korrektor për 30 dollarë në muaj. Unë mendoj se do të ishte shumë më mirë që ta merrja vetë drejtimin e kësaj, sepse e di që mund ta bëj shumë më lirë. Jam plotësisht i bindur për atë që më keni sugjeruar një herë, domethënë dy grekë dhe unë t'i shihnim vazhdimisht fletët dhe një korrektor është i nevojshëm për shqipen. Në rast se do të lejohem unë, do t'i kërkoja Komitetit tuaj Grigorin, ish kryepeshkop i Negropontit, i cili e ka rishikuar punën për shtyp dhe është ende këtu, por në nevojë kaq të madhe, sa tashti së fundi vendosi të shkonte midis turqve, por unë i kërkoja të qëndronte, duke i thënë se shpresoja të kisha mundësinë t'i gjeja diçka në kohën që do të shtypej Dhiata shqip. Më pikon në zemër për një njeri kaq të nderuar sa ai dhe kaq të dërrmuar. Unë nuk njoh tjetër njeri si ai për të ndrequr shqipen, sepse ai e ka rishikuar, e njeh ortografinë etj. Ai është shumë i aftë për të punuar si njëri ndër korrektorët e greqishtes së re. Diçka e përmuajshme, e mjaftë sa për të përballuar jetën, do të ishte një bamirësi e madhe dhe nga ana e Shoqërisë Biblike (e cila, natyrisht, nuk mund të thuhet se është ngritur për të dhënë lëmosha) kjo do të ishte vetëm një pagesë për atë që duhet paguar dhe që pa kryepeshkopin nuk do të bëhej mirë. Nuk kam dyshim se, po ta pranonte Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, unë do ta kënaqja kryepeshkopin dhe dy korrektorët për greqishten të shumtën me sasinë që u përmend më lart 30 dollarë në muaj, ndoshta edhe më pak. Më lejoni t'ju lutem për një përgjigje sa më të shpejtë lidhur me këtë çështje, sepse kam frikë që përndryshe kryepeshkopi do të largohet, gjë që do të ishte humbje mjaft e rëndë.

I. Lowndes.

Rregullimi përfundimtar i këtyre punëve mësohet nga letra e mëposhtme:

*Korfuz, 3 shkurt 1826*

Më në fund mora fashikullin e parë të Dhiatës së re shqip e greqisht, e cila besoj se do ta kënaqë Komitetin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Formatin është ai që përcaktuat ju dhe unë nuk e kam kursyer mundin për ta bërë punën sa më të mirë të ishte e mundur. Mendoj se shkronjat e reja që bëmë përshtaten shumë mirë, më mirë sesa ato të alfabetit që ju pata dërguar, sepse përmasat e tyre ishin tepër të vogla e si pasojë, do të na duhej të bënim matrica të reja më të mëdha. E them me gëzim që tipi është i hijshëm dhe shpresoj se libri do të lexohet si me kënaqësi, ashtu edhe me dobi, me bekimin e Zotit.

Me Kapitenin White të anijes Ledy Keith, që u ngarkua për Liverpul, ju kam dërguar një pako të vogël, ku ka fashikuj, prej të cilëve është kjo fletë bashkangjitur; por meqë anija do të lundrojë ngadalë deri në Angli, kurse posta me tokë vjen më shpejt, po ju dërgoj këtë tashti.

Kryepeshkopi Grigor është plotësisht i kënaqur që me 20 dollarë spanjollë në muaj të ndreqë shqipen e gjithashtu greqishten e re. E ndiej veten mjaft borxhli kundrejt Komitetit dhe ju lutem kini mirësinë t'u paraqisni atyre falënderimet e mia për besimin që më dhanë, duke më lejuar të paguaja edhe 30 po të ishte e nevojshme për korrekturat. Megjithatë i kam mbajtur para sysh interesat e Shoqërisë, dhe meqë puna nuk do të ecte përpara aq shpejt, siç është e zakonshme në Angli, dhe vetë Grigori është plotësisht i kënaqur, mendova se 20 do të ishin një rregullim fare i mirë ndërmjet atij dhe Shoqërisë. E pashë të nevojshme të kisha një korrektor tjetër gjithashtu për greqishten, sepse ndonëse kam ndër mend t'u kushtoj vetë vëmendje të rreptë ndreqjeve, përsëri disa herë detyrimisht mund të kem pengesa për t'i shqyrtuar bocat me imtësinë e kërkuar. Komiteti mund të ketë besim te vëmendja ime e përhershme për këtë punë. Më vjen keq që po shoh se fjala e tretë në Dhiatën greqisht ka *dy* v në vend të *një*.

Njeriu që kam caktuar si korrektor kryesor për greqishten e re është një i ri me emrin Gusti, nga Universiteti Jonian, një djalë aktiv, i cili e kupton gjuhën e vet shumë mirë. Jemi marrë vesh t'i jap 5 dollarë spanjollë në muaj (me lejen e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja), shumë e cila së bashku me të kryepeshkopit do të arrijë 25. Nuk jam i sigurtë nëse do të dalë më mirë llogaria po t'i jap nja dy para radhitësit ose tipografit herë pas here, meqë kështu puna do të ecte më shpejt. Po ta bëj këtë, do të detyrohem gjithashtu t'ua shtoj këtë shpenzimeve të rregullta.

*I. Lowndes.*

#### Z. Lowndes ka shkruar përsëri më 5 qershor 1826.

Meqë shqipja po ecën tashti mirë dhe unë po bëj çmos për ta shpejtuar, pa kaluar shumë kohë, me vullnetin e Zotit, do të arrijmë te përfundimi i Katër ungjijve. Kryepeshkopi ka thënë më se një herë se do të ishte më mirë të lidhej Dhiata në dy vëllime, në të parin të përfshiheshin Katër ungjijtë dhe në të dytin pjesa që mbetet e Dhiatës, pasi shqiptarët e kanë zakon t'i mbajnë librat me vete në gji. Ka diçka të pëlqyeshme në këtë mendim. A do ta quante Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja se do të ishte më mirë që një pjesë e botimit, ndoshta gjysma, të lidhej kështu, kurse pjesa tjetër të përmbledhte gjithë Dhiatën e re së bashku? Po të lidhej një pjesë vetëm me Katër ungjijtë, do të dilte më shpejt në qarkullim. Kam dëshirë të madhe që ta lehtësoj botimin dhe qarkullimin e Shkrimeve të shenjta, prandaj do të isha shumë i kënaqur po të merrja dhe të ndiqja udhëzimet nga ana e Komitetit.

*I. Lowndes.*

Në një mbledhje të Komitetit më 13 korrik 1827 u lexua letra e mësipërme dhe: "U vendos, që t'i kërkohet Komitetit të Shoqërisë Biblike Joniane të lidhen 500 kopje të Dhiatës shqip e greqisht në dy vëllime, në përputhje me rekomandimin e bërë prej kryepeshkopit."

### Më 11 qershor 1827 z. Lowndes shkruante:

Shpresoj që përpara se kjo letër të arrijë te ju, do të keni marrë dy kopje të greqishtes së re dhe shqipes deri te fundi i Punëve, si dhe që do të jenë të kënaqshme për Shoqërinë. Jua kam dërguar prej këndej më 23 prill me anë të Falmouthi-it. Puna po ecën përpara dhe radhitja tashti ka arritur deri te Letra e Judës. Në fund të marsit kryepeshkopi i Negropontit u largua dhe u nis në Scio të arkipelagut. Po të kishte ikur mjaft kohë më parë, nuk do të ishte shtypur Dhiata shqip, por Zoti me providencën e vet bëri që ai të qëndronte derisa prania e tij të mos ishte absolutisht e domosdoshme. Ai stërviti një të ri për shqipen që të bënte korrekturat etj., pasi e kishte përgatitur vetë plotësisht dorëshkrimin dhe tashti ne mund të vazhdojmë pa ndihmën e tij.

### Më në fund më 12 nëntor 1827 z. Lowndes ka shkruar:

Më 10 gusht mora fletën e fundit të Dhiatës shqip. 500 kopjet e lidhura në dy vëllime tashti janë pothuaj të gjitha gati. Dhjetë kopje të vëllimit të madh, domethënë gjithë Dhiata, janë lidhur dhe 150 të tjera janë në duart e libraldhësve. Shpresoj se puna do t'i kënaqë kërkesat. Lidhur me formën dhe pamjen nuk ka gjë të madhe për të qortuar, sepse duken shumë mirë. Me shtytjen time të veçantë, kryepeshkopi Grigor i ka kushtuar shumë vëmendje rishikimit të dorëshkrimit, me qëllim që ai t'i shëmbëllente greqishtes pa shtesa ose ndryshime dhe banorët e Shqipërisë e kuptojnë. Megjithatë gjendja e vendit ende nuk më ka lejuar asnjë herë të bëja një vizitë (një synim që ende e kam) dhe pikërisht tashti, për shkak të pasigurisë së luftës, aq më pak mund të më lejojë; por ne jetojmë me shpresën se retë kërcënuese do të shpërndahen dhe do të hapet një rrugë për në Shqipëri për përhapjen e së vërtetës hyjnore.

Më poshtë po jap Raportin e një greku, i cili ka vizituar Shqipërinë më 1826, raport që z. Lowndes ia ka dërguar Komitetit në Londër.

Kam kënaqësinë t'ju njoftoj se gjatë kthimit në Shkodër prej këndeje (nga Korfuzi) i dërgova nga Kepi i Rodonit të përnd. Andrea Ikonomit, pastor i kishave greke në Kavajë e Durrës, katër kopje të Dhiatës së re në greqishten e re, së bashku me 10 kopje të Ungjillit të Sh. Mateut në greqishten e re dhe shqip. Duke menduar se kaq ishin të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e pak të krishterëve të Kishës lindore, që janë të përhapur në rrethinat e Kavajës e të Durrësit, e mbajta sasinë tjetër të kopjeve, që më besuat ju, pra dy kopje të Dhiatës në greqishten e re dhe 10 kopje të Ungjillit të Sh. Mateut për t'ia dhënë kreut të Kishës lindore dhe atyre pak të krishterëve të lidhur me të, që janë në Shkodër. Megjithatë, pasi nuk gjeta ndonjë rast për t'u takuar me ta, diçka për të cilën në të vërtetë nuk kisha ndonjë dëshirë të madhe, aq më tepër sepse do të ngjallte dyshime lidhur me rrethanat e tanishme kaq kritike për të gjithë ortodoksët fatzinj të përzier midis turqve, i shpërndava kopjet e mbetura midis disa druvarëve, të cilët i takova rastësisht në pyjet e këtyre krahinave.

Ju kam informuar se gjatë bisedave të ndryshme me mikun tim Ikonomin në Kavajë dhe në Durrës, vura re se ky prift i nderuar ndjeu kënaqësi të madhe, kur e njoftova, me aq sa mundja, lidhur me formimin dhe përparimin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, si dhe për shoqëritë biblike kudo në botë. Por ai ndjeu një gëzim të pamasë e të papërshkrueshëm, kur e mori fjalën e Shpëtimtarit tonë në një gjuhë të kuptueshme nga grigja e tij. Gjithashtu druvarët e ndryshëm, midis të cilëve siç thashë, shpërndava kopjet e mbetura, duke lexuar e duke dëgjuar nga shpjegimet e paraqitja ime për përhapjen e punës kolosale të Shoqërisë Biblike, thirrën: "O Zot, je i madh dhe të mrekullueshme janë punët e tua!".

Mendoj se është e këshillueshme të tërheq pak vëmendjen tuaj lidhur me përkthimin e Ungjillit të Shën Mateut e njëkohësisht t'ju them atë çka mundem për gjendjen e krishterimit në këto anë.



Dialekti në të cilin është përkthyer, sipas mendimit të disa njerëzve të shkolluar, është mjaft i ndryshëm prej atij që flitet në Durrës dhe në pjesët më veriore të Shqipërisë. Megjithatë ai flitet në gjithë Epirin dhe ortodoksët kryesorë që jetojnë në Shkodër e kuptojnë në mënyrë të mjaftueshme.

Numri i të krishterëve që i përkasin kishës latine në këto krahina është mbi 80.000, kanë pesë ose gjashtë kryepeshkopë e peshkopë dhe një delegat nga Propaganda në Romë, i cili jeton në një manastir në Kepin Rodon. Shumica e kishave janë nëpër male, shumë pak ka në qytetet dhe në kryeqendrën, Shkodër, nuk ka asnjë, kështu që priftërinjtë e tyre janë të detyruar t'i bëjnë meshat nëpër luginat larg qyteteve. Megjithatë është për t'u shënuar që në Durrës, në anën e majtë të hyrjes në kishën ortodokse kushtuar Shën Gjergjit, ka një altar të kishës latine kushtuar Shën Lucianit, ku priftërinjtë e tyre bëjnë meshën pasi prifti ortodoks mbaron të veten. Klerikët katolikë që vishen përgjithësisht si shqiptarët, vishen si priftërinj katolikë gjatë ceremonive dhe përdorin gjuhën latine; nganjëherë e shpjegojnë Ungjillin duke shtuar disa udhëzime gojore në shqipen, në të cilën njerëzit janë të detyruar të rrëfehen.

Shqiptarët që i përkasin kishës perëndimore flasin gjuhën shqipe, me përjashtim të shumë pak tregtarëve në kryeqendër, Shkodër, dhe në disa qytete të tjera kryesore, ku për shkak të marrëdhënieve të tyre tregtare me Venedikun dhe me pjesë të tjera të Italisë, e kuptojnë italishten. Gjithashtu kam takuar shumë veta, të cilët për të shkruar letrat në korrespondencë, përdorin shkronjat italiane, së bashku me disa shenja shtojcë, të cilat i kanë për të shprehur tingujt e veçantë të gjuhës shqipe.

Propaganda, siç dihet mirë, më parë është përkujdesur shumë që ta mbante të ngrohtë zellin e pasuesve të kishës perëndimore në këto anë, por tashti, siç më kanë informuar, ajo pothuaj as që merret me ta.

Unë e kam quajtur si barrën time të përpiqesha sipas mundësive për të dhënë një ide mbi planet e Shoqërisë Biblike; për këtë qëllim kam hyrë në biseda të gjata me klerikë të ndryshëm dhe me një numër të madh laikësh të besimit katolik; nga ajo që kam mundur të mbledh (ndonëse gjërat që janë të pamundura me njerëzit, janë të mundshme me Zotin), del që po ta kthejë

vëmendjen Shoqëria Biblike nga këto krahina, me siguri do të gjejë vështirësi të mëdha dhe kundërshtime në përmbushjen e veprës së saj jo vetëm ngaqë klerikët dhe krerët, të cilët janë plot paragjykime dhe prandaj shfaqin një këmbëngulje të madhe në veçantitë e fesë së vet, por edhe ndoshta drejtpërdrejt nga kisha e Romës. Përveç kësaj, do të ndeshë shumë pengesa në rrugën e plotësimit të qëllimeve të saj për shkak të gjendjes politike kritike në mjaft pjesë të Turqisë Europiane.

*Le vite*

Pas kësaj lënde të gjerë, që ia detyrojmë përkushtimit ndaj gjuhës shqipe nga ana e bibliotekarit T. P. Plat, është e nevojshme të jepen përfundimet e përgjithshme.

Botimi i Dhiatës së re shqip më 1824-1827, pas shumë diskutimesh e ndryshimesh, ka përdorur shkronjat e greqishtes duke i përshtatur për nevojat e shqipes dhe madje duke iu drejtuar edhe alfabetit latin. Vijat themelore të kësaj zgjidhjeje janë përcaktuar nga R. Pinkertoni më 1816, pas diskutimeve me shqiptarët në Vjenë: *“Në rast se kjo punë do të ndërmerrej, duhet të shtypet me shkronja të greqishtes, mbasi alfabeti grek, duke iu shtuar vetëm pak tinguj, është më i miri për të shprehur gjuhën shqipe, dhe duke përdorur alfabetin grek në vend të latinut, gjithë ata midis tyre që dinë të lexojnë, do të jenë në gjendje menjëherë ta përdorin Dhiatën tuaj shqip.”*

Vangjel Meksi e bëri përkthimin me një alfabet të tillë të përshtatur, por nuk mund të flitet me siguri për të, sepse dorëshkrimi i tij u redaktua nga G. Gjirakastri nën mbikëqyrjen edhe të Laundzit. Sapo u shtypën fletët e para të Ungjillit të Mateut, në pranverë 1824 u dërguan në Angli si model. Ato i shqyrtoi T.

Plati dhe nisi letërkëmbimin me Laundzin për alfabetin e shqipes. Më vjen keq, që Plati nuk e ka dhënë të plotë, por sidoqoftë letrën e parë dhe përgjigjen e Laundzit me shtjellimet e mëtejshme i kemi. Ka interes të veçantë të vihet në dukje, se ai i kishte hyrë këtij shqyrtimi me njohje të botimeve shqipe. Siç e thotë vetë, e njihte Gramatikën e F. Maria da Lecce-s, shtypur në Romë më 1716, si edhe Fjalorin e Bardhit (1635). Për këtë besoj se i ka shërbyer libri i W. Martin-Leake-ut i vitit 1814 *Researches in Greece*, pjesën për shqipen të të cilit e kam përkthyer dhe botuar më 2006. Por Martin-Liku shkruan se nuk e kishte parë Fjalorin e F. Bardhit, ndërsa Plati e dëshmon se e kishte përdorur, kur shtron pyetjen për shkronjën “ç” të shqipes. Plati me Laundzin kanë diskutuar për ato shkronja të shqipes që nevojiteshin për tingujt e saj, të cilët nuk mund t’i jepnin drejt shkronjat e greqishtes.

Një çështje e veçantë ka lindur edhe për tingullin **h**, i cili dilte edhe si një tingull i aspiruar për trevën e skajshme jugperëndimore të shqipes. Togjet: **mb**, **nd**, **ng**, **ngj** linden si problem prej parimeve të alfabetit të greqishtes, ndërsa togjet: **ks**, **ps**, **st** janë thjesht imitim i greqishtes, sepse nuk kanë të bëjnë me shqipen.

Të dhënat e *Historisë* së Platis mund të krahasohen me botimet e shtypura, por kjo është një punë e ndërlikuar, sepse kemi disa botime dhe një dorëshkrim, që e kam gjetur më 1972 në Londër.

Plati flet për “sh” të dhënë me dy “s” të greqishtes. Këtë e kemi te botimi i vitit 1824, p.sh. σσκρουαν = shkruan. Në botimin e plotë 1827 kemi një “s” greke me dy pika sipër, ashtu si dhe dorëshkrimi.

Për “b” Laundzi ka menduar të jepet me shkronjë dyfishe të betës greke, por Plati nuk e ka gjetur në fashikullin e dërguar, ku thotë se ka gjetur  $\mu\pi$  ose  $\pi$ . Këtu ai gabohet nga mosnjohja e shqipes dhe Laundzi ia ka shpjeguar drejt në përgjigje. Më poshtë Plati jep shembull fjalën “çdo” si një ndërthurje të keqe bashkëtingëlloresh, ku nuk ka dalluar se pikërisht “d” është dhënë me dy “dd”. Gjithashtu, është e vërtetë se “mp” greqisht do të shqiptohet “b”, mirëpo në shqipen ndeshet edhe “mb” (si te: *mbush*) dhe prandaj duhet bërë dallimi. Në botimin 1824 që në titull thuhet:  $\mu\pi\epsilon\ \delta\iota\ \text{F}\iota\upsilon\chi\epsilon$  (*mbë di gjuhë*). Më 1827 është dhënë me “p” me një pikë sipër, porse te dorëshkrimi e ka me “b” latine. Besoj se kjo ka qenë zgjidhja fillestare e V. Meksit.

I njëjti problem pozicional ka dalë me shkronjën “d”. Përsëri Plati gabohet se mund të jepej njësoj me shkronjat greke “nt” ose “t”. Shqipja ka edhe “d”, edhe “nd”, siç ia ka shtjelluar Laundzi, madje ka edhe “ngj”. Këtë të fundit Meksi e ka zgjidhur me dy “g” të greqishtes dhe kjo zgjidhje është në dorëshkrim dhe në botimet. Vetëm se këtu shfaqet një ndërlikim tjetër. Ka mundësi që dorëshkrimi të mos jetë me dorën e Meksit, por i kopjuar prej dikujt tjetër, një fakt që përmendet edhe në dokumentimin përkatës. Për shembull: te rreshti i parë i Ungjillit të Markut në dorëshkrim gjejmë “perdiisë” për “perëndisë” dhe besoj se është gabim i kopjuesit. Botimi 1827 e ka në rregull “Perndisë”. Laundzi kishte propozuar që të zbatoheshin “b” dhe “d” të prera me vizë në mes, ndërsa Plati me të drejtë i ka quajtur shkronja të shëmtuara.

Nuk i ka pëlqyer Platit as dhënia e shkronjës “ë” me shkronjën greke të kthyer mbrapsht. Te dorëshkrimi përsëri ka një zgjidhje, që besoj se i përket vetë V. Meksit. Aty përdoret epsilon i greqishtes si “e” e shqipes, ndërsa për “ë” është përdorur “e” e latinishtes. Pavarësisht nga gabimet në dorëshkrim, kështu del se Meksi ka gjetur zgjidhje duke përfshirë edhe shkronja të latinishtes, siç kishte bërë më parë edhe bashkëkohësi i tij, M. Boçari për Pukëvilin.

Së fundi, është me interes që Plati ka kërkuar të mbahen para sysh edhe zgjidhjet për tinguj të ngjashëm në gjuhë të tjera, e konkretisht për turqishten. Kjo i ka shërbyer për të rekomanduar se çfarë të bëhej me rastin e “h” së aspiruar, një diskutim që për ne sot nuk paraqet më interes.

Tashti është e qartë përse në botimin e vitit 1824 janë vënë që në krye leximet e 9 germave, ndër to 6 janë dyshkronjështa të greqishtes: bb (b), gg (gj), dd (d), ll (ll), nn (nj) dhe ss (sh), kurse tri janë për “ë”, “q” dhe “h”. Madje edhe shembujt ilustrues janë ata që kanë dalë gjatë diskutimit në letërkëmbimin e Platit me Laundzin: *birit, do, lehëtë*. Në përgjigjen e vet, veç sqarimeve, Laundzi është shprehur kundër dyshkronjështave, por i ka quajtur zgjidhje të pashmangshme. Ndërkaq, Ungjilli i Mateut ishte shtypur dhe ai kishte nisur punën për botimin e plotë të vitit 1827, prandaj alfabetet e këtyre dy botimeve kanë ndryshime të ndjeshme. Dallimi më i dukshëm është ai për shkronjën “ë”, që me të vërtetë duke e kthyer mbrapsht “E” të greqishtes që në titull del mjaft e pahijshme, duke qenë një tingull mjaft i dendur për tos-

kërishten, sepse në fund të fundit dy “gg” për “gj” dhe dy “ss” për “sh” kanë mbetur dyshkronjësia edhe në alfabetin e sotëm. Dallimi ndërmjet “g” dhe “gj” më 1824 është bërë nëpërmjet “gk” për të parën. Shkronja “j” është dhënë me “i”, ndërsa dallimi ndërmjet “d” dhe “dh” është bërë duke e dhënë të parën me dy “dd” të greqishtes.

Më 6 maj 1825 Laundzi njofton se cilat zgjidhje ka zbatuar përfundimisht dhe ato ia ka përcjellë G. Gjironkastritit për të ndjekur redaktimin për shtyp. Shkronjat e reja përfunduan në tetor dhe në janar 1826 nisi shtypja e Dhiatës së re. Fashikulli i parë kishte përfunduar në shkurt dhe përsëri Laundzi dërgoi një kopje në Londër, duke e shoqëruar me këto fjalë: “E them me gëzim, se tipi i shkronjave është i hijshëm dhe shpresoj se libri do të lexohet si me ëndje, ashtu edhe me dobi.” Në faqen e parë pas kopertinës jepet i plotë alfabeti me leximin. Me gjithë këto shtjellime, nuk del një përgjigje e qartë për pyetjen: Cili ka qenë alfabeti i V. Meksit? Nuk ka dyshim, se kur i është përveshur përkthimit, ai tashmë ishte i përgatitur. Nuk e dimë me çfarë alfabeti i bëri përkthimet, për të cilat thuhet se i botoi në Venedik më 1814. Nuk e dimë me cilin alfabet e kishte shkruar Gramatikën e shqipes, por po të kishte qenë thjesht me shkronja latine, pa dyshim do t’i kishte bërë përshtypje R. Pinkertonit, kur ia tregoi. Mbetet, që sipas traditës së Janinës dhe mjedisit ku ai qarkullonte, do të ketë përdorur një alfabet të përshtatur të greqishtes. Nuk e quaj alfabet grek, sepse edhe diskutimet e botimet tregojnë që janë marrë germet greke bashkë me parimet e pë-

dorimit të tyre për greqishten, kur shkonin pa vështirësi për shqipen. Pinkertoni ishte i bindur për një zgjidhje të tillë sipas këshillimit me shqiptarët në Vjenë. Ndërkaq, është e drejtë të shtrohet pyetja: A ndoqi Vangjeli ndonjë alfabet të traditës? Nuk kemi dëshmi për këtë. As të huajt që përmenda, as dhe J. Vellaraj nuk kanë qoftë edhe tërthorazi ndonjë element të tillë. Me dorëshkrimin e M. Boçarit ka vetëm ndonjë përputhje të rastit, ndërsa ndryshimet janë thelbësore; mjafton të përmendet shkronja “nj” për shqipen e të dyve. Mbetet të pranohet, se alfabeti i Meksit ka qenë origjinal, por aq origjinal sa mund të quhet në një mje-dis, ku shqiptarët shkruanin greqisht. Në arkivat anglezë kam gjetur një tufë me letra greqisht me dorën e Ali Pashë Tepelenës dhe sidomos të djalit të tij, Vehbiut. Për to kam shkruar në Parathënien për përkthimin e Martin-Likut.

Kur ka parë dorëshkrimin e Meksit, Laundzit i kanë bërë përshtypje pikërisht dy shkronjat latine: **b**, **d**. Më lart fola dhe për nevojën e dallimeve pozicionale në rastet e MB dhe ND. Meksi kishte përdorur “x” me pikë sipër për aspiraten, kurse Laundzi e ktheu përmbys etën greke. Këtë dhe “sh” me dy “s” i pranon Laundzi përfundimisht si zgjidhje të vetat. Diskutimi në fund të fundit ka qenë ndërmjet dyshkronjeshave dhe vendosjes së pikave diakritike mbi shkronja njëshe. Që të dyja zgjidhjet janë pjesërisht të Meksi dhe prandaj do ta quaja si përfundim, se botimet e vitit 1824 e 1827 janë nisur nga zgjidhjet e Meksit, janë përpunuar në diskutimet e Laundzit me Platin dhe me të tjerë dhe përfundimisht Laundzi ka

marrë vendimin, duke i vënë vulën një alfabeti të shqipes me shkronjat e greqishtes. Nuk mund të lihet pa shënuar një fakt tjetër. Tridhjetë vjet më vonë Laundzi ndërmoi ribotimin e përkthimit të vitit 1827. Shtypja u bë më 1858 nga Kristo Nikolaidisi në Athinë, por pa ndihmën e ndonjë shqiptari të përgatitur. Kjo provë dëshmoi sesa e çmueshme kishte qenë puna e redaktorit G. Gjirokastriti. Laundzi mori një kopje në Maltë dhe më 31 dhjetor 1859 i shkroi të vërtetën Londrës. Nënkomiteti i Botimeve në Londër vendosi: “Mbi botimin e Dhiatës shqip e greqisht në kolona paralele. Ka pasur aq shumë gabime, sa u vendos të mos tërhiqen kopjet për t’i qarkulluar.” Kopje të këtij botimi gjenden sot në bibliotekat tona, por ai nuk duhet marrë si i rregullt nga studiuesit, sepse është versioni i fundit me gabime i përkthimit të V. Meksit.

Botimi shqip i Dhiatës së re ka pasur rëndësi të posaçme për gjuhën shqipe dhe studimin e saj në shkallë europiane. Për këtë tashmë kam shkruar hollësisht që më 1974 dhe më pas,<sup>19</sup> ndërsa dua të shtoj se tirazhi ka qenë 2000 kopje dhe ne e dimë sot se cili është kuptimi i këtyre shifrave të tirazheve po të kujtojmë se atëherë popullsia shqiptare ka qenë shumë herë më e vogël se 7 milionët e sotëm. Gjithsesi, dëshiroj të vë në dukje se ai libër ka ndikuar edhe për ecurinë e alfabetit të shqipes. J. R. fon Ksilanderi<sup>20</sup> jo vetëm është mbështetur në të për të nxjerrë veçoritë gramatikore të shqipes dhe për të hartuar fjalorin shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip, por edhe e ka pranuar si alfabet për të shkruar lëndën shqipe. Madje ka ribotuar të plotë Ungjillin e Markut prej botimit të vi-



tit 1827, si dhe një letër të Palit e Apokalipsin e Gjonit. Ksilanderi e hap librin e vet me trajtimin e alfabetit dhe menjëherë përmend praninë e alfabeteve të ndryshme, duke iu referuar edhe Pukëvilit. Për mendimin e tij, i plotësuar me disa shenja, alfabeti i greqishtes është më i përshtatshëm për shqipen dhe mund të përgjithësohet. Obradoviçit, i cili më 1829 kishte shkruar se shqipja mund të merrte alfabetin cirilik, ai i kundërvihet sepse kjo do të krijonte një gardh ndërmjet shqiptarëve dhe fqinjëve të tyre. Alfabetin e vitit 1827 Ksilanderi e jep në faqen 5 të librit të vet dhe i vë pranë shkronjat përkatëse të gjermanishtes me ndonjë sqarim të shkurtër. Më tej jep shpjegime më të hollësishme për shqiptimin e shkronjave, si dhe bën ndonjë vërejtje për alfabetin e Thunmanit (në të vërtetë të Kavaliotit) dhe të Martin-Likut. Rrjedhimisht, me alfabetin e vitit 1827 është shkruar një ndër gramatikat e hershme të shqipes, janë hartuar dy fjalorë dygjuhësh, e madje janë transkriptuar nga Ksilanderi disa vargje të shënuara me shkronja latine në fund të *Çaljd Haroldit* nga Xh. Bajroni.

Prej Ksilanderit i ka marrë të dhënat e para për gjuhën shqipe edhe gjuhëtari i njohur i shek. XIX A. Shlajher (Schleicher). Në librin *Gjuhët e Europës së sotme* (përkthyer frëngjisht me titullin *Les langues de l'Europe Moderne*, Paris 1852) ai ka dhënë si shembull lakimi atë të marrë prej Ksilanderit për fjalën “i miri” dhe e shënon qartë: “Ortografia që kam përdorur këtu sipas Ksilanderit është marrë prej *Dhiatës së re* shqip, të botuar në Korfuz më 1827.” (f. 191). Kështu, Shlajheri ka përdorur alfabetin e *Dhiatës së re*, një arsye më te-

për kjo përse e kam dhënë të dokumentuar hollësisht se si u ndërtua ky alfabet. Riprodhimi që i ka bërë T. Osmani alfabetit nga libri i Ksilanderit<sup>21</sup> është me gabime, po ashtu si dhe ai për V. Meksin.

Njohësi i dytë më i thelluar i Dhiatës shqip ka qenë J. G. fon Hani (von Hahn), sepse kishte punuar bashkë me Kristoforidhin mbi atë tekst për të mësuar shqipen, duke komentuar e zgjeruar edhe gramatikën e leksikun. Rrjedhimisht, edhe Hani ka ndjekur traditën e nisur nga V. Mexsi. Kur ka ardhur puna te Fjalori shqip-gjermanisht, ka vënë në dukje se si bazë kishite marrë fjalësin e Ksilanderit, mirëpo me shtesat i dilte problem se si të zbatonte një sistem të përgjithshëm. Lidhur me fjalët e toskërishtes ai ka sjellë disa ndryshime: për dallimin l-ll, r-rr dhe për vlerën e “z” pas “d”. Mirëpo probleme më të ndërlikuara i dilnin për fjalët e gegërishtes, për të cilat nuk mbështetej dot te ndonjë traditë me shkronja greke, ndonëse e pohonte që dialektet e shqipes nuk ishin shumë larg njëri-tjetrit. Përfundimisht, Hani ka përfshirë shkronjat “b, d, j” në vend të atyre greke te Ksilanderi, ka nxjerrë si shkronjë më vetë t+s për tingullin “c”; t+s me dy pika për “ç”; edhe për “gj” të Ksilandrit ka sjellë “g” të greqishtes dhe “j” të latinishtes. Me interes është se e ka mënjanuar tërësisht Ψ të greqishtes. Veçantia e Hanit është se ka bërë përpjekje për ta dhënë lëndën e gegërishtes me shkronja greke, një fakt ky të cilin nuk e kanë vënë re autorët për alfabetin e shqipes, duke nënkuptuar një ndarje të pakapërcyeshme. Në të vërtetë, siç do të tregohet te shkrimi tjetër këtu më poshtë lidhur me Kavaliotin e Dhanilin, kjo ndarje

nuk ka qenë ndonjë dogmë e ngulitur, sepse p.sh. edhe përpara tij kemi gegizmat e Kavaliotit dhe te Dhanili numërori “një” është dhënë rregullisht në trajtën “nji” të gegërishtes dhe është shkruar me shkronja greke.

Një gjerman tjetër, K. Rajnholdi (C.H.T. Reinhold), pothuaj i së njëjtës kohë (1855) nuk ndoqi vijën Meksi-Ksilandër-Han, por ndërtoi një alfabet mbi bazën e latinishtes, duke përfshirë pesë shkronja të greqishtes: δ, γ, λ, θ, ζ dhe ξ me vijë përsipër për “zh”. Me sa duket, ai nuk i njihte shkrimet shqipe të mbështetura në alfabetin e greqishtes. Gjuhëtari i njohur Franc Bopi, përkundrazi, në punimin e tij themelvënës për natyrën indoeuropiane të shqipes (1855) ka zbatuar alfabetin me zanafillë të Dhiata e re dhe ka kryer ndonjë ndryshim të vogël kundrejt Hanit, p.sh. e ka dhënë togun e greqishtes ου me shkronjën latine “u”, kurse vitën greke e ka dhënë me ‘v’, duke e shënuar numrin e shkronjave latine. Nga ana tjetër, e ka njohur F. da Leçen dhe shembujt prej tij i ka riprodhuar me shkronjat latine.

Redaktimin dhe ndjekjen në shtyp të përkthimit të V. Meksit i kreu G. Gjirokastriti. Ideatori i parë, R. Pinkertoni, u nis më 1824 për një udhëtim të gjatë nëpër Mesdhe e në vendet e Lindjes. Më 22 shtator i ka shkruar letër Shoqërisë së Broshurave Fetare në Londër, se kishte ndarë 25 lira për të përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe 7 broshura dhe Gjirokastriti e kishte nisur përkthimin e tyre. Ishin muajt kur G. Gjirokastriti sapo kishte përfunduar korrekturat e Mateut dhe do të niste rishikimin e gjithë Dhiatës së re. Pu-

nën konkrete Pinkertoni ia la Laundzit. Më 9 korrik 1829 Laundzit i kanë shkruar nga Shoqëria e Broshurave në Londër: "Do të kishim dëshirë të na shkruanit nëse është arritur ndonjë rezultat pozitiv me Broshurat e shtypura shqip dhe nëse keni ndër mend t'i ribotoni ato." Komiteti e autorizoi që t'i përdorte të ardhurat për qarkullimin e broshurave shqip dhe greqisht. Shumë vjet më vonë, më 1867, Laundzi flet për dy broshura shqip. Ai e ka ndjekur punën me Grigorin deri në botimin e tyre dhe besoj se kanë qenë po me atë alfabet që është përdorur për Mateun. Me këtë letër vërtetohet se broshurat janë botuar, madje pas pak vjetësh është kërkuar një ribotim i tyre. Nuk është e qartë, nëse ishin dy apo të shtata, mbetet që të kërkojen, meqë tani jemi të sigurtë se ato janë botuar në Maltë dhe përbëjnë një dëshmi tjetër të përdorimit të alfabetit, të cilin e kishte pasur botimi i vitit 1824.

### *Arbëreshët e Italisë*

Pjesa më e madhe e arbëreshëve të Italisë ishin shpërngulur nga treva të kishës ortodokse dhe madje nga vise të greqishtes, si Peloponezi. Porse u vendosën në një mjedis si fetar edhe gjuhësor, ku përdorej alfabeti latin. Është e vërtetë se jugu i Italisë e Sicilia kishin pasur lidhje të lashta me botën greke e ndoshta kjo ka qenë një ndër arsyt përse arbëreshët i vendosën atje. Konfesionin uniat në një trevë të katolicizmit e lehtësonte edhe praninë e arbëreshëve. Megjithatë,

nuk mund të hamendësohet se atje do të kishte pasur ndonjë traditë të shkrimit të shqipes me alfabetin grek; kjo nuk e përjashton që shkrimin me alfabetin e greqishtes arbëreshët ta kishin sjellë me vete, si mund të hamendësohet prej Perikopesë së ungjillit të shek. XVI. E njihnin shumë mirë greqishten G. Guzzetta (1682-1756) dhe F. Avati (1717-1800). Guxeta kishte marrë hamendjen e Barletit dhe shprehej se shqipja rridhte tërësisht prej latinishtes. Gjithsesi, ishin kushtet që të dy alfabetet të ndërthureshin.

Ndonjë shkronjë greke përfshihet në alfabetin latin për shkrimin e shqipes që më 1736 në Kodikun e Kieutit prej N. Filies, alfabet me tri shkronja greke (δ, ε, θ), që më pas është përdorur edhe nga P. M. Parrino (1710-1765). Parrinoja e mohonte çfarëdo lidhje të të folmeve arbëreshe të Italisë me greqishten dhe e quante shqipen të njëjtë me maqedonishten. Dh. Shuteriqi<sup>22</sup> shënon një anonim nga Sicilia të vitit 1755 me alfabetin e misionarit italian N. Katalano (1637-1694), domethënë të përdorur për të shkruar shqipen përpara vitit 1694. Shuteriqi shton se kjo: “flet për një traditë arbëreshe të shkrimit të shqipes në Sicili me alfabetin grek, e pakta që nga shek. XVII”. Besoj se më e drejtë do të ishte të pohohej, se nga shek. XVII kemi hapat e parë për shkrimin e shqipes nga arbëreshët me alfabetin e greqishtes, meqë ende ruanin ndikimin e drejtpërdrejtë në viset nga ishin shpërngulur. Ndërkaq, për dorëshkrimin e fjalorit të vetë N. Katalanos ka njoftime se ka qenë në dialektin verior të shqipes dhe ka pasur disa këngë arbëreshe të shkruara me alfabetin grek. Sipas Shuteriqit ndonjë shkronjë greke

ka dorëshkrimi i N. Athanas Sullit (1757) në Sicili për një vjershë shqip, dëshmi se tashmë po kalohej në alfabetin latin, por alfabeti grek ndihmonte për kapërcimin e vështirësive me disa tinguj (ë, rr, th, z). Ai shton se është përdorur edhe nga nxënësit në Seminarin e Palermos. Pak shkronja greke ka edhe Jul Variboba te poema e vet e njohur, që doli më 1762: δ, θ, γ, ζ.

Një vit pas veprës së Varibobës, mbi Fjalorin italisht-shqip të N. Ketës ka një fjali shqip me alfabet grek, ndërsa përmbajtja tregon se duhet të jetë bërë më vonë nga viti 1763 i Fjalorit. Po aty në faqen 39 të dorëshkrimit ka një strofë shqipe me alfabetin grek. Në alfabetin latin të N. Ketës ka 6 shkronja të greqishtes, ndonjë të përdorur krahas shkronjës latine (δ, γ, λ, κ, θ, ζ). Dorëshkrimet e botuara më 2003 në Palermo nga M. Mandala dëshmojnë për një ndërthurje origjinale të shkronjave greke nga N. Keta. Bie në sy parapëlqimi për dyshkronjështa me germa greke për të kapërcyer vështirësitë me tinguj të shqipes, si: *b, l, gj, sh*. Porse ndërkaq M. Mandala shënon, se një dorëshkrim (Një copë e fjalorit të Kolesë të Ketësë) prej 70 fletësh është me alfabetin grek, që haset te Leksikoi dhe në vepra të tjera të Ketës. Mbetet një çështje për ta shkoqitur konkretisht, porse do të shtoj se nga këto të dhëna nuk del të ketë mbështetje pohimi i T. Osmanit,<sup>23</sup> se ka pasur një ndarje të tillë: arbëreshët e Sicilisë e kanë shkruar shqipen me alfabetin grek, ata të Kalabrisë me alfabetin latin. Po ky autor ka shënuar për Mikele Skutarin (1825) se ishte i mendimit për të marrë alfabetin latin, duke e plotësuar me ndonjë shenjë greke, ndërkohë që Zef Krispi (1831) nga Sicilia

ka përdorur alfabetin latin. Anasjelltas, Françesko Santori (1819-1894) nga Kozenca mendonte se alfabeti grek ishte më i përshtatshëm për shqipen, por përdori vetë alfabetin latin dhe përfshiu vetëm një shkronjë greke: θ. Është përsëri T. Osmani, i cili ka rënë në kundërthënie, duke shkruar: “në veprën e tij përdori gjithnjë alfabetin latin-italian, pa e përzier me asnjë shkronjë greke”, kurse katër faqe më poshtë (162) e pranon se krahas atyre latine ka përdorur dy greke: δ dhe θ. V. Dorsa (në botime të viteve 1847 e 1862) ka përfshirë në alfabetin latin edhe gjashtë shkronja greke (δ, γ, ζ, λ, θ, ξ), me një ndryshim vetëm kundrejt N. Ketës. Edhe Zef Serembja (1843-1914) në dorëshkrimin e vet ka zgjedhur tri shkronja greke (ζ, θ, ξ). Sipas njoftimeve, Andrea Dara, i ati i Gavrililit, në dorëshkrimet e veta ka përdorur brenda alfabetit italian disa shkronja greke (ε, λ, δ, θ, ζ), e po ashtu Gavril Dara i Riu e ka plotësuar shkrimin me disa shenja të greqishtes.

Me emrin e V. Dorsës lidhet një fakt tjetër kuresh-tar. Princi Luis Lysjen Bonaparti (Louis Lucien Bonaparte, 1813-1891), i biri i vëllait të Napoleonit, i hyri përkthimit të një libri të Biblës në 133 gjuhë e dialekte për ta paraqitur me rastin e Ekspozitës Botërore të Parisit më 1867 dhe në të vërtetë u arrit të shifra 170 gjuhë të botës. Një përkthim e bëri në të folmen e Shkodrës misionari italian F. Rossi, autori i dy fjalorëve, ndërsa redaktimin e bëri G. Krasniqi. Një përkthim tjetër doli më 1868, i bërë në të folmen e Horës së shqiptarëve në Sicili nga vëllai më i vogël i Kamardës (Giuseppe Camarda, 1831-1878) dhe u redaktua nga Dh. Kamarda. Në dorëshkrimet e Kopenhagës

ndodhet edhe një dorëshkrim i përkthimit të Zef Kamardës me alfabetin grek. Dhe së treti, një përkthim e bëri V. Dorsa, përsëri me redaktim të Dh. Kamardës. Titulli është *Il Vangelo di S. Matteo, tradotto dal testo greco nel dialetto calabro-albanese di Frascineto dal Sig. Vincenzo Dorsa*, Londra 1869. Për shkak se është botuar në Londër, është zbatuar zgjidhja e pazakontë e Martin-Likut për paraqitjen e shkronjës “ë”, domethënë është përdorur një “e” kursive = e. Nga alfabeti grek janë përzier me alfabetin latin tri shkronja: δ, θ, χ.

Si përfundim i parë del se arbëreshët deri nga fundi i shek. XIX herë pas here në alfabetet e tyre kanë përfshirë shkronja të greqishtes. Këto shkronja janë integruar për nevoja të tingujve të veçantë të shqipes, por ka luhatje dhe jo zgjidhje të qëndrueshme, ndonëse problemet kanë qenë kurdoherë po ato. Një vërejtje e tillë vlen madje jo vetëm për dallimet ndërmjet autorëve, por edhe për shkrimet e të njëjtit autor gjatë veprimtarisë së tij. Shembulli më i plotë për këtë është shkrimtari me krijimtarinë më të gjatë, Jeronim De Rada (1814-1903). Ai ka dhënë edhe tabela të alfabeve të veta, ndonjëherë me shpjegime, siç kishte bërë edhe Kristoforidhi. Prej këndeje do të pohoj se hipoteza, që De Rada ka ndjekur një alfabet të trashëguar, bie poshtë. Në fillimet e veta (1836) ai ishte shprehur për alfabetin latin dhe ka marrë disa shkronja si gjithnjë për rastet kur dalin probleme me alfabetin latin: “Unë hartova një të tretë me shenja italiane dhe një shtojcë me shenja greke, të cilin alfabet e kam përdorur vazhdimisht si diçka të plotë dhe që nuk paraqet të meta.” Më 1834 kishte 5 shenja greke dhe dy-



shkronjësja, më 1836 i shtoi në 8 shkronjat greke, më 1843 dhe 1847 i ka pakësuar deri në 3, në ribotimin e "Milosaos" të vitit 1873 ka katër dhe më pas ndeshen 5 prej tyre (δ, υ, θ, χ, ζ). Këtë qëndrim e ka përsëritur edhe më 1871 me rastin e asaj që është quajtur Gramatika e Zef De Radës. Edhe më 1884 ai ruajti vetëm katër shenja greke, duke u mbështetur përgjithësisht te alfabeti latin. Në Kongresin gjuhësor të tetorit 1895 u shpreh mendimi, që njësimi i shkrimit të botimeve arbëreshe të bëhej mbi bazën e alfabetit të përdorur nga De Rada prej një viti më parë me vetëm 3 shkronja greke.

Me rritjen e lëvizjes kombëtare shqiptare edhe te arbëreshët e Italisë, çështja e alfabetit iu nënshtrua një këndvështrimi të ri, thelbi i të cilit ishte: të gjenden zgjidhje të përbashkëta. Prandaj De Rada në revistën "Fjamuri i Arbërit" (1883) hoqi dorë prej shkronjave greke dhe ka ruajtur vetëm χ. Më 20 korrik 1883 shkruante në revistë: "Sipas këshillës së filologëve të ditur, duke lënë mënjanë disa nga shkronjat greke që kemi përdorur më përpara dhe duke pranuar shenja artificiale, i jemi përmbajtur alfabetit latin." Sipas T. Osmanit, ky arbëresh "nuk arriti të shkëputet plotësisht nga ndikimi i sistemit grafik grek. Në variantin e fundit, ai ruajti katër shkronja greke, duke bërë një hap prapa në krahasim me alfabetin e "Fiamurit të Arbërit".<sup>24</sup> Mirëpo nga një krahasim me alfabetin e Stambollit më del se ai ka përdorur δ, θ, të cilat i kishite ai alfabet dhe mund të bëhet një interpretim i kundërt: De Rada ka gjetur pika afrimi me vëllezërit Frashëri, pavarësisht se kundërshtia nga të dyja palët ka qenë e ashpër. Më 31 mars 1897 De Rada e pohon se

qe i detyruar të ndryshonte pesë a gjashtë alfabete dhe e përmbledh punën e vet qartë me këto fjalë: "... dy albanologët e shkëlqyer, Hahni-i e Stieri me kapiten Xylander-in, duke u marrë me gjuhën shqipe përdorën alfabetin grek, duke e plotësuar me germa të italishtes. Në të njëjtën kohë botohej 'Milosaoja' me germa latine, duke përdorur pak shkronja greke e pak të tjera konvencionale".

Emri tjetër te arbëreshët e Italisë, i cili ka qenë në qendër të diskutimeve për alfabetin e shqipes është ai i Dh. Kamardës (1821-1882). Ribotimi i veprës së tij<sup>25</sup> (botuar së pari më 1864) më 1989 hapet me një *Presentazione* nga A. Guzzetta. Duke u bashkuar me F. Altamarin, edhe Guxeta mbështet mendimin se Kamarda për alfabetin është nisur nga qëndrimi politik për çështjen shqiptare dhe nga hipoteza e vet për farefisninë e afërt ndërmjet greqishtes dhe shqipes. Këtë hipotezë të Kamardës e kam trajtuar më hollësisht në një kumtesë<sup>26</sup> më 1994. Sipas T. Osmanit, veprën e vet Kamarda e shkroi me alfabetin grek. Ky pohim është i papranueshëm. Kamarda e shkroi veprën e vet italisht. Lëndën shqipe e paraqiti me alfabetin e përshtatur të greqishtes, duke hequr dorë prej një ideje të vitit 1861, se duhej mbajtur vetëm alfabeti grek. Në atë kohë në revistën "Elpis" (21 mars), kishte mbrojtur idenë, se shqiptarët duhej të zotëronin greqishten si gjuhën e kulturës së tyre dhe prandaj u paraqiste alfabetin e vet si bazë. Një vit më parë po në atë gazetë (14 nëntor 1860) i njëjti mendim ishte shprehur nga V. Zhapa. Mund të bëhet një paralelizëm me fillimet e Jani Vretos dhe me zhvillimet e tij të mëpastajme. Pas

fare pak vitesh Kamarda ka përfshirë një varg shkronjash latine (pasqyrën e ka dhënë në faqen 14 të *Saggio di grammatologia comparata*), e konkretisht: *b, j, d, e*. Për dyshkronjëshat ka përdorur "j" pranë shkronjës përkatëse greke, që të përftoheshin: *gj, q, l, nj, hj*. Kjo e fundit nuk është për tingullin "q", si e merr aty gabim T. Osmani, por për fonemën e posaçme të arbëreshëve, ndërsa autori e ka dhënë tingullin "q" me anë të "kj". Për më tepër, T. Osmani shprehet, se Kamarda nuk pati ndonjë kriter për dyshkronjëshat me alfabet grek plus latin. Përsëri është dhënë një gjykim i gabuar. Kamarda ka qenë i qartë në zgjidhjet e veta. I ka kushtuar një krye të veçantë, të tretin, metodës së shkrimit (*Metodo di scrittura*) dhe po të mos ishte tekst i gjatë, do ta kisha përkthyer të plotë këtu. E kthjellon edhe historikisht përse ka vënë dy "s" në vend të një "s" me pika sipër për tingullin "sh". Me ç në fund të fjalëve sipas parimit të greqishtes ka ndër-tuar kështu dyshkronjëshat për: **ç, sh, xh, zh**, ndërsa me  $\sigma$  në trup të fjalëve greke ka ndër-tuar **c** dhe **x**. Me një fletushkë më 1869 Kamarda përhapi alfabetin e vet me shkronja latine, për të cilin botoi edhe broshurën *Alfabeto generale albano-epirotico*, ku ballafaqonte dy alfabetet. Por ky alfabet iu duk i vështirë Zef Se-rembes, i cili ishte shprehur se baza e alfabetit të përbashkët të shqipes do të bëhej alfabeti i greqishtes.

Edhe me këta shembuj prej Kamardës vërtetohet se shumica e atyre që ndeshen sot me shkronjat e greqishtes, të përdorura për alfabetin e shqipes, nuk e njohin përdorimin e alfabetit grek për greqishten dhe parimin pozicional që e përshkon drejtshkrimin e saj.

Por çështja bëhet shqetësuese, kur kjo mosnjohje shoqërohet me shtrembërimin e hapur të fakteve. Kështu, po i rikthehem edhe një herë rastit të Marko Boçarit, për të cilin J. Kastrati ka shkruar: “Një Fjalorth greqisht-shqip me 1494 fjalë, i regjistruar nga goja e tij prej Pukëvilit, shërbeu për njohjen e shqipes.”<sup>27</sup> Na del se Marko Boçari ka folur, kurse Pukëvili ka shkruar, domethënë tërësisht në kundërshtim me dokumentin historik, me shënimin e Pukëvilit mbi dorëshkrim, se lënda është shkruar me dorën e Marko Boçarit, dhe që vetë J. Kastrati e citon. Më lart kam vërtetuar se Pukëvili nuk ishte në gjendje të bënte asnjë regjistrim të shqipes me alfabetin grek, madje edhe kur kopjonte nga shqiptarët që shkruanin me shkronja greke, bënte gabime. Raste të tilla aq larg së vërtetës më detyrojnë të them, se as që mund të bëhet fjalë për të shqyrtuar mendimet e disa autorëve, që kanë prekur çështjet e alfabetit në një mënyrë, e cila nuk ka të bëjë me shkencën gjuhësore, prandaj i kam lënë jashtë.

Alfabeti i Kamardës është i afërt me të J. G. fon Hanit (von Hahn) dhe këtë arbëreshi e ka thënë qartë: “§ 8. Metoda e shkrimit, e ndjekur në këtë punim në thelb është po ajo metodë, që e ka zbatuar Hahn-i (duke i bërë disa ndryshime atij të Dhiatës së re) e që përgjithësisht është zbatuar nga të tjerë në Gjermani e në Greqi, dhe i cili edhe mua më duket më i ploti e më i arsyeshmi.” Ndryshimet e veta Kamarda i ka bërë sepse shkronjat greke të modifikuara duheshin prerë posaçërisht për shtypshkronjat italiane, kurse ndryshimet e tij e bënin më të lehtë shtypjen në Itali. Për shembull, ka hequr epsilon-in me vizë poshtë, ka he-

qur 's' greke me dy pika sipër dhe 'g' me pikë sipër. Vetë J. G. Hani i kishte hequr katë shkronja greke me pikë sipër të Dhiatës së re dhe kishte përfshirë 'j' latine me këtë rol. Ky ka qenë argumenti i përhershëm teknik kundër shkronjave greke, të cilin Kamarda na e ka formuluar qartë për herë të parë. Gjëja më interesante është se Kamarda është interesuar edhe për shkrimin e fjalëve me trajta të gegërishtes, të cilat i gjente te Hani. Prandaj për "n hundore", që Hani e kishte me një pikë sipër, ka gjetur zgjidhje të thjeshtë teknike për shtypshkronjën, duke vënë pas një apostrof dhe jep si shembull trajtën  $\alpha\upsilon\sigma\zeta\tau$  = ansht = asht.

Po ashtu si De Rada, edhe Kamarda ka ndryshuar qëndrim dhe nga viti 1867 e më pas ka zbatuar alfabetin latin në botimet e veta, për shembull edhe në "Gramatikën e vogël" (Grammatichetta). Përveç faktorit të përgjithshëm, me të cilin shpjegova kthesën e De Radës, këtu duhen shtuar edhe dy pika. Së pari, veprën e vitit 1864 Kamarda e shkroi me një njohje të mirë jo vetëm të përkthimeve të Dhiatës së re nga V. Meksi, por edhe të ndikimit që pati ai përkthim në alfabetin e përdorur prej Hanit e Bopit, siç është shtjelluar më lart. Së dyti, besoj se menjëherë pas kësaj ka pasur ndikim botimi i përkthimeve të K. Kristoforidhit, praktika e tij për të përdorur dy alfabete.

Së fundi, më 1874 gjejmë dy shkronja greke te B. Bilota për: *dh*, *th*. Nga botimet e sotme të shkrimeve të F. A. Santorit, bie në sy se edhe ai i ka përfshirë këto dy shkronja pothuaj të pashmangshme të greqishtes.

### *Shekulli XIX*

Shkatërrimi i pashallëkut të Ali Pashës dhe shfaqja e imperializmit grek, që gjeti shprehjen e përqendruar te Megali Ideja, sollën pasoja të ndjeshme në gjendjen e dygjuhësisë dhe të ecurisë së mëtejshme të shqipes së shkruar. Gramatika e Jan Vellarait dhe botimi i Dhiatës së re shqip e greqisht më 1827 ishin përftuar në rrethanat e veçanta të fillimit të shek. XIX dhe kurrë nuk do të bëheshin të mundshme më pas. Nga ana e politikës greke jo vetëm nuk do të pëlqehet mbështetja e shkrimit të shqipes qoftë dhe me shkronja greke, por do të ndërmerreshin të gjithë hapat shtetërorë e fetarë që shqiptarët të mos e shkruanin gjuhën e tyre e, mundësisht, as të mos flisnin më shqip. Është e natyrshme që kjo trysni do të shkaktonte reagimin e kulturës shqiptare. Ecuria e mëtejshme e shekullit XIX do të quhej zhgënjimi hap pas hapi i shqiptarëve nga kultura bashkëkohore greke, pa e humbur adhurimin për shkëlqimin e Greqisë së lashtë. Rrjedhimi i drejtpërdrejtë do të ishte edhe ndryshimi i qëndrimit hap pas hapi ndaj vetë alfabetit grek. Ndërkaq, u ngjiz e mori krahë edhe Rilindja Kombëtare e shqiptarëve. Abetarja e Naum Veqilharxhit ishte pikërisht pjesë e këtij reagimi, duke e mënjanuar alfabetin grek qoftë dhe me një alfabet të shpikur. Por mbishkrimet greqisht për nevojat e kishës ortodokse janë të pranishme gjatë gjithë shekullit në territorin e Shqipërisë së sotme, duke nisur nga viti 1811 në ikonostasin e kishës së Shën Kollit në Vanaj të Myzeqesë, e deri në kambanaren e vitit 1877 në Voskopojë. Në

artoforin e Ardenicës kemi të shkruar: “Me dorën e Apostolit të birit të Jakovit Elbasanasit.” Madje I. Zamputi ka njoftuar<sup>28</sup> për një dorëshkrim bektashian, në të cilin është përdorur alfabeti i greqishtes për të shkruar shqip, greqisht dhe turqisht. Kodiku i kishave të Rëmbecit (Korçë) është mbajtur greqisht nga viti 1815 deri më 1902.

Rilindas të shquar kanë hartuar e botuar vepra greqisht jo vetëm të drejtuara botës së huaj, por edhe vetë shqiptarëve që e merrnin kulturën e shkruar greqisht. Edhe N. Veqilharxhi abetaren e vet e ka titulluar greqisht (Neon alvanikon alfavitacion, 1844), po ashtu si do të bënte Mitkoja për “Bletën” e vet. Më pas do të jenë N. Frashëri (shih më poshtë) dhe Asdreni që do të shkruajnë poezi greqisht, ky i fundit në vitin e pavarësisë (vjersha *Ti mitri Albania, Tafi i roon*). Sipas Dh. Shuteriqit,<sup>29</sup> me alfabetin grek janë shkruar 2 përmbledhje këngësh të vjetra elbasanase: njëra e vitit 1858 dhe tjetra e vitit 1877 nga anëtarë të familjes Papajani. Viti 1858 është viti i ribotimit të dështuar me shkronja greke të Dhiatës së re nga Shoqëria Biblike e Londrës. Po ashtu, Dh. Shuteriqi njofton se Kostë Cepi rreth vitit 1820 ka kopjuar shkrimet greqisht e shqip të Kostë Beratit në një kodik vithkuqar. Nga Kostë Berati që nga viti 1764 njihen me alfabetin e greqishtes disa lutje, një vjershë e përshtatur, disa faqe përkthime dhe fjalori greqisht-shqip e një fjalorth i vogël greqisht-shqip. Thuhet se Ikonom Nikolla Postenani (1748-1838) kishte përkthyer himnet triadike dhe në kishë e lexonte ungjillin shqip, duke përdorur alfabetin e greqishtes, të plotësuar me germa latine.

Kurse familja Popa, përsëri sipas Dh. Shuteriqit, pas familjes së Dh. Todrit ka qenë e dyta, që e ka shkruar shqipen me alfabetin e greqishtes në fund të shek. XVIII e në gjysmën e parë të shek. XIX në Elbasan. Vërehet se edhe kur kanë përdorur alfabetin e veçantë të Todrit, ata ndonjëherë e kanë përfshirë ndonjë shkronjë greke, të ndikuar nga praktika e përditshme për të mbajtur greqisht marrëdhëniet tregtare dhe llogaritë. Në dorëshkrimet e tyre dalin me shkronja greke emra të përveçëm, si p.sh. Stavre Gjata (1776), Anastas Maleshova (1837), Semani (1853), Gavrill D. Tirana (1885) etj.

Dy ngjarje e kanë ristrukturuar gjithë diskutimin për alfabetin e shqipes në shekullin XIX: botimet e Kristoforidhit dhe Alfabeti i Stambollit. Këto nuk ishin pjesë të një debati, por fakte historike. Shkrimet e përkthimet e Kristoforidhit nuk perceptoheshin si dukuri me peshë vetjake, por si praktika që mund të kishin fuqinë për të përcaktuar zgjidhje të përgjithshme të qëndrueshme. Alfabeti i Stambollit nuk ka nevojë të komentohet për peshën e tij, që me një fjalë të sotme mund ta quaja institucionale. Nuk është vendi këtu, që të hyj më tej në debatin interesant midis autorëve arbëreshë dhe të arbëreshëve me shqiptarët e brigjeve lindore të Adriatikut lidhur me Kristoforidhin e me Alfabetin e Stambollit, sepse po e përsëris, që prej asaj kohe nuk do të ishte e drejtë të flitej veçan për arbëreshët, domethënë të shkëputur nga rryma e përgjithshme shqiptare rilindëse.

Jani Vretoja (1822-1900) me punën e vet vlen si një pasqyrë e ecurisë së qëndrimeve ndaj alfabetit grek



gjatë shek. XIX, ashtu si e përmenda paralelisht me Dh. Kamardën. I mori mësimet e para greqisht dhe kur ishte në Zosime të Janinës, përpara se të vinte atje Kristoforidhi, nisi të shkruante edhe shqip me alfabetin e greqishtes (një vjershë për Skënderbeun më 1847). Po me atë alfabet, sipas shembullit të S. Ikonomit, hartoi e botoi më 1866 një gramatikë të greqishtes së re, hartuar shqip. Sipas M. Domit,<sup>30</sup> alfabeti i greqishtes ishte i përzier me 9 shkronja latine dhe me dy të tjera me shenja diakritike. Po ashtu si Kamarda, ai i përmbahej tezës për afrinë e posaçme të shqipes me greqishten, porse pothuaj si Dhanil Voskopojari kërkonte që shqipja të braktisej dhe prej shqiptarëve të përvetësohej greqishtja si themeli i gjuhëve të botës. Me të drejtë Dh. Shuteriqi e ka quajtur një mendim në thelb filohelen kundër lëvrimit të shqipes. Pikërisht këtu e ka zanafillën ashpërsia e kundërvënies së atdhetarëve shqiptarë ndaj alfabetit grek: përqaftimi i atij alfabeti nënkuptonte braktisjen e shqipes dhe asimilimin.

Pak vjet më vonë J. Vretoja do të informohej nga Kristoforidhi për Komisionin e alfabetit në Stamboll, siç e përmenda në punimin e parë të këtij libri, ndërsa pastaj do të merrte pjesë edhe vetë në diskutime më 1872. Aty ai mbështeti alfabetin mbi bazën e shkronjave greke. Duke këmbëngulur te parimi një tingull – një shkronjë, e pa të nevojshme që plotësimi të bëhej me shkronja latine: *b, c, d, e, l, s, j*. Këtë parim e quante themelor edhe S. Frashëri e me këtë shpjegohet edhe ndërlikimi i të dy emrave lidhur me autorësinë e alfabetit të Stambollit. Besoj se rrahja e pikëpamjeve me rilindësit e tjerë e shtrëngoi Vreton të bënte ndryshi-

me në qëndrimet e veta më 1877 dhe 1878, por hija e qasjeve të mëparshme nuk iu nda dhe ia përcolli atë hije pjesërisht gjithë alfabetit të Stambollit, si e dëshmojnë shprehjet e rrepta më vonë të Th. Mitkos e të disa të tjerëve. Më duket se këtu nuk duhet përjashtuar edhe ndikimi vetjak i Kristoforidhit dhe i botimeve të tij, meqë e kemi të dëshmuar vlerësimin e tij për elbasanasin e njohur. Edhe në diskutimet e gjera që përfunduan më 1879 Vretoja është paraqitur me alfabetin grek të përzier, prej të cilit 7 shkronja u përfshinë në alfabetin e Stambollit. Ato krijuan edhe vështirësi teknike e, mund të them, e bënë të nevojshme një marrëveshje të re pas 30 vjetësh. Por ironikisht frymëzimi shovinist grek e ka dënuar më pas Vreton dhe mitropolitin ortodoks i Gjirokastrës e shkishëroi, sepse kishite kryer herezi duke ngjallur çështjen shqiptare.

Vetëm një vit më parë, më 1878, Vretoja kishte botuar *Apologjinë* greqisht, ku përsëriste edhe etimologjitë e hamendësuarra për fjalë të mitologjisë greke që kinse shpjegoheshin vetëm me gjuhën shqipe. Greqizmat e kota dhe kalkimet e pakëndshme prej greqishtes kanë qenë e meta më e rëndë e gjuhës së tij, e cila sot shpesh është e palexueshme, krejt ndryshe nga shumica e bashkëkohësve të tjerë të tij. Punimin e rëndësishëm për shkrimin e shqipes, mbetur dorëshkrim, i cili ka shërbyer si burim edhe i gabimeve të përsëritura në historinë akademike, Vretoja e hartoi greqisht dhe prandaj u bë i njohur në përkthim tri të katërta shekulli më vonë. Ndër të tjera, ai arrin në përfundimin e dyfishtë: “Për këtë arsye alfabeti i shqipes formohet në dy stile: grek dhe si plotësues ai latin, ose në

atë latin, në qoftë se merret si bazë stili latin dhe si plotësues ai grek.”

Për shkak të vendit me peshë që zë puna shumëplanëshe e K. Kristoforidhit dhe dukuria e veçantë në punën e tij njëkohësisht me dy variante të shqipes së shkruar dhe dy alfabetetë të dalluara, asaj i kushtohet punimi i veçantë këtu për *alfabetet e Kristoforidhit*.

Pothuaj bashkëmoshatar me J. Vreton, ndonëse vdiq dhjetë vjet përpara tij, ka qenë Thimi Mitkoja (1820-1890). E mori arsimin fillor në shkollën greke të Korçës, por nuk e plotësoi më tej. Pati lidhje të dendura me miqtë e letrave dhe duke e njohur praktikën e pranishme, sidomos atë që e ndoqi gjatë Kristoforidhi, në fillimet e veta ishte për ta shkruar toskët shqipen me alfabetin grek dhe gegët me alfabetin latin. Dihet se ka nisur të botojë greqisht që më 1859. Te “Disa shënime rreth Korçës” ka përmendur dhe kodikët greqisht të kishave. Edhe ai ka rënë pre e modës diletante për të gjetur fjalë, të cilat i quante greko-shqiptare të lashta, duke i shpjeguar etimologjikisht nga shqipja.

Ndikimin më të madh e më të parë Mitkoja e ka pasur nga Dh. Kamarda, për pasojë, edhe ka përshtatur alfabetin e tij. Në një letër drejtuar atij në dhjetor 1871 ka shprehur interesim të gjallë për botimet e Kristoforidhit dhe e ka vënë veten në rolin e një ndërlidhësi për të arritur qëndrime të përbashkëta, duke përfshirë edhe P. Kupitorin. Pikërisht aty ka paraqitur me formulim të qartë dëshirën thelbësore të shqiptarëve të kohës kudo që ishin: “Puna më e mirë do të ishte të kishte vetëm një metodë shkrimi, në mënyrë

që të nguliteshin shkronjat.” Këtu dhe gjetskë vëmë re te ai një praktikë jo të rrallë për periudhën: fjalë e shprehje të ndryshme të shqipes shoqërohen me përgjegjëset prej greqishtes. Me këtë nënkuptohet se si autorët e shkrimeve ose letrave, edhe marrësit ose lexuesit e tyre e njihnin mirë greqishten dhe e kishin mjet shpjegimi sipas nevojave. Po e vë në dukje këtë fakt, sepse ai na jep shpjegimin përse edhe në dorëshkrimet e fjalorëve të shek. XIX greqishtja del si mjet shpjegimi. Pak më shumë se një vit më vonë Mitkoja i ka dërguar një letër Kristoforidhit (më 25 mars 1872), të cilën e kam botuar prej kohësh. Këtu dua të ritheksoj ngulmimin e tij për bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet lëvruesve të shqipes, pavarësisht nga pakënaqësitë e rastit. Dhe kjo vlente dhe për alfabetin: “... dhe vetë kam qenë i këtij mendimi shumë vjet më parë, se gjuha jonë duhet të shkruhet, qoftë edhe me shkronja greke për arsye ekonomike dhe për hir të lidhjeve të ngushta midis këtyre dy gjuhëve, shqipes e greqishtes.” Rrjedhimisht, alfabetin grek të përshtatur Mitkoja e shihte si një zgjidhje për shkak të disa rrethanave, por nuk ishte i mbërthyer pas tij si Vretoja dhe këtu fshihet dallimi e kundërvënia me J. Vreton. Më 17 maj 1877 ndër të tjera i ka shkruar Th. Kreit: “Shtypshkronja që do të ngrihet në Misir të jetë vërtet me shkronja helene, por ato duhet të plotësohen me shenja e shkronja të posaçme, që t’u përgjigjen kërkesave tingullore të gjuhës sonë.”

Qasja e Mitkos ndaj alfabetit me shkronja greke del kështu elastike dhe në evoluim, por kryesorja është se ai përpiquej të mënjanonte frymën helenizuese

që mund të përcillte ajo zgjidhje. E gjithë Parathënia e “Bletës” përshkohet thellë nga kjo ide. V. Dodani (si të thuash, një dishepull i Mitkos) në kujtimet e veta shumë të njohura, ka prekur trajtat e emrave të përveçëm dhe ka nxjerrë në pah se bashkë me Mitkon i është kundërvënë praktikës së J. Vretos, që i jepte trajtat sipas greqishtes. Mitkoja me Dodanin ishin për: *Babillonia*, *Trasibuli*, *Kartaxhena*, *Sicilia*, domethën për trajta më afër atyre europiane, dhe kundër kopjeve helene: *Vavillonia*, *Thrasivuli*, *Karqidhonia*, *Siqelia*.

Veprën e vet madhore Th. Mitkoja e botoi me alfabetin grek të përshtatur. Gjithë kopertina është greqisht, me përjashtim të fjalëve “Bëleta shqipëtare”. Me këtë autori tërhiqte vëmendjen jo vetëm të shqiptarëve që e njihnin greqishten, por edhe të botës së huaj e në veçanti të albanologëve, marrëdhëniet me të cilët kanë qenë të dendura dhe tejet bujare nga ana e tij. Nuk mund të pritej një zgjidhje tjetër prej tij dhe prej shqiptarëve të tjerë, që në fushën e gjuhës së shkruar ishin dygjuhësh. Letrën e cituar më sipër për Kristoforidhin ai e kishte shkruar greqisht. Që në numrin e parë të gazetës “Zëri i Shqipërisë” të A. Kulluriotit më 1879 Mitkoja ka botuar një artikull për çështjen shqiptare, ku ka kundërshtuar synimet gllabëruese greke. Ndër të tjera shkruan edhe se: “greqishtja madje nuk është as në gjendje t’i shkruajë drejt emrat e trimave shqiptarë [suliotë]”. Dihet se më 1881 ka shkruar një vjershë në të dyja gjuhët. Nuk ka nevojë për argumente të tjera, që të kuptohen fjalët e tij në Parathënien e veprës: “Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashkët, që i jep gjallëri popullit; sa për klasat më të

lart, le të mbetet greqishtja si gjuha më e përkryer dhe më e lëvruar.”

Përsa i përket më konkretisht alfabetit të zbatuar, përgjithësisht është pranuar se ka marrë atë të Dh. Kamardës. Më duket se çështja është pak më ndryshe. Në dorëshkrimet e tij para vitit 1868 ka përdorur alfabetin lartin. Ndoshta pastaj u ndikua edhe nga Kamarda e Kristoforidhi për të kaluar te shkronjat greke. Siç e kam treguar në fillim, rreth 20 shkronja të greqishtes mund të zbatohen për shqipen nga cilido që njih shkrimin grek dhe parimet e sistemit të tij. Mitkoja, ashtu si në greqishten përgjithësisht, e shënon “q” me një “k” përpara zanores palatalizuese dhe këtu nuk ka asgjë të veçantë. Nëse flasim për veçantë të alfabeve të autorëve të ndryshëm, vëmendja duhet të përqendrohet te disa shkronja e shenja themelore dalluese. Mitkoja e ka pranuar se mori tri shkronja latine, por nuk e përmend se ka ndjekur shembullin e tjetërkujt. Në dorëshkrime dhe në letra të ndryshme Mitkoja ka përdorur sipas rastit alfabetin latin të përzier me një dy shkronja greke dhe po kështu njoftojnë kërkuesit lidhur me dorëshkrimin e tij, që është quajtur i Pragës.<sup>31</sup> Këtu, si të thuash, kemi pasqyrën e kundërt: në vend të një alfabeti grek me tri shkronja latine, kemi një alfabet latin me tri shkronja greke (δ, ε, θ). Në një dorëshkrim të fundit ka pranuar alfabetin e G. Majerit, meqë kurdoherë synonte që të lehtësonte botimin e thesareve të folklorit shqiptar.

Me interes të veçantë është puna e tij për Fjalorin e gjuhës shqipe. Që në janar 1868 i shkruante Kamardës, se do të ishte një punë e vlefshme të nxirrej një

gazetë shqip dhe të të bëhej një fjalor shqip e greqisht. Në letrën që kam botuar, dërguar Kristoforidhit në mars 1872, përmend se kishte mbledhur disa fjalë shqip dhe ishte i gatshëm t'ia dërgonte. Së fundi, i ka shkruar G. Majerit në nëntor 1886 se lënda kishte nevojë të përpunohej, pasi e ndiente vetë se nuk i kishte njohuritë për një punë me cilësi. J. Buloja<sup>32</sup> ka gjetur në Egjipt dorëshkrimin dhe pati mirësinë të më jepte fotokopje të disa fjalëve nga shkronja K. Fjalët e shqipes janë përkthyer greqisht dhe janë shoqëruar me trajta gramatikore, me sinonime dhe me shembuj përdorimi. Jep variante të ndryshme, ndërmjet tyre edhe nga gegërishtja. Ka cituar P. Budin me përpikëri, p.sh. "Maa e mbrapëna kafshë, qi i goditet gjithë kuujnaaj mbë këtë jetë (bd. 129)" te fjala 'kodit'. Pastaj shton se ai dhe toskët thonë "I gjan, i ra, i qëlloj një punë." Te 'klithas' jep edhe: *gërthas, grithas, klithënja, klitha, klithurë, këlthas, këlthet, këlthet, klith*. Më pas shton si shembull një përkthim nga Bibla (Ezekieli): "Do të jetë një klithm' e madhe, që nuk' është bërë kurrë." Nga shqyrtimi më del se përsëri ka marrë alfabetin e Kamardës, sidomos ka shtuar "b, d, j" latine mes germave greke e përdor "j" për dyshkronjëshat: *nj, kj, lj*. Dallimet janë të vogla: dy "rr" greke, ndryshe nga Kamarda, dhe "i". Shkronjat kështu anojnë nga Fjalori i Kristoforidhit, por lënda nuk e ka arritur shkallën e përpunimit të tij; gjithsesi, në tërësi do të sillte gjëra të reja po të botohej.

Pakënaqësia ndaj J. Vretos u shndërrua te Mitkoja në kundërvënien ndaj alfabetit të Stambollit, të cilin e ka quajtur pikërisht fantazi të Vretos. Aq keq ishte

prekur në këtë pikë, sa në një vjershë në tetor 1879, kur tashmë alfabeti ishte miratuar, Mitkoja shkruante se ne, shqiptarët “shkronja të gjuhës s’kemi”. Gjithashtu është shprehur, se si alfabet kombëtar më mirë do të kishte qenë ai i Dh. Todrit. Por më pas i ka zbutur këto qëndrime. Në një artikull të 24 majit 1889 në gazetën e A. Kulluriotit e ka përmendur mallkimin e patriarkut grek kundër alfabetit të Stambollit. Përfundimisht, në një letër De Radës më 1888 ka pranuar që: “Le të përhapet njëherë, pa mund të ndreqet pastaj.”

Samiu dhe Naimi gjithashtu ndoqën mësimet në gjimnazin e njohur Zosimea të Janinës, domethënë edhe ata, ndonëse myslimanë, e njohën mirë alfabetin e greqishtes dhe ky fakt mjafton për të mënjanuar pohimet e thjeshtëzuara, se zgjedhja e alfabeteve ka ndjekur përkatësinë fetare. Dëshiroj t’i shtoj kësaj edhe faktin tepër të njohur, se madje Naimi ka botuar greqisht më 1886 “Dëshirën e vërtetë të shqiptarëve” drejtuar opinionit grek, kurse edhe shumë vjet më vonë ka shkruar një vjershë të gjatë për dashurinë pikërisht greqisht (*O eros*, 1895). Dihet adhurimi i tij për letërsinë e vjetër greke, që e çoi te përkthimi i një pjesë prej “Iliadës”.

Samiu ishte shprehur kundër dyshkronjëshave të “Gjuha shqip” botuar në “Alfabetaren” më 1879 dhe zgjidhjen e pranuar e ka shpjeguar qartë në radhët e mëposhtme:

Vërtet shkronjat e llatinishtesë janë aqë të paka, sa jo për gjuhët tënë, që ka kaqë zërra, po edhe për gjuhërat e Evropësë nukë janë mjaft. Evropianët për të mbushurë ato të pakatë, shkruajnë nga dy shkronja, e i këndojënë të dyja bashë, po kjo është një punë e rëndë e e mërzhiturë. Kësaj i desh gjëndurë një udhë.



Përmi këtë shumë njerëz janë menduarë, edhe shumë udhëra kanë gjeturë, po nonjë nukë ka qën' e leht' e e pëlqyerë sikundrë duhetë. Këtë herë që u duk nevojt' e madhe për të shkruarët të gjuhësë sanë, këtë her' u gjënt edhe një udhë shumë e leht' edhe shumë e mirë: Muarmë të njëzet e pesë shkronjatë llatinishte, u dhamë cave nga ato një këndim pas nevojës së gjuhësë sanë, edhe nga të njëmbëdhjetat' e tjera ca i bëmë prapë nga ato shkronja, duke ndërruarë pakë fytyrë-në, ca i muarmë nga greqishtja, që është' edhe ajo një nga motërat' e vjetëra të gjuhësë sanë, si edhe llatinishtja.

Arsyetimi teknik është i shkoqur, por nuk janë përmendur aspak diskutimet e gjera, është kaluar butë gjithë ndërlikimi kulturor e historik prapa kësaj zgjidhjeje.

Gjithçka është shtjelluar hollësisht deri këtu shërben për të shpjeguar përse alfabeti i Stambollit i vitit 1879 ka përfshirë edhe 6 shkronja të greqishtes dhe arsyeja nuk ka qenë thjesht nevoja për të gjetur shkronja njëshe, domethënë për të mënjeluar dyshkronjëshat. Ky mënjanim mund të arrihej me ndihmën e shenjave diakritike, siç është arritur përfundimisht te "ë" dhe "ç". *Alfabeti i Stambollit ishte zgjidhje kompromisi, një kompromis që theksohej duke e quajtur "alfabet kombëtar". Ai ishte hapi i fundit, përpara se të arrihej shkëputja vendosmërisht nga alfabeti grek.*

Kongresi i Manastirit u bë në një periudhë, kur kompromisi i kishte ardhur fundi. Paskëtaj nuk do të ishte më nevoja, që sa herë paraqitej tabela e cilitdo alfabet të shqipes, të jepeshin edhe shkronjat greke përgjegjëse. Për shembull, më 1889 ka dalë një botim i librit të parë të Biblës toskërisht, i shtypur në Bukuresht. Është përkthim i Kristoforidhit, historinë e të cilit nuk do ta jap këtu, i kthyer në alfabetin e Stambo-

llit. Ky libër dëshmon se alfabeti i Stambollit u pranua edhe në shkallë ndërkombëtare, përderisa Shoqëria Biblike e Londrës vendosi të hiqte dorë nga alfabeti grek në variante të ndryshme, përdorur në botimet e saj që prej vitit 1824. Këtu krahas alfabetit shqip jepen edhe alfabeti i frëngjishtes, edhe alfabeti i greqishtes. Mirëpo gjithsej pesë vjet më parë te shtypja e po këtij përkthimi, alfabeti ishte botuar vetëm me shkronjat greke, shoqëruar me shpjegime greqisht, kurse dhjetë vjet më parë shoqërohej edhe me shkronjat e arabishtes, që i shërbenin turqishtes osmane. Dëshmohet kështu një tërheqje hap pas hapi, deri te mënjanimi i plotë i tabelave të tjera.

E vlen të vihet në dukje edhe një fakt i vogël domethënës. Më 1889 thuhet “abëcëja”. Ndonëse edhe sot ne shkruajmë “alfabeti”, kjo perceptohej qartë në atë periudhë kur e njihnin gjerësisht greqishten, si fjalë e ndërtuar nga emërtimi i shkronjave të para të greqishtes (alfa dhe beta), prandaj u krijuan variante të tjera (edhe: *abecëja*, *abëja*), mjafton që të mos dilnin shkronjat e greqishtes në atë term. Paralelisht me këto kanë ndodhur edhe ndryshimet e termit “abetare”. Kristoforidhi më 1866 në botimin e parë gegërisht e ka “Abetar”shqip, për toskërishten e ka “Allfavitar”, ndërsa botimi i Shoqërisë së Stambollit quhej “Alfabetare”.

Ndërkaq, është i papranueshëm pohimi i T. Osmanit, se P. Vasa hoqi dorë nga alfabeti i Stambollit dhe të njëjtën gjë bëri edhe K. Kristoforidhi. Ky i dyti nuk kishte botuar gjë ndonjëherë me alfabetin e Stambollit, që pastaj të hiqte dorë prej tij, prandaj thënia e mësipërme qëndron vetëm për Pashko Vasën, i cili për më

tepër kishte qenë pjesëmarrës në veprimtarinë e gjerë për alfabetin e shqipes prej kohësh dhe kurdoherë ishte shprehur për alfabetin latin. Ndër ata që nuk e pranuan qenë Kamarda, Mitkoja, De Rada, përgjithësisht nuk u ndoq në veriperëndim të vendit, ndërsa gjeti mbështetje të madhe në Shqipërinë e Mesme dhe veçanërisht te beljerët e myslimanët e Tiranës. Kundërvënie të ashpër ka shprehur F. Konica<sup>33</sup> te shkrimi “Abetari shqip”, ku madje shkronjat greke përpiqet t’i paraqesë në radhë të parë si shkronja sllave. Aty flet edhe për alfabetin e vet alternativ, të cilin e quan shumë të afërt me alfabetin e “Bashkimit”. Më pas ka shprehur pakënaqësi ndaj tij edhe Aleksandër Xhuvani.

### *Arbëreshët e Greqisë*

Formësimi i shovinizmit grek ortodoks si strategji shtetërore solli pasoja të thella në gjendjen e shqipes në Ballkan. Pa kaluar një dhjetëvjeçar pas entuziazmit me pjesëmarrjen e arbëreshëve në Revolucionin Grek, kur u kujtua se mund të flitej shqip në parlamentin grek, shqipja përfundoi në statusin e gjuhës së ndaluar në komunikimin publik, domethënë as që mund të përmendej shkrimi i saj. Kthesa ishte politike, sepse nuk kishte të bënte me ndryshime në popullsi. Po përmend vetëm njoftimet e paanshme të dy dëshmitarëve të kohës. Th. Gordoni më 1832 shkruante, se arvanitët nuk e kuptojnë greqishten dhe e flasin me një theks të fortë. D. Hartley më 1833 thoshte se gjuha

shqipe është gjuha e përditshme dhe gratë në përgjithësi nuk dinin greqisht.

Ndonëse ne e përdorim njësoj termin “arbëresh”, nga këndvështrimi i shkrimit të shqipes ka dallime të ndjeshme ndërmjet arbëreshëve të Italisë dhe arbëreshëve të Greqisë. Për ta ndriçuar më mirë këtë anë, e vlen të dallohen tre grupime. Grupimi i parë lidhet me atë, që do ta quaj **çështja shqiptare në Greqi**. Duhet mbajtur para sysh një fakt gjeopolitik: shteti grek gjatë shek. XIX nuk përfshinte aspak kufijtë, që do të arrinte në prag të Luftës I Botërore; mjafton të sillet ndër mend se deri atëherë Selaniku nuk ishte qytet i saj. Prandaj nga njëra anë, rilindësit shqiptarë në fillimet e lëvizjes kombëtare nuk e perceptuan këtë kthesë, sepse ishin të përqendruar te katër vilajetet, të cilat mendonin se do të mbeteshin të paprekura në projektet e ardhshme. Ata vazhdonin të shkonin në gjimnazin Zosimea të Janinës, i cili nuk ishte në territoret e shtetit grek. Anasjelltas: te arvanitët e Greqisë së asaj periudhe u përkundën shpresa bashkë me zgjimin kombëtar shqiptar dhe u përftua përpjekja për t’u bashkuar me të. Kujtohej se roli i arbëreshëve në Itali dhe në Greqi do të ishte i njëjtë dhe me këtë mendje u veprua. Në këto rrethana nuk u perceptua se kishte një çështje shqiptare në shtetin e ri grek dhe mosdallimi i përshkonte edhe qasjet ndaj gjuhës.

Dëshminë më të mirë të mosdiferencimit e kemi te Anastas Byku (vdiq më 1878). Emri i tij lidhet me njërën nga të parat gazeta, ku janë botuar shkrime shqip: “Pellazgos”, e cila doli më 1860-1861 në Lamia. Në jetën dhe veprimtarinë e tij vërehet ndërlíkimi ka-

rakteristik për kohën. Ishte nga Lekli i Tepelenës, mbaroi si shumëkush tjetër Zosimenë e Janinës, punoi si mësues i greqishtes dhe botoi një abetare *Gramë për shqiptarët* (1861), e cila natyrshëm do të ishte me alfabetin e përshtatur të greqishtes. Edhe më 1878 bëri përpjekje për një gazetë tjetër greqisht. Nga njëra anë, ai ishte për zgjimin e shqiptarëve nëpërmjet lëvrimin të shqipes, por nga ana tjetër ushqente iluzione për helenizmin dhe kërkonte mbështetjen e qarqeve zyrtare greke, ndërsa përjashtonte çdo alfabet tjetër për shqipen përpara alfabetit grek. Rrjedhimisht, ishte një rilindës shqiptar, por që punonte në Greqi, si të ishte arvanitas, dhe prandaj nuk la ndonjë gjurmë me punën e tij.

Krejt ndryshe paraqitet puna e Panajot Kupitorit (1821-1881), i cili ishte nga Hidra dhe mori arsim të vërtetë universitar në Athinë. Arriti të bëhej drejtor gjimnazi në Athinë dhe thuhet se mbante edhe një shkollë mbrëmjeje, në të cilën shqipja mësohej me alfabetin e greqishtes, e për të përgatiti një Abetare të gjuhës shqipe (1860), por nuk kam njoftime për mënyrën e shkrimit të saj. Përveç punimeve e artikujve të rëndësishëm greqisht, la në dorëshkrim edhe një Fjalor greqisht-shqip. Në nëntor 2006 studiuesi T. Johalasi, duke vijuar punën e tij shumë të frytshme, paraqiti në Athinë një vëllim për gjuhën e arvanitasve në ishullin Hidra dhe Fjalorin greqisht-shqip të Kupitorit. Tashmë mund të jepen disa mendime për këtë fjalor. Autori ka përshtatur alfabetin e greqishtes, duke përfshirë edhe disa shkronja latine: *b*, *d* (për ta dalluar nga "dh" që e jep me germën përkatëse greke), *e* për

“ë” (kurse ε për e), g, gj, h, j; ka përdorur dyshkronjësha: λj (lj), μπ (mb), γγ (ng), vj (nj), σs (sh), τσ (q). Shqyrtimi i leksikut shqip në Fjalorin e Kupitorit e vërteton më së miri, se ai punonte për shqipen përgjithësisht dhe jo për të folmet e arvanitëve. Me njohuritë që ka pasur, ka përfshirë edhe trajta të gegërishtes, të cilave u ka vënë shënimin përkatës; p.sh. *allonari*, *bredhësi*, g. *qershuri*; *lëmë*, g. *lanjmëma*. Përballë një fjalësi shumë të gjerë të greqishtes ka qenë i detyruar të ndërtojë shumë neologjizma vetjakë; po sjell si shembull vetëm disa me parashtesën pa-: *i pabëfardisurë*, *i padritësuarë*, *i padritësuar*, *i padhembshurë*, *i padhembshëm*, *i padhemburë*, *i paharuarë*, *i paharuam*, *i pahelmuarë*, *i pahelmuam*, *i pahidhëhurë*, *i paizendërlisurë*, *i palarë*, *i palajturë*, *i palathiturë*, *i palerë*, *i palejturë*, *i paliturgjisurë*, *i pamendësuarë*, *i panëmëruarë*, *panxerë*, *i papastruarë*, *i papërgërë*, *i pasbardhurë*, *i pasbardhëlluarë*, *i pasbërdhëlluam*, *i pasglidhurë*, *i pasharë*, *i pashtirë drita*, *i pash-trembuarë*, *i pashuajturë*, *i pathënë*, *i pavënë*, *i pavrerëtë*, *i paxëguarë*, *i pazgjesurë*. Kjo lëndë shërben për të njohur përpjekjet vetjake të autorit, por nuk e ka vlerën e leksikut të mbledhur nga përdorimi i gjallë, si në rastin e Kristoforidhit. Me keqardhje më duhet të shtoj, se nuk mbetet vend për vlerësimin e studiuesit të shquar të të folmeve të arvanitëve, drejtorit të Institutit të Gjuhësisë në Universitetin e Këlnit, Hans-Jürgen Sasse, se ky dorëshkrim: “Pavarësisht nga disa vështirësi në transkriptimin dhe nga mungesa e shënimeve për vendin e prejardhjes së disa fjalëve, nuk mund t’i mohohet kësaj vepre rëndësia si burimi leksikografik më i rëndësishëm për arvanitishten e shekullit të kaluar.”<sup>34</sup>

Kur po hapte faqen e re të përkthimeve shqip më 1865, A. Tomsoni iu drejtua agjentit grek të BFBS në Athinë, Kalopothakes, për t'i gjetur një redaktor. Ky i ka rekomanduar A. Kulluriotin me prejardhje nga Salamina. Mirëpo Tomsoni donte një redaktor nga Veriu i Shqipërisë, sepse puna ishte për një variant përkthimi të ri gegërisht. Prandaj Tomsoni i shkruante më 15 prill 1865, se do të kënaqej me Kulluriotin vetëm po të mos gjente tjetër njeri. Megjithatë i ka kërkuar që t'i propozonte të përgatiste një përkthim të Psalmeve në variantin jugor. Më 3 tetor 1865 Kullurioti i ka shkruar drejtpërdrejt Tomsonit. Pas dhjetë ditësh mori përgjigje prej tij (përmbledhjen e kam botuar më 2005 në librin për Kristoforidhin). I ka propozuar që t'u hyjë përkthimeve në shqipen e arbëreshëve të Greqisë dhe po të kishte sukses, do ta merrte në punë. Më 1866 Kalopothakesi kaloi në shërbim të Shoqërisë Biblike Amerikane dhe në vend të tij u caktua një Dewar, i cili e mori si ndihmës Kulluriotin për katër vjet. Edhe ky u largua dhe më 1870 detyrën e mori Kullurioti, të cilin atëherë nisën ta ndiqnin prelatët grekë. Ata ia arritën të ndërhyjnë te autoritetet osmane dhe e arrestuan më 1872 në Korfuz. E ndaluan të vijonte shitjen e librave të përkthyer të Biblës dhe, kur ai nguli këmbë për të drejtat si qytetar grek, policët ndërsyen turmën, e cila ia shkatërroi librat dhe ai mezi shpëtoi nën mbrojtjen e nënkonsullit britanik.

Edhe A. Kullurioti (1822-1887) lindi në Athinë, por gjithashtu veproi si rilindës shqiptar, madje u përfshi në bashkëpunimin me BFBS si Kristoforidhi. Në vitet 1879-1880 nxori gazetën "Zëri i Shqipërisë"

me titull dhe lëndë greqisht, disa herë me shkrime shqip, duke zbatuar alfabetin e greqishtes. Ndryshe nga rasti i A. Bykut, kjo gazetë ka pasur peshë të madhe për lëvizjen shqiptare dhe për lëvrimin e shqipes. Gazeta e përmendi punën për alfabetin e përbashkët të shqipes në Stamboll dhe iu kundërvu atyre, që propagandonin se “shqipja nuk ka një gjuhë letrare dhe si e tillë nuk ka çfarë t’i duhet alfabeti latin, por i duhet alfabeti grek.” (3 nëntor 1879). Përveç një përkthimi shqip, ai ka përgatitur edhe një Alfavitari dygjuhësh për shqipen (1882) me alfabetin e greqishtes. Nga njoftimet e reja, që solla më lart, shpjegohet edhe diçka tjetër. Dh. Shuteriqi (*Autorë dhe tekste*, 1977, f. 336) përmend një fletore të tij me këngë folklorike dhe vjersha të vetat, të cilat në faqet 91-109 midis radhëve shoqërohen me përkthimin anglisht. Përkthimi lidhet me bashkëpunimin e Kullurioti me Shoqërinë Biblike dhe ai e dinte anglishten. E njëjtte fare mirë edhe punën e Kristoforidhit me dy alfabete dhe, po të kishte pranuar propozimin e Tomsonit për të bërë përkthime në të folmen arbëreshe, do t’u përmbahej alfabeve të Shoqërisë Biblike. Tashmë ishte periudha pas alfabetit të Stambollit, prandaj në nr. 39 të gazetës së vet Kullurioti ka botuar një alfabet të vetin me 24 shkronja greke dhe me sajesa të vetat për 8 shkronja të tjera. Ndërsa te varianti me shenja latine ka përdorur dyshkronjësha, por jo me depërtim të qartë në problemet e marrëdhënive tingull-shkronjë. Kështu, te Kullurioti si të thuash, janë ndërlikuar mjaft nga rrymat e asaj periudhe për alfabetin dhe del se ai nuk ka pranuar as alfabetin e Stambollit, duke u



përfshirë në palën që përbëhet nga paraqitësit e alfabetëve vetjake.

Përpyekjet e këtij grupimi përfundojnë me shekullin XIX dhe shuhen gjatë shekullit XX. Por në shekullin XXI kemi përsëri një **çështje shqiptare në Greqi** nga pikëvështrimi i shqipes. Meqë del jashtë temës së këtij punimi, nuk do të zgjatem për të, por mbetet problem i madh se si do ta shkruajnë gjuhën amtare shqiptarët e sotëm në një vend europian, ku nuk zbatohen kërkesat e Bashkimit Europian për pakicat kombëtare. Ndërkaq, nuk mund të mos vë në dukje, se veçan nga përpyekjet për shoqëri, për shkolla dhe për gazeta shqipe nga ana e emigrantëve ekonomikë, tashmë për nevojat ekonomike dhe tregtare në Greqi shqip shkruhet gjithandej ku grekët kanë interes të tërheqin klientë shqiptarë, madje në qendër të Selanikut që nga vitit 2000 një njoftim për përkthimet në një tabelë në mes të sheshit, si gjuhë të dytë rendiste shqipen pas rusishtes dhe ishte shkruar me shqipe krejt të rregullt.

Grupimi i dytë lidhet me atë që simetrikisht do ta quaj **çështja arvanite në Greqi**.

Në gazetën greke "E ardhmja e atdheut" të datës 29 dhjetor 1860 është botuar një Thirrje me rastin e zgjedhjeve parlamentare në dy shtylla: greqisht dhe në të folmen arvanite të Atikës. Teksti shqip është paraqitur nga Androkli Kostallari me një manipulim antishkencor.<sup>35</sup> A. Kostallari e quan atë "dëshmi e rrallë e prozës letrare-publicistike në të folmen e arbëreshëve të Atikës." Sipas tij, në këtë tekst bie në sy "ndjenja e pastër e krenarisë dhe e dinjitetit të njeriut arbëror." Në të vërtetë, në atë tekst nuk ka asnjë lloj referimi

për arvanitët, ata thjesht shihen si zgjedhës grekë, domethënë kjo është dëshmi e politikës asimiluese, që nuk përfill prani bashkësish të tjera në vend, me përjashtim të trajtimit si objekt propagande kur i leverdis. Duke e lënë mënjanë përmbajtjen propagandistike me demagogjinë e njohur të fushatave elektorale, e quaj të domosdoshme të tërheq vëmendjen se ky është një tekst i përkthyer. Ai është hartuar së pari greqisht dhe pastaj është gjetur një arvanit, që e ka përkthyer. Të gjitha vlerësimet hiperbolike të Kostallarit për gjuhën dhe stilin e tekstit kanë të bëjnë me origjinalin greqisht dhe pastaj duhet parë mjeshtëria e përkthyesit arvanit për t'i dhënë ato shqip. Asnjë lloj "bisede të drejtpërdrejtë, të çiltër, të ngrohtë me njerëzit e thjeshtë arbëreshë" nuk ka aty. Sintaksa është tërësisht e greqishtes. Sa për leksikun, mjafton një nga fjalitë e para: "progjismë tiragnomë, apoktismë eleftherinë, ishtë shumë e madhe lipon vlastimi ndë kaj gjaku të mos jemi ikano për lefteri." Përkthyesi ka ngecur edhe në fjalët më të zakonshme dhe, besoj, janë të meta të njohjes së tij dhe jo shprehje e gjendjes së arbërishtes, që në këtë rast do të ishte një hap nga shuarja e plotë në rrethanat e dygjuhësisë. Si përfundim, kjo Thirrje nuk ka asnjë lidhje me veprat e autorëve arbëreshë të Rilindjes dhe aq më pak nuk përbën "një dëshmi të përpjekjeve të tyre për ta shkruar e përpunuar këtë gjuhë si mjet kulture, si mjet zhvillimi e përparimi." siç shkruan po ashtu me një frymë propagande Kostallari, po ta marrim proagandën në kuptimin e saj më të keq.

E vetmja përpjekje pozitive në këtë rast është nxjerrja e disa veçorive të alfabetit. Është shfrytëzuar alfabeti i greqishtes, domethënë jo shkronjat por parimet e tij. Me interes është përfshirja e shkronjës latine “j” dhe paraqitja e tingullit “ë” me një epsilon me theks.

Ishte e kuptueshme se, duke u shkolluar si shtetas të Greqisë, arvanitët do t’i ndërmerrnin përpjekjet në kushtet e dygjuhësisë dhe sprovat shqip do të ishin me alfabetin e greqishtes. Një vjershë kushtuar Dora d’Istrias, botuar prej Dh. Kamardës, ka shkruar hidrioti Gjergj Driva (1870). Me shkronjat e greqishtes e ka dhënë shqipen në një vjershë (1886) Jani Botasi nga Specia. Vasil Dh. Rusi kishte lindur në Rumani, por mori arsim helen. Nxori në Bukuresht (1877) një libër leximi shqip, kushtuar djemve të vet, me titullin greqisht, që mund të përkthehet: “Pellasgjika – alfabet i thjeshtë shqip”, me alfabet të greqishtes, të përzier me disa shkronja latine, por në disa raste ka ndjekur edhe grafinë e rumanishtes. Gjuha është e ndikuar fort greqishtja dhe nuk ka vend për vlerësimin e tij, se ka bërë një alfabet origjinal. Bën pjesë ndër ato, që i quajta alfabete të dështuara.

Ndryshe nga çështja shqiptare, çështja arvanite nuk mund të shuhej në Greqi qoftë edhe për arsyen e thjeshtë, se nga radhët e arbëreshëve të Greqisë do të dilnin njerëz të shkolluar, të cilët do të ndërgegjësoheshin për vlerën kulturore e shkencore të traditave dhe të gjuhës së tyre. Për pasojë, ata bëjnë pjesë në grupimin e tretë.

Grupimi i tretë lidhet me studimin e të folmeve arvanite. Në këtë rast bashkësitë shqiptare në Greqi

dhe gjuha e tyre janë objekti i studimit, domethënë puna është si të pasqyrohen me shkrim të folmet e tyre për qëllime studimore. Para së gjithash këtu del problemi i ribotimeve dhe pastaj i regjistrimeve të sotme. Prandaj për këtë do të flas në pjesën për përdorimin shkencor të shkronjave greke. Gjithsesi, këtë pikë dëshiroj ta mbyll me qëndrimin e G. Majerit, i cili ndodhej përpara larmisë së alfabeve të shqipes në një kohë, që i duhej të përgatiste studimet e veta. Para së gjithash, ai iu drejtua alfabetit të K. Lepsiusit (shih në punimin më tej lidhur me K. Kristoforidhin), i cili gëzonte njohje ndërkombëtare. E zbatoi në studimet e veta dhe në transkriptimin e T. Kavaliotit. Te *Gramatika e shkurtër e shqipes* (1888) mori para sysh alfabetin e *Gramatikës* së Kristoforidhit dhe aty dalin 4 germa greke. Në veprën e tij madhore, *Fjalorin etimologjik të botuar më 1891 gjithashtu ka ndjekur alfabetin latin, por përsëri ka ndërthurur  $\delta$ ,  $\epsilon$ ,  $\theta$ ,  $\gamma$ ,  $\chi$ , sidmos për fjalët nga arvanitët. Holger Pedersen në përmbledhjen e tij të rëndësishme *Albanesische Texte mit Glossar*, botuar më 1895, e tregon se ka ndjekur alfabetin e G. Majerit, domethënë duke përfshirë pak shkronja greke sipas kërkesës së profesorit Brugman. Ai kishte menduar në fillim të shfrytëzonte vetëm shkronja latine të përshtatura e me shenja diakritike. Siç shihet, edhe gjuhëtarë të rëndësishëm europianë nuk e zbatuan alfabetin e Stambollit. Shpjegimi, sipas mendimit tim, është se nuk donin të përziheshin në parapëlqimet e autorëve shqiptarë, me të cilët kishin marrëdhënie të rëndësishme për punën e tyre, sepse si pasojë do të shkaktonte pakënaqësi të dëmshme për veten.*

Megjithatë, nuk mund të mos vë në dukje, se në këtë mënyrë ata e shtonin pësjtjellimin e alfabeve të shqipes para Kongresit të Manastirit.

### *Kundërshtimi i shkronjave greke*

Vështrimi shkencor na detyron të heqim dorë nga cilësimet me paragjytime të dukurive historike, cilësimet që i ndeshim te autorë të ndryshëm, nganjëherë me shprehje të skajshme.<sup>36</sup> Ndërkaq, edhe qëndrimet e politizuara do t'i nënshtrohen paraqitjes objektive, sepse janë pjesë e ecurisë së një dukurie shoqërore. Tashmë e kam vënë në dukje se në të katërtën e dytë të shek. XIX nisi një ndryshim rrënjësor në perceptimin e synimeve të kulturës ortodokse greke, aq sa erdhi dita kur qëndrimi negativ ndaj saj u njëjtësua me qëndrimin kundrejt kulturës së sunduesit osman. Si rrjedhim, ky qëndrim u bart edhe ndaj shkronjave greke e arabe. Në këtë punim nuk ka vend të merrem me alfabetet e tjera, prandaj do të shoh shkurt kundërshtimin e shkronjave të greqishtes. Alfabetet origjinale ishin shfaqja e parë ballore e këtij kundërshtimi. Çështjen e alfabetit të Kristoforidhit do ta zbërthej më poshtë, por edhe ai nuk u ka shpëtuar vërejtjeve të herëpashershme. Ndërkaq, edhe studiuesit e huaj deri në fund të shek. XIX nuk i janë ndarë alfabetit grek, duke i dhënë mbështetje një tradite. Intelektualët shqiptarë, për pasojë, ndodheshin në kushte të ndërlikuara, që të merrnin një qasje të prerë. Por me Kon-

gresin e Berlinit, me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe me përhapjen e alfabetit të Stambollit kundërshtimi erdhi e u bë gjithnjë e më i hapur, derisa shtypi shqiptar që mori hov, e ktheu në një temë debati dhe ishte pikërisht aty vendi për ta rrahur me termat karakteristike të gazetarisë.

Thelbin e qëndrimit e ka paraqitur në mënyrë të ngjeshur e tejet të kthjellët A. Z. Çajupi, aq sa mund të mos shtohet asgjë tjetër: "U themi pra allfabetave turqisht edhe greqisht: Ju jini shumë të interesatur në këtë çështje, ju kini qënë shkruarë në kartë me gjak në vend të mellanitë; keni qënë përdorurë më shumë herë të dëfteni gënjeshtrenë, grindjenë dhe paturpjenë; juve jini ngaja e ndarjesë dhe armiqësisë që ka hyrë ndë mes tonë, ashtu që nuku kemi besë mbë juve; më në fund nuku do të mundni të na mbani që të zgjedhim allfabetnë që duam ne; nuku kini nder të merrni pjesë ndë gjuhënë tonë." (gazeta "Shqipëria", Bukuresht, 31 gusht 1898).

Ngarkesa negative e shkronjave të greqishtes u rëndua në të katërtën e fundit të shek. XIX, sepse vepërimtaria greke u ushtrua haptas kundër shkollave shqipe dhe kundër shërbesave shqip në kishë. Gazeta e A. Kulluriotit "Zëri i Shqipërisë" në ato dy vite që doli nuk u step t'u kundërvihet hapur atyre, të cilët e quanin shqipen gjuhë të prapambetur dhe që i mallkonin shkronjat e saj jo greke, siç ishte rasti me enciklikën e mitropolitit të Gjirokastrës, Anthimidhin (5 janar 1880). J. De Rada te "Fiamuri Arbrit" më 20 gusht 1884 shkruante "disa klerikë të lartë në Korçë predikojnë në popull 'gjuhën e shenjtë greke', me qëllim që

të pengojnë shkrimin dhe hapjen e shkollave shqipe, por të gjitha këto veprime të ulëta të tyre do të dësh-tojnë." Më 9 tetor 1888 gazeta "Shqipëtar" shkruante për kërkesën e korçarëve që mesha në kishë të bëhej shqip dhe kryepriifti grek arriti ta përfundonte një meshë greqisht vetëm me xhandarë turq te dyert e kishës. Dhe shkrimi vijonte: "Shqipëtarët e kuptuan dhe e njohën, që mësimi në gjuhë të grekut nuku është as për nonjë fitim; djemtë e shkollës shqipe mbloodhë gjithë kartërat greqishte dhe në mes të pazarit u vunë zjarrë e i doqnë." Një varg mitropolitësh lëshuan mallkime kundër shkronjave shqipe: Qirili (1887), Grigori (1889), Fillareti (1892). Që më 1890 kur u bë drejtor i shkollës së Korçës, Petro Nini Luarasi nisi mënjanimin e alfabetit të greqishtes, duke e zëvendësuar me atë të Stambollit, dhe hyri në konflikt me dhespotin Qiril të Kosturit. Nuk ka nevojë për komente pamfleti i tij i njohur "Mallkimi i shkronjave shqipe dhe përfolja e shqiptarit", 1911, ku i përmendi me emër. "është shesh ç'bëjnë grekërit që të na humbasin gjuhën dhe kombësinë tënë dhe për këtë kanë dy armë: shkolla dhe kisha," shkruante 'Kalendari kombiar' më 1898.

Nuk mund të lihet në hije, se kundërshtimi ndaj alfabetit të greqishtes u shpreh nga pena e njerëzve me peshë në kulturën shqiptare të asaj periudhe. Përveç A. Z. Çajupit, disa herë ka dalë në faqet e shtypit Asdreni. "Ne i kuptojmë dhëlpëritë tuaj, që dyke shkrojtur shqiupen me shkronja greqisht të mbytet letërsia shqipe edhe Europa ta marrë drej për greqisht," shprehej ai te 'Toska' në prill 1902. Mihal Gra-

menoja shkroi komedinë me tre akte "Mallkimi i gjuhës shqipe" e gjithashtu mbi këtë subjekt hartoi një tregim sentimental me titullin "Var' i pagëzimit" më 1909, ku përsëri del po ai prift ortodoks: Dhespoti Qirill kërkon "të punojmë me çfarëdo mënyrë për të humbur këtë gjuhë, se këtu varet çështja e rrojtjes ose e vdekjes së Elinizmës." A. Xhuvani mori qëndrim të qartë për alfabetin latin dhe vinte në dukje: "... aqë pëngime që i vihen prej miqve që ka rreth e rrotull, të cilët na bëhen miq të dashur, që të na prishin punë, edhe me çdo farë mënyrë përpiqen t'i bindin shqiptarët duk'u thënë se i vetmi abetar që i përket shqipes është i tyri, domethënë me letra gërqishte." ("Albania", 1905, nr. 4) Një njoftim interesant jep Thoma Abrami në artikullin 'Mëmëdhetarërija dhe shqiptarët' ('Drita', 20 maj 1902): "Na çpiknë një ditare n'Athinë nën drejtimin e z-tit Thoma Haxhiut nga Konica, emëruar 'Astir-Ylli' dhe në të cilën shkruan edhe nga nonjë kollonë shqip me ca farë shkronja, a më mirë të them me ca farë shenja telegrafi, që duken si të shkelura zoqsh në baltë a në dëborë për të gënjyer shqiptarët se 'ja, ku Greqia po përpiqet për ju dhe do që të shkruhet gjuha shqip'. Gjepura pa kripë."

Pati e dhe një rrymë, e cila përballë pasojave tejshekuese të veprimtarisë mallkuese, do ta pranonte shkrimin e shqipes me alfabetin e greqishtes me shpresë se kjo do të shërbente si rrugë e asimilimit të mëvonshëm. Me këtë synim u pranua edhe botimi i Fjalorit të gjuhës shqipe të Kristoforidhit më 1904. Mirëpo ishte tepër vonë. "Shkopi" i Kajros më 1908 ironizonte "Të 120 këpucëgrisurit e Selanikut", domethë-



në 120 grekomanë shqiptarë, që u mbledhën në Selanik nën kryesinë e dr. Josif Adhamudhit (të cilin e ka ironizuar Çajupi) dhe kërkuan që shqipja të shkruhej me alfabetin grek. Ishte tepër vonë, sepse tashmë që nga vrasja e Papa Kristo Negovanit në shkurt 1905 me dhjetëra atdhetarë të tjerë shqiptarë patën të njëjtin fat. Kongresi i Manastirit u mbledh edhe nën ndikimin e thirrjes së atyre, që hynë në histori si “dëshmorët e abesë shqipe.”

### *Pas Kongresit të Manastirit*

Ishte e natyrshme që xhonturqit nuk do ta përkrahnin idenë e shqiptarëve për të mos u përfshirë në kombin e tyre “osman” dhe, për pasojë, nuk do ta prisnin mirë arritjen e Kongresit të Manastirit. Nuk i bënë buzë madje as bashkëpunimit me klerin grek, krahas fushatës tjetër për të imponuar alfabetin arab. Është e dokumentuar, se Patrikana e Stambollit dërgoi një urdhër në Durrës, që shqipja të mësohej me shkronjat greke.

Mëdyshja e lënë për zgjedhjen nga Kongresi i Manastirit nuk ka kaluar pa lënë gjurmë. Shfaqja më interesante e atij dyzimi ka qenë Abetarja për shkolla të para e Parashqevi Qiriazit, botuar në Manastir më 1909, ku janë përdorur të dy alfabetet te copa në dy faqe përballë njëra-tjetrës. Ajo qe edhe autorja e një vjershe në mbrojtje të alfabetit, ku janë edhe këto vargje:

*Armikët o shqipëtarë,  
Po përpiqenë  
Shkronjat turçe dhe greqishte  
Të na apënë;  
Le t'i mbajnë ata për vetëhe,  
Kemi tonatë.*

Mithat Frashëri nuk do të hiqte dorë ashtu fare thjesht prej alfabetit të Stambollit. Një krahasim del mjaft interesant. Më 1900 në Sofje punonte Shtypshkronja shqipe "Mbrothësia" e K. Luarasit dhe e K. Trebickës. Aty është botuar një përkthim i Lumo Skëndos me titullin "Bëje të mirën pa hidhe në det", nga autori Franc Hofman. Natyrisht, është përdorur për "ë" të madhe shkronja "B" sllave e përmbysur dhe po ajo e madhe jo e përmbysur për "DH". Po ashtu si në alfabetin e Stambollit është përdorur "p" për "rr". Një vit pas Kongresit, domethënë më 1909, po nga ajo shtypshkronjë ka dalë novela e M. Grame-nos "Varri i pagëzimit". Në kopertinë përmendet Korça, kurse në fund shtypshkronja "Mbrothësia" shënohet në Selanik. Është ruajtur "B" sllave e perm-bysur, por "r" dhe "rr" janë tashmë sipas alfabetit të sotëm. Më 1911 në Sofje është shtypur një shkurtim i "Robinson Kruzoit" përsëri në përkthimin e Lumo Skëndos dhe te po ajo shtypshkronjë. Këtu është më-njanuar shkronja krejt e posaçme për "xh" e Stambo-llit dhe thjesht është zëvendësuar me një "x" që ka bishtin poshtë si "ç". Një vit më pas përsëri në Sofje, po prej asaj shtypshkronje të K. Luarasit ka dalë një përkthim i autorit R. Faurrès me titull "Skënderbeu

ose heroi shqipëtar". Nga shkronjat greke vijojnë të përdoren:  $\sigma$ ,  $\lambda$ ,  $\epsilon$ ,  $\delta$ ,  $\theta$ ,  $\eta$ . Po ashtu ishte e natyrshme që të vijonte me alfabetin e Stambollit "Kalendari kombi-ar", i cili kishte nisur të botohej më 1897 si "Ditërrëfë-njësi shqip" dhe vijoi deri më 1916. Ndonëse kishte ardhur koha për ndryshim, "Liri e Shqipërisë" doli njësoj në Sofje gjatë viteve 1911-1914. Në këto raste e përbashkëta lidhet me emrin e K. Luarasit. Kanonizma e "Shoqërisë shkollare" të Korçës është shtypur më 1912 në Korçë gjithashtu me atë alfabet, sepse shtypshkronja u shpërngul nga Manastiri. Shkurt, ngulmimi për të mos hequr dorë nga alfabeti i Stambollit ka shkaktuar që deri në Luftën e Parë Botërore germat greke të ishin të pranishme në botime të ndryshme shqipe.

Nuk ka qenë kundërvënie me Kongresin botimi i Psaltirit toskërisht më 1911 në Manastir me kujdesin e A. Sinës. Këtu kishte arsye thjesht teknike, meqë pjesa më e madhe tashmë ishte shtypur në Stamboll që më 1899 dhe për këtë është dhënë shënimi i qartë përkatës që në fillim. Por mjaft e papritur është tabela "Të dy alfabetat shqyp" e dhënë në faqen 3 të librit të vogël "Gramatika apo folmarmja shqype", e shtypur nga Shoqëria "Dija" e Vjenës më 1914. Së pari jepet alfabeti i Manastirit, i quajtur "i bashkumi". Aty janë shtuar pesë zanore me theksin hundor, të cilat janë përdorur edhe në tekstin e librit. Kjo nënkuptonte sikur alfabeti i Manastirit ishte alfabet për toskërishten dhe prandaj duhej plotësuar me zanoret e tjera hundore të gegërishtes. Një praktikë e tillë me variacione të ndryshme ka vazhduar më pas e ka ardhur deri në

ditët tona. Autorë që ndjekin këtë zgjidhje asnjëherë nuk e shprehin hapur se kështu e quajnë të pamjaf-tueshëm Kongresin e Manastirit dhe i shmangen diskutimit thelbësor, por kjo del jashtë temës së këtij punimi. Pranë është dhënë alfabeti tjetër me emërtimin “i njejtë”, besoj me kuptimin “i veçanti”. Ky është alfabeti i Stambollit me disa mungesa, sepse duket nuk i kanë gjetur shenjat përkatëse në Vjenë. Por aty kanë mbetur shkronjat greke: ε, λ, η, σ, θ. Rrjedhimisht, do të pranohet se shmangiet për arsye të ndryshme nga alfabeti i vitit 1908 më pas kanë sjellë vijimin e përdorimit të disa shkronjave greke, duke qenë një prapavajtje kundrejt arritjes më të rëndësishme të Rilindjes shqiptare si fryt i frymës së bashkëpunimit kombëtar. Nuk mund ta mbyll këtë pikë, pa përmendur “Fjalorin shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip” të Gustav Vajgandit (G. Weigand), botuar më 1914 në Lajpcig. Autori ka trilluar pa asnjë nevojë zgjidhje të ndryshme nga alfabeti i vitit 1908, të cilat nuk e meritojnë të diskutohen. Mjafton të sjell si shembull se “cicëroj” i ka dalë “tsitsiroj”, kurse “çarçafi” i ka dalë “tshartshaf” dhe kështu i ka fshirë nga alfabeti i shqipes shkronjat “c, ç”.

### *Përdorimi shkencor*

Pas Luftës së Parë Botërore në mendimin shqiptar pak nga pak ndodhi një ndryshim i ndjeshëm. Kultura e Greqisë së lashtë nisi të perceptohej si pjesë e

përgjithshme e kulturës europiane, duke u bashkuar me kulturën romake dhe, rrjedhimisht, nisi të flitej për letërsinë e vjetër greke-romake. Kultura ortodokse greke u njëjtësua me shfrytëzimin e saj fetar dhe shkoi duke humbur truall. Sipas termave në diskutimin e asaj periudhe, kultura e lashtë greke përfshihej në kulturën Oksidentale, ndërsa kultura ortodokse greke mbetej në kulturën Orientale. Vetëm njerëz të formuluar herët në kulturën greke, si Aleksandër Xhuvani, vijuan të merreshin me përkthime e me trajtime të letërsisë greke pa e rrokur këtë ndryshim që u përvijua.

Ky ndryshim i ndjeshëm pati rrjedhime edhe për alfabetin. Hap pas hapi në Shqipëri u pakësua numri i njerëzve që e zotëronin greqishten e re, e sidomos që ishin në gjendje të kuptonin problematikën e kësaj greqishteje, e cila do të kalonte gjithashtu për vete në reforma të drejtshkrimit. Ndikim vendimtar kanë pasur dy ngjarje të rëndësishme: shpallja e Kishës autoqefale shqiptare dhe vendimi për mbylljen e shkollave të huaja. Ecuria e mëtejshme arriti aty ku jemi sot, domethënë që edhe njerëz të cilët merren me alfabetin, nuk e njohin më leximin e greqishtes së re dhe nuk i kapin hollësitë e përdorimit të shkronjave të greqishtes për shqipen. Si përfundim do të shprehem, se për shkrimin e shqipes mbeti çështja e përdorimit të shkronjave të alfabetit grek, por nuk kishte më vend për alfabetin e greqishtes në marrëdhënie me shkrimin e shqipes. Alfabeti grek është një alfabet ndërkombëtar, alfabeti i greqishtes i shërben vetëm një gjuhe.

Pas Luftës II Botërore pati një ndërprerje të rreptë ideologjike të marrëdhënieve me kulturën e sotme greke, aq sa edhe greqishtja e shkruar e gazetave për pakicën në Shqipëri ishte nën ndikimin e shqipes së politizuar.<sup>38</sup> Asnjë ndikim real nuk mund të kishte greqishtja për gjithë gjysmën e dytë të shek. XX dhe janë absurde, pa mbështetje historike e me padituri të thellë për gjendjen e sotme të shqipes shprehjet e disa autorëve, sidomos në Prishtinë, se kemi një ndikim të fortë të greqishtes mbi shqipen e sotme, po ashtu si edhe të italishtes. Ky krahasim, sidomos kur në diskutim përfshihet edhe ndikimi i serbishtes pas Luftës II Botërore, vjen thjesht nga një paragjykim, i mbështetur në paditurinë si çdo paragjykim. Nuk besoj se e ndryshojnë gjendjen disa fjalë, si *sufllaqe* e *paidhaqe*, që i kanë sjellë tashti emigrantët ekonomikë, madje çuditërisht fjala e parë edhe prej tyre përdoret me dy kup-time të ndryshme sipas gjuhës që përdorin në rastin konkret (domethënë e përdorin për shishqebapin, kur flasin greqisht, dhe për gjirot kur flasin shqip).

Konteksti ka qenë tjetër për arvanitët, që arrinin të merrnin arsimin e lartë. Një dijetar i shquar arbëresh nga Salamina ka qenë Petro Furiqi (1875-1936). Dy veprat e tij të rëndësishme, njëra për dialektet arvanite në Atikë dhe tjetra për toponiminë qenë ndihmesa themelvënëse për njohjen e të folmeve shqipe dhe toponimisë së asaj treve. Nga punimi "Toponimia shqipe", botuar më 1929 në revistën "Athina" (nr. 41, f. 97-136) vërehet se autori ka përdorur alfabetin latin për të dhënë trajtat e fjalëve shqipe, që shpjegojnë toponimet përkatëse dhe kështu kemi paraqitjen e një-

kohshme me alfabetin e greqishtes dhe me shkronja latine të po atyre fjalëve. Megjithatë, në mjaft raste është detyruar të përziejë disa shkronja greke ndër ato latine, si p.sh. aryleza, Αρα ε γγλιatë, darða etj.

Paraardhës të Kupitorit janë K. D. Sotiriu nga Speca dhe Kristo N. Petro-Mesogjiti (1904-1944) nga Kalivia. I pari ka botuar më 1909-1910 lëndë folklorike me shkronja të greqishtes dhe me disa shenja diakritike. Një Fjalorth i greqizmave në të folmen arvanite të Atikës është hartuar prej të dytit dhe u botua më 1984 në vëllimin IV të veprave të tij prej Petro Filip-Angjeliut. Me Furiqin u ndërpre për një periudhë studimi i të folmeve arvanite nga autorë arvanitë. Pas Luftës II Botërore ka qenë K. Hebleri, i cili nisi të merrej gjerësisht me studimet për të folmet arvanite.<sup>37</sup> Ndërkaq, ai përdori alfabetin e Shoqatës Fonetike Ndërkombëtare, të cilin e ka pranuar nga viti 1971 edhe H.-J. Sasse.<sup>38</sup> Sipas këtij studiuesi të dytë, traditën e arvanitëve e rimori Evangelos Konstantini nga fshati Panaja afër Tebës. Nga ana tjetër, ai i ka kritikuar disa autorë, si J. P. Gjikën, i cili në botimin e vitit 1978 për arvanitët e Eubesë i ka dhënë tekstet arvanite me transkriptim krejt diletant, ndërsa botimet e K. S. Rodhisit (1978 e 1980 në Athinë), i quan thjesht botime propagandistike.

Vlerat historike dhe shkencore të trashëgimisë së arbëreshëve të Greqisë janë pranuar nga të gjithë dhe për këtë arsye vijon të kryhet një punë e frytshme për regjistrimin dhe botimin e tyre, që të mos zhduken. Por konkretisht për të folmet e tyre mbetet çështje e hapur me çfarë alfabeti do të botohet lënda. Gjuhëtarët shqiptarë nuk janë marrë me këtë anë dhe luhatjet

i ka shtuar sidomos ngatërrimi në këtë fushë i gjuhës shqipe standarde. Disa shkrime të gjera publicistike të Androkli Kostallarit kanë sjellë një pështjellim të shumanshëm. Po sjell si shembull të parë librat e Jani P. Gjikes. A. Kostallari ka shkruar: "Vlerat e mëdha shpirtërore dhe visaret e veçoritë gjuhësore që ruhen të gjalla në këto ngulime po dalin në dritë edhe më gjerë në mjaft botime të këtyre të fundit. Interes gjuhësor të veçantë paraqesin p.sh. veprat e Jani Gjikes."<sup>39</sup> Jo vetëm nuk është përmendur vërejtja e mësipërme e K. Heblerit, por për librin e parë të J. P. Gjikes të vitit 1962 nuk kujtohet as recensionin, botuar nga V. Xhaxhçka njëzet vjet më parë po në revistën "Studime filologjike", ku ishte kryeredaktor A. Kostallari. Sipas Xhaxhçkës,<sup>40</sup> këngët janë dhënë me alfabetin e greqishtes, të përzier me 9 shkronja latine. Ndërkaq, ai është shprehur në mënyrë fyese për pohimin e J. P. Gjikes, se: "Është e ditur që gjuha shqipe s'ka mënyrë shkrimi.", duke mos e kuptuar se J. Gjika e kishte fjalën për arvanitishten dhe jo për shqipen në përgjithësi. A. Kostallari përkundrazi, nënvizon "visaret e veçoritë gjuhësore që ruhen të gjalla në këto ngulime", në një kohë kur vetë J. P. Gjika njëzet vjet më parë shkruante fare qartë: "Sot gjuha shqipe flitet fare pak dhe është e natyrshme që me kohë dalngadalë do të humbasë." Një shembull tjetër: A. Kostallari e ka përmendur disa herë K. P. Mesogjitin dhe botuesin e veprës së tij të plotë më 1984 P. Filipu-Angjeliun, por nuk e ka vënë re se edhe autori i Fjalorit të greqizma-ve, edhe botuesi i tij afër gjysmë shekulli më vonë nuk e kanë përdorur në titull termin "arvanit", por e kanë



thënë “shqipfolësit e Atikës.” Pa u zgjatur për këtë, po vë në dukje se “shqipfolës” është njësoj si “frëngjishtfolës” (frankofon) dhe nënkupton një popullsi jo shqiptare, që ka përvetësuar greqishten. Ndërkaq, Mesogjiti kishte përdorur alfabetin latin për fjalët arvanite. Georgiu K. Kollia, kushëri i A. Kollias, botoi më 1984 në Athinë një përmbledhje të vogël me shprehje arvanite nga Loentari, duke përdorur alfabetin e greqishtes; A. Belushi e ka sjellë lëndën e arbëreshëve të Greqisë me shkronja latine dhe kështu ka bërë sipas rastit edhe vetë A. Kollia.

Sipas A. Kostallarit, edhe arbëreshët pa dallim duhet të kalojnë nga e folmja e ligjërimi dialektor në gjuhën letrare të njësuar, “bartësit e të folmeve arbëreshë del nevoja që ta mësojnë gjuhën letrare kombëtare.” Natyrisht, gjuhëtari ka të drejtë të shprehë mendimet e veta për një çështje, porse në këtë rast puna qëndron krejt ndryshe. Me fjalë të tjera, ky mund të quhej një imperializëm gjuhësor *sui generis*, sipas shprehjes së parapëlqyer të Kostallarit. Ai kërkonte që “rrugët e zotërimit të gjuhës letrare të përbashkët nga arbëreshët kanë nevojë të bëhen objekt studimesh të veçanta ... edhe nga ana praktike e metodike.” Miti i gjuhës standarde shqipe që përvetësohet nga arbëreshët pikërisht nga ana praktike shpërbëhet plotësisht. Si mund t’u kërkohet qytetarëve prej shekujsh të shteteve të tjera, që të marrin një orientim të ri nga një vend tjetër, madje nga një vend i cili nuk ka as përmasat numerike, as fuqinë ekonomike që t’i mbështesë në këtë rrugë? Lidhur me dijetarët dhe shkrimtarët arbëreshë, është kurdoherë e mirëpritur krijimtaria e

tyre në gjuhën e sotme shqipe, po aq sa dëshira e tyre për të dhënë ndihmesë në kulturën dhe shkencën e sotme shqipe, por çështja se në cilën gjuhë i shkruan punimet e veta një dijetar ose një shkrimtar në Europën e sotme ka të bëjë me zgjedhjen e tij.

Përsëri për të mbështetur mitin e vet, A. Kostallari i ka shtrembëruar faktet. Sipas tij, te arbëreshët sot ka një lëvizje “për të përvetësuar gjuhën letrare shqipe të njësuar e të përbashkët e për ta përdorur atë njëkohësisht si mjet të pazëvendësueshëm si për vetëruajtjen etnike, ashtu edhe për zhvillimin e përparimin arsimor e kulturor në vijën e traditave të shquara kombëtare.” Dhe e çon më tej këtë, duke sjellë si dëshmi, se revista “Mondo albanese” që nga viti 1975 u përgjigjet “kërkesave reale të masave më të gjera të lexuesve, që po e njohin dhe po e zotërojnë gjuhën letrare çdo ditë e më mirë.” Kjo është thjesht propagandë. Se çfarë po ndodh çdo ditë mes arbëreshëve sot në Itali ata e dinë më mirë vetë. Ndërkaq, është krejt e papranueshme, që thëniet e A. Gramshit për qëndrimin ndaj dialekteve t’u përmenden arbëreshëve. A. Gramshi as në mendje nuk i kishte problemet e pakicave etnike në kushtet e dygjuhësisë, aq më pak, ndonëse kishte diçka nga prejardhja arbërore, nuk lidhet emri i tij me ëndërrimet për “shkrimin e gjuhës amtare në gjithë diasporën e sotme shqiptare”, duke nënkuptuar shqipen standarde. Në vend të këtyre fantazive, është koha të mendohet për analfabetizmin në Shqipëri dhe për qindra mijëra shqiptarët, të cilët janë emigrantë në vende të tjera dhe mund ta humbasin

edhe atë njohje të mirë të shqipes standarde që kanë marrë me vete.

Ndërkaq, arsyeja përse u zgjata lidhur me këtë pikë është se ndërhyrje të tilla jo vetëm e kanë mënjanuar çështjen e alfabetit për të folmet e arvanitëve, por edhe kanë lënë pasojë në mesin e arbëreshëve, për të cilat nuk dëshiroj të jap asnjë koment, kështu që vetëm po i përmend në fund të një shënimi.<sup>41</sup>

Pavarësisht nga shmangia prej thelbit të punës, A. Kostallari i ka përmendur çështjet e trajtuara në Kongresin për gjuhën dhe kulturën arvanite, të mbajtur në dhjetor 1985 në Athinë. Aty ka dalë qartë shtrimi i problemit për mënyrat e shkrimit të arvanishtes, sepse shihet se janë ndjekur zgjidhje të ndryshme. Fjalët shqipe në një rubrikë të dikurshme të “Besës” së A. Kollias jepeshin me alfabetin e greqishtes të përshtatur dhe të plotësuar me shenja diakritike. Vangjel Lapi në “Vajtmet arvanite” më 1985 i ka dhënë vajt me alfabetin e greqishtes, por krahas edhe me alfabetin e sotëm të shqipes.

Është e natyrshme, që së pari probleme me alfabetin e greqishtes do të dilnin gjatë ribotimit dhe trajtimit gjuhësor të materialeve të botuara përpara Luftës I Botërore. Vështirësia më e madhe lind pikërisht për t’i transkriptuar me alfabetin e shqipes tekstet dhe fjalët shqipe të atyre materialeve. Në këto raste duhen bërë interpretime dhe jo thjesht kalime të shkronjave prej një alfabeti në tjetrin. Për këtë arsye ka ecur mjaft ngadalë paraqitja me alfabetin e sotëm të shqipes e gjithë trashëgimisë që na ka ardhur me alfabetin e greqishtes. Anasjelltas, kjo ka bërë që të ruhet ai alfa-

bet në ribotimet dhe trajtimet e sotme shkencore. Po të themi të vërtetën, transkriptimi i thjeshtë në këto raste e dëmton shqyrtimin e rreptë shkencor, megjithatë është i nevojshëm. Prej këndej vijnë përpjekjet e mundimshme të gjuhëtarëve dhe shtjellimet e hollësishme për çështje të alfabetit, të cilat pengojnë studimin më të gjerë gramatikor, leksikor dhe tekstual, i cili ka shumë më tepër vlerë sesa ana teknike e shkronjave. Gjithsesi, nga ky kënd vështrimi, nuk ka rëndësi nëse studiuesi është shqiptar, arvanit ose i huaj, të gjithë ndeshen me po atë problem të alfabetit.

Ndihmesë të posaçme në ribotimin e trashëgimisë ka dhënë Tito P. Johalasi nga Akademia e Athinës. Në paraqitjet e tij janë ndërthurur si riprodhimet, ashtu edhe transkriptimet e rishkrimet me alfabetin e sotëm të shqipes dhe kështu e lehtësojnë shumë punën studimore. J. Kristophson-i më 1974 ka ribotuar Fjalorin katërgjuhësh të Dh. Voskopojarit me alfabetin e origjinalit, pastaj ka shtuar transkriptimin e Martin-Likut me alfabetin e sotëm dhe së fundi ka dhënë interpretimin e vet (me ndonjë pasaktësi të vogël) me alfabetin e sotëm të shqipes. Edhe A. Hetzer-i në ribotimin më 1981 të Fjalorit trigjuhësh të Th. Kavaliotit e ka dhënë pjesën shqipe me alfabetin e arumanishtes (të krijuar mbi bazën e greqishtes) të autorit dhe pastaj e ka transkriptuar dhe e ka shoqëruar me trajtën e sotme të fjalës shqipe dhe me përkthimin gjermanisht, duke e bërë botimin po ashtu me vlerë për kërkimet shkencore.

Edhe në fusha të veçanta të tjera, përveç gjuhësisë e filologjisë, del nevoja e përdorimit të shkronjave nga alfabeti grek. Në matematikë, fizikë e astronomi ka

një përdorim ndërkombëtar të atyre shkronjave për emërtime të posaçme. “Fjalori i astronomisë” i botuar më 1978 nga R. Hysa ka tri fjalë titull me shkronjat përkatëse greke: alfa, delta, ita. Po sidomos të pashmangshme janë ato kur dijet shkencore jepen për qëllime pedagogjike. Në gjeometri nuk mund të flitet për rrethin pa përmendur “pi” ose “pi greke”, nuk mund të flitet për këndet pa i emërtuar ato me emërtimet e shkronjave greke etj. Përfundimisht edhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* më 1980 ka përfshirë diçka. Janë dhënë si fjalë titull *alfa* dhe *omega*, madje edhe duke vënë në kllapa gjermanë përkatëse. Por ndonëse janë dhënë fjalët, nuk dalin shkronjat përkatëse për: *gama*, *ipilon* dhe *omega*. Ka qenë e dobishme të paraqiteshin edhe dy shprehje tashmë të gjuhës së përgjithshme librore: *alfa* dhe *omega* dhe nga *alfa* te *omega*. Në të vërtetë po kaq e nevojshme është edhe “pi”. Në rezistencën e materialeve nuk mund të flitet pa qëndresën në tërheqje “tau”, në matjet nuk mund të flitet për diametrin pa “fi” dhe po aq nevojë ka për “sigmën” e për “deltën”. Kam vënë re se “lamda” përgjithësisht te ne shqiptohet “landa”. Në fjalorët e mëdhenj të gjuhëve të tjera europiane paraqiten pothuaj të gjitha emërtimet e shkronjave të alfabetit grek. Së fundi, nuk mund të mos shënoj se edhe në veprën madhore të prof. Eqrem Çabejt disa herë ka dalë e nevojshme të përdoren shkronjat greke te fjalët titull; p.sh. te vëllimi IV (1996) gjenden: *εξέ*, *γυγ*, *χ*eromë, *χ*idhis.

Si përfundim mund të thuhet se në epokën tonë të shkencës dhe të marrëdhënieve të gjera ndërkombëtare është e nevojshme që shkolla t’i pajisë nxënësit me njohuritë e thjeshta për alfabetin grek si alfabet ndërkombëtar.

### Shënimet:

1. OSMANI, Tomor (1999): *Udha e shkronjave shqipe*. Shkodër, f. 515-535.
2. Shih shkrimet e autorëve: N.CEKA - M. KORKUTI (1995: për mbishkrimet greke të Ilirisë jugore e të Epirit; 1997: për mbishkrimet e Epidamnit, Mbishkrimet e Apolonisë së Ilirisë); S. ANAMALI (1976: *Të dhëna mbishkrimore në disa qytete të Ilirisë së Jugut*; 1987: *Katër mbishkrime ndërtimi nga Bylisi*); H. CEKA (1965: *Përputhje onomastike ilire-epirote*; 1965: *Mbishkrime bizantine të unazave të Komantit dhe datimi i tyre*); N. CEKA (1987: *Mbishkrime byline*); B. DAUTAJ (1994: *Gjetje epigrafike nga Dimale*); F. MIRAJ (1981: *Mbishkrimet për ujësjellësin e Durrësit*; 1991: *Mbishkrime për ndërtimin e Dyrrahut*); V. TOÇI (1986: *Të dhëna të reja për onomastikën ilire në Dyrrah*); K. ZHEKU (1972: *Zbulime epigrafike në muret rrethuese të Kalasë së Durrësit*), sipas *Bibliografisë* në veprën e N. CEKËS (2000): *Ilirët*, f. 323-332.
3. JANURA, P. (1969): *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, f. 5 shkruan: "Pra stërgjyshërit e shqiptarëve, ilirët, nën ndikesën e gjuhës latine dhe të kulturës romake, në shekullin VI-I, para epokës sonë, përdorën alfabetin latin të tipit onisial. Ky alfabet vijoi të përdoret edhe pas kristianizimit të tyre në shekullin III. Si të tillë ilirët vijuan të jenë të lidhur me këtë alfabet, me shkrimin latin, por tani të tipit semionsial, edhe nëpërmjet të fesë kristiane." Këto pohime jo vetëm janë në kundërshtim me të dhënat historike që përmenda lart në tekst, por edhe me historikun e shkrimit latin. Alfabeti onisial është përdorur vetëm në erën e re, nga shek. III deri në shek. VIII, kurse alfabeti gjysmonsial është përdorur po ashtu në erën e re nga shek. V deri në shek. VIII.
4. CEKA, N. – KORKUTI, M. (1998): *Arkeologjia*. SHBLU, f. 355-356. Të më lejohet që të bëj një ndreqje të vogël. Nga gjuhëtarët, gjuha greke quhet arkaike deri në shek. VI para e.r.; më pas vjen greqishtja e vjetër, e periudhës klasike dhe më vonë helenistike deri në shek. V të erës së re. Prandaj pronari ilir ka përdorur gjuhën dhe alfabetin e greqishtes së vjetër, jo të greqishtes arkaike.
5. *Po aty*, f. 301.

6. *Po aty*, f. 407.
7. LLOSHI, XH. (2005): *Problemi gjuhësor i përhapjes së krishterimit*, në: KOSOVA, nr. 26, 2004, f. 33-43.
8. ÇABEJ, E. (1974): *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, në: Studime filologjike, nr. 2.
9. CEKA, N. (2000): *Ilirët*, f. 260.
10. POPA, TH. (1957): *Të dhëna mbi princët mesjetarë shqiptarë në mbishkrimet e kishave tona*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 2; *Onufri – piktor i madh shqiptar i shek. XVI*, në: Buletin për shkencat shoqërore, nr. 1; (1958): *Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 1; (1959): *Disa mbishkrime të kishave të Shën Mërisë në Maligrad dhe të Ristozit në Mborje*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 2; (1962): *Mbishkrime dhe piktura në katedralen 'Fjetja e Shën Mërisë' në Voskopojë*, BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 3.
11. POPA, TH. (1955): *Piktor Kostandini prej Shpati*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 4; (1957): *Onufri – piktor i madh shqiptar i shek. XVI*, në: Buletin për shkencat shoqërore, nr. 1; (1959): *Piktorët korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe freskat e tyre në Skenat e Apokalipsit*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 1; (1960): *Piktorët grabovarë Çetiri nga familja Katro*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 3; (1960): *Piktura të tjera të piktor Nikollës zbulue në Kurjan të Fierit*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 4; (1962): *Onufri, ikonograf i shquar shqiptar*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 1.
12. OSMANI, T., *vep. cit.*, f. 21.
13. KASTRATI, J. (2000): *Historia e albanologjisë*, vëll. I, f. 195.
14. KAMSI, K. (1958): *Një dokument i vjetër shqip dhe disa vjersha arbneshe të Kalabrisë dhe Bazilikatës*, në: BUSHT, Seria shkencat shoqërore, nr. 2, f. 210.
15. HETZER, A. (1981): *Griechisches in Südalbanien im Zeitalter der Aufklärung*, në: Müncher Zeitschrift für Balkankunde, 4, f. 169-218.
16. ÇABEJ, E. (1979): *Për pastërtinë e gjuhës*, në: "Mësuesi", 28 mars-4 prill, ndër të tjera shkruan: "Me një ndjenjë habie shohim ne sot si një njeri jo i pendës, po i armës, dhe folës i një dialekti në skaj të trevës gjuhësore, si Marko Boçari prej Suli,

- përdor në fillim të shekullit të kaluar leksema të sferës kuptimore–abstrakte, si: kërkim, madhësi, i papunë, i pamasë.” Është plotësisht e kuptueshme ndjenja e habitë të prof. E. Çabej, sepse realisht nuk ka pasur asgjë të tillë. E para, në moshën 18 vjeç nuk mund të thuhet se Markoja ishte njeri i armës, pasi djaloshi ende nuk e meritonte një cilësim të i tillë. E dyta, asnjë nga ato fjalë nuk është e tij, por është përkthim shqip i fjalëve greqisht që ua kërkonte Pukëvili burrave Boçarë rreth sofrës ku pinin dhe pastaj i hidhte me shkrim Markoja djalosh. Vërtetimin më të mirë e përbën përkthimi shqip i cilësorit për Shën Mërinë e *virgjër*, që është një shaka e rëndë e atyre burrave hokatarë, sepse është e papërfytyrueshme që të krishterë realë të përdomin një fjalë të ndyrë për shenjtoren.
17. POUQUEVILLE, F.C.H.L. (1820): *Voyage de la Grèce*. Tome troisième, Paris, botimi i dytë 1826, f. 298.
  18. OSMANI, T. *vep. cit.*, f. 129.
  19. LLOSHI, XH. (2000): *Vangjel Meksi – përkthyesi i parë i sukseshëm i Dhiatës së re shqip*, në: “Vangjel Meksi (1770-1823) personalitet i gjuhës shqipe”. DITA, f. 38-43.
  20. XYLANDER, J. RITTER VON (1835): *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*. Frankfurt am Main.
  21. OSMANI, T. *vep. cit.*, f. .
  22. SHUTERIQI, DH. (1976): *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, f. 113.
  23. OSMANI, T., *vep. cit.*, f. 143.
  24. OSMANI, T., *vep. cit.*, f. 338.
  25. *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese per Demetrio Camarda*. Ristampa anastatica, Palermo 1989.
  26. LLOSHI, XH. (1994): *D. Camarda: A Case of Greek-Albanian Filiation Hypothesis*, në: “Studies in Greek Linguistics. Proceedings of the 15th Annual Meeting of the Department of Linguistics, Faculty of Philosophy, Aristotle University of Thessaloniki”. Thessaloniki, 1995, f. 573-584.
  27. KASTRATI, J. (2000): *Historia e albanologjisë*, f. 460.
  28. ZAMPUTI, I. (1955): *Një dorëshkrim bektashian i gjysmës së shek. XIX*, në: Buletin për shkencat shoqërore, nr. 4.
  29. SHUTERIQI, DH. (2005): *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Tiranë, f. 282.



30. DOMI, M. (1978): *Gramatika e Jani Vretos e vitit 1866*, në: Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike. VII, 1977, Prishtinë, f. 53-62.
31. *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)*, II. Tiranë, 1961, f. 189.
32. BULO, J. (1986): *Në gjurmët e rilindësve*, në: "Drita", 28 shtator, f. 11.
33. KONICA, F. (2000): *Abetari shqip*, në: "F. Konica, Vepra I", Duda, f. 181-186.
34. SASSE, H.-J. (1991): *Arvanitika: Die albanischen Sprachreste in Griechenland*. Teil 1. Wiesbaden.
35. KOSTALLARI, A. (1987): *Një dëshmi e panjohur e shkrimit të arabishtes së Greqisë në shekullin XIX*, në: "Studime filologjike", nr. 2, f. 89-103. Autori e ka shtrembëruar tërësisht edhe kontekstin historik. Ai flet për "frymën e thellë demokratike dhe besimin e madh se në gjirin e masave popullore arbëreshe rron gjithnjë e gjallë dashuria për liri e drejtësi shoqërore." Në të vërtetë ato zgjedhje zhvilloheshin në kohën e sundimit të mbretit bavarez Oton, i cili ishte një tiran absolutist dhe, ndonëse u detyrua të pranonte Kushtetutën më 1844, nuk e vuri atë në jetë. Pa mbushur dy vjet nga koha e botimit të këtij teksti, në Greqi u bë një kryengritje kundër tij dhe e dëbuan nga Greqia.
36. JANURA, P. (1969): *vep. cit.*, f. 7 shkruan: "Alfabetet grek dhe arab u përdorën për të shkruar shqipen me qëllime dekadente, të paramenduara, për të rrënjosur sa më shumë fenë, që shqiptari të mos ketë tjetër preokupim si i zhytur në fanatizëm fetar e pasandaj kishin edhe qëllim çkombëtarizues të shqiptarit me fe islame ose me fe ortodokse."
37. HAEBLER, C. (1965): *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis*. Wiesbaden.
38. QIRIAZI, DH. Q. (2004): *Bilinguizmi dhe marrëdhëniet e shqipes me greqishten në veprën e prof. Çabejt*, në: "Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare", f. 314-315 jep një varg shembujsh për këtë dukuri. Ndërkaq, janë po me aq interes ndikime të shqipes mbi të folmet e Greqisë veri-perëndimore, të cilat dalin në vepra të autorëve të sotëm grekë, të cilat e meritojnë të gjurmohen. Kështu, pavarësisht nga qëndrimet e veta të theksua-

ra politike, Nicholas Gage në veprën e vëllimshme "Eleni", botuar në New York, 1983, ka përmendur këngët e dasmës dhe të njohurën "Në të pyeçin ç'emër mori..."; ka emra të përveçëm, si: *Petrit, Bukëvala*; ka shprehje të shqipes, si "Të shkosh e të vish para se të thahet pështyma"; një varg turqiz-mash që mbaheshin gjallë deri në Luftën II Botërore për shkak të lidhjeve të ngushta me shqipen, si: *efendi, hallexhi, hanxhar, haram, kadi, kallaj, raki* etj., dhe fjalë shqipe, si: *shëllirë, velencë, zonjë*.

39. KOSTALLARI, A. (1986): *Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar*, në: "Studime filologjike", nr. 3, f. 21-71.
40. XHAXHÇKA, V. (1966): *Jani P. Gjika, "Këngë shqiptare të Kavo d'Oro", Athinë 1962, në* "Studime filologjike", nr. 1, f. 209-211.
41. Ndër të tjera, në kryeartikullin *Shoku Enver ndër arbëreshët*, të numrit 54, llanar-gusht 2007 të revistës "Jeta arbëreshe", shkruhet: "Shoqata 'Vatra Arbëreshe' – ... shkruan se ky prof. është diktatori Hoxha i ri-mishëruar, sepse do të qellënj përpara këtë farë imperializmi gjuhësor", do të imponojë një gjuhë çë Arbëreshët ndiejën të huaj." Gjuhëtarët shqiptarë e kanë të domosdoshme të mënjanojnë nga përfitim i të tilla qëndrimeve.

## *Alfabetet e Kristoforidhit*

Mësimet e para K. Kristoforidhi i bëri në shkollën greke të Kalasë në Elbasan. Katër vjetët e parë ishin si fillorja e sotme dhe tre vjet të tjerë të atij tipi, që më vonë është quajtur qytetëse. Mësimet bëheshin greqisht. Përshtypjet që i kishin mbetur nga mësimorja greke i ka shprehur me këto fjalë dhjetë vjet më vonë: “Shqiptarët që i përkasin kishës greke kanë në çdo qytet e qendër banimi shkolla greke dhe shumë prej tyre mësojnë të lexojnë e të shkruajnë shkronjat greke, por me një njohje shumë të kufizuar të gjuhës greke.” E ka përsëritur këtë ndjenjë tre vjet më vonë, më 1860: “Qytetarët e varfër i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat greke, që të mësojnë lexim e shkrim në një gjuhë të huaj, përpara se të kenë mësuar gjuhën e vet amtare gramatikisht, dhe nxënësit janë të detyruar të mësojnë përmendsh rregullat e gramatikës mekanikisht, pa i kuptuar, e në këtë mënyrë shpenzojnë shtatë ose tetë vjet të jetës së tyre e zor se i kuptojnë autorët grekë.” Këto ai i ka shkruar shumë vjet përpara se të bëhej i njohur me përkthimet e botimet e veta. Nga ana tjetër, për dy dhjetëvjeçarë shkrimet në variantin toskërisht i ka botuar me alfabetin grek të përshtatur. Kjo kundërshti ka nevojë të ndriçohet, sepse ndonjëherë është shfrytëzuar edhe për ta cenuar punën e tij.<sup>1</sup> Njëkohësisht që nga G. Majeri në fund të shekullit XIX e deri më sot është folur për alfabetet e krijuara nga

Kristoforidhi, duke nënkuptuar ato me të cilat janë botuar librat e tij.

Ishte afër njëzet vjeç, kur prindët më 15 gusht 1847 e nisën Kristoforidhin në Janinë. Në gjimnazin e themeluar më 1828 nga katër vëllezër me mbiemrin Zosimea, kanë ndjekur mësimet disa nga rilindësit tanë më të shquar. Ishte një shkollë trevjeçare, e tipit të kolegjeve sipas modeleve europiane të kohës. Veç greqishtes së vjetër e të re jepeshin edhe dy gjuhë të huaja. Në të njëjtën kohë u caktua në Janinë si konsull austriak albanologu i njohur Johan Georg von Hahn. Që në krye ky u ndesh me një vështirësi befasuese: aty nuk mund të bëhej gjë pa ditur gjuhën shqipe. Zgjodhi një rrugë të frytshme: nga gjimnazi i dhanë emrat e dy nxënësve të mirë nga Shqipëria: Apostol Panajotit dhe Konstandin Kristoforidhit. Metoda e mësimit ishte mjaft interesante: Hani mori përkthimin shqip të Dhiatës së re (1827) dhe veprën e J. Ksilanderit të vitit 1835. Mbi lëndën e tyre zbërthente gramatikën e kuptimet e fjalëve shqipe, duke vjelë gjuhën e gjallë të dy nxënësve shqiptarë, që flisnin dy dialektet kryesore të shqipes. J. Hani i botoi studimet e veta me një alfabet të mbështetur te përkthimi i V. Meksit, duke bërë disa ndryshime. Alfabetin e botimit të përkthimit më 1824 dhe 1827 e kam zbërthyer hollësisht më sipër dhe këtu ka rëndësi të theksohet se ishte alfabet i ndërtuar me shkronjat greke, të cilat Kristoforidhi i kishte mësuar në Elbasan e me to punonte edhe në Janinë.

Për shkak të disa fatkeqësive familjare, pas mbarimit të shkollës Kristoforidhi u mor me tregti dhe më

1857 e gjejmë nga Durrësi të ketë vajtur në Smirnë (Izmir) të Turqisë. Kishin kaluar tridhjetë vjet nga botimi i Dhiatës së re shqip dhe misionarët amerikanë e Shoqëria Biblike e Londrës (BFBS) e quanin të nevojshëm një përkthim të ri. Më 1 mars ata e sollën Kristoforidhin në Stamboll që ta ndërmernte këtë punë menjëherë. Mirëpo ndërkohë njeriu më me përvojë në këtë punë, përfaqësuesi i BFBS I. Laundzi, një emër i njohur lidhur me gjithë punën e botimeve më 1824, 1827, po përpigëj të bënte ribotimin e përkthimit të V. Meksit (i cili doli një ribotim i dështuar më 1858).

Lindi një konflikt ndërmjet ribotimit dhe përkthimit të ri. Si pjesë përbërëse e tij për herë të parë në historinë e shkruar të shqipes u shfaq edhe problemi i paraqitjes dhe botimit të të njëjtit tekst në dy variante të ndryshme, rrjedhimisht edhe me alfabetë të ndryshme. Kundërshtimi në parim i I. Laundzit e detyroi Kristoforidhin të shkruante *Memorandumin për gjuhën shqipe* në qershor 1857. Besoj do të ketë qenë greqisht, por në Londër u përcoll i përmbledhur dhe anglisht. Nuk mund të prisnim që të huajt ta kuptonin në thelb gjendjen gjuhësore të shqipes dhe prandaj në kundërshtitë e tyre ka mjaft ngatërime. Elbasanasi nuk kishte menduar ende për një përkthim në variantin gegërisht, si kujtonin amerikanët e anglezët. C. Hamlini, përkthyesi e përmbledhësi i punimit të Kristoforidhit, besonte se do të ishte një variant gegërisht me alfabet grek. Vetë Kristoforidhi e kishte plotësisht të qartë se çfarë bënte. Dokumentimin e kam botuar të plotë më 2005.<sup>2</sup>

Rreth katër muaj të vitit 1857 Kristoforidhi ka qëndruar në Stamboll e brenda marsit mbaroi ungji-

llin e parë. Kjo shpejtësi do të thoshte se nga përvoja i kishte tashmë të zgjidhura problemet e vështira të alfabetit e të drejtshkrimit. Ai kishte nisur një përkthim të ri toskërisht. Ndonëse e njihnte mirë alfabetin me shkronja të greqishtes, të hartuar për botimin e përkthimit të Meksit më 1827, nuk duket se e ka pranuar pa mëdyshje. Lexuesi e njeh tashmë gjithë historinë deri në përcaktimin përfundimtar nga Laundzi, që solli edhe geramat për shtypshkronjën në Korfuz. Nga Korfuzi ato shkuan në Athinë për ribotimin e vitit 1858 dhe prej andej në Maltë. Kristoforidhi duket gjithashtu se nuk përdori thjesht alfabetin e J. G. Hanit, kur filloi punimet e veta. Në mes të korrikut 1857 u nis për Maltë, ku do të hynte në një kolegji protestant. Puna kaloi përsëri në duart e Laundzit të regjur. Kristoforidhi e kishte mbaruar përkthimin në dorë të parë dhe po e hidhte në të pastër. Por Laundzit, sipas një letre më 29 shtator 1857 nga Malta, menjëherë i bëri përshtypje alfabeti: Kristoforidhi po e kopjonte veprën me një ortografi, që kishte shkronja latine dhe greke, pra i kishte përzier shkronjat. Do ta quaja një alfabet origjinal të Kristoforidhit, ndoshta jo pa lidhje me traditën nga Janina. Me këmbënguljen e vet karakteristike Laundzi i tha se në botimin e Meksit ishte përdorur një alfabet, që u përgjigjej gjithë kërkesave. Pas një diskutimi, Kristoforidhi e ka pranuar atë alfabet, që e njihnte fare mirë kur i kishte mësuar shqipen J. Hanit, dhe u pajtua që ta përdorte gjatë kopjimit në të pastër. Ishte realisht e mundur ta lexonin shqiptarët e familjarizuar me të deri në Shqipërinë e Mesme, ku arrinin shkollat greke. Një punonjës i BFBS, Benia-

min Barker, ka shkruar më 1857 nga Stambolli: "Grekët kanë bërë çmos për ta futur gjuhën e tyre në Shqipëri, por ia kanë dalë vetëm t'u mësojnë alfabetin shumicës së njerëzve, pasi ndonëse këta kanë mësuar të lexojnë greqisht, përsëri nuk mund ta kuptojnë. Duke futur alfabetin e tyre në këtë vend, grekët kanë përgatitur rrugën, që Shkrimet e shenjta të përhapen midis një populli, të cilit i mungon plotësisht fjala e Zotit."

Po Laundzi, në shënimet për punimin e vitit 1860, pasi e pa se po përdorte një alfabet të mbështetur edhe në shkronjat latine, vë në dukje që e ndryshoi më pas, duke ruajtur vetëm 'j'. Kristoforidhi ishte detyruar ta pranonte, porse përgatitja e tij e shëndoshë gjuhësore dhe vetë niveli i zhvillimit të shqipes në krahasim me tridhjetë vjet më parë e shtynin që të përpunonte një alfabet më të studiuar. Kështu u krijua një variant i ri i alfabetit të shqipes. Në Londër kam gjetur dorëshkrimet e kësaj periudhe toskërisht: katër ungjijtë dhe pjesën deri te Zbulesa; mungojnë Punët e apostujve. Nga krahasimi me botimin e Dhiatës toskërisht, del se dorëshkrimi ka qenë varianti i parë i përkthimit të tij dhe mbi të ka bërë redaktimin. Vetëm më 1878 do t'i jepte dorën e fundit për botim. Për fat të mirë, dorëshkrimet kanë edhe Alfabetin e gjuhës shqipe, madje të shoqëruar me shpjegime dhe shembuj, prandaj ai shtrihet në dy faqe. E vetmja shkronjë latine është pikërisht 'j', për të cilën Laundzi ka thënë se do të dukej keq ndërmjet shkronjave greke. Kam botuar një fotokopje<sup>3</sup> më 1974, por meriton pak më shumë vëmendje këtu.

Alfabeti është renditur në kolonë në anën e majtë të faqes së parë. Shkronjat përkatëse greke të njëjta me botimin e vitit 1827 janë 23: a, v, g, dh, e, ë, z, th, i, k, m, n, o, p, r, s, sh, t, ipilon, f, h, h e aspiruar, omega. Ipsilon Meksi (po e përdor shkurt për botimin e vitit 1827) e kishte për të ndërtuar ‘u’ si në greqisht (ou), kurse Kristoforidhi e ka për ‘y’, e cila nuk dilte si tingull në të folmen e Meksit. Duke e lënë këtë mënjanë, janë vetëm 5 shkronja të thjeshta, në të cilat ndryshojnë. Kristoforidhi nuk ka: shkronjat e posaçme për ‘gj’ (F), psi, ksi, ita, psi. Është një thjeshtim krejt i arsyeshëm. Nga 33 shkronjat e Meksit mbeten pesë të tjera. Kristoforidhi ka dhënë për to zgjidhje të ndryshuara. Për ‘d’ që Meksi e kishte me deltë me pikë sipër, ka vënë ‘t’ me pikë sipër. Për ‘q’ të Meksi ‘k’ me pikë sipër, ka dyshkronjësh ‘kj’. Dallimin I-II Meksi e kishte me lamdën e thjeshtë dhe lamdën me pikë sipër, Kristoforidhi e ka arritur me ‘lj’ dhe lamdën e thjeshtë. Tingullin ‘nj’ Meksi e kishte me ‘n’ me pikë sipër, Kristoforidhi e ka me ‘nj’. Rrjedhimisht, Kristoforidhi ka 28 shkronja njëshe dhe 16 dyshe. Dyshkronjëshat janë për: gj (gj), q (kj), ks (e panevojshme për shqipen), ksh (e panevojshme për shqipen), l (lj), nj (nj), ng (ng – duke e menduar si një shqiptim të bashkuar), ngj (ngj – po ashtu), ps (e panevojshme për shqipen), psh (e panevojshme për shqipen), rr (rr), c (ts), ç (tsh), x (ds), xh (dsh), u (ou). Është më afër tingujve të shqipes, sepse të Meksi kishte mungesa në alfabetin e paraqitur në krye të librit (nuk ishin *c, ç, j, rr, x, xh, y, zh*). Po të hiqen 6 dyshkronjësha të panevojshëm, omega dhe h e aspiruar (një borxh i panevojshëm ndaj alfa-



betit të greqishtes), del se alfabeti i Kristoforidhit i vitit 1860 përputhet me 36 tingujt që shënon alfabeti ynë i sotëm.

Dallimi kryesor ndaj Meksit është prania e dyshkronjësive me ‘j’ latine. Rrjedhimisht, ky është edhe dallimi kundrejt Ksilanderit e njëkohësisht është afrimi më i madh me J. G. Hanin, duke shtuar edhe dyshkronjëshat për *c, ç, x, xh*.

Në pjesën tjetër të faqes së parë janë dhënë zanoret e diftongjet. Pastaj vijnë rrokje me të shtata zanoret për 26 bashkëtingëllore dhe në fund shënohen dy theksat për gjatësinë e zanoreve. Faqja e dytë djathtas titullohet greqisht “Mbi shqiptimin e shkronjave”. Jepen shpjegime për të gjitha rastet, duke iu drejtuar shqiptimeve të italishtes, frëngjishtes, anglishtes e greqishtes bashkë me shembuj. E ka quajtur të panevojshme të jepte shpjegime për: *b, dh, z, th, m, n, p, o, t, f* përpara zanoreve, sepse shqiptimi do të ishte i njëjtë si në drejtshkrimin e greqishtes. E gjithë kjo përvojë do t’i shërbente më pas edhe për shkrimet e veta, sa herë do t’i duhej të jepte shpjegime për alfabetin e përdorur. Është, si të thuash, një variant i shkurtuar i faqeve të para të *Abetares*, që do të botohej pas dhjetë vjetësh.

Përfundimisht, alfabetet e Kristoforidhit në fillim kanë qenë dy: i pari i mbështetur kryesisht në shkronjat latine, të cilin nuk e njohim, i dyti i mbështetur në alfabetin e J. G. Hanit me disa variacione, gjithmonë një alfabet për të dy dialektet. E vlen të shënohet, se edhe Kristoforidhi, edhe J. G. Hani e kanë zanafillën te botimi i vitit 1827. Alfabeti i *Fjalorit* të Kristoforidhit, botuar më 1904 është ai i përdorur nga J. G. Hani

me fare pak ndryshime: nuk ka pikë mbi 'g', e ka hequr dyshkronjëshin 'ks', ndryshojnë në dhënien e 'zh' dhe të 'x' dhe nuk ka dy 'h'. Këto dallime janë më të vogla sesa ndryshimet që i bëri J. G. Hani alfabetit të Meksit-Ksilanderit. Po ta them ndryshe, Kristoforidhi e ka marrë dy herë si pikënisje Dhiatën e vitit 1827: një herë për alfabetin sipas kërkesës së I. Laundzit, dhe një herë duke u mbështetur te varianti i Hanit dhe ndryshe nga alfabeti i tij i fillimit, këta të dy i kemi konkretisht të njohur edhe në tekste me dorën tij.

Ky alfabet, i pari në një tabelë me dorën e Kristoforidhit, nuk është ndonjë kureshti, një variant më tepër midis aq të tjerëve që diheshin. Me atë janë shkruar si përkthimi toskërisht, ashtu edhe ai gegërisht i atyre viteve, pra **Kristoforidhi nuk mendonte për dy alfabete të ndryshme të shqipes, por për një të vetëm.** Ndonëse nuk e kemi dorëshkrimin e variantit gegërisht, sepse ai u përdor për botimin e vitit 1866 dhe është hedhur, kemi dëshminë e punimit të tij "Shënime mbi Shqipërinë. Gjuha dhe përkthimi i shkrimeve të shenjta" pikërisht të vitit 1860. Aty shembujt e shqipes janë dhënë së pari gegërisht e pastaj toskërisht dhe në të dy rastet me shkronja të greqishtes, ashtu siç do të jenë në gjithë *Fjalorin* e tij. Është e vërtetë, se njohim përkthimin e punimit të tij anglisht dhe jo origjinalin, domethënë fjalët janë shkruar me dorën e një anglezi dhe jo të autorit. Megjithatë, pa asnjë mëdyshje kemi shkronjën 'j' mes shkronjave greke dhe ajo gjithashtu shërben për të dhënë 'l' (nëpërmjet lj); kemi 't' me pikë sipër për 'd', kemi 'ç' me dyshkronjësh (tsh), 'rr' me dy 'rr'.

Gjithsesi, nuk mund të mëtohet nga Kristoforidhi, që çdo gjë ta kishte të përsosur përpara se të arrinte të bënte vërtet një botim, domethënë përpara se t'i jepte dorën e fundit me kujdesin edhe për imtësitë më të vogla. Shkarje dhe gabime na dalin edhe neve sot. Duke shqyrtuar ungjillin e Mateut të vitit 1860, në kapakun e dorëshkrimit të të cilit ishte alfabeti, më del se kundrejt atij Marku përgjithësisht i përmbahet, kurse nga krahasimi i dorëshkrimeve të Joani dhe të Kartat shfaqen disa lëkundje; brenda po atij dorëshkrimi gjithashtu mund të shihen ndryshime të redaktimit, gjë që dëshmon për etapa të ndryshme pune.

Fjalët shqipe si shembuj për shqiptimin e shkronjave në punimin e vitit 1860 janë dhënë bashkë me përkthimet greqisht. Krahasimi me *Fjalorin* e Kristoforidhit dëshmon se ato janë përfshirë në *Fjalor* (me përjashtim të dy fjalëve, që ai i ka lënë jashtë si të huaja) dhe po me atë përkthim, duke ndryshuar alfabetin. Janë si të thuash, thërmijat e para të Fjalorit të tij. Kjo do të thotë se lënda e fjalorit është mbledhur me kohë, por sistemimi i saj dhe formulimi me një alfabet është bërë më vonë (në çdo rast, pas vitit 1860), duke mos e zbatuar alfabetin e përkthimeve për Shoqërinë Biblike.

Por kryesorja është se Kristoforidhi i ka filluar me kohë përpjekjet për një alfabet të shqipes dhe kështu nga V. Meksi e N. Veqilharxhi e deri te përpjekjet e vitit 1867 nuk ka ndonjë ndërprerje, shqiptarët kanë punuar pareshtur për të arritur një zgjidhje.

Njëkohësisht ka rëndësi të nënvizoj që punën për një alfabet të shqipes Kristoforidhi e ka filluar me

kohë, por ka qenë i detyruar qysh në hapat e parë të pranonte ndryshime.

Gjatë tre vjetëve në kolegjin e Maltës me nismën e vet përgatiti jo vetëm variantin toskërisht të Dhiatës së re, por edhe një tjetër gegërisht, sepse ishte një punë jo fort e rëndë: “ishte e nevojshme vetëm të ndryshoheshin ndërtimi gramatikor, theksat e shkrimi, gjë që e bëra brenda pak muajve.” Në mars 1860 ai i kishte të gatshme dy variantet, por i mbetën të pabotuara.

Çështja e alfabetit i ka dalë Kristoforidhit vazhdimisht gjatë punës së frytshme shumëvjeçare. Në krye të agjencisë së BFBS për gjithë Perandorinë Osmane erdhi në Stamboll më 1861 Aleksandër Tomsoni. Për t’i dhënë një shtysë të re veprimtarisë së BFBS Tomsoni nisi t’i shkelte vetë trevat e agjencisë së vet. Shqipërisë i erdhi radha në qershor 1863. Pas tetë ditësh udhëtimesh u bind në vend se versioni toskërisht i përkthimit me shkronjat greke (1827) nuk ishte i përshtatshëm për t’u përdorur në Veri, madje shkodranët i kërkuan që të shtypej një Bibël me shkronja latine (letër e tij nga Bari më 22 qershor 1863). Nisi të gjurmonte për një përkthyes të aftë shqiptar dhe një redaktor për dialektin e Veriut. Ky skocez fisnik i përkushtuar<sup>4</sup> këtej e tutje jo vetëm do të jepte ndihmesë të jashtëzakonshme për botimet shqip, por edhe do të na linte një dokumentim të pasur, që nuk e ka pasur fat asnjë rilindës tjetër i asaj periudhe. Në dokumentet e agjencisë në Stamboll ai u njoh me gjithë praktikën e Laundzit dhe e hetoi se Kristoforidhi ishte kandidatura më e përshtatshme.

Pashmangshmërisht edhe Tomsoni do të mendonte në radhë të parë për alfabetin. Duke iu përgjigjur Sebastian Bellos më 19 mars 1864, i premtoi se do të përgatitej një përkthim besnik i Ungjijve me alfabetin latin. Edhe në letrën e parë për Kristoforidhin (dhjetor 1864) i thoshte se kishte nevojë për një përkthim me shkronja latine. Më 18 janar 1865 shprehej se prej kohësh e kishte ndier nevojën që shkrimet e shenjta të bëheshin në shqipen veriore me shkronja latine për katolikët. Kristoforidhi iu përgjigj (janar 1865), se e kishte Dhiatën në të dy dialektet, por me shkronja greke; do ta kishte shumë të lehtë që ta rishkruante me shkronja latine. Tomsoni, që e kishte marrë seriozisht punën, zgjodhi ndërkaq edhe variantin e alfabetit, duke qenë i sigurtë se do të gjente një komplet shkronjash në Londër. Puna e germave nuk është diçka anësore. Shqiptarët që vendosnin të zgjidhnin ose të përpunonin një alfabet, nuk mund ta anashkalonin një vështirësi të madhe teknike: cila shtypshkronjë do të pranonte të shtypte libra me germa të pazakonshme ose të shpikura? Edhe pas shpikjes së linotipit, derisa doli radhitja me kompjuter, matricat kanë qenë kurdoherë të shtrenjta.

Më 22 shkurt Tomsoni i shkroi Londrës, duke vënë në dukje se shumica e popullsisë katolike ato shkronja përdorte, por nuk mund të zbatoheshin thjesht shkronjat latine për gjuhën shqipe. Në këtë letrë të fundit të Tomsonit, para se Kristoforidhi të shpërngulej nga Tunisi në Stamboll, del një element i ri: ai propozonte, që ta përgatiste Dhiatën e re edhe në dialektin e jugut me alfabetin grek të modifikuar.

Këtu zë fill dyzimi i mëvonshëm në përkthimet e botuara të Kristoforidhit dhe kjo është provë bindëse, se ky dyzim asnjëherë nuk e ka pasur zanafillën te Kristoforidhi. Punonjësit e BFBS, që përballonin qindra gjuhë e dialekte të botës, kishin njohuri të gjera për këtë fushë. Tomsoni propozoi të merrej edhe për shqipen sistemi alfabetik i përgatitur nga Karl Rikard Lepsius (1810-1884). Ishte një egjiptolog i njohur, profesor në Universitetin e Berlinit, që kishte hartuar një alfabet, i cili duke shtuar shenja diakritike dhe nja dy shkronja greke, mund t'u përgjigjej kërkesave për të paraqitur edhe tingujt e shqipes. Komplete të këtyre germave mund të silleshin nga Londra në Stamboll.

Por cilat do të ishin ndërlikimet kur të zbatohet Lepsius për t'u përgjigjur drejtshkrimit të shqipes? Kundërshtimin e parë Tomsoni e ndeshi nga përfaqësuesi në agjencinë për Greqinë, Kalopothakesi, i cili në mars 1865 i shkruante, se alfabeti latin do t'i fyente ortodoksët si shqiptarë edhe grekë. Po ndodhte një kthesë në traditën e botimeve të Shoqërisë Biblike dhe Kalopothakesi si grek i mbronte pa mëdyshje ngjyrat e veta, aq sa të guxonte të fliste në emër të ortodoksëve shqiptarë. Nga Londra Tomsoni mori përgjigje, se i kishin dy dorëshkrime të ungjillit të Mateut me shkronjat greke, që i kishte përfunduar Kristoforidhi më 1860, dhe do të dërgoheshin në Stamboll, që perkthyesi t'i kthente në alfabetin e ri me shkronja latine. Xheksoni nga qendra shprehu miratimin për të rishikuar një dorëshkrim të Mateut dhe vetëm pas verifikimit, të vazhdohej më tej. Në prill 1865 Tomsoni shkon edhe një hap më tej: nuk mjaftonte pranimi i alfabetit

të Lepsiusit, duhej diskutuar edhe një drejtshkrim, i cili të mos kërkonte pastaj prerjen e germave të tjera. Për këtë i kishte premtuar ndihmë një dr. Rigo nga Shoqëria Misionare Kishtare. Për fat të keq, në këtë fazë Tomsoni dinte fare pak për traditën e shkrimit të shqipes, sepse njihte vetëm katekizmin e Belarminos shqip (Doktrinën e Kërshtenë të P. Budit, 1618) dhe asgjë tjetër të shtypur.

Ndërkohë Tomsoni gjeti edhe redaktorin, një shkodran të ri të arsimuar, Nikollë Gjon Serreqin. Në fillim të majit 1865 Serreqi erdhi në Stamboll, kurse Kristoforidhi erdhi në fund të muajit. Mbeti i kënaqur nga aftësitë e redaktorit dhe ia nisën punës së bashku. Kristoforidhi nga ana e vet i paraqiti Tomsonit dorëshkrimet e gjithë përkthimit gegërisht me shkronja greke, njësoj si për toskërishten.

Asnjëri prej të dyve, as Kristoforidhi dhe as Tomsoni, nuk e kishin parashikuar, që pas takimit fatlum, gjëja e parë për të cilën do t'u lindnin mosmarrëveshje, do të ishte pikërisht alfabeti. Kristoforidhi kishte mbi tryezë dorëshkrimin e Mateut të vitit 1860 gegërisht me alfabetin grek dhe do të niste ta rishkruante. U mbledhën që të tre bashkë dhe e shqyrtuan në mënyrë të plotë e të gjithanshme çështjen e alfabetit që do të përdornin (letër e Tomsonit për Xheksionin, 15 qershor 1865). Përfunduan se do të zbatonin Lepsiusin, duke hequr dy shkronja greke (për h dhe g). Kristoforidhi e bëri transkriptimin dhe nisi rishikimin gjuhësor me Serreqin. Duke përparuar me ungjijtë e tjerë, ata diskutonin për çdo vështirësi që hasnin dhe atëherë doli në shesh diçka tjetër. Serreqi vinte nga Shko-

dra, ku përdorej alfabeti i autorëve të vjetër, me pak ndryshime të mëvonshme që e thjeshtonin. Ai tregoi se ky sistem njihej nga populli e me të shkruheshin edhe letrat. Qarkullonin gjithashtu katekizma dhe libra liturgjikë me atë alfabet. Serreqi më në fund e kundërshtoi hapur Lepsiusin. Me të u bashkua edhe Kristoforidhi dhe në shtator 1865 Tomsoni informon se i kanë lindur disa ndërlikime lidhur me alfabetin deri në atë shkallë, sa nga pasiguria do të pranonte një botim provë vetëm për dy kapituj të Mateut.

Kështu, dy shqiptarë në verën e vitit 1865 në Stamboll hapën një diskutim për alfabetin e shqipes lidhur me një botim të rëndësishëm, i cili do të shtypej realisht, domethënë nuk ishte një diskutim abstrakt për alfabetin e shqipes, qoftë edhe me shumë zell atdhetar, por që nuk i drejtohej askujt. Historianët tanë të alfabetit gjithmonë i kanë shpërfillur rrethanat objektive dhe konkrete që e përbëjnë historinë, prandaj në mënyrë spekulative i janë drejtuar vetëm zellit atdhetar. Zgjedhja e përcaktuar më pas do të kërkonte shpenzime dhe punë me tipografë të huaj, do të përfshihej në përshtjellimin për shkak të mungesës së një alfabeti të vetëm të shqipes, do të përballonte shqetësimin nëse do t'i qëndronte kohës, do të ndërhynte në mësimin nëpër shkolla dhe në botimin e gazetave, do të përcaktonte fatin e librave të shtypur: a do ta pranonin lexuesit shqiptarë atë zgjidhje? Ishte një zgjidhje e pandashme nga aspektet praktike, teknike dhe financiare, por sidomos nga tradita dhe nga orientimi kulturor, që vepronin në kushtet e sundimit të gjatë osman në Shqipëri, domethënë që do të ballafaqohe-



shin edhe me aspektet politike, ligjore e ideologjike të autoriteteve sunduese, po edhe me problemet që ato kishin me popullsitë e tjera nën sundim dhe të cilat gjithashtu luftonin për vete, edhe me problemet kundrejt fuqive të mëdha, të cilat e shfrytëzonin sipas interesave të vet Perandorinë Osmane, duke pasur njëkohësisht planet se çfarë do të bënin me viset e popullsitë, kur asaj t'i mbaronin ditët në Ballkan.

Përpara vështirësive, në udhëkryqe, Kristoforidhi ose merrte një vendim të krisur, ose mblidhte forcat intelektuale dhe e jepte zgjidhjen me një vepër. Në këtë mënyrë u përfatuan punimet dhe dorëshkrimet e përkthimeve të para më 1857-1860. Këtë radhë ai përgatiti një *Vështrim krahasues të sistemeve alfabetike*. Nuk e kam gjetur atë, por pasqyrat e alfabeve, të botuara më pas në librat e tij, pa dyshim e kanë këtu burimin. Në vend të dy faqeve të zbërthyera pak më sipër prej dorëshkrimeve më 1860 që u drejtoheshin katër gjuhëve si mjete sqarimi, janë parashtruar sisteme alfabetike të gjuhëve të ndryshme. Ia dorëzoi vështrimin Tomsonit. Diskutimi kështu u nxeh dhe u kthye në debat. Kristoforidhi i foli mjaft fort, për të treguar se sistemi i Lepsiusit i përshtatur për shqipen ishte i ndërlikuar, i pakuptueshëm e kështu më tej, dhe populli nuk do ta pranonte. Në debat ai pati mbështetjen e plotë të Serreqit. Tomsoni u zu ngushtë. Ai nuk e mohoi, se kishte argumente për ta hedhur poshtë. Megjithatë i propozoi Kristoforidhit ta shkruante Predikimin në Mal sipas traditës shkodrane. Nuk doli aq e thjeshtë dhe që të tre u bindën se nuk mund të zbatohet ashtu siç ishte. Përfundimin Tomsoni ia ka para-

shtruar Xheksanit më 20 shtator 1865: realisht zgjedhja mbetej midis dy sistemeve, që të dy përbënin novacione kundrejt alfabetit tradicional të Veriut. Ai do të ngulte këmbë për Lepsiusin, duke e paraprirë botimin me një çelës, ku të përfshihej edhe sistemi i përdorur në Shkodër. Dhe vërtet ashtu u bë. Por në atë çast Tomsoni ishte i lëkundur, aq sa të shfaqej ideja se mund të bëhej një shtypje në shtylla shqipe paralele sipas të dy stileve (siç kishte qenë botimi i vitit 1827 në dy shtylla: greqisht dhe shqip)! Londrës i dërgoi tabelën e Kristoforidhit, duke e shoqëruar me tri vërejtje. Variantin e Kristoforidhit të mbështetur në alfabetin shkodran e quan të vështirë e me të meta. Sistemi ekzistues shkodran kishte dy shenja origjinale, dy greke dhe një sllave. Së fundi, e mbron sistemin e Lepsiusit për saktësinë e tij. Sidoqoftë, ai e mirëpriste që dikush nga Londra të bënte një shqyrtim e krahasim të varianteve. Komiteti u përgjigj në tetor, se ia linin Tomsonit dhe miqve të tij në Stamboll që ta zgjidhnin çështjen. Nga letra e 28 shtatorit (dokumenti 30), del e qartë se Kristoforidhi ka qenë për të kaluar në alfabetin me bazë latine, të përdorur nga autorët e veriut, duke i bërë disa ndryshime të nevojshme (të hiqeshin pikërisht 5 shkronja jo latine të tij). Mos ishte një rimarrje e idesë së vitit 1857? Kristoforidhi ka luftuar me forcë kundër idesë së Tomsonit edhe pasi ajo ishte sanksionuar nga Komiteti në Londër, i ka paraqitur edhe vështrimin krahasues të alfabeveve, me sa duket ka pranuar deri edhe idenë që shtypja të bëhej në dy shtylla paralele me të dy alfabetet. Në këtë vështrim krahasues ka qenë pra varianti i Kristofori-

dhit i mbështetur te alfabeti i shkrimtarëve të veriut. Është i dyti variant i tij, për të cilin kemi njoftime, por jo dëshmi konkrete.

Kundërshtimi i Kristoforidhit edhe këtë radhë ka qenë pa dobi, por jo pa ndonjë ndikim. Tomsoni do ta pohojë në korrik 1867 se ende nuk e njihnte gjuhën shqipe dhe prandaj i ka pranuar pa kundërshtime shenjat për gjatësinë, shkurtësinë dhe hundorësinë, që i kishte kërkuar Kristoforidhi për saktësi, dhe shtonte se: “natyrisht, unë jam nisur prej tij.” Kam bindjen se me këmbënguljen e Kristoforidhit shpjegohet, përse u vendos paraqitja e një çelësi në botimin e vitit 1866, ku vlere e shenjave të reja shpjegohet me shkronjat e alfabetit të veriut, dhe kjo vijoi deri në botimin e plotë të Dhiatës së re gegërisht më 1872.

Komiteti i Botimeve në Londër e sanksionoi alfabetin e Lepsiusit në shtator 1865 dhe kjo është data e tij për gjuhën shqipe. Deri në tetor 1865 arritën të përpunonin dy të tretat e Dhiatës së re, duke i rishkruar me alfabetin e ri variantet e sjella nga Kristoforidhi, po ndërkohë germat ende nuk kishin ardhur. Shtypshkronja e zgjedhur prej Shoqërisë Biblike ishte e armenit A. H. Bojaxhian. Mëdyshja e lindur për shkak të alfabetit ishte: të bëhej një provë vetëm me ungjillin e Mateut, apo të shtypej gjithë Dhiata e re. U gjet një zgjidhje e mesme: të shtypeshin vetëm katër ungjijtë dhe Punët e apostujve. Tomsoni mbeti i pakënaqur: më 16 nëntor shkruan se e pranon pa dëshirë vendimin, por e ngushëllon veten se këtë e bën për hir të drejtshkrimit. Arkat me germa u nisën nga Brenda në fund të nëntorit dhe viti i ri do ta gjente Kristoforidhin

duke ndrequr bocat. Kështu, në fillim të vitit 1866, dyzet vjet pas Meksit, doli i shtypur për herë të parë, me sa dimë deri më sot, një variant gegërisht i pjesës më të madhe të Dhiatës së re me titullin *Katër ungjillat e Zotit edhe Shelbuesit tonë Iesu Krishtit edhe Punët e Apostuivët*. Në faqen e tretë jepet treguesi i permbajtjes me titull “Tabula”, fjalë e cila në vetvete është tregues se ndiqet tradita latine. Në faqen e gjashtë është “Çilsi i disa letrave”, ku janë dhënë 19 shkronja dhe katër dyshkronjësja të alfabetit sipas Lepsiusit, të interpretuara me shkronjat e përdorura në traditën që nga autorët e vjetër shqiptarë. Trajtat shkodrane të fjalëve janë për shkak të redaktimit të Serreqit. Më vonë Kristoforidhi do t’i mënjanonte tërësisht ato gjatë gjithë tekstit dhe prandaj ky botim i parë i Kristoforidhit në të vërtetë nuk përfaqëson konceptet e tij gjuhësore.

Si njeri serioz, duke mos e quajtur të mbyllur diskutimin, përderisa Kristoforidhi me Serreqin kishin qenë aq të prerë, Tomsoni vendosi që ta verifikonte në vend rezultatin e punës dhe ndërmori në maj 1867 një udhëtim nëpër Shqipëri. Si një ndër qëllimet kishte të hulumtonte, nëse do të ishte e këshillueshme të ngulite këmbë më tej për sistemin e Lepsiusit. Rrugës nga Stambolli ndaloi në Syra dhe i bëri një vizitë J. G. fon Hanit, i cili i foli shumë mirë për Kristoforidhin. I dhuroi një kopje të Abetares dhe më pas Tomsoni i dërgoi edhe një kopje të botimit shqip, kurse J. G. Hani nga ana e vet i dërgoi për Kristoforidhin një kopje të veprës së P. Bogdanit, botuar më 1685. Kristoforidhi i ka thënë Tomsonit, se ishte një libër me legjenda, i shkruar njësoj me atë stil që kishte përdorur

edhe vetë. Është dëshmi se Kristoforidhi e quante të kënaqshëm alfabetin e vet të propozuar mbi alfabetin e përmirësuar të autorëve të vjetër. Gjatë takimit në Syra Tomsoni e bisedoi edhe këtë pikë me albanologun dhe pohon, se ai "e miratoi pa hezitim zbatimin e sistemit të Lepsiusit si më të mirin pa asnjë dyshim". Duke e mbyllur reportazhin e vet, Tomsoni i pranonte vështirësitë që po krijonte sistemi i ri alfabetik: "Pa dyshim, ka disa pengesa në këtë rrugë dhe një prej tyre është zbatimi nga Shoqëria i një ortografie pak të ndryshme nga secila që përdoret midis çdo shtrese të popullsisë muhamedane, ortodokse ose katolike. Por edhe në këtë pikë unë mendoj se rruga jonë ka qenë e drejtë".

Një muaj pas udhëtimit Tomsoni, që ishte në Bukuresht, mori një letër nga Sellari (William Sellar, depozitar i BFBS në Stamboll). E njoftonte se një farë dr. Hyde Clarke i kishte dërguar një letër revistës *Athenium* dhe një *Earl Street*, ku e qortonte zbatimin e sistemit të Lepsiusit në Ungjijtë shqip, të cilin e dënonte si të ngatërruar aq sa nuk do të ishte në gjendje ta lexonte asnjë shqiptar. Arrinte deri aty, sa ndërmarrjen e Tomsonit ta quante një 'aventurë'. Tomsoni më 13 korrik 1867 i shkruan Nolekut në Londër, duke i mbrojtur meritat e brendshme të sistemit të Lepsiusit. Pa e fshehur se kishte vendosur jo pa mëdyshje të rekomandonte Lepsiusin, parashtron një argumentim të hollësishëm dhe interesant, për të cilin lexuesi mund t'i drejtohet dokumentit nr. 43 në botimin tim<sup>5</sup> të vitit 2005. Është e pamundur të mos vihet re ngjashmëria me diskutimin që lindi për alfabetin e botimit të Mek-

sit dhe me letërkëmbimin që na e ka ruajtur T. P. Plati. Tani është Tomsoni i cili shqyrton shkronjat një nga një. Sipas tij, Lepsiusi ka vetëm dy shkronja greke, bën dallimin me rëndësi për shqipen ndërmjet *e*-së dhe *ë*-së, përdor 7 shkronja njëshe në vend të dyshkronjëshave, ka një shenjë për të treguar hundorësinë dhe për gjatësinë e zanoreve. Tomsoni jep edhe një argument jashtëgjuhësor: librat ishin destinuar jo vetëm për katolikët, por edhe për myslimanët e ortodoksët. Dhe me të vërtetë, myslimanë e ortodoksë, në Stamboll e në Shqipëri, i kishin pritur me gëzim librat. Noleku e ndoqi më tej çështjen dhe prandaj e zgjoi edhe një herë të mirënjohurin Laundz, që më 1867 ishte mbi 75 vjeç. Edhe përkthimi i Mateut me shpenzimet e Bonapartit tërthorazi e prekte Tomsonin lidhur me alfabetin.

Si mbështetje për argumentimin e vet Tomsoni citon edhe fjalët e Kristoforidhit, me vlerë historike për karakterizimin e gjithë lëvizjes sonë kombëtare, se dalja e këtyre librave me një drejtshkrim kaq të thjeshtë e të plotë ka zgjuar midis njerëzve shijen për gjuhën kombëtare. Zgjimi i shijes për gjuhën amtare ishte një nga qëllimet madhore të Rilindjes sonë. Një pjesë po aq domethënëse e përbëjnë radhët vijuese: "Nuk është një kënaqësi e vogël të shohësh grekët, ose më mirë shqiptarët e kishës greke, të gatshëm në këtë rast ta kapërcejnë përdorimin e alfabetit grek dhe të përdorin libra, që në fakt ishin caktuar për katolikët." Kjo është një provë e pakundërshtueshme, se edhe Kristoforidhi, edhe lexuesit e tij ishin të etur për fjalën e shkruar shqipe dhe nuk qëndron asgjëkundi mendi-

mi, se alfabetet e tij i shërbenin përçarjes së shqiptarëve. Librat e tij janë lexuar nga myslimanë, nga ortodoksë e nga katolikë shqiptarë, janë lexuar me shkronja latine dhe me shkronja greke sipas rastit, aq më tepër që Kristoforidhi nuk mund t'i ndryshonte me një të rënë dallimet e krijuara prej traditave. Edhe të vëllanë e qeveritarit të Elbasanit Tomsoni e gjeti me një kopje të Abetares në dorë, madje e ndihmoi për të përvetësuar alfabetin e ri. Ishte abetarja gegërisht, me shkronja latine sipas Lepsiusit, në duar të një myslimani nga Elbasani. Në Gjirokastrë Tomsoni vizitoi myftiun. Aty lexoi disa copa nga ungjijtë dhe nga Abetarja gegërisht, të cilat gjithë të pranishmit i kuptuan për bukuri dhe librat ngjallën shumë interes. Në një han të Tiranës takoi një të ri, i cili ishte i lumtur se kishte gjetur një kopje të Abetares, por nuk kishte dëshirë ta pranonte që këta libra ishin botuar me ndihmën e të krishterëve të huaj! Natyrisht, në Elbasan dhe gjatë udhëtimit Tomsoni takoi mjaft ortodoksë, që e kishin marrë librin drejtpërdrejt nga autori. Kur u kthye në gusht në Stamboll, Kristoforidhi i vuri në dukje kënaqësinë që ndiente, kur merrte vesh se libra me alfabet latin, të caktuar për katolikët, ishin pritur me gëzim nga ortodoksët, pavarësisht se këta ishin mësuar me alfabetin e greqishtes. Ky është një dokumentim i qartë i vitit 1867.

Parimet e alfabetit të Lepsiusit vlenin për shkrimin e mjaft gjuhëve afrikane. Të zbatuara për shqipen, ato krijojnë mundësinë që tekstet në gjuhën shqipe të lexoheshin me lehtësi në shkallë ndërkombëtare. Nuk mund të mohohet se ato jepnin zgjidhje të do-

bishme edhe për të arritur, që alfabeti i shqipes të ngarkohej me sa më pak dyshkronjësha, germa nga alfabetet të ndryshme dhe shenja të ndërlikuara diakritike. Duke folur për Mjedën, pavarësisht se e quan alfabet të Kristoforidhit, M. Quku<sup>6</sup> shkruan: “Si pikënisje për alfabetin e tij Mjeda zgjodhi alfabetin latin të Kristoforidhit, ku përdorëshin 10 shkronja me shenja diakritike dhe 4 shenja binjake. Mjeda e pranoi alfabetin e Kristoforidhit para se të hyntë në kontakt me G. Majerin, të paktën që më 1887. Zgjedhja e alfabetit të Kristoforidhit nuk qe diçka e rastit, por u nxit nga motive atdhetare. Në alfabetin e Kristoforidhit Mjeda pëlqeu karakterin latin të shkronjave, si dhe mundësitë që jepte ai alfabet për bashkim me rrethet patriotike që përdornin alfabetin e Stambollit. Të dy alfabetet mbështeteshin në parimin: ‘Një tingull – një shkronjë.’” Këta rreshta nuk kanë nevojë për komente të tepërta dhe dëshmojnë se rrjedha e kohës e shfrytëzoi anën e dobishme të një alfabeti mbi parime të rregullta.

Shihej kthjelltas se mbështetja më e mirë për qarullimin e përkthimeve të reja do të ishte përpilimi i një abetareje, i një udhëzuesi të thjeshtë për të mësuar leximin. Për herë të parë Tomsoni e përmend në një letër më 8 nëntor 1865. Pasi shpreh kënaqësinë për miratimin e alfabetit të Lepsiusit, shton: “Kristoforidhi duhet të shtypë një abetare për këtë sistem.” Kjo do të thotë se, me të mbaruar rishikimin e Katër ungjijve, i ka kërkuar të merrej me abetaren. Ideja ishte shumë e pëlqyeshme, por kishte një pengesë të pakapërcyeshme. Shoqëria Biblike nuk ishte ndonjë fondacion për arsimin; në fund të fundit këtu kishte edhe



një anë financiare dhe ajo nuk kishte para për veprimtari të tilla. Tomsoni e shihte se Kristoforidhi kishte plotësisht të drejtë, kur kërkonte që në radhë të parë duhej përhapur arsimit shqip në popull, prandaj i ka shkruar Londrës, se ai më tepër mund të përdorej për arsimimin e vendlindjes. Ndërkaq, nuk mund të shkonte kundër udhëzimeve të qendrës së vet. Për shumë vjet në letrat e raportet e tij shfaqet qartë kjo përplasje ndërmjet dy anëve të kundërta. Është përpjekur t'i pajtojë, me vetëdijen për seriozitetin e punës duke kapërcyer vështirësi, herë-herë në cakun e fundit. Bashkë me Kristoforidhin gjetën një zgjidhje të mençur: për librat e tjerë, përveç Biblës, do t'i drejtoheshin një botuesi tjetër: Shoqërisë së Broshurave Fetare (RTS).

*Abetarja shqip me figure* është libri i dytë i Kristoforidhit, që doli nga shtypi në fund të vitit 1866 nëpërmjet RTS nga po ajo shtypshkronjë në Stamboll. Në faqen e parë jepen shkronjat: *Kapitale, italike dhe trazumun*. Janë terma që përkthejnë fjalë përkatëse të anglishtes (*capitals, italics, mixed*), domethënë të abetares anglisht, që ia kishte dhënë Tomsoni për ta pasur si gjedhe. Kuptimi i fjalës 'trazumun' është: jo sipas rendit alfabetik. Janë 32 shkronja njëshe. Kështu, vijnë në fillim 21 shkronja të thjeshta latine, pastaj 11 shkronja me shenja diakritike. Këto të fundit janë për: dh, gj, nj, rr, sh, th, zh, ë, l, y, q. Mes shkronjave latine janë vetëm dy greke, për *dh* e *th*. Duket qartë se me sistemin Lepsius janë pakësuar ndjeshëm dyshkronjëshat. Përsëri duhet vënë në dukje se ky botim është i redaktuar nga Serreqi, domethënë nuk përbën një pasqyrë të

mendimeve autentike të Kristoforidhit për shqipen. Vërtetimi është i thjeshtë: më 1872 *Abetari shqip* është ribotuar duke e fshirë atë redaktim dhe gjuha ka ndryshuar në përputhje me gjithë shkrimet e tjera të autorit. Mjafton fjala e parë 'Trazumun', e cila tashmë bëhet 'Përziem'. Ashtu si në vitin 1860 vijnë menjëherë zanoret, diftongjet dhe rrokjet me bashkëtingëlloret.

Si praktikë e përhershme në të gjitha botimet e mëvonshme gegërisht menjëherë pas kopertinës do të vinte tabela e plotë me titullin "Alfabet shqip", domethënë e alfabetit të përpunuar sipas Lepsiusit, duke vënë krahas në kolona shkronjat përkatëse prej alfabetit sllav, grek, latin të Veriut dhe arab. Dëshiroj ta theksoj qartë, se këto nuk janë alfabetë të gjuhëve të huaja, por janë alfabeti i shqipes sipas sistemit Lepsius, i shprehur me shkronja të tri gjuhëve të huaja dhe të alfabetit të Veriut. Prandaj janë nën titullin e përbashkët "Alfabet shqip". Cilido që zotëronte një prej këtyre tri gjuhëve të huaja, mund të mësonte të lexonte shqip tekstin përkatës. Përveç 32 shkronjave njëshe, në fund vijnë edhe katër dyshkronjësja për: *c, ç, x, xh*. Jemi plotësisht të alfabeti i përshtatshëm për tingujt e shqipes, që do të merrte trajtën përfundimtare më 1908. Porse në librin e parë të Kristoforidhit më 1866 (domethënë pa numëruar përkthimin), është dhënë "Çilsi i disa letrave". Fjala 'letër' këtu ka kuptimin e shkronjës, ashtu si në italishten. Janë përzgjedhur ato me shenja diakritike, dy shkronja të greqishtes (dh, th), dhe të gjitha çiftet që kanë nevojë për dallime, pra: e-ë, g-gj, k-q, l-ll, r-rr, s-sh, u-y, z-zh, e kështu bashkë me 'n' me shenjë për 'nj' bëhen gjithsej 19

shkronja; atyre u shtohen katër shkronjat dyshe (për *c*, *ç*, *x*, *xh*). Krahas këtyre jepen përgjegjëset në alfabetin shkodran, që kanë për ilustrim fjalë përkatëse me përkthim italisht. Është pra një aparat posaçërisht për shkodranët, që kishin në përdorim një alfabet dhe që kuptonin italishten, e njëkohësisht pa alfabete me shkronja të gjuhëve të tjera, të cilat më pas do t'u shtoheshin librave të llogaritur edhe për të rriturit, që mund të njihnin gjuhë të tjera, ndërkohë që do të hiqeshin krejt fjalët ilustruese. (Te botimet toskërisht, përkundrazi, mbeteshin fjalë ilustruese, ndonëse të ndryshme nga dorëshkrimi i vitit 1860). Është po ai çelës, që e kishte përkthimi i parë më 1866 sipas kërkesës së përkthyesit elbasanas. Si shoqërues të Abetares Kristoforidhi përgatiti edhe një katekizëm, një botim i thjeshtë, që u drejtohet fëmijëve, ashtu si në shkollën e zakonshme nga abetarja kalohet te libri i leximit. Në fund të vitit 1867 doli *Katrë kateqisma për çunat e vogjilë*. Në faqet 2-3 pas kapakut është "Truveza e letrave", domethënë është ndryshuar fjala "Tabula" e vitit 1866.

Njohja me botimet gegërisht i bëri shqiptarët ortodoksë ta prisnin me padurim botimin toskërisht të Abetares, por duhej të vinin geramat përkatëse dhe ato erdhën shpejt. Në fund të vitit 1867 doli *Allfavitar shqip*. Për herë të parë në historinë e shqipes së shkruar po botohej i njëjti libër në dy variante të shqipes së shkruar, nga i njëjti autor dhe me dy alfabete të ndryshme. Për shkak se kishin mbetur dy faqe pa gjë në fund të librit, është dhënë alfabeti i dorës me bukurshkrim dhe një faqe me titullin "Urat' e Zotit" si ilus-

trim. Në fillim, në faqe të panumërtuara, jepet alfabeti i shqipes. Ka 32 shkronja njëshe dhe katër dyshkronjësha, por pa katër kolonat me germa të gjuhëve të tjera si botimi gegërisht. Edhe në botimin e Dhiatës së re më 1879 është po ajo tabelë, vetëm se anash është shtuar një kolonë me shenjat arabe. Por ka një fakt kureshtar, që nuk mund të lihet pa u vënë në dukje. Për ilustrimin e dyshkronjëshave, të cilët dilnin të njëjtë me sistemin e Lepsiusit, pavarësisht nga llojet e alfabeve, janë dhënë katër fjalë: *cuca*, *çuni*, *nxë* dhe *xhepi*. Dy të parat jo vetëm janë fjalë të gegërishtes, por edhe ishin po ashtu si ilustrim në të njëjtin vend të tabelës (Çilsi i disa letrave) më 1866. Fjala e tretë nga “me xanun” është kthyer toskërisht, kurse e katërta mbetet e njëjtë. Dy fjalët e para gegërisht i ka ruajtur edhe në alfabetin për Dhiatën e re toskërisht më 1879. Nuk më mbetet vend për ta shpjeguar këtë me ndonjë shkarje të autorit. Prova është se këto dy fjalë gegërisht kanë mbetur si ilustrime në botimet toskërisht, kurse më 1879 dy fjalët e tjera i ka ndryshuar, i ka bërë: *xixa*, *xhoka*, domethënë e ka hequr fjalën turke. Të gjitha këto mund të duken imtësira të rastit, por prej shumës së tyre del vështrimi kurdoherë tërësor për shqipen i autorit, i cili pavarësisht nga alfabetet e dialektet punonte për lëvrimin e shqipes, i rikthehej asaj që kishte bërë, e ndryshonte ose e pasuronte, e redaktonte dhe e përmirësonte, nuk e shihte të ndarë pasurinë e gjuhës amtare që nga dy shembuj ilustrues në një tabelë alfabeti e deri te gramatika dhe fjalori i shqipes.

Abetarja ishte i pari botim i Kristoforidhit në variantin toskërisht me alfabetin grek të përshtatur sipas Lepsiusit. Edhe këtu duhet shkoqitur qartë, se nuk është alfabet i greqishtes, domethënë nuk ka lexim të shkronjave sipas pozicioneve, përkundrazi, ato e kanë vlerën e vet njësoj në çdo rast. Menjëherë gjeti përhapje kudo dhe këtë radhë ka një njoftim tjetër mjaft interesant. Në Raportin vjetor të përgatitur më 1868 A. Tomsoni shënonte se në Dibër, në luginën e Drinit të Zi, ku nëpër shkolla mësohej serbishtja dhe priftërinjtë ishin ortodoksë sllavë, përsëri populli e priti daljen e librave me kënaqësi. Ky informacion ka bërë përshtypje edhe në Londër deri në atë shkallë, sa W. Canton-i, në librin për historinë e BFBS më 1904 ka shkruar: “Rreth Dibrës në veçanti, në luginën e Drinit të Zi, ku mësohej serbishtja në shkolla dhe sllavishtja përdorej në kisha, priftërinjtë e populli daljen e këtyre librave e përshëndetën me kënaqësi në bisedat rreth vatrës.”<sup>77</sup> Edhe një vit më vonë (Raporti vjetor për vitin 1869, dok. 61), marrim vesh se depozitari në Shkodër von Laer, gjatë udhëtimeve të tij kishte takuar dy veta: “një prift katolik nga krahina e Mirditës, që e ftoi t’i bënte një vizitë, dhe një hoxhë mysliman, i cili ishte shumë i interesuar për ungjijtë shqip, meqë ishin në gjuhën e tij amtare, aq sa 4-5 mbrëmje me radhë i erdhi në dhomë z. von Laer derisa e mësoi mirë mënyrën e leximit dhe atëherë e bleu vëllimin.”

Pa e tepruar mund të thuhet se dalja e kësaj tufe botimesh pati jehonë edhe përtej qarqeve shqiptare. E përmenda se u ngacmua edhe veterani I. Laundz. Në një letër të gjatë të 12 dhjetorit 1867 e ka ringjallur

gjithë historinë e botimeve më 1824 e 1827, me ndonjë pasaktësi të pranueshme pas dyzet vjetësh, po gjithëse si e përmend letërkëmbimin me T. P. Platin rreth alfabetit. Matricat e germave për shqipen nga Korfuzi kishin kaluar në Maltë dhe ende ishin atje. Princi L. Bonaparti, që ndërmoi përkthimet për Ekspozitën e Parisit të atij viti ishte interesuar për përkthimet në Stamboll, domethënë të Kristoforidhit pikërisht për punë të alfabetit. E paraqita letrën e Tomsonit, ku shprehej se ishte gati t'i përgjigjej çdo pyetjeje të princit, por e quante se nuk kishte gabuar duke zbatuar alfabetin e Lepsiusit. Vinte në dukje se e dinte që F. Rossi e kishte Mateun të përkthyer në dialektin e Shkodrës, domethënë me tjetër alfabet.

Rasti tjetër në shkallë ndërkombëtare lidhet me emrin e Petro Raçov Sllavejkovit (1827-1895), një figurë e shquar e kulturës dhe e lëvizjes kombëtare bullgare, i cili nga pikëpamja e veprimtarisë ishte, si të thuash, barasvlerësi bullgar i Kristoforidhit. Më 1866-1872 botonte gazetën "Makedonia", e cila herë pas here jepte informacione nga Shqipëria.<sup>8</sup> Me të ardhur në Stamboll më 1865 Kristoforidhi ishte njohur me të, sepse edhe ai po bënte një rishikim të Dhiatës së re për Shoqërinë Biblike të Londrës. Sllavejkovi e ka ndjekur me vëmendje punën e Kristoforidhit dhe më 28 janar 1867 ka botuar artikullin "Abetarja shqipe", lidhur me variantin gegërisht. Sllavejkovi përgjithësisht ishte për përhapjen e ideve iluministe midis shqiptarëve, por nuk e përkrahte alfabetin latin. Alfabeti mbi bazë latine i dukej i pamjaftueshëm po aq sa edhe shkronjat greke për të dhënë tingujt e shqipes.

Ky ishte argument gjuhësor. Argumenti tjetër kishte natyrë praktike: e quante aq të vështirë, sa nuk besonte që do të hynte në përdorim. Sipas tij, shumë më mirë do të ishte të përdorej alfabeti sllav, sepse do të përshtatej më mirë për të shprehur tingujt e shqipes. Shtonte edhe një argument historik: alfabeti cirilik ishte përdorur që në kohën e Klementit të Ohrit nga ata bullgarë, të cilët ishin fqinjë të shqiptarëve dhe këta e kishin pranuar atëherë dhe e kishin në përdorim deri në kohët e fundit. Këtë e vërtetonin dorëshkrime të ndryshme, që gjendeshin në manastirin e Gjon Vladimirit në Elbasan dhe disa krisobula të Skënderbeut. Sipas tij, edhe në atë kohë kishte vise, ku shqiptarët e kishin në përdorim alfabetin cirilik. Ku i kishte marrë Sllavejkovi këto informacione të sakta? Përmendja e Elbasanit të bën të dyshosh me të drejtë, se diçka e kishte mësuar nga vetë Kristoforidhi. Ideja e Sllavejkovit ishte për një alfabet të përbashkët për gjithë shqipen, si kusht për afirmimin e kombësisë. Propozimi i tij konkret nuk kishte asnjë gjasë të fitonte, sepse ishte në kundërshtim me traditat e rrënjosura në Shqipëri, do të krijonte vështirësi teknike për shtypjen e librave shqip në vendet europiane dhe nga ana politike, do të quhej si një tentativë për depërtimin e rrezikut rus e pansllav. Gjithsesi, në fund të vitit, më 2 dhjetor e përshëndeti punën e shqiptarëve, që blinin libra në gjuhën amtare.

Debati për alfabetin nuk do të mbetej më i mbyllur midis tre vetave, ai do të bëhej edhe me punonjësit e qendrës në Londër, edhe me miqtë e Tomsonit në Stamboll, ndërmjet të cilëve pa asnjë mëdyshje kishte

shqiptarë të tjerë, edhe me veprimtarë ballkanas si Sllavejkovi, e natyrisht, para së gjithash midis veprimtarëve shqiptarë që njëri pas tjetrit po përfshihehin në rrjedhën e madhe të lëvizjes kombëtare. *Ishte hapur diskutimi për alfabetin e shqipes*. Mospajtimi për shkronjat ndërmjet Kristoforidhit e Tomsonit mbetej i pashuar edhe pas daljes së veprave të shtypura. Për më tepër, në debat po përfshiheshin edhe të tjerë një-rëz, jashtë shqiptarëve të interesuar drejtpërdrejt.

Burimi kryesor i përshtjellimeve në trajtimet rreth kësaj çështjeje kanë qenë të dhënat e J. Vretos. Qysh në një letër dërguar S. Kolesë më 23 tetor 1894 ai thoshte: "Që nga 1864 shumë mbledhje e mendime prej shqiptarësh orthodoksë e muhamedanë e katolikë u bënë ndë Konstandinopolë për allfavitë të plotë e të bukurë e të njohurë për gjuhënë shqip". Dy vjet më vonë i shkruante po Kolesë, duke ia dhënë nismën këtë radhë Kristoforidhit, i cili "më 1864 u vu e bindi parësinë e shqiptarëve muhamedanë, që gjendeshin në Konstandinopolë, të mblidheshin para e të viheshin në një trapezë për shkronja e për mësonjëtoreshqip, po na vafisnë". Prej këndeje "Historia e Shqipërisë", domethënë A. Buda, Dh. Shuteriqi, K. Frashëri e të tjerë, përmendin vitin 1864. Besoj se tashmë e kam provuar bindshëm, që kjo datë nuk qëndron. Do të shtoj se më 1861 kishte ardhur në fuqi sulltan Abdyl Azizi, një kundërshtar i reformave, i cili më 1865 nxori edhe një ligj të ri shtrëngues për shtypin. Nuk ishte periudhë lehtësuese për lëvizje shqiptare në Stamboll.

Madje vetë të dhënat e lëna nga Vretoja kanë lëkundje, gjë që nuk është vlerësuar me metodën kriti-



ke, të nevojshme për historianin. Në dorëshkrimin "Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe"<sup>9</sup> hartuar nga fundi i shek. XIX greqisht dhe përkthyer vetëm pas tre çerekë shekulli, bënte një hap më tej, sepse idenë ia atribuonte një rrethi të tërë atdhetarësh: "Nevojën e përdorimit të një alfabeti të vetëm, të përbashkët, që të kish aq shkronja të thjeshta njëformësa sa ka gjuha shqipe zanore e bashkëtingëllore, e ndien në vitin 1867 njerëz të shquar të kombit tonë, që ndodheshin e banonin në Stamboll". Edhe unë, në punimin e botuar më 1973 e quaja të mirëqenë vitin 1867 si fillimin e mbledhjeve për një alfabet të përbashkët të shqipes, meqë ishte dhënë prej një pjesëmarrësi të kohës. Por mosbesimi i grumbulluar pas gjetjes së kaq shumë pasaktësive, më bëri që ta vija edhe këtë në dyshim e ta zhbiroja më hollë.

Kishte ndodhur me të vërtetë një hop brenda dy vjetëve 1866-1867: dolën tre libra gegërisht me alfabet latin dhe menjëherë pas tyre një toskërisht me alfabet grek gjithashtu të përshtatur. "Abetarja toskërisht është në shtyp dhe sapo të shtypet, shpresojmë se do të jemi në gjendje të dërgojmë në shtyp Psalmet toskërisht, ndërsa rishikimi i versionit gegërisht ka arritur deri te Psalmi 103," shkruante Tomsoni më 16 dhjetor 1867. Por ai kishte një vështrim edhe më të gjerë - pas dy muajsh i përmend arbëreshët si 'disjecta membra' dhe thekson: "Dëshiroj që sapo të botohen Psalmet tona, t'u dërgohen disa kopje, si dhe disa nga abetaret tona për t'i përdorur në shkollat e tyre ... Kur të jenë gati Psalmet toskërisht, do të jetë më mirë të dërgohen nga Korfuzi në Bari ose në ndonjë qytet tje-

tër në brigjet e Kalabrisë dhe kështu kursejmë shumë kohë e para. Do të dëshiroja të bëheshin hetime të tilla lidhur me shqiptarët afër Palermos në Sicili. Ata janë nga Kruja, vendi i Skënderbeut dhe i Ungjijve e Psalmëve gegërisht.” Ky po, është vizioni i një njeriu që punon në krye të një agjencie me shtrirje perandorake. Ndërkaq, një shtrirje e tillë ia nxirrte përsëri Tomsonit problemin e alfabetit. Për çdo libër që u binte në dorë, ai dhe Kristoforidhi nuk i shmangeshin po atij diskutimi. Tomsonit i dërguan një botim me “disa këngë kombëtare, të shoqëruara me përkthim italisht.” Tomsoni i ka lexuar dhe i quan poezi me karakter të vërtetë trubadurësh. Besoj se është fjala për *Rapsodie di un poema albanese*, botuar nga De Rada në Firence më 1866. Librin ia dha Kristoforidhit dhe në bibliotekën e mbetur prej tij ka qenë ky botim, kurse në dorëshkrimet e tij ka një përshtatje deri te Kënga 13. Në bisedën e bërë në shtator 1868 Kristoforidhi i ka thënë: “Gjuha është pikërisht e atij dialekti dhe me atë stil, si ai që kam zbatuar në Abetaren tonë toskërisht dhe në Psalmet”.

Debati do të merrte udhë kudo, por sidomos shqiptarët në Stamboll e rrokën qartë, se po viheshin në qarkullim vepra të rëndësishme, me ndikim mbi trajtën e ardhshme të kulturës kombëtare. Aty, në kryeqytetin e Perandorisë, ata e shihnin se çfarë roli luanin botime të tilla për kulturën e popujve të tjerë fqinjë, në rrethana të afërta me shqiptarët (siç përmenda Sllavejkovin). Kristoforidhi ishte nismëtari, në kuptimin se ai kishte bërë një hap vendimtar dhe real, me libra të botuar, por nuk e quante të mbyllur rru-

gën e mëtejshme, siç e provon dokumentimi. Ai ishte jo thjesht i hapur për diskutime me bashkatdhetarët, por e kërkonte mendimin dhe mbështetjen e tyre për fatin e ardhshëm të shkrimit të shqipes. Në këto rrethana do të lindte e natyrshme ideja për mbledhje në Stamboll që të diskutoheshin shkronjat e shqipes, sepse botimet do të vazhdonin. Aq më tepër, që për herë të parë në të njëjtën shtypshkronjë *po shtypeshin libra për gjithë Shqipërinë, abetare që mbulonin dialektet kryesore të shqipes*. Mbledhjet për shkronjat u bënë të natyrshme dhe të domosdoshme. Kristoforidhi ishte i vetëdijshëm për atë që bënte dhe për atë që kërkonte. Dhe nuk qe e vështirë të gjente bashkatdhetarë të përgatitur dhe të prirur drejt kësaj ideje, sepse të gjithë i kishte shituar zana e Rilindjes, të gjithë ishin nën magjinë e Rilindjes.

Pjesëmarrja e Kristoforidhit në përpjekjet për një alfabet të vetëm të shqipes, të filluara më 1867, nuk përbën kështu ndonjë kontradiktë në qëndrimet e tij. Përkundrazi, kjo ishte përgjigjja më e mirë dhe më e drejtë ndaj botimeve të detyruara me dy alfabete të ndryshme sipas kërkesave të BFBS. Edhe në shkrime të mëvonshme ka përdorur alfabete të tjera. Ishte një rrugë kërkimesh, provash e dështimesh, këmbënguljesh e tërheqjesh, porse shqipja vazhdonte të shkruhej dhe çka është më kryesorja, në këtë ecuri praktike dhe jo spekulimesh me fjalë boshe eksperimentoheshin idetë, provoheshin zgjidhjet, përpunoheshin anë të tjera thelbësore të shqipes së shkruar. Tashti që mund ta shohim procesin nga largësia historike, shquhet dukshëm se kështu ka ndodhur edhe me të gjitha pro-

jektet e tjera: alfabeti i Stambollit pati të metat e tij dhe kundërshtarë të fortë, edhe Kongresi i Manastirit e la një shteg kompromisi; siç e kam treguar më sipër, deri vonë ka pasur orvatje të tërthorta për t'i anashkalluar, e gjithsesi asgjë e tillë nuk mund të vlerësohet se i ka shërbyer përçarjes.

Rrethanat kur nisën diskutimet në trajtën e *përpjekjeve të përbashkëta për një alfabet të shqipes* përfshijnë disa aspekte. Atëherë ishte edhe mundësia që I. Qemali, P. Vasa e të tjerë, duke qenë tashmë në Stamboll, të përfshiheshin në këtë rrjedhë, por përveç shkrimeve të J. Vretos, dokumentim për këtë nuk ka. Konteksti historik duhet vështruar më gjerë dhe kjo u takonte specialistëve ta bënin. Me aq sa kam mundësi, po shtoj se më 1867 sundimtarët e Stambollit po kalonin një krizë të radhës. U krijua një Këshill i Shtetit dhe më 1868 si kryetar u thirr Mithat Pasha (lindi më 1822 dhe vdiq i mbytur në burg më 1883). Për të I. Qemali ka thënë, se ishte i vetmi që nuk ushqente paragjykitime kundër kombësive të tjera dhe kërkonte reforma e një monarki kushtetuese. Si guvernator në provincat e Danubit më 1861, krahas reformave administrative e financiare, kishte bërë edhe reforma arsimore. Tashti dekretoi shkollën fillore të detyruar dhe fakte të tilla janë të detyrueshme të shënohen në historitë e bollshme që janë hartuar për arsimin në Shqipëri, po ku dalim sikur të kemi qenë edhe atëherë të izoluar e kundër gjithë botës. Shkollat shqipe nuk ishin lejuar kur nisën reformat e Tanzimatit, sepse ato reforma i jepnin të drejtat mbi bazë fetare dhe jo etnike. Nuk u lejuan as pas vitit 1856, kur ishte shpallur dekreti pe-

randorak (Hatti Humaium), që premtonte trajtim të barabartë për arsim mes gjithë popujve të Perandorisë. Dekreti perandorak (Irade) i vitit 1869 shpallte një ligj organik mbi arsimin publik, duke i ndarë shkollat në dy kategori: publike dhe private. Publiket ishin nën kontrollin e qeverisë, privatet vetëm inspektoheshin prej saj. Kuptohet, që kjo do të përfundonte në një flluskë për të kënaqur diplomacitë europiane dhe pak gjëra do të realizoheshin vërtet. Tomsoni udhëtoi nëpër Shqipëri pikërisht në këtë atmosferë dhe prandaj i ka vizituar me aq kureshtje mejtepet e bashkive. Sidoqoftë, shqiptarët në Stamboll, e ndër ta ishte I. Qemali, mik i ngushtë i Mithat Pashës, nuk mund të mos mendonin në këtë atmosferë edhe për shkolla fillore shqipe, domethënë edhe për abëcënë, që do të mësonin fëmijët.

Gjatë vitit 1868 e mbajtën ndezur interesimin për abëcënë jo vetëm dy abetaret, por edhe njoftimet se do të shtypeshin gjithashtu përkthime të tjera me ato alfabetë. Tomsoni na tregon, se sistemi i toskërishtes do të ishte i njëjtë me atë të gegërishtes sipas Lepsiusit, me përjashtim të shenjës së hundorësisë që hiqej dhe, meqë shkronjat do të ishin greke, dilte e nevojshme të përdorëshin *B* sllave dhe *D* e *J* latine.

Faktori tjetër me peshë ka qenë përpunimi i mëtejshëm në planet e shqiptarëve i idesë për një gazetë shqipe, siç i kishin për vete popujt e tjerë të Ballkanit. Zanafillën e shtypit shqiptar e shohin te arbëreshët e Italisë e të Greqisë me "Shqiptarin e Italisë" (1848) dhe te "Pellasgos" (1860), por të dyja dilnin me tituj jo shqip dhe vetëm pjesërisht me shkrime shqip. Do të

pritej viti 1883 që të dilte një gazetë me titull shqip. Thimi Mitkoja kishte një vështrim mjaft të qartë dhe më 9 janar 1868 i ka shkruar Dh. Kamardës, se do të ishte një punë e mirë dhe e vlefshme për shqiptarët një gazetë vetëm shqip dhe një fjalor shqip e greqisht. Në Raportin për vitin 1868 Tomsoni ka një pjesë, që e vlen të citohet:

"Me sa kam vërejtur nga shtypi publik, ka pasur një plan nga ana e njerëzve me influencë në Shkodër për të botuar atje një gazetë turqisht e shqip, që do të ishte pjesërisht me karakter zyrtar. Unë i lejova vetes të kërkoja ndihmën e ambasadorit të Lartmadhërisë për ta vënë në dijeni qeverinë (osmane) për librat, që janë botuar kohët e fundit nga Shoqëria dhe për sistemin e ortografisë, që është zbatuar në to. Shkëlqesia e tij e bëri këtë dhe zotëria që mendohet të jetë botues i gazetës, më bëri një vizitë e bleu kopje të Ungjijve e të Psalmeve gegërisht dhe ne kemi mjaft besim, se po të dalë vërtet një botim i tillë, pjesa shqipe do të shtypet me ortografinë latine të Lepsiusit. Rëndësia e kësaj për të ndihmuar qarkullimin e Shkrimeve, vështirë se mund të mbivlerësohet, porse ashtu si shumë gjëra të tjera në këtë vend, realizimi i saj mund të shtyhet për një periudhë të pacaktuar".

Mundësia për një gazetë në Shqipëri u përftua në po ato rrethana të krizës së sundimit në Stamboll e të flluskave propagandistike për sytë e botës. Shqiptarët ishin të gatitur për një hap të tillë. Gazeta do të ishte javore, por ashtu siç kishte frikë Tomsoni, realizimi u shty për shumë kohë (ajo doli më 1879 në Shkodër me alfabet arab dhe me titullin "Ishkodra"). Shtjella e ngjarjeve ndërkohë përfshinte disa drejtime. Botimi i një gazete kërkon në mënyrë të mprehtë e të menjëhershme zgjidhjen e punës së alfabetit, domethënë

edhe të germave për shtypshkronjën. Po në atë raport Tomsoni shënonte diçka zemërdhënëse: “Ka një rrethanë interesante, kanë ardhur myslimanë nga të dy grupet gegë e toskë për të blerë Shkrimet e abetaret dhe për të mësuar të lexojnë në sistemin e ortografisë që kemi zbatuar në botimet tona.” Me intuitën e tij të pagabueshme ai e ka rrokur menjëherë thelbin dhe ka ndërmarrë hapa konkretë. Ka vënë në lëvizje ambasadorin britanik, i cili del se ishte Henry Elliot, që kishte ardhur më 1867 në vend të Llajënzit (Lyons). Kjo do të thotë se *çështja e alfabetit të shqipes i është paraqitur nga një fuqi e madhe qeverisë osmane* dhe gjërat nuk kanë ecur në atë mënyrë pothuaj anekdotike, siç është treguar shpesh. Porta e Lartë kishte marrë detyrime edhe për botimet e Shoqërisë Biblike dhe çdo kërkesë nga ana e kësaj e shqyrtonte seriozisht, aq më tepër kur vinte drejtpërdrejt nga goja e ambasadorit të Perandorisë Britanike. (Kjo mund të kuptohet thellë, po të sjellim ndër mend se çfarë ndodh me qeveritarët tanë sot). Shkurt, autoritetet qeveritare turke ishin të parapërgatitura për këtë çështje, pavarësisht se shqiptarët kur u drejtoheshin atyre, nuk i njihnin lëvizjet në prapaskenë në nivelet më të larta pushtetore. Tashti ndriçohet se si mund të vinte në mbledhjen e pak shqiptarëve edhe një kryeministër turk. Nuk e dimë se çfarë biseduan kur e thirri personalisht Tomsoni botuesin e gazetës së projektuar, as na e ka thënë emrin e tij, por ka ngulmuar për qëllimet e veta. Vetëkuptohen përfitimet e jashtëzakonshme për qarkullimin e botimeve të BFBS, në rast se një gazetë do të botohej në pjesën shqipe sipas alfabetit të Lepsiusit.

Ideja për një mbledhje të përfaqësuesve nga vise të ndryshme të Shqipërisë, që të diskutonin për alfabetin e shqipes, tashmë po piqej. Atë e kishin bërë të pranishme shtysat reale historike, që përmenda: librat, gazeta, shkollat, shtypshkronja, përballimi i përhapjes së botimeve në shkallë kombëtare dhe jo brenda qarqeve të veçanta kulturore e fetare, siç kishte ndodhur me shekuj të tërë. Nëse fillimi do të ishte në trajtën e një komisioni për alfabetin, vazhdimi do të ishte institucionalizimi si një shoqëri arsimore-kulturore dhe kështu do të bëhej një hap vendimtar për organizimin e lëvizjes kombëtare. Është e nevojshme ta ritheksoj, se shqiptarët ndodheshin edhe nën ndikimin e shembullit të organizmave të tillë ndër popujt e perandorisë, pa përmendur këtu përvojën e arbëreshëve të Italisë. Vetë turqit, përfaqësues të një rryme rilindëse, kishin formuar më 1865 "Shoqatën e Osmanëve të rinj", ku bënë pjesë edhe figura me prejardhje shqiptare. Më 1867 u themelua organizata "Vëllazëria qendrore kulturore", që mbronte orientimin grek. Sllavejkovi kishte bërë pjesë në disa shoqëri për botimet bullgarisht, e kështu me radhë. Shqiptarët merrnin pjesë në proceset brenda Perandorisë Osmane dhe na duhet ta mënjanojmë qëndrimin që ka përshkuar shkrimet tona, të cilat për inat të kësaj perandorie, i japin gjërat sikur Stambolli nuk ishte kryeqytet shumëkombësh edhe për shqiptarët për disa shekuj, me të gjitha rrjedhimet që ka ky fakt këqfortë. Shqiptarë në Stamboll kishte më shumë se në cilindo qytet të Shqipërisë.

Studiuesit deri më sot janë përpjekur t'i saktësojnë pohimet e J. Vretos, duke iu drejtuar burimeve të



tjera, por pa arritur në një zgjidhje. Burime të tilla të njohura kanë qenë disa. Më 27 janar P. Sllavejkovi botoi një informacion të shkurtër për rezultatet e veprimtarisë së Komisionit dhe nuk pritej gjë tjetër, veçse dekreti i sulltanit për ta zbatuar alfabetin. E quante shumë të thjeshtë alfabetin e ri. Më 15 shkurt 1870, duke shtuar disa fjalë miqësie, Sllavejkovi ka ribotuar një artikull të marrë nga "Courier d'Orient" me titullin "Shqiptarët merren vesh për herë të parë." Nuk e kam gjetur cili ka qenë ky shqiptar nga Shkodra, që dërgoi artikullin, por qëndrimet e tij janë të qarta kundër shkollave në gjuhë të huaj. Po ajo gazetë e Stambollit "Courier d'Orient" e tre marsit 1870 njoftonte për formimin e një komisioni të alfabetit (prej saj e ka marrë A. Dozoni, shih më poshtë). Dh. Kamarda me sa duket po këtë ka ditur, kur shkruante se gazetatat në fillim të vitit 1870 njoftuan se ishte emëruar një komision alfabeti. Është shkruar, se H. Tahsini u kthye nga Parisi dhe e shfrytëzoi këtë për të organizuar takime për rikrijimin e shoqërisë kombëtare. Duke ia çmuar gjithë meritat Hasanit si një nga nismëtarët më të rëndësishëm, unë nuk do ta thjeshtoja kështu çështjen, duke i lënë gjërat në vullnetin e një njeriu, cilido qoftë ai, me çfarëdo 'zelli atdhetar' të lindur. Asnjë shoqëri kombëtare nuk kishte pasur më parë. Gjithçka që po paraqes, është një përpjekje për të argumentuar, se ngjarjet e mëdha përgatiten në një kontekst të madh historik, ku personat me personalitet përfshihen si aktorë dhe si autorë. Që të mos largohem më tej nëpër këto fije të panumërta, po u kthehem dokumenteve, të cilat i çojnë në vendet e tyre edhe burimet e tjera.

Për të mos e ndërprerë shtjellimin me referime, detyrohem ta ndjek, duke i përsëritur disa gjëra. Në vjeshtën e vitit 1869, në vazhden e po asaj krize, qeveria osmane shpalli një plan për arsimin në gjuhët kombëtare. Tomsoni e njofton Xheksonin për të më 11 nëntor e i dëfton se në këtë plan ka disa gjëra të mira. Duke përfituar nga kjo, edhe shqiptarët ngritën një komision për Shqipërinë. Kështu saktësohet një datë me rëndësi: *Komisioni për alfabetin e shqipes është ngritur në mesin e vjeshtës 1869*. Tomsoni shkruan: “Është mbledhur një komision për çështjet e shqipes dhe përkthyesi i mëparshëm i Shoqërisë, z. Kristoforidhi, si një letrar i shquar është zgjedhur anëtar i tij. Mirëpo, ndonëse dihet fare mirë që shkronjat greke janë në përdorim të përgjithshëm midis gjithë shqiptarëve të arsimuar të Epirit dhe shkronjat latine midis të paktën njërit prej katër grupeve të popullsisë në Shqipërinë e Veriut, përsëri u bë një propozim dhe siç duket po gjen mbështetje në qarqet e larta, për të krijuar një alfabet të ri për të gjithë vendin dhe për ta futur në përdorim.” I kishte dëgjuar këto më 10 nëntor. Për herë të parë Tomsoni del kundër një alfabeti të vetëm për shqipen. Arsyeja ishte se puna e tij me shqipen kishte ecur mjaft përpara, ai kishte sjellë germat në shtypshkronjë, kishte shtypur e shpërndarë mijëra kopje librash të cilët ia kishte paraqitur si sukses të vetin Londrës, e kishte shtrirë bashkëpunimin po me ato alfabete me Shoqërinë e Broshurave Fetare dhe kishte në duar punë të tjera. Që lexuesi të rrokë përmasat e vërteta të kësaj pune, përveç katër librave duke përfshirë dy abetaret, që i kam përmendur deri

këtu, janë edhe: Psalltiri toskërisht që shkoi në shtyp në shkurt 1868, Psalteri gegërisht që doli në shtator, Dhiata e re e plotë gegërisht në tetor 1869, Historia e Shenjtës Shkronjë më 1870, e ndërkohë përgatitej një tufë tjetër që i përket vitit 1872. Vrulli i Tomsonit për shqipen kishte shkuar aq përpara, sa tashmë nuk mund të kthente rrugë.

Domethënia e mospranimit të Tomsonit për një alfabet të ri të përbashkët ishte që të mos pranoheshin tre alfabetet e tjera: latin, grek dhe arab. Unë nuk kam dyshim, se përmes rreshtave të tij fjala është për propozimin e Hasan Tahsinit, i cili duket se ka parashtruar që në fillim para Komisionit një alfabet origjinal dhe e ka bërë këtë në krye të javës së dytë të nëntorit. Reagimi i Tomsonit ishte i ashpër, pikërisht për shkak të autoritetit të Tahsinit, i cili ishte edhe rektor i Universitetit të Stambollit, të hapur për herë të parë. Kjo nënkuptohet kur shton, se ky propozim po gjente mbështetje edhe në qarqet e larta (ende nuk kishin shpërthyer përndjekjet kundër Hasanit). Si argument për ta kundërshtuar, Tomsoni thekson se ky propozim do t'i izolonte shqiptarët nga e gjithë bota tjetër. Parashtron si kundërpeshë kërkesën e njohur për ta zënë këtë fushë më parë. Dhe rikthehet atje, ku e kishite hallin gjithë kohën: t'i shkëpuste Komitetit në Londër miratimin për qarkullimin e abetareve shqip. Nuk mund të mos e përsëris një të vërtetë, e cila Tomsonit i del e pamënjanueshme: "Shpesh kërkesa është po aq e madhe për abetare, sa edhe për vëllimin e shenjtë, ose edhe më tepër. Kjo është dy herë më tepër në Shqipëri, ku jo vetëm arsimi është shumë poshtë, por edhe

ne po përpiqemi të fusim një stil të veçantë ortografie. Suksesi i këtij eksperimenti, me sa duket, në thelb varet nga qarkullimi i njëkohshëm i *abetareve* dhe i *ekzemplarëve të Shkrimeve*".

Ishte e natyrshme, që Tomsoni do ta bisedonte më gjatë këtë temë me Kristoforidhin. Sipas letrës së mësipërme, mendimi i shqiptarit tonë ka qenë ky: *qeveria osmane kërkon që myslimanët të mos mbeten prapa të krishterëve, por nuk dëshiron që njëkohësisht të ndihmojë edhe të krishterët; myslimanët shqiptarë i do mish për top për ushtrinë e vet; që t'i mbajë të ndarë nga të krishterët, kërkon ose të fusë në përdorim shkronjat arabe, ose të paktën shkronja krejt të reja. Për ne tani shpjegohet, përse qarqet e larta qeveritare osmane nuk e shihnin me sy të keq propozimin e Hasan Tahsinit.*

Diskutimet në komision vazhduan. Atdhetarët shqiptarë ishin mbledhur për t'u marrë vesh dhe pak nga pak iu afruan alfabetit latin, me nja gjashtë shkronja origjinale, që të mos kishte shumë shenja diakritike e dyshkronjësia. Tomsoni e njoftoi për këtë Xheksinin pas dy javësh (dok. 59) dhe tani ishte më i qetësuar: do të kishte "tri shkronja greke në vend të dy të miave." Një alfabet i tillë do ta pengonte më pak përhapjen e botimeve të Shoqërisë dhe po ta vijonte ajo punën, para sesa "rrotat e dhjamosura të qeverisë të vihen në lëvizje", nuk kishte përse të frikësoheshin. E quante të vështirë t'i përfshinte këto risi në botimet e veta dhe në fund të fundit e quante vetëm një ndryshim në shijet. Edhe më 20 dhjetor Tomsoni thekson se qeveria ende nuk ka marrë hapa konkretë dhe meqë shpenzimet e pritshme do të jenë të mëdha për

shkolla, mësues, libra etj., do të shkojë shumë kohë deri sa të bëhet diçka.

Me mbështetjen e këtij dokumentimi mund të risistemohen të dhënat kontradiktore për këtë çështje kaq me rëndësi në historinë tonë. Ka të drejtë P. Sllavejkovi, se në janar 1870 Komisioni e përfundoi punën. Madje nuk e kundërshton variantin e miratuar mbi bazë latine dhe si iluminist, gëzohet që letrarët shqiptarë do të mund të lëvrojnë gjuhën e tyre dhe letërsinë kombëtare. Por ende ai ka iluzionin se Porta e Lartë do t'i mbështesë për të hapur shkolla. Ai ribotoi artikullin e shqiptarit të panjohur me titullin "Shqiptarët merren vesh për herë të parë", i cili detyrën e Komisionit e quante një nga më të vështirat dhe njëkohësisht nga më të lavdishmet: kjo është detyra për të ringjallur një gjuhë shumë të lashtë. Sllavejkovi e përshëndeti me një koment këtë letër "po aq patriotike, sa edhe të arsyeshme".

Po atë ditë Tomsoni ka përfunduar Raportin vjetor për vitin 1869 (dokumenti 61 në botimin tim të vitit 2005). U rikthehet atyre gjërave që kishte njoftuar, duke e quajtur përsëri ide dashakeqëse propozimin për një alfabet origjinal. Por tani shton disa gjëra të tjera me vlerë informuese, ndonëse kurdoherë ai i përshkruan në prizmin e tij si protestant. Sipas tij, Komisioni ra dakord të rekomandonte një alfabet latin të modifikuar, që shkronjat të mos ndërlikoheshin me konotacione politike. Për më tepër, në planet e Komisionit ishin edhe kërkesat për të përgatitur libra shkollore, për të ngritur shkolla dhe për të siguruar mësues. I gjithë ky plan u përmbys, sepse qeveria ishte e

paaftë të përballonte shpenzimet. Gjithashtu Kisha katolike, e lidhur dorë për dorë me Patrikanën greke ushtruan gjithë ndikimin diplomatik për ta kundërshtuar planin e gjerë, që do t'ua lëkundte pushtetin tiranik mbi shqiptarët. Është mjaft domethënëse, që këto njoftime të Tomsonit përputhen me mendimet e shprehura në historiografinë tonë, se personalitetet shqiptare në atë kohë ngritën çështjen e formimit të një vilajeti shqiptar dhe i kërkuan kryeministrit Ali Pasha të nxirrte nga sulltani lejen për Shoqërinë kulturore shqiptare, por sulltani nuk e pranoi përballë protestave të Sheik-ul-islamit dhe të Patrikanës fanariote. Tollumbacja e qeverisë osmane, e shpallur me aq bujë trumbetash, plasi. Tomsoni ishte i kënaqur nga ky dështim: "me sa duket, ne do ta kemi tashti fushën tonën vetëm".

Duke rilexuar tashti çka ishte shkruar më parë, del se Vretoja ka bërë një gabim prej dy vjetësh. Shqiptarët e shquar janë mbledhur në shtëpinë e Rustem Pashë Leskovikut më 1869, atë vit ishte në Stamboll edhe Hasan Tahsini. Emrat e pjesëmarrësve ia ka dhënë një për një Kristoforidhi dhe bëhen 9, duke përfaqësuar me të vërtetë gjithë shqiptarët. Ata hartuan një relacion drejtuar kryeministrit Ali Pasha, por Vretoja nuk i dinte ndërhyrjet e ambasadorit britanik e të përfaqësuesit të BFBS, dhe as nuk i përmend projektet e shpallura nga qeveria. Kristoforidhi i ka treguar se propozimin e parë për të përdorur alfabetin arab e bëri Rustem Pasha. E kundërshtoi i pari Ismail Qemali, i cili ishte për të modifikuar alfabetin latin ose grek. Me të u bashkuan edhe Pashko Vasa e Kristoforidhi.

Kristaq Efendiu nga Qestorati tha se fjala u takonte atyre, që ishin me kulturë e merreshin me këtë punë: Hasanit, Ismailit, Pashkos e Kristoforidhit. Por Ismaili u largua, sepse u caktua guvernator dhe këtu Vreton nuk e ka tradhtuar kujtesa: me të vërtetë Ismaili u caktua guvernator i Varnës më 1869, gjë që e provon edhe një herë gabimin e Vretos për datat. I erdhi radha propozimit të Hasanit për alfabetin origjinal. Përsëri Vretoja shkruan se gazetat në Stamboll nisën të shkruanin që njerëz të shquar midis shqiptarëve po bënë mbledhje e po shkëmbenin mendime për të bërë të mundur shkrimin e gjuhës së tyre. Edhe këtu Vretoja nuk gabon, por ne e pamë se gazetat shkruan në fillim të vitit 1870, e kjo ka sjellë mëdyshjet e studuesve të sotëm. Së fundi, ai përmend hollësisht përkrahjen e Ali Pashës, që ishte kryeministër pikërisht në vitet 1867-1871, shqyrtimin e çështjes në këshillin e ministrave dhe tolerancën e kryeministrit për t'i afruar shqiptarët. Kundërshtarët e tij i thanë të paktën të mos i inkurajonte shqiptarët, duke shkuar në mbledhjet e tyre. Kjo përputhet me fjalët e Tomsonit, se propozimi i Hasanit po gjente mbështetje në qarqet e larta, porse kishte qenë Tomsoni vetë, që e kishte çuar çështjen te këto qarqe të larta, e prandaj Ali Pasha kishte zbritur poshtë te Komisioni!

Kundërshtarët zyrtarë të një alfabeti për gjithë shqipen janë shprehur haptas, se duhej ndjekur një politikë për t'i përçarë shqiptarët, sidomos me anë të kishës greke. Ali Pasha u tërhoq. Hasan Tahsini i organizoi mbledhjet në dhomën e vet në Stamboll, ku Vretoja mori pjesë edhe vetë më vonë. Me përfundi-

min e punës së komisionit Kristoforidhi do të nisej për atdhe në fund të marsit 1870. Të gjitha datat kësh-tu përputhen me saktësi në këtë renditje, siç e kërkon një historiografi objektive dhe korrekte.

Shahin Kolonja<sup>10</sup> më 1903 u ka bërë një rrëfim të thjeshtë, por jo pa vlerë, ngjarjeve të vitit 1869. Sipas tij, Ali Pasha që e dinte se në Europë nuk qëndronte dot përveçse me kombin shqiptar, një ditë paskish thirrur disa shqiptarë e u kishte thënë që të shkruhej e të këndohej shqipja e të bëheshin shkronjat për të. Kjo përputhet me faktin që qeveria osmane kishte shpallur një projekt të plotë, pavarësisht se Shahini e quan sikur i shkrepi në kokë kryeministrit. Si kundërshtar të Aliut ai përmend ministrin e punëve të jashtme, që nuk mund të pranonte myslimanët shqiptarë të shkruanin e të këndonin shqip dhe doli kundër kësaj pune "me fjalë të firaunta". Ali Pasha hoqi dorë dhe s'u bë gjësendi.

Artikullin e vet Sh. Kolonja e vazhdon me fjalët që kishte dëgjuar më 1902 nga një bullgar plak. Meqë P. Sllavejkovi kishte vdekur, hamendësoj se ky bullgar ka qenë Kristobul Kostoviçi, i cili kishte qenë bashkë me Sllavejkovin anëtar i komisionit për rishikimin e versionit bullgarisht që më 1865. Rrëfimi këtu merr ngjyra pak anekdotike, si çdo gjë e thënë pas shumë vjet gojë më gojë, megjithatë e vlen ta dëgjojmë:

*Mithat Pasha një ditë paska thirrur Kristoforidhin,  
e paska pyetur gjerë e gjatë dhe pastaj i kishte thënë:*

- Shqiptarët duhet të këndojnë shqip, si greku edhe si bullgari, se edhe mbretëria në këtë mendje është; për këtë qëllim do të keni ndihmë nga guvernata.



Ti që përpiqesh për këtë punë, merr ca shqiptarë të mirë, edhe bëni një mbledhje, edhe për çdo nevojë që të keni, ejani këtu e m'i thuaj mua.

*Kristoforidhi kishte dalë fort i kënaqur e me gaz të madh vajti të gjente shqiptarë e t'u thoshte fjalët e halldupit të ndjerë e qëllimet e bukura të guvernës turke për kombin shqiptar. Shqiptarë katolikë nuk kishte, ortodoksët ishin të lidhur e të qepur me kishën greke, e cila shqipen e kishte halë në sy. Meqë punonte në Shoqërinë e Protestantëve, Kristoforidhit nuk i thoshin as mirëdita, e jo t'i afroreshin për të tillë punë. Kristoforidhi ua tha mendimet e Mithat Pashës disa muhamedanëve, të cilëve u erdhi mirë. Me vrap vajti e i tha të madhit halldup, duke pandehur se do të gëzohej, që janë me këtë mendim edhe shqiptarët kryelidhur.*

*Mithat Pasha zuri mjekrën me dorë, u mendua pak e i tha:*

*- S'është mirë të përzihen muhamedanët në këtë punë, shiko të bësh punën me të krishterët.*

*Kristoforidhi u largua i habitur. Kurse Mithat Pasha kishte thënë më pas:*

*- Çudi e madhe! Mundimi i pesëqind vjetëve na paska vajtur kot, s'paskemi bërë turq as softët e shqiptarëve! Ata që do të qëndronin me gojë e me dorë kundër kësaj pune, ata qenkan të parët që dashkan!*

Shahin Kolonja e përfundon, se këto nuk ishin fjalë të ngjizura, por ia kishte thënë bullgari, i cili i kishte dëgjuar nga goja e Kristoforidhit në Stamboll. Në thelb ky rrëfim është i vërtetë. Dh. Shuteriqi<sup>11</sup> i ka

ritreguar fjalët e tij dhe e quan se kjo ka ndodhur më 1877. Është datë e gabuar për shumë shkaqe, mjafton të them se më 1877 Kristoforidhi nuk ishte në Stamboll, ndërsa në shkurt Mithat Pasha iku në mërgim në Brindizi. Nuk qëndron as viti 1872, sikur atë vit Kristoforidhi mori takime me vezirin Mithat Pashën. Kristoforidhi iku nga Stambolli në nëntor 1872, kurse Mithat Pasha u bë vezir më 1873-74. Pastaj përse do të vepronte kështu Kristoforidhi më 1872, kur ai tashmë kishte marrë pjesë, si të thuash, zyrtarisht në një komision më 1869 dhe më 1872 kishte parashtruar idenë e avancuar e serioze për një shoqëri kombëtare? Edhe një studiues i sotëm turk përmend pa ndonjë mëdyshje për vitin 1869 një komision prej tre vetash për alfabetin e shqipes.<sup>12</sup>

Mundësia është vetëm më 1869, kur Mithati ishte kryetar i Këshillit të Shtetit të krijuar gjatë krizës. Ai vërtet do ta ketë thirrur Kristoforidhin pas ndërhyrjes së ambasadorit britanik dhe prandaj është befasuar që Kristoforidhi, në shërbim të Shoqërisë Biblike, na kishte biseduar me myslimanët. Ngjarjet e mëtejshme me punën e Komisionit tashmë i kam shtjelluar. Do të ripërsëris fjalët e Kristoforidhit, të paraqitura në letrën e 11 nëntorit 1869 të Tomsonit, se qeveria osmane i do myslimanët shqiptarë mish për top për ushtrinë e vet e do t'i mbajë të ndarë nga të krishterët. Është po ajo ide te fjalët e Kristoforidhit, të dhëna nëpërmjet gojës së bullgarit plak.

Po në atë kohë kur botonte artikullin Sh. Kolonja, historiani i BFBS Kanton po shkruante librin e tij dhe episodi i Komisionit të alfabetit shqip nuk ka mbetur

pa u pasqyruar në një vepër, që fliste për disa qindra gjuhë e dialekte të tjera të botës:

"Sistemi ortografik i zbatuar nga Shoqëria u bë në këtë kohë një çështje me rëndësi të veçantë dhe më 1869, kur kaloi në shtyp Dhiata e re gegërisht, nuk u ndie asnjë shqetësim nëse do të zëvendësohej me ndonjërin nga alfabetet e reja, të hartuara nga Komisioni shqiptar sipas planit qeveritar për arsimin. Megjithatë propozimet e tyre ishin të lidhura me plane për shkolla të reja dhe me përgatitjen e mësuesve, gjë që qeveria e pa si shumë të kushtueshme dhe veprimtaria e mëtejshme u ndalua nga ndikimi kundërshtues i kishave greke e latine 'të tmerruara nga perspektiva se mund të futej kaq shumë dritë midis popullit'."

I gjithë paragrafi i "Historisë së Shqipërisë" me titullin "Përpyjekjet për organizimin e shoqërisë kulturore dhe çështja e alfabetit të gjuhës shqipe" ka nevojë të rishkruhet. Nga ana tjetër, edhe autorë që kanë shfrytëzuar gjerësisht punimet e mia, nganjëherë pa më cituar fare, duhet më në fund t'i rishikojnë disa pika. Lidhur me Tomsonin, po përpiqem vazhdimisht të provoj, se ai kryente detyrën e tij, madje edhe e ka kapërcyer në të mirë të botimeve shqipe me vetëdijen se rrjedha objektive do ta përlligjte. Pastaj nuk mund t'i mohohet dikujt e drejta, që gjatë dhjetëvjeçarëve të evoluojë në qëndrimet, siç evoluon edhe vetë jeta në kompleksitetin e saj. Provën më të mirë për këtë e kemi nga një letër e Tomsonit e 21 shtatorit 1893, në të cilën gjejmë qëndrimin e tij ndaj alfabetit të Stambollit. Një kopje e saj ruhet në Arkivin e Shtetit, por i mungon hyrja, kështu që nuk i dihej as data. Tani që e kam

gjetur hyrjen dhe e kam saktësuar datën, ajo flet shumë qartë me fjalët e Tomsonit drejtuar vetë Kristoforidhit:

"Juve do t'ju kujtohet, që ishte mendimi im gjithnjë se, meqë toskët e gegët përbëjnë të njëjtin komb, unë kam përdorur dy alfabetë të ndryshme vetëm që të dy pjesët e kombit të ishin në gjendje ta lexonin menjëherë Biblën me ato germa që njihnin, por gjithashtu shpresoja që të shihnim një ditë se do të përdorej një alfabet i përbashkët prej gjithë kombit. Edhe në alfabetin tonë të toskërishtes, të ndërtuar me shkronja greke, ne kemi përdorur pika, që nuk janë të dëshirueshme dhe gjithashtu kemi shenja të ndryshme në alfabetin e gegërishtes të Lepsiusit. Tani alfabeti i ri, me gjithë format e tij të çuditshme, nuk ka pika ose shenja të tjera, ndonëse mendoj që një theks duhet të vihet gjithmonë mbi rrokjen e theksuar. Nëse do të bëhej kjo, mendoj se alfabeti i ri do të kënaqte të gjitha palët dhe do të ishte më i mirë se cilido nga tanët, qoftë i toskërishtes ose i gegërishtes".

Edhe Kristoforidhi ka pasur evoluimin e lëkundjet e tij, të mishëruara në pasurinë e botimeve e të dorëshkrimeve që la. Përmbledhtas, Kristoforidhi ka përdorur një tufë variantesh për alfabetin e shqipes, disa të vetat e disa të detyruara. Nuk i meriton qortimet, që lëshohen kalimthi, se u tërhoq për çështjet e alfabetit, duke e vonuar kështu hartimin e një alfabeti të vetëm të shqipes dhe duke krijuar vështirësi për t'u lexuar veprat e tij. Botimet e tij edhe sot lexohen me një përpjekje të vogël, kurse shtysa që dha ai për t'u ulur në tryezën e shkronjave të shqipes është një nga meritat e tij të pavëna në dukje e jo shkas për ta fajësuar ne, që e kemi gjetur këtë tryezë të gatshme.

Është botuar më 1897 një artikull<sup>13</sup> nga një shqiptar, që të habit me kthjelltësinë e mendjes dhe njohuri-

të e shëndosha. Për fat të keq nuk e di kush ka qenë ai, aq më tepër sepse thotë që ka diskutuar gjatë me Kristoforidhin në Elbasan e pastaj në Stamboll. Ka shumë gjasa që të ketë qenë arbëreshi i njohur Pietro Kjara. Për këtë autor gjuha letrare është një farë kontrate shoqërore filologjike, që ka konvencionin e vet. Ky pohim është shkencërisht i palëkundshëm edhe sot. Ai i ka shprehur pakënaqësinë Kristoforidhit, madje e ka qortuar:

- Një njeri i shquar si ti, siç po e shoh, për gjuhën shqipe që është një, përdor dy alfabetë të ndryshme. Kështu cenohet njësia e gjuhës ose e shkrimit të saj dhe me përdorimin e dy alfabeteve, mbahet gjallë një dualizëm i dëmshëm.

Kristoforidhi, siç e pohon vetë me plot gojën, i dha një përgjigje vendimtare, të prerë, praktike e të pakundërshtueshme:

*- Për mua tashti pak rëndësi kanë shkronjat, shenjat dhe alfabetet; unë dua, kam dëshirë të madhe, që gjuha ime të shkruhet me çfarëdo mënyre, mjaft që të shkruhet. Admironjë mrekullinë, që e shohim atë të ketë mbijetuar për kaq shekuj dhe e kemi trashëguar ne, stërnipër të vonë të stërgjyshërve të famshëm; porse tashti është urgjente ta shkruajmë, ta shkruajmë, ta shkruajmë; të tjerat vijnë pastaj vetë”.*

Këto fjalë janë shkruar njëqind e dhjetë vjet më parë. Besoj se ka lidhje me P. Kjarën, sepse pothuaj njëzet vjet më parë ai i kishte shkruar një letër De Radës (1 maj 1870), duke mbështetur idenë për njësimin e shkrimit të të gjithë shqiptarët dhe e quante se “ky njeri i ditur nga Elbasani shkruan me një alfabet

shumë të lehtë e të kuptueshëm për gjithë shqiptarët.” Arsyetimin e qëndrimit në dukje kontradiktor të Kristoforidhit e gjejmë të qartë te letra e Thimi Mitkos e vitit 1872. Për Mitkon, natyrisht, puna më e mirë do të ishte të përdorej vetëm një mënyrë e njëjtë shkrimi, një alfabet i konsoliduar, megjithatë: “Unë pajtohem me ju, i dashur zotëri, dhe vetë kam qenë i këtij mendimi shumë vjet më parë, se gjuha jonë duhet të shkruhet, qoftë edhe me shkronja greke për arsye ekonomike dhe për hir të lidhjeve të ngushta ndërmjet këtyre dy gjuhëve”. Detyra kryesore ishte të shkruhej shqipja, të shkonte fjala e shkruar shqipe në duart e popullit sa më parë, kurse karakterin e shkronjave do ta vendoste më mirë koha, ashtu si e vendosi vërtet më 1908.

Legjenda e ngritur rreth veprimtarisë së Kristoforidhit ka qenë aq mbresëlënëse, saqë e ka përfshirë në librin e tij për historinë e Ballkanit edhe historiani i sotëm i njohur, Xh. Kastelani.<sup>14</sup> Pavarësisht se përsërit gjëra të pavërteta të marra aty-këtu nga autorë shqiptarë, si për shembull, se Kristoforidhi kishte studiuar në Angli dhe se shkaktoi konflikt me shehulislamin, është me vlerë që ai e quan të thjeshtë alfabetin përkatës dhe pjesë të luftës për gjuhën e kulturën. Mjaft të pavërteta, të marra po ashtu andej-kënde, në vend që të na pasuronte me të dhëna nga arkivat e pasur osmanë, ka edhe Nuraj Bozbori.<sup>15</sup> Përsëri na del se paska qenë Kristoforidhi më 1864 që iu vu punës për krijimin e një shoqate kulturore dhe përgatiti një alfabet të shqipes për të nxitur hapjen e shkollave shqipe. Gjithsesi, me një tjetër pasaktësi (sepse në vjeshtë 1871

Ali Pasha vdiq), ka shënuar se Ali Pasha i priti mirë kërkesat e një grupi intelektualësh shqiptarë dhe se kundërshtimi erdhi nga Divani dhe Patriarkane ortodokse.

Bashkëpunimi i Kristoforidhit me Shoqërinë Biblike nuk ka qenë siç e kanë përfytyruar shumica e autorëve, që kanë shkruar për të. Nuk ishte një rrogëtar i rregullt, merrej vesh me Tomsonin për një projekt, si mund të quhet me termat e sotëm, dhe me mbarimin e marrëveshjes, ai mbetej pa punë. I duhej herë pas here të gjente zgjidhje për të mbajtur familjen e madhe dhe prandaj po ashtu herë pas here gjendej në krizë të vërtetë. Në janar 1870, kur e pa se punimet e komisionit për alfabetin po mbylleshin, i propozoi Tomsonit të kthehej në atdhe “për të vënë të gjitha forcat që t’i mësonte popullit ortografinë e për të përhapur Shkrimet.”

U largua nga Stambolli në fund të marsit 1870. Në atdhe u shpalos qartë sukcesi i punës së tij dhe ai e vijoi atë pa ndërprerje. Është koha kur iu përvesh edhe veprës së vet themelore: Fjalorit.

Në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë janë dy fletë me shkrimin e tij. Faqja e parë ka titullin greqisht të Fjalorit me datën: 1870-18..., kurse faqja e dytë jep alfabetin e shqipes, i cili është i njëjtë me atë si do të dilte në botimin e vitit 1904. Krahasimi me *Historinë e Shkronjës* toskërisht të vitit 1872, tregon se shpjegimet për dyshkronjëshat dhe fjalët si shembuj janë njëjloj. Alfabeti standard i të gjitha botimeve të tij toskërisht ishte sipas Lepsiusit, domethënë me shenja diakritike. Alfabeti i Kristoforidhit duke nisur me dorëshkrimin e Fjalorit, ka këtë ndryshim kundrejt Lepsiusit: në

vend të shenjave diakritike përdoren dyshkronjëshat, kryesisht duke shtuar ‘j’ (për *gj, q, l, nj*) dhe për ‘rr’ dhe ndonjëherë ‘u’ (ou). Shkurt, **alfabetet themelore me shkronja greke, që ka përdorur Kristoforidhi, kanë qenë dy: A. Alfabeti i përkthimeve sipas Lepsiusit; B. Alfabeti i Fjalorit**, i cili vjen me ndryshime nga Meksi, Ksilanderi e Hani. Kurse alfabeti i dorëshkrimit të përkthimit më 1860 ishte variant paraprak i këtij të Fjalorit, por me disa ngarkesa të panevojshme dhe me ndonjë shkronjë latine më pak, sidoqoftë i afërt me të Hanit, kështu që ky i fundit del alfabeti i tij i parapëlqyer, i lidhur me bashkëpunimin e tij me albanologun e shquar që në rini e që në fillim.

Gjatë udhëtimeve nëpër Shqipëri Kristoforidhi u mëson gjerësisht njerëzve alfabetin e përdorur në Abetaret e përkthimit e veta (dok. 71-80). Në Raportin për vitin 1871 Tomsoni shënon ndër të tjera: “Kur vizitoi Beratin, pa për habinë dhe gëzimin e tij, se një grua mësuese tashmë e kishte përvetësuar sistemin e ri të ortografisë dhe u kishte mësuar të lexonin lirisht nxënësve të tri klasave më të larta ... Z. Kristoforidhi në veçanti përmend rastin e një bakërxiu të varfër nga Shkodra, i cili ndonëse ishte katolik, i bleu dhe i lexoi Shkrimet me zell të madh, duke i studiuar e duke kërkuar shpjegime, madje duke i mësuar edhe të tjerët t’i lexojnë. Gjithashtu jo pak myslimanë në qytetet e Shqipërisë së Mesme kanë mësuar të lexojnë dhe ata më të arsimuarit prej tyre e pranojnë letërsinë kombëtare si të vetmin mjet për të siguruar bashkimin kombëtar dhe përparimin.” Në vjeshtë 1871 Kristoforidhi u rikthye në Stamboll.



Përsëri duhen rivendosur në rregull kartat, që i ka ngatërruar J. Vretoja në dorëshkrimin e vet për shkrimin e shqipes. Përfundimet e Komisionit më 1870 nuk u pranuan nga qeveria osmane dhe Ali Pasha, ish ministër e vezir nga viti 1867, i cili ishte interesuar për mbledhjet e Komisionit të alfabetit të shqipes, u tërhoq. Në shtator 1871 ai vdiq. Hasan Tahsini kishte gjetur një shtëpi në Makriqoj, ku mund të mblidheshin shqiptarët pa rënë në sy, si dhe mund të shkëmbeheshin mendime në medresenë e tij. Jani Vretoja nuk kishte marrë pjesë në mbledhjet e mëparshme, sepse vetë shkruan, që të dhënat për to i kishte marrë nga goja e Kristoforidhit. Ndërsa më tej shton se kishte qenë vetë pjesëmarrës. Kur ka ndodhur atëherë rifillimi i mbledhjeve të atdhetarëve në Stamboll?

Pas Ali Pashës erdhi Mahmut Nedin Pasha. Sulltan Abdyl Azizi e rimori pushtetin edhe për pesë vjet të tjera. Pas ngjarjeve në sferat e larta të pushtetit osman, për shqiptarët bëhej më e domosdoshme të gjendeshin rrugë të tjera. Kundër Hasan Tahsinit nisën ndjekjet. Kristoforidhi kishte ardhur i frymëzuar me plane të gjera për botime të reja. Sami Frashëri erdhi në Stamboll më 1872. Përfundimisht, **përpyjekjet e reja të përbashkëta e të organizuara për alfabetin i përkasin vitit 1872**. Tashti do t'i pranojmë fjalët e Vretos, se disa nga pjesëmarrësit e mëparshëm nuk ishin më. Veç tij, tani mblidheshin edhe: Seit Toptani, Shefki Gjirakastri, Jahja Dinoja nga Paramithia, Ibrahim Bërzështa nga Starova, si dhe Pashko Vasa e Kristoforidhi, ndërsa në mbledhjet e fundit edhe Sami Frashëri.

Për parimin ‘një tingull – një shkronjë’ ka këmbëngulur J. Vretoja, rrjedhimisht kërkonte që të ndërthureshin alfabeti grek e latin dhe ndonjë shkronjë e re. Edhe Pashko Vasa e kishte pranuar këtë ide. Fjalët e Kristoforidhit ai i jep sikur t’i kishte mbajtur në protokoll: “Për një alfabet të tillë kemi mbetur të një mendimi me parafolësin edhe në bisedimet tona të veçanta, por që të vihet në zbatim të përgjithshëm, duhet të miratohet edhe prej një shoqërie kombëtare, e cila të kishte për qëllim dhe të kujdesej për përhapjen e dritës në kombin tonë me anë të gjuhës amtare. Dhe pasi të merremi vesh për alfabetin, mendoj se do të ishte mirë të kujdeseshim edhe për themelimin e një shoqërie të tillë.” Nuk kishte si t’i regjistronte këto fjalë Vretoja më 1869, kur nuk merrte pjesë në mbledhjet. Por idetë janë dhënë drejt dhe kanë të ndjeshme jehonën e letrës së Th. Mitkos për Kristoforidhin. Njëkohësisht kemi një argument tjetër, përse fillimet e organizimit të shqiptarëve nuk kanë qenë në vitin 1864. Po të ishte ashtu, do t’i kishte përmendur Mitkoja qoftë shkarazi dhe Vretoja nuk është kujtuar për ndonjë gjë më përpara, sepse ishte rasti pikërisht në këtë kontekst. Kristoforidhi e shihte, për shembull, se çfarë bënin bullgarët me Sllavejkovin, me të cilin punonte për BFBS. Përsëri mund të shtrohet pyetja: si fliste ai për një alfabet të njësuar, kur botimet vetë i bënte në dy alfabete? Shpjegimi është po ai, por tani me mbështetje plotësuese: ai kishte ndër mend të botonte edhe gramatikën e fjalorin dhe për to nuk ishte i detyruar t’i nënshtrohej alfabetit të përkthimeve. Po të ngrihej një shoqëri kombëtare, ajo do ta ndihmonte drejtpërdrejt

për botimin e veprave të tilla dhe realisht pas dhjetë vjetësh ai pati mbështetjen për botimin e Fjalorit në Bukuresht, që për fat të keq dështoi.

Zgjatja e diskutimeve për një alfabet pati si pasojë, që secili prej pjesëmarrësve të këmbëngulte për variantin e vet. Alfabeti i H. Tahsinit njihet në trajtën e vitit 1874, por besoj se ishte hartuar që atëherë. Jani Vretoja alfabetin e vet ua ka dërguar miqve më 1877, por dhe ai do ta ketë pasur të gatshëm më 1872. Pashko Vasa e botoi alfabetin thjesht latin prej 35 shkronjash më 1878, natyrisht të përgatitur që më parë. Si të bënte Kristoforidhi? Ai eci përpara, qoftë edhe me dy alfabete. Në prill 1872 dolën *Katër Ungjillat* gegërisht si më 1866, por me ndryshimet e bëra, dhe në fillim të gushtit 1872 u botua Dhiata e re e plotë gegërisht. Në tetor i ribotuan Psalmet gegërisht. Ka dalë në qarkullim edhe një vëllim, në të cilin janë së bashku Dhiata e Psalmet dhe ky është botimi i tij i fundit gegërisht. Në verë Tomsoni ndërmori edhe një udhëtim tjetër nëpër Shqipëri. I kushtoi vëmendje posaçërisht gjendjes së arsimit dhe vizitoi shkollat. Mundësia e nxënësve të shkollës në gjuhën italiane për të lexuar alfabetin e italishtes i jepte shpresë se me pak vështirësi ata do të lexonin edhe përkthimet gegërisht. Ndërkohe Kristoforidhi në bashkëpunim me RTS nxori *Katrë përgjëmime* toskërisht, të njëjta me Katekizmat gegërisht, si dhe *Istorinë e Shkronjës* toskërisht po ashtu të njëjtë me versionin gegërisht. Ribotimi më i rëndësishëm ishte Abetarja dhe mund të thuhet se librat e vitit 1872 përfaqësojnë më së miri konceptet e autorit për gjuhën e shkruar.

Është e vërtetë, siç thotë Vretoja, se Kristoforidhi mungoi në mbledhjet e fundit, sepse nga fundi i nëntorit 1872 ai u kthye përsëri në atdhe, ku do të qëndronte gjashtë vjet. Kudo ku shkonte, pjesë e pandarë e veprimtarisë së tij ishte t'u mësonte alfabetin e shqipes fëmijëve dhe të rriturve. August Dozoni, botuesi i librit për gjuhën shqipe, e ka takuar dhe ka ndenjur gjatë me Kristoforidhin në maj 1874. Filli i Kristoforidhit e përshkon gjithë librin e francezit, ndërsa anasjelltas, do të thosha se Dozoni ka bërë kështu të parin studim për gjuhën e Kristoforidhit e ka ngulitur disa pikëpamje të tij. Me një pasaktësi të vogël për datën, Dozoni shkruan: "Kristoforidhi përgatiti rrugët nëpërmjet hartimit të abetareve dhe të një historie të shkurtër të shkrimit të shenjtë; me sa duket, vetë qeveria osmane i ofroi bashkëpunimin dhe në fillim të vitit 1870 dekretoi emërimin e një komisioni të përzier, të përbërë nga tre myslimanë dhe tre të krishterë, që u ngarkua të krijonte një alfabet të ri, i cili t'i shërbente 'gjithë Shqipërisë, pa qenë nevoja që ne të jemi të detyruar t'u drejtohem alfabeve të huaja, gjuhët e të cilave nuk kanë asnjë lidhje me gjuhën tonë'."<sup>16</sup> Më tej thuhet se ky hap ishte pa precedent në politikën osmane, drejtohej kuundër helenizmit dhe komisioni, i cili kishte si program të përshtaste shkronjat e turqishtes ose të shpikte shkronja krejt të reja, u shpërnda pa arritur gjë. Në shënim Dozoni shton se kjo nuk është e përpiktë, pasi u ndërtua një alfabet dhe ai u shtyp dhe u shpërnda në Janinë nga H. Tahsini. Këtu ai shmanget nga faktet, se H. Tahsini në të vërtetë përhapte alfabetin e vet dhe jo atë që përpunoi Komi-

sioni, të cilin mirë do të ishte të kërkohej edhe sot në arkivat e Turqisë.

Në mes të vitit 1875 Tomsoni parashtroi nevojën për një botim të ri të Dhiatës së re toskërisht. Përkthimi i vjetër nga Meksi me redaktimin e Gjirokastritit ishte i kapërcyer nga të gjitha drejtimet. Prej Kristoforidhit ishin dorëshkrimet e përfunduara më 1860, që i kam trajtuar më sipër. Si gjithnjë, kërkesa e parë ishte të ndryshohej alfabeti, domethënë të kalohej te Lepsius. Më mirë se përkthyesi nuk mund ta bënte as kush tjetër. Por marrëdhëniet me Kristoforidhin në këtë periudhë po kalonin një krizë të rëndë. Përpyekjet e Tomsonit për ta kapërcyer atë krizë janë mishëruar në një krahasim biblik të goditur: “Të pranohet një botim i ri, duke më hequr mundësinë për të angazhuar Kristoforidhin, do të ishte njësoj, si në rastin e faraonit që u kërkoi izraelitëve të bënin qerpiçë pa kashtë.” (mars 1876, dok. 101) Pas botimit të disa alfabeve, edhe A. Kullurioti kërkonte të vihej në përdorim një alfabet me gjashtë shkronja të reja të shpikura dhe nuk përfillte asnjë variant tjetër. Tomsoni e njihte si bashkëpunëtor të BFBS, ndërsa shtimin e pështjellimit prej tij e shtoi ndër argumentet për të vijuar me Lepsius dhe gjente shtegun për ta hapur përsëri kërkesën e kahershme, meqë prej këtej: “del vlera e madhe e Kristoforidhit si një shkruer, në mos më tepër ... Pastaj unë e konsideroj atë njohësin më të mirë kompetent, në mos po të vetmin që kemi.”

Nga një drejtim krejt tjetër, por jo i papritur, puna e Kristoforidhit për alfabetin e shqipes na shfaqet me të tjera ngjyra. Historiana nga Janina, Elefteria Niko-

llaidhi<sup>17</sup> ka botur një vëllim të trashë më 1978. Patriarku Joahimi II ka dërguar dy letra për mitropolitin e Beratit me vërejtje të rënda, sepse kishte lejuar propagandën e protestantëve. Është tepër interesante, se ku e dinte ai që në atë periudhë Kristoforidhi kishte rënë në mërinë e Shoqërisë Biblike, por e vijonte veprimtarinë, duke pasur si bazë Tiranën dhe Elbasanin. Madje historiana janinjote është e informuar aq mirë, sa tregon që më 1877 Tomsoni i kishte bërë ftesë Kristoforidhit për ta rimarrë në shërbim. Ajo shkruan më tej: “Të gjitha këto patriarku i lidhte me përpjekjet, që kishte ndërmarrë në po atë drejtim agjenti i Shoqërisë, Konstandin Kristoforidhi, i cili për këtë qëllim kishte hartuar një alfabet e një gramatikë shqipe dhe kishte shtypur edhe libra fetarë në gjuhën shqipe.” Nuk mund të mos e nxjerr në pah, se autorë keqdashës, objektivisht sepse kjo u dhemb, e kanë kapur drejt thelbin e punës së Kristoforidhit. Autorja na tregon se Anthim Aleksudhi i dërgoi Patrikanës tri letra si përgjigje dhe një raport në nëntor 1877. Është pikërisht ky Anthimidhi, që bëri një letër qarkore si mallkim kishtar kundër atdhetarëve ortodoksë, të cilët përpiqeshin për shkrimin e shqipes. A. Kullurioti në gazetën e tij më 8 dhjetor 1879 i është përgjigjur me ashpërsi, duke iu përmbajtur qëndrimit të protestantëve kundër klerikëve të papizmit e të ortodoksisë. Ndërkohë kthjellohet diçka tjetër: duke mos u njohur kjo prapaskenë, është marrë sikur zanafilla e mallkimit ka qenë më vonë, me themelimin e Shoqërisë së Stambollit. Anthimi i nisi sulmet e tij pasi ia tërhoqën fort veshët nga lart, dhe i nisi drejtpërdrejt kundër Kristoforidhit.

Rishikimin e Dhiatës toskërisht Tomsoni e pati në qendër të vëmendjes për disa vjet, kur Kristoforidhi jetonte në Shqipëri dhe Shoqëria nuk e pranonte vijimin e punës me të. Bëri përpjekje për të gjetur bashkëpunëtorë të tjerë dhe për të ngritur një komision redaktimi në Athinë, po u ndesh me gjëra kureshtare. P. Kupitori ishte i gatshëm të jepte ndihmesën e vet, por ia tha Tomsonit, se Kristoforidhi ishte shumë më i aftë për çështjet e ortografisë e të etimologjisë. Kullurioni nuk mund të quhej studiues i shqipes, ndonëse edhe ai mund të jepte ndihmë. Tomsoni i bëri një vizitë edhe Rajnholdit në Pire, i cili ishte në pension, dhe shkruan më 22 qershor 1877: "Ai e ka parë abetaren e z. Kristoforidhi, por ndonëse e ngre lart duke e quajtur autorin njeri me kulturë shkencore, të cilit mund t'i besohet nga ana letrare, shprehu një pakënaqësi kundër tij meqë, siç më tha, ai i ka vjedhur alfabetin pa e pranuar."(!) Rajnholdi e fliste shqipen, por nuk vlente për detyrën e anëtarit në komisionin e redaktimit. Tomsoni ia shpreh shkoqur Londrës, se nuk kishin zgjidhje tjetër, përveçse ta rimerinin Kristoforidhin. Dhe ai erdhi në Stamboll në fillim të tetorit 1878.

Ngjarjet e vrullshme të vitit 1878 i kishin dhënë një shtysë të jashtëzakonshme lëvizjes shqiptare dhe ajo kishte hyrë në një fazë të re me Lidhjen e Prizrenit. Kristoforidhi kishte mbetur mënjanë. Edhe për alfabetin rrjedha kishte përparuar. Që më 1877 Tomsoni e kishte ndier se po bëheshin plane të ndryshme alfabetesh. Dhe kur u arrit te alfabeti i Stambollit, nuk mund të mbyllte më sytë: "Të tjerët po propozojnë alfabete rivale dhe të tjera plane, por unë jam i bindur

se ne kemi zgjedhur pozitën e vërtetë.” (dok. 117) Fillimisht vendosi të mos bënte asnjë ndryshim, madje do ta shtonte sasinë e botimeve me alfabetin grek për tos-kërishten, që ta konsolidonte më tej pozitën e vet. Në këto rrethana, Kristoforidhi gjithashtu nuk mund të kishte ndonjë evoluim në ecurinë e vet, madje në botimet e mëpastajme nuk i është shënuar as emri si përkthyes. Por veprimtarët shqiptarë, pas arritjes së tyre të madhe me Shoqërinë e shkronjave dhe me alfabetin, nuk mund ta shpërfillnin punën e BFBS. Menjëherë një muaj më pas iu drejtuan Tomsonit, të cilin e njihnin mirë. Ata i kërkuan që të pranonte alfabetin e ri. Në vend të komenteve, po jap një pjesë pak të gjerë nga letra e tij e 25 nëntorit 1879, që flet mjaft qartë:

“Ca kohë më parë një Komitet shqiptar ka botuar një abetare me alfabet të ri, të caktuar për gjithë kombin dhe për të cilin thuhet se janë marrë vesh ta pranojnë njerëz kryesorë midis myslimanëve, katolikëve e ortodoksëve (të kishës greke). Një anëtar i këtij Komiteti më bëri dje një vizitë, i shoqëruar nga një i ri shqiptar, të cilin e njihja. Ata më falënderuan nga zemra dhe shprehën dëshirën t’i dërgohen falënderime Shoqërisë për atë që ka bërë duke nxjerrë në pah gjuhën amtare të vendit. Ata gjithashtu lëvduan punën e z. Kristoforidhi, i cili në shërbim të Shoqërisë ka hedhur poshtë shpifjet e përbuzura të grekëve e ka provuar se shqipja është një gjuhë e saktë e shprehëse, në mos e pasur. Z. K. nuk ishte në zyrën time, sepse e ka mbaruar punën dhe po pret përgjigje nga Komiteti për pyetjen time, a të vazhdojë më tej përkthimet. Unë u thashë për dëshirat që kam dhe ata më kërkuan që



çdo gjë tjetër, të cilën do të mund ta shtypja, të ishte në alfabetin e ri, të pranuar nga Komiteti kombëtar. Por qëllimi i tyre kryesor ishte të kërkonin ndihmën time në përpjekjet për të botuar një gramatikë dhe një fjalor. Natyrisht, u thashë se nuk mund ta bëja zyrtarisht, se asnjë nga Shoqëritë me të cilat kisha lidhje nuk do ta bënte dot. Megjithatë kam shpresë t'u jap ndihmë, nëse nga shqyrtimi i mëtejshëm do ta mendojmë si të këshillueshme për të mbështetur alfabetin e tyre. Sigurisht, është mirë të jetë një për gjithë kombin, mirëpo mbetet për t'u parë a do ta pranojnë kishat dhe vetë njerëzit. Ne nuk duhet të ngutemi në këtë çështje. Alfabeti ynë ka epërsinë e madhe, se cili do që lexon greqisht, edhe atë mund ta lexojë lehtë."

Tomsoni e lë derën hapur për të kaluar një ditë te alfabeti i Stambollit dhe e quan më mirë që të ketë një alfabet të vetëm kombëtar. Por përfundimi kryesor ishte që të mos ngutej. Kështu u përcaktua fati i botimeve të mëtejshme: do të vijohej pa bërë ndryshime. Edhe një muaj më pas (dok. 125) ai e quante si më mirë të lihej çështja e alfabetit e papërcaktuar dhe: "është detyra e interesi ynë të shkojmë krahas me çdo lëvizje kombëtare për ngulitjen e një letërsie kombëtare dhe ne duhet t'i lejojmë ata të zgjedhin alfabetin e vet. Vetëm se duhet të presim derisa të shohim nëse toskët do të pranojnë alfabetin kombëtar kundrejt atij tonit." Ndërkohë u botua Dhiata e re toskërisht (1879) me shkronjat greke sipas Lepsiusit, u vijua me disa libra të Dhiatës së vjetër përsëri toskërisht (1880, 1884).

Njëkohësisht Kristoforidhi ka punuar edhe për dy vepra të rëndësishme: gramatikën dhe fjalorin. Fondet për gramatikën i kishte mbledhur Tomsoni dhe ajo doli më 1882 me alfabetin sipas Lepsiusit në frontespice e po nga shtypshkronja e Bojaxhianit. Nuk mund ta lë pa e vënë në dukje, se shembujt edhe gegërisht janë me të njëjtin alfabet, ashtu si njëzet e ca vjet më parë. Për Fjalorin njihet mirë letra dërguar degës së Bukureshtit më 23 korrik 1882, e gjithashtu letra e Kristoforidhit dërguar G. Majerit më 14 nëntor 1883. Në të dy rastet nuk ka asnjë përmendje të alfabetit që do të zbatohet. Dhjetë vjet më vonë, në letrën dërguar Kristoforidhit, Tomsoni e ka ngritur çështjen e alfabetit dhe i ka kërkuar të hiqte dorë prej shkronjave greke për të kaluar te alfabeti i Stambollit si më i thjeshtë. Por mbi të gjitha, i vë në dukje se autoritetet osmane kishin ndaluar çfarëdo botimi me shkronja greke, e njëkohësisht vepra nuk do të gjente vend mes pjesës tjetër të popullsisë, që nuk e njihje greqishten. Ripunimi do të kërkonte shumë mund dhe prandaj vepra mbeti me alfabetin e dorëshkrimit të paredaktuar dhe ashtu u botua më 1904.

Përfundimisht botimet e elbasanasit me BFBS u ndërprejnë dhe ai u kthye në Elbasan; po kështu ndërpritën edhe njoftimet e Tomsonit për të. Mirëpo pikërisht datën 1884 kanë një varg dorëshkrimesh të Kristoforidhit, që ruhen në arkivat tanë. Më 1981 kam transkriptuar dhe botuar dorëshkrimin e tij për fjalëformimin e shqipes.<sup>18</sup> Deri në faqen 94 është zbatuar alfabeti i Fjalorit me një ndryshim të vogël, porse në pak faqe të fundit, duke nisur nga 94, është kaluar te

zgjdhjet me shenja diakritike për *q, gj, l, rr*. Shkurt është alfabeti i Fjalorit për pjesën më të madhe dhe vetëm në fund ka kaluar te Gramatika, ndonëse ishte një plotësim pikërisht i Gramatikës. Një varg faqesh me përpjekje etimologjike (fjalë nga latinishtja, greqishtja, sllavishtja, turqishtja, madje dhe sanskritishtja) janë me alfabetin e Fjalorit, ka edhe ndonjë copë gegërisht po ashtu. Tri faqe për parashtesat ‘s’ dhe ‘c’ janë me alfabetin latin të Lepsiusit, si edhe për shembuj nga gegërishtja të etimologjive, duke i përzier rastet. Sidoqoftë, në dorëshkrimet mbizotëron alfabeti i Fjalorit ose ai që e quajta alfabeti B.

Gjatë viteve si mësues në Elbasan ka përgatitur disa pjesë, ndër të cilat ‘Jetëshkronja e Gutenbergut’ është sipas Fjalorit, si edhe ‘Pleqënia e shtëpisë Bogdanje’ (1885), kurse ‘Systema diellore’ është me alfabetin latin të Lepsiusit. Nuk i kam origjinalet e tre varianteve të ‘Gjahut të malësorëve’ për të dhënë një vlerësim të plotë të tyre. Së fundi vjen letra shumë e njohur, dërguar N. Naços në janar 1888. Prej saj del shkoqur, se Kristoforidhi i ndiqte me vëmendje ngjarjet dhe posaçërisht ndarjen e dy shoqërive shqiptare në Bukuresht e lidh drejtpërdrejt me alfabetin: ‘Dituria’ zbaton alfabetin e Stambollit, kurse ‘Drita’ kërkon alfabetin latin. Autori i letrës e quan alfabetin e Stambollit si alfabet të J. Vretos, meqë ka parimin një tingull – një shkronjë, dhe rrjedhimisht, ka përzier shkronjat, kurse: “Ndë më pyetshi mua, unë pëlqenj më fort alfavitën latinishte, sepse me atë alfavitë munt të shtypenë vivlia shqipe kudo, sepse gjendenë mbë çdo vënt që të kërkojsh, edhe është një alfavitë e

kupëtuar' e e njohurë nga të tërë kombet' e Evropësë." G. Majeri më 1885 shkruante se Kristoforidhi kishte bërë përpjekje për të krijuar një alfabet kombëtar mbi bazë latine dhe për gramatikën e vet të shkurtër të shqipes është mbështetur te Kristoforidhi.<sup>19</sup>

Pas tridhjetë vjet përvoje me lëvrimin e shqipes, ky është përfundimi ku ka arritur rilindësi ynë i shquar. Si mbështetje për këtë koncept, edhe vetë letrën e ka shkruar me alfabet latin të përshtatur. Për 'ç' dhe 's' ka përdorur po këto shkronja me një shenjë poshtë si në turqishten e sotme; për 'gj' ka dyshkronjësh, por me ndërthurjen 'gh'; për 'y' ka një 'u' me shenjë përsipër e po të njëjtën shenjë përsipër mbi 'n' për 'nj'; dallimin *e-ë* e ka bërë me luhatje, duke i vënë një pikë po asaj shkronje; për 'dh' ka deltën greke, por edhe ka lëkundje gjatë letrës për këto. Përbën një ironi të historisë fakti që më 1889 u shtypën në Bukuresht përkthimet e Kristoforidhit *Mateu* dhe *Të bërët* pikërisht me alfabetin e Stambollit dhe nga Shoqëria 'Dituria', që nuk kishin gjetur miratimin e tij. Gjithsesi, nuk mund të lihet mënjanë botimi i 'Fjalorit të gjuhës shqipe' më 1904. Ai doli me alfabetin e tij të dytë me shkronja greke. Ishte periudha e fundit e luftës për pavarësi dhe po afrohej zgjidhja përfundimtare e alfabetit të shqipes me Kongresin e Manastirit. Pikërisht kjo anë e zbehu ndikimin, që me aq zulmë pritej të kishte ai botim aq i rëndësishëm për gjuhën shqipe.

Pas këtij shtjellimi të hollësishëm do të ishte e padrejtë të viheshin në shënjestrën e kritikës mendimet e shprehura me të meta e pasaktësi nga autorë të ndryshëm.<sup>20</sup> Sidomos nuk vijnë në vështrim shkrimet

nga autorë si M. Pirraku e P. Janura, të bëra para vitit 1972, domethënë përpara se të zbulohet një dokumentim i pasur për Kristoforidhin. Gjithsesi nuk mund ta mbyll pa tërhequr vëmendjen se për Kristoforidhin nuk qëndron një qortimi si ky: "Atdhetari ynë, që punoi aq shumë për çështjen kombëtare, nuk duhej të tërhiqej për probleme të alfabetit, sigurisht brenda atyre mundësive që kishte."<sup>21</sup> Nuk qëndron ky qortim, sepse mospranimi prej tij do ta përjashtonte nga botimi i shkrimeve shqip dhe kjo do të kishte qenë një humbje jo e vogël për kulturën e shkruar shqipe në shekullin e Rilindjes kombëtare. T'u hedhim një vështrim viteve nga 1865 deri më 1879 dhe të shtrojmë pyetjen: cilat botime nga të tjerë autorë janë bërë shqip me alfabete, që të kenë dhënë ndihmesë për zgjidhjen e kësaj çështjeje kaq vendimtare dhe që të kenë pasur qarkullim të vërtetë në Shqipëri? T. Osmani përmend vetëm "Fyletia arbënore" të Dh. Kamardeş me alfabet latin, me një gjuhë të cilën nuk e kuptonin as arbëreshët, kurse në fund të kësaj periudhe "Bletën shqiptare" të Th. Mitkos me alfabetin e greqishtes, në kopertinën e së cilës gjithçka është greqisht, veç titullit me shkronja më të vogla shqip. Në të njëjtën kohë në Stamboll D. Boriçi botonte Abetaren e tij me alfabet arab, kurse Sami Frashëri shkruante turqisht vepra me tematikë shqiptare.

Mund të pohohet se për afër 15 vjet shkrimet e Kristoforidhit kanë sunduar rrjedhën e lëvrimin të gjuhës shqipe, e për më tepër, kanë qarkulluar gjerësisht në Shqipëri në duart e lexuesve që nga nxënësit e deri te gratë shtëpiake, po edhe kanë shkruar te kolonitë

shqiptare, te arbëreshët në Itali e në Greqi dhe janë shfrytëzuar nga një varg albanologësh. Me Shoqërinë e të shtypurit shkronja shqip më 1879 ndodhi një ndryshim i shkëlqyer në fushën e botimeve shqipe, por deri në atë ditë dritën në mes të errësirës e mbajtën të ndezur botimet e Kristoforidhit. Prej këtij këndvështrimi duhet nisur për të dhënë vlerësimin objektiv mbi arritjet dhe mangësitë e këtyre veprimtarëve të shquar të kulturës në gjuhën shqipe.

### Shënimet:

1. KASTRATI, J. (1972): *Lufta për njësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905*, në: *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, f. 77, shkruan: “Konstandin Kristoforidhi i bontonte veprat e veta me shkronja latine për veriorët dhe me shkronja greke për jugorët. Pa dyshim, kjo nuk ndihmonte në bashkim, por tërthorazi, çonte në përçarje.”
2. LLOSHI, XH. (2005): *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Tiranë.
3. LLOSHI, XH. (1974): *Një alfabet i Kristoforidhit*, në: “Ylli”, nr. 7, f. 26.
4. OSMANI, T. (1999): *Udha e shkronjave shqipe*. Shkodër, f. 191 shkruan: “Shumë dinake është politika e Tomsonit. Ai do të realizojë planet dhe qëllimet e tij që i kishte vënë Komiteti i Londrës.” Është e vërtetë se gjatë diktaturës të gjithë kemi qenë të detyruar të mos shprehnim simpati për të huajt, por në një botim të vitit 1999 nuk ka përse të shkruhet po me atë frymë si dikur.
5. LLOSHI, XH. (2005): *vep. cit.*, f. 253-254. E vlen të riprodhoh vetëm disa radhë, që japin shpjegime krahasuese: “Pika e parë që duhet marrë parasysh është merita e brendshme e sistemit të Lepsiusit në krahasim me atë që është në përdorim... Një vështrim në tabelën krahasuese të këtyre dy sistemeve, që janë në fillim të Ungjijve, besoj se do të jetë i mjaftueshëm për të kënaqur çdo njeri të paanshëm lidhur me gjendjen e çështjes. Unë nuk do ta theksoj më tepër rrethanën që ai alfabet latin paraqet pesë tinguj me dy shkronja greke e një sllave, si dhe një shenjë origjinale, e cila paraqet një tingull kur është e vetme dhe një tingull tjetër të dyfishtë, ndonëse nga kjo anë ky sistem del më i dobët në krahasim me të Lepsiusit, i cili e plotëson alfabetin latin vetëm me dy shkronja greke Δ e Θ, të cilat futen për të paraqitur tingujt e vet të greqishtes. Ka më shumë rëndësi të shënohet, se alfabeti latin nuk bën dallim ndërmjet *e* së hapur dhe *e* së mbyllur, ashtu siç e kemi në anglishten ndërmjet tingujve të *e* në dy fjalë: *pen* dhe *open*. Lepsiusi e shënon këtë dallim, i cili është me shumë rëndësi në gjuhën shqipe. Më tej, vijnë shtatë tinguj të thjeshtë, të cilët Lepsiusi i shënon po me aq shkronja, disa prej tyre me shenja

- diakritike, ndërsa në alfabetin latin ata shënohen secili me dy shkronja, duke huazuar nga italishtja mënyrën e ndërthurjes, në disa raste si te: *scia, scio, sciu* ku tingulli i thjeshtë *sh* paraqitet me tri shkronja, ndërsa Lepsiusi e paraqet thjesht me një.”
6. QUKU, M. (1986): *Rreth punës së Ndre Mjedës për alfabetin e gjuhës shqipe*, në: Studime filologjike, nr. 2, f. 133. Më duhet të shënoj se me shenja diakritike te varianti që përdori Kristoforidhi ishin 9 dhe jo 10 shkronja. Me rëndësi është plotësimi i autorit, prej të cilit del se Mjeda e ka kryer punën e vet që kur Kristoforidhi ishte gjallë.
  7. CANTON, W. (1904): *History of the British and Foreign Bible Society*, vol. III, London, f. 225.
  8. DIMITROV, S. (1967): *L’Albanie et la Renaissance albanaise dans la presse dirigée par P. R. Slavejkov*, në: Etudes Balkaniques, nr. 7, f. 191-206.
  9. VRETO, J. (1973): *Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe*, në: Vepra të zgjedhura, Tiranë, f. 249-287.
  10. KOLONJA, SH. (1903): *Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës shqip*, në: Drita, Sofje, nr. 32 e 33, 18 dhe 21 nëntor.
  11. SHUTERIQI, DH. (1950): *Kostandin Nelk-Kristoforidhi (1830-1895). Monografi mbi jetën dhe botimet e tij*, në: Buletin i Institutit të Shkencave, nr. 1-2, f. 13.
  12. LEVEND, A. S. (2004): *Sami Frashëri*, Tiranë, f. 82: “Shqiptarët në një takim me ministrin osman të arsimit më 1869 kërkuan një alfabet të veçantë për gjuhën shqipe. Komisioni prej tre vetash, i krijuar për këtë qëllim, pas një pune të gjatë hartoi për shqipen një alfabet me germa latine.” Ky libër është botuar turqisht më 1968, ndërsa rreshtat e mësipërm i ka shkruar që më 1960 në veprën *Etapat e zhvillimit dhe të purizmit të gjuhës turke*.
  13. *Coltura nazionale*, në: La Nazione Albanese, vol. I, nr. 2, 31 janar 1897, f. 7
  14. CASTELLAN, G. (1996): *Histori e Ballkanit*, Tiranë, f. 380: “Në Stamboll K. Kristoforidhi (1830-1895), që kishte studiuar në Angli, bëri të njëjtën gjë dhe u përpoq të fuste një alfabet më të thjeshtë, gjë që shkaktoi konflikt me sheik-ul-islamit dhe patriarkanën, që u skandalizuan ngaqë Kristoforidhi guxoi të transkriptonte me këtë alfabet tekstet fetare.” Autori e ka ga-



- bim datën e lindjes dhe nuk e ka ditur se Kristoforidhi prej kohësh botonte tekste fetare me tjetër alfabet.
15. BOZBORA, N. (2002): *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë, f. 139: "Më 1871 një grup intelektualësh shqiptarë u mblodhën në Stamboll e formuluan edhe një herë kërkesat e tyre: kryeministri Ali Pasha i priti mirë këto kërkesa dhe për pasojë u vendos që rektori i Universitetit të Stambollit, Hasan Tahsini, dhe ish kryeministri Mustafa Pasha, të takoheshin me sulltanin. Por qëndrimi negativ i Divanit dhe i Patriarkanës ortodokse bënë që këto takime të përfundojnë pa asnjë rezultat. Më pas qeveria osmane hapi në Shqipëri shkolla në gjuhën turke dhe drejtimi i tyre iu la zyrave të arsimit publik."
  16. DOZON, A. (1879): *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, f. 169.
  17. NIKOLLAIDHOU, E. (1976): *Ksenes propagandes kai ethniki alvaniki kinisi stis mitropolitikes eparhies Durracion kai Velegradhon kata to teli tou 19 kai tis arhes tou 20 aiona*, Janinë, f. 40-64.
  18. LLOSHI, XH. (1989): *Dorëshkrimi i Kristoforidhit për fjalëformimin e shqipes*, në: Studime filologjike, nr. 1, f. 159-194.
  19. MEYER, G. (1885): *Della lingua e della letteratura albanese*, në: Nuova antologia, 14 prill, f. 597; (1888): *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, Leipzig.
  20. PIRRAKU, M. (1970): *Konstantin Kristoforidhi dhe alfabeti*, në: Bota e re, nr. 27, tetor; JANURA, P. (1969): *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, f. 30-31; OSMANI, T. (1982): *Rreth alfabeve të përdorura në veprën e Kostandin Kristoforidhit*, në: Buletin shkencor, Shkodër, nr. 1; AJETI, I. (1985): *Alfabeti i K. Kristoforidhit dhe çështje gjuhësore në veprën e tij*, në: Gjuha jonë, nr. 1-4, f. 27-32, ribotuar në: Konferenca shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot, Tiranë, 2002, f. 169-175; ALTIMARI, F. (1985): *Disa vëzhgime mbi alfabetin e K. Kristoforidhit*, në: Seminari X për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë; OSMANI, T. (2002): *Ndihmesa e K. Kristoforidhit për njësimin e alfabetit të shqipes dhe sistemet shkrimore të përdorura prej tij*, në: Përmbledhje me studime për Kostandin Kristoforidhin, Elbasan, f. 138-145.
  21. OSMANI, T. (1999): *vep. cit.*, f. 194.



## *Alfabeti i arumanishtes për shkrimin e shqipes*

Përpara se të bëhet pyetja: Me çfarë alfabeti e ka paraqitur shqipen T. Kavalioti?, është e nevojshme të shtrohet një pyetje tjetër: Cili ishte Kavalioti?

Ndërsa J. Rrota në "Letratyrën shqype për shkolla të mjesme" më 1925 nuk e përmendte aspak, për Eqrem Çabejn: "Me Teodor Kavaliotin fillon periudha e shkurtër e kulturës aromune në Shqipëri.", si e thoshte në librin e tij po ashtu për shkollat e mesme<sup>1</sup> më 1936. Pas Luftës II Botërore përsëri në një libër për shkollat e mesme<sup>2</sup> T. Kavalioti përfshihet në një grup tjetër prodhimi letrar, që përfaqësonte kryesisht shtresat e zanatçinjve, të tregtarëve ose edhe të fshatarësisë së lirë të këtyre anëve të Shqipërisë. Nga sa kam lexuar, nuk kam ndeshur ndonjëherë që në historiografinë letrare të thuhet, se zanatçinjtë bashkohen me tregtarët e me fshatarët për të dhënë prodhim letrar. Më tej Dh. Shuteriqi së pari në tekstin për shkollat e mesme<sup>3</sup> do ta përfshijë te grupi i "Shkrimtarëve fetarë të Shqipërisë së mesme e të jugut".

Vëllimi i parë i "Historisë së Shqipërisë"<sup>4</sup> do ta quajë 'mendimtar i shquar i shek. XVIII' dhe pasi do të flasë hollësisht për pikëpamjet e tij filozofike, do të arrijë të thotë se: "u shqua si përkrahës i ideve iluministe. I pajisur me një kulturë të gjerë ai u bë udhëheqës i lëvizjes kulturele jo vetëm të Voskopojës, por

edhe të krahinave të tjera të Shqipërisë së mesme e të jugut.” Po të lihet mënjanë se gjurmë të një udhëheqësie dhe iluminizmi të tillë prej librave të shkruar greqisht e të mbetur dorëshkrime, të cilat deri më sot nuk dihet a janë përdorur nga ndonjë shqiptar, nuk gjenden gjëkund, bie në sy se janë mënjanuar të dhëna themelore për këtë autor: *fakti që ishte klerik dhe për këtë arsye mund të shërbente edhe si pedagog, dhe fakti se ishte arumun*. Artikulli për Kavaliotin në “Fjalorin enciklopedik shqiptar” (1985) është shkruar nga A. Uçi. Aty për tekstet e tij shkollorë thuhet se janë ruajtur si dorëshkrime, ndërsa fjalori trigjuhësh quhet se është greqisht, sllavisht dhe shqip. Kështu arumanishtja aty i është mohuar Kavaliotit, por ndërkajzë zënë vend të gjerë prirja materialiste, kombinimi me frymën e idealizmit objektiv, moskonsekuenca në luftën kundër skolastikës mesjetare, meqë pikëpamjet e tij nuk u lidhën me problemet themelore të kohës dhe sidomos me detyrat e çlirimit kombëtar. Nuk e di nëse mund të shkruhen absurditete më të mëdha se kaq nga një akademik shqiptar, i cili kërkon nga një prift vllah me formin grek që të merret me detyrat e çlirimit kombëtar të shqiptarëve në shek. XVIII. A. Buda përkundrazi, pasi vëren lidhur me Voskopojën se “forcat intelektuale të vendit, mësuesit e kësaj shkolle ndien nevojën që t’u përgjigjeshin kërkesave të ambientit të tyre dhe filluan t’u kushtojnë vëmendje disa çështjeve që lidheshin me vendin e tyre.”, vijon: “T. Kavalioti, duke çarë guaskën e temave filozofike-tradicionale, hartoi një fjalor të gjuhës së vendit si edhe të folmes vllahe.”<sup>5</sup>

T. Kavalioti nuk ka çarë asnjë guaskë temash dhe nuk ka hartuar asnjë fjalor të shqipes, por një fjalorth trigjuhësh. Megjithatë, për pohimet e pambështetura të sapocituara në paragrafin e mësipërm mund të paraqitet si arsytim, se janë bërë nga njerëz që nuk kanë qenë specialistë të filologjisë. Fatkeqësisht e njëjta gjendje vërtetohet edhe në lagjen tonë. “Historia e letërsisë shqiptare”, botim akademik i vitit 1983, gjithashtu flet hollësisht për manualët dhe idetë filozofike të Kavaliotit, për veprat e pabotuara greqisht dhe për gramatikën e greqishtes, por nuk e përmend se ishte arumun dhe nuk del e qartë, çfarë kanë të bëjnë këto gjëra me letërsinë shqipe. Dh. Shuteriqi ka qëm-tuar me skrupulozitet çdo thërmijë për të dokumentuar shkrimet shqipe<sup>6</sup> dhe ka dhënë një informacion të ngjeshur e të përpiktë gjithashtu për Kavaliotin. Gjithsesi, edhe në këtë rast është mënjanuar përmendja e Kavaliotit si arumun, por me të drejtë vërehet se: “Vepra është një libër fillestar për ata që, midis shqiptarëve e vllëve, do të duan të mësojnë gjuhën greke.” Nuk qëndron mendimi i tij, se ky është fjalori i parë i arumanishtes e përgjithësisht i gjuhës rumune.<sup>7</sup>

Një bibliografi të gjerë, në pjesën më të madhe krejt të panevojshme e të pakonsultuar nga vetë hartuesi, ka dhënë J. Kastrati<sup>8</sup> në fund të kreut për Kavaliotin. Është përmendur aty E. Çabeji për njëren ndër skicat e shkurtra, kushtuar Kavaliotit. Çabej shprehet qartë: Kavalioti veshi petkun e priftit, u bë protopapë dhe fjalori i tij pasqyron shkallën e arsimit të dijetarëve të atëhershëm, të cilët duke banuar në një ambient arumun e shqiptar dhe si priftër greko-ortodoksë, i

zotëronin gjuhët e tre popujve. Çabej nuk e ka ndryshuar atë që kishte shkruar që më 1936. Si të kuptohen atëherë fjalët e J. Kastratit, se 'Teodori ynë', domethënë Kavalioti: "I shtrënguar nga ky mjedis për të njohur me të njëjtën lehtësi, si gjuhën e vet amtare shqipen, ashtu edhe arumanishten e greqishten, zbatoi praktikisht dhe vazhdimisht teorinë krahasuese të Leibnizit."?? Kavalioti ishte dygjuhësh, ai nuk ishte i shtrënguar ta mësonte arumanishten njësoj si greqishten, përkundrazi, arumanishtja zinte vendin e parë për të, ndërsa greqishten e kishte gjuhën e mësuar si gjuhë të dijes e të kulturës. Kur vjen puna te paragrafi "Studimet për Teodor Kavaliotin", J. Kastrati përmend të parën veprën e P. Papahaxhit *Shkrimtarë arumunë në shekullin XVIII* si të botuar më 1919 dhe e ka gabim, sepse shton që autori kishte botuar më 1915 edhe *Arumunët nga pikëpamja historike, kulturore dhe politike*. Për hir të së vërtetës, duhet shënuar se Papahaxhi librin e parë e botoi më 1909 dhe pastaj ka shkruar të dytin. Por thelbi është këtu: si mund të citohet Papahaxhi, që flet qartë për një autor rumun, dhe po në atë tekst nga J. Kastrati të jepen mendime si ato që sapo ia citova? Edhe më tej Kastrati përmend Th. Kapidanin me *Kontributin e rumunëve në rilindjen shqiptare*, F. Miklosiçin me *Kërkime rumune*, V. Papahaxhin me *Arumunët e Voskopojës dhe tregtia venedikase në shekujt XVII-XVIII*, E. Pikonë me *Rumunët e Maqedonisë*. Të gjithë këta autorë flasin për arumunë dhe nuk bëhet e qartë përse përfshihen në një trajtim, ku shpërfillen tërësisht mendimet e tyre.

*Teodor Kavalioti ka qenë arumun shqiptar.* Fshirja e këtij fakti objektiv është arsyeja e trajtimeve joshkencore për këtë figurë dhe për gjithë problematikën e lidhur me të. Tashmë në paraqitjen e veprës së Martin-Likut<sup>9</sup> më 2006 e kam rrahur çështjen e arumunëve në lidhje me librin e këtij autori anglez dhe me leksikografinë e shqipes. Shkurtimisht po rimarr disa pika, që ndihmojnë për të rrokur drejt edhe alfabetin e përdorur më 1770.

Shumica e vllëve kanë qenë dygjuhësh në kuptimin e plotë të fjalës, me përjashtime të veçanta, si p.sh. në fshatin Floq të Korçës ku edhe më 1980 kam ndeshur gra në lagjen e tyre, që nuk flisnin shqip. Bashkëjetesa e tyre etnike me shqiptarët për shekuj ka vijuar pa asnjë shfaqje negative. Ata nuk e kanë ndier veten si të huaj, dhe anasjelltas, studiuesit tanë vepërimtarinë e tyre në të gjitha fushat e kanë trajtuar si pjesë të pashkëputur të kulturës në truallin shqiptar. Arumanishten e kishin gjuhë të familjes, por edhe shqipen e kishin gjuhë të jetës së përditshme. Deri në lindjen e shtetit shqiptar të pavarur, për shkak se jetonin kryesisht poshtë Shkumbinit, duke përfshirë edhe Elbasanin, dhe si të besimit ortodoks, ata mësonin në shkollat greke. Greqishtja ishte gjuha e fesë dhe e shkollës për ta, por jo gjuhë e familjes dhe e jetës së përditshme.

Duke ardhur në shek. XVIII do të vëmë re se gjendja historike, demografike, fetare, kulturore e gjuhësore në Shqipërinë jugore ishte mjaft e ndërlikuar për shkak të sundimit të Perandorisë Osmane, e cila ngrihej mbi një bazë shumetnike dhe nuk e përfillte kom-

bësinë në ndarjet administrative. Voskopoja u shfaq si përjashtim me një shumicë arumunësh të ngulur dhe ky përjashtim prandaj edhe nuk e pati të gjatë jetën, por për aq kohë sa jetoi, qe një qendër me forcë tërheqëse të madhe, pothuaj si 'toka e premtuar', si Jerusalemi vllah. Edhe nga ana gjuhësore është e domosdoshme që të vendoset tradita e saj jo sipas përfytyrimit të sotëm të ndarjes gjeografike-dialektore brenda kufijve politikë të Shqipërisë. Për njerëz si Kavalioti zona e ortodoksëve që flisnin shqip përfshinte një hapësirë të pandërprerë nga Durrësi e Elbasani në veri dhe deri te Follorina e Janina në jug. Kjo ishte edhe treva e popullsisë ortodokse, nga mesi i së cilës dilnin klerikët ortodoksë shqiptarë e arumunë. Njerëzit e shkolluar dhe në shërbim të fesë qarkullonin nga një qendër në tjetrën, siç e dëshmon bindshëm jeta e emrave që do të përmend pak më poshtë; ata ishin midis tyre edhe në komunikim profesional, siç do ta quaja.

Brenda vetë trysnisë ortodokse kishte orientime të ndryshme kulturore. Deri në atë kohë kishte bashkësi ortodokse, që vareshin nga patriarkati i Ohrit, i cili u shkatërrua vetëm dy vjet para djegies së parë të Voskopojës. Prej andej vinte ndikimi për ta shkruar shqipen me shkronja cirilike. Një orientim kulturor u përpoq ta ndërtonte shkrimin e shqipes me alfabetë origjinale, për t'u shkëputur nga gjuhët e huaja. Ky përfaqësohet nga Grigori i Durrësit; nga Dhaskal Todri që kishte qenë nxënës i Kavaliotit, kurse si autor i Anonimit të Elbasanit mbahet Papa Totasi, gjithashtu krijues i një alfabeti origjinal. Grigor Voskopojarë ose i Durrësit ishte zëvendës i Kavaliotit, u bë kryepesh-



kop i Durrësit dhe duket se vdiq në Elbasan. Thuhet se ka shqipëruar të dyja dhiatat e ndoshta ka qenë nga Elbasani. Por të gjithë këta nuk kanë ndonjë gjurmë se kanë qenë bashkë me Kavaliotin të një grupimi për alfabetin e shqipes, madje edhe kur kanë qenë nxënës të tij.

Me alfabetin e greqishtes e kanë shkruar shqipen:

Jan Evstrat Vithkuqari (1755 ?-1822) ishte nga Vithkuqi, ku mësoi në shkollën vendëse; e ndihmoi gjerësisht Martin-Likun për lëndën gjuhësore të shqipes. Edhe ai kishte mësuar në Akademinë e Re të Voskopojës dhe kishte qenë mjaft kohë mësues në atë qytet.

Kostë Xehani, nxënës i T. Kavaliotit dhe autor i një vargu veprash greqisht, ishte nga Voskopoja e i dha gjithë informacionin për shqipen dhe arumanishten historianit J. Thunman.

Kostandin Berati është quajtur autori kryesor i Kodikut të Beratit; ka kopjuar një pjesë të Fjalorit të Kavaliotit dhe besohet se ka nënshkruar një dokument fetar greqisht bashkë me Dh. Todrin dhe T. Kavaliotin në Voskopojë më 1779. Në dorëshkrim krahas alfabetit të greqishtes ka edhe gjurmë të një alfabeti origjinal shqip

Kostandin Cepi ishte po ashtu vllah shqiptar nga Vithkuqi; ka lënë një kodik greqisht në të cilin përfshihen edhe 22 faqe shqip, që shërbenin për mësimin e greqishtes, si dhe përmban disa tekste arumanisht (u përket viteve 1820-1822). Shkrimet janë kopjuar nga tekstet e Kodikut të Beratit. Së fundi, për Dhanil Voskopojarin do të flas më poshtë.

Duke i marrë së bashku me arumunët shqiptarë, këta veprimtarë fetarë dhe të arsimit e njihnin shqipen e folur ose ishin në kontakt me të në Elbasan e në Berat, në Durrës e në Voskopojë, në Korçë në Janinë. Për këta njerëz, që shërbenin kudo në këtë trevë, për shkak të përfshirjes aty të gjithë zonës dialektore kalimtare të shqipes, për arsye edhe të vetë dallimeve dialektore, që ende nuk kishin shkuar aq larg sa do të ndodhte gjatë dy shekujve më pas, dallimi dialektor veri-jug nuk përbënte një faktor të fortë dhe imponues. Do të shtohet këtu si argumentim edhe vetë natyra e gjuhës së shkruar. Gjithë ata që e ndien nevojën ta shkruanin shqipen, kalonin nga gjuha e folur në trajtën e shkruar, ishin të detyruar të përpunonin alfabetin e përshtatshëm, të ngulitnin fjalët e trajtat. Asnjëherë gjuha e shkruar nuk përputhet me të folurit e gjallë, përkundrazi, ndërhyr një element artificial, një veprimtari rregulluese, madje edhe përftohet një ndjenjë ose një shije tjetër; shkurt, bëhet një përzgjedhje e vetëdijshme. Nuk ka provë më të qartë, sesa shkrimi i palëkundur i numërorit *nji* në vend të 'një'; te Dhanil Voskopojari del 34 herë. Po ashtu del te ai 48 herë *qi* në vend të "që". Këtu nuk mbetet vend për të pranuar diçka të rastësishme. Dukuri të kësaj ndjenje, për më shumë edhe të parapëlqimeve në shkrim, i kemi edhe sot, pas kaq dhjetëvjeçarësh të ngulitjes së gjuhës standarde.

Në shekullin XVIII vërehet se shfaqet parapëlqimi për elementë të së folmes së Elbasanit në shkrimet fetare në gjithë Shqipërinë jugore (sipas nocionit të kohës), parapëlqim i cili do të rritet deri te vendimi për gjuhën zyrtare pas Kongresit të Lushnjës më 1920. Aq

më pak do t'u kërkohej vllëve shqiptarë që t'u përmbaheshin me rreptësi dallimeve dialektore kur shkruanin shqip. Për mendimin tim, këtu nuk bëhet fjalë për një përzjerje artificiale të tipareve dialektore ose për amalgamë, por për një proces evoluimi, ose për një zhvillim, që do ta përmbledhja me këto fjalë: në shekullin XVIII tashmë kishte një traditë të shkrimit të shqipes, të mbështetur jo në toskërishten jugore, por në gegërishten e mesme, me të cilën ishin në kontakt edhe veprimtarët ortodoksë, që qarkullonin në hapësirën toske jugore. Për ata shtrohej problemi themelor, se cilin variant të zgjidhnin si gjuhë të shkruar. N. Tërpoja, tek i cili do të ndalem më tutje, është shembulli i zgjedhjes së variantit të gegërishtes së mesme në kontakt me variantin verior. Th. Kavalioti përfaqëson hapin e mëtejshëm drejt një baze jugore, por pa u shkëputur tërësisht nga ajo traditë. Përfundimi prej këtej, që dëshiroj ta theksoj me forcë, është se te Kavalioti nuk ka disa gegizma, siç është folur deri më sot, por ka një vazhdë të qartë të një tradite të shkruar mbi bazën e gegërishtes së mesme. Dhanil Voskopojari përbën hapin e mëtejshëm, ndërsa Kostë Berati shkëputet ndjeshëm drejt variantit të shkruar mbi bazë të toskërishtes. Së fundi, prodhimi i mëpastajmë me Boçarët, V. Meksin e G. Gjirokastritin shkon më poshtë drejt jugut dhe tashmë ka shfaqje të ndikimit të arbëreshëve të Greqisë, të arvanitëve.

Përpara se të kaloj te shqyrtimi më i afërt i alfabetit të Kavaliotit, e quaj të domosdoshme të theksoj, se te të gjithë këta autorë, ku ndeshen elementë të gegërishtes, kemi shembuj kur me raste *gegërishtja gjith-*

*ashtu është shkruar me shkronja të alfabetit të greqishtes* dhe nuk ka nevojë as nga ky këndvështrim t'i mëshohet dallimit ndërmjet dy dialekteve kryesore të shqipes edhe në traditën e shkruar. Madje dëshmimi i ecurisë së ndërlikuar në përpunimin e trajtës së shkruar të shqipes është synimi qendror i këtij libri, synim i mbështetur në dokumentim historik dhe në argumentim shkencor objektiv; shpresoj se me këtë kuptim do t'i marrin lexuesit edhe vërejtjet e mia nga njëherë mjaft të rrepta.

Gjithsesi, emri qendror në Voskopoje del T. Kavalioti (1718-1789). Ai ishte arumun, ndoshta nga një familje me prejardhje nga Kavaja. Por në kushtimin e veprës së tij Voskopoja cilësohet si vendlindja. Ka shkruar rregullisht greqisht, botoi edhe një Gramatikë fillestare të greqishtes (1760). Për ne (jo për mua) e vetmja vepër e tij e rëndësishme është *Protopeiria* – libër fillestar për shkollat me 104 faqe, shtypur në Veneçie më 1770. Përmban lëndë të ndryshme greqisht për shkollarë që të mësojnë greqishten, kurse në faqet 15-59 përfshihet *Fjalori greqisht-arumanisht-shqip*. Në kopertinë thuhet se pati nxitjen e tregtarit nga Voskopoja Jorgji Trikupa, i mbiquajtur Kosmiski (gjithmonë arumun), që ta botonte 'për të mirën e grekëve'. Libri u drejtohej nxënësve arumunë e shqiptarë, që duhej të mësonin duke ndjekur shkollat greke. Gjuha amtare në shkollë përdorej si mjet ndihmës për mësimin e greqishtes. Pikërisht kur doli ky libër, Voskopoja sapo kishte marrë një goditje shkatërrimtare: u dogj më 1769. Ndoshta kjo e ka shtyrë autorin ta botonte për ta përdorur jo vetëm nxënësit në Voskopoje, por edhe

më përgjithësisht ortodoksët (me këtë kuptim duhet të merret fjala 'grekët' te kopertina) pranë kishave e manastireve. Kjo shpjegon përse ndonjë kopje nga librat e tij është gjetur kaq larg sa deri në Moldavi.

*Fjalorthi greqisht-arumanisht-shqip* i Th. Kavaliotit ka 1170 fjalë greke. Pyetja e parë është: çfarë gjuhësh përfaqësohen në këtë fjalor? Pjesa greke është e greqishtes popullore. Nuk mund të përdorte për shkollarët e vet greqishten e vjetër apo greqishten bizantine, por vetëm gjuhën e gjallë, për të cilën në ato vite niste periudha e përpunimit si gjuhë shkrimi, derisa të vinte në nivelin e asaj, që sot quhet dhimotiki. Natyrisht, këto formacione gjuhësore nuk mund të priten me gërshtëri, prandaj në Fjalorin e tij nuk përjashtohen elementë të gjuhës librore ose të vjetruar. Pjesa arumune gjithashtu do të ishte e të folurit popullor, sepse përgjithësisht nuk kishte traditë me vepra të botuara. Për pjesën shqipe pranohet se është toskërishtja e krahinës së Voskopojës dhe Vithkuqit e më gjerë, e Korçës. Por studiuesit nuk pajtohen për shkallën e lëvrimin të dialektit në nivelin e gjuhës së shkruar. Sidomos ka ngjallur diskutime prania e trajtave të gegërishtes në fjalët e Kavaliotit. Te botimi i vitit 2006 për Martin-Likun e kam shtjelluar hollësisht këtë aspekt, duke diskutuar edhe mendimet e ndryshme, si të A. V. Desnickajës e të A. Hecerit, prandaj nuk do ta rimarr këtu.<sup>10</sup>

Pas greqishtes në Fjalorth vjen arumanishtja, një fakt ky thelbësor, që shpesh është kapërcyer si pa ndonjë peshë. Kavalioti gjuhë amtare kishte arumanishten, por shqipja ishte shumë e rëndësishme për të

edhe sepse jetonte mes shqiptarëve e një popullsie dygjuhëshe, edhe sepse jepte mësim në klasa me po këtë gjendje gjuhësore. Problemi i tij ishte të përpunonte një alfabet për të shkruar arumanishten. Greqishten e kishte gjuhën e kulturës, të mësuar, po sidomos gjuhën me prestigj, gjuhën e shkruar, me të cilën shërbente në kishë, bënte mësim e përpilonte libra. Nuk kishte nevojë të shpikte ndonjë alfabet, mjafton ta përshtaste për arumanishten. Pastaj këtë do ta përdorte njësoj për të shkruar edhe shqipen. Prej këndeje rrjedhin zgjidhjet e tij të çuditshme kundrejt cilitdo alfabet tjetër të shqipes, sidomos përdorimi deri i tri shkronjave për të dhënë një tingull, dukuri që nuk ndeshet zakonisht në historinë e alfabetit tonë. Por treguesi më bindës është shenja e tij e njëjtë për tingullin 'ë' si të arumanishtes, edhe të shqipes.

Studiuesit tanë, madje edhe T. Osmani<sup>11</sup> në vepërën e tij të vëllimshme, nuk e kanë paraqitur alfabetin e tij. Prandaj e vlen të jepet këtu. Nga një shqyrtimi i fjalëve del përbërja e mëposhtme, ku po përmend shembuj të shqipes të shkruar prej tij krejt njësoj si të arumanishtes krahas po në atë vend:

Zanoret:

- **a** jepet me alfën greke: *afër*; njësoj si ar.: *asllan*;
- **e** jepet me epsilon: *edhe, eshk*, por njësoj si ar. me *ai* të greqishtes te *fener, jetë*;
- **ë** me alfën me një pikë diakritike poshtë: *afër, hënë*;
- **o** me të dy shkronjat e greqishtes: *dhuroj, oborr*; me omegën te *lehon*, dhe njësoj si ar. te *honi, ohtik*;

- **u** me dyshkronjëshin e zakonshëm të greqishtes  
ov: *akull, unë*; njësoj si ar.: *kube, kupë, kurban, kurvar*;

- **i** me zgjidhjet jo të thjeshta të alfabetit të greqishtes nëpërmjet η, ι: *i ditur, nisi*; por me υ njësoj si ar. te: *fitil, fil, nisi*;

- **y** me ιου, ιου: *ay, brymë*.

Bashkëtingëlloret:

- **b** si zakonisht greqisht μπ: *bark, bast, berber*; njësoj si ar.: *ballsam, labrik*;

- **c** me dyshkronjësh τç: *cohë, mace*; njësoj si ar. *cincife*;

- **ç** nuk del si shkronjë më vete, është njësoj me 'c' dhe nga kompetenca jonë gjuhësore e dallojmë; njësoj si ar. te *ahçi*; A. Heceri e ka interpretuar gabim te fjala *borxh*, për arsye se Kavalioti nuk ka 'xh' ;

- **d** me ντ: *çadër, dafinë*; njësoj si ar. *fund*;

- **dh** me deltën greke: *i bardhë, dardhë*; njësoj si ar. *dhelfin, dhiamant*;

- **f** me fi greke: *fre*; njësoj si ar. *flakë, fund, frikë, furrkë, furtunë, futë*;

- **g** me dyshkronjësh γκ: *gafor, gati, gërhas*; njësoj si ar.: *grep*;

- **gj** me dyshkronjësha γγ dhe γκ përpara –i dhe –e: *gjak, gjalpë, gjenj, i gjelbër, gji*; njësoj si ar.: *gjellë, gje-raqinë, gjind, gjinkallë*;

- **h** me χ: *ahere, bëhem*; njësoj si ar.: *haliç, haraç*;

- **j** me γ në fund fjale: *arnoj, çaj*; njësoj si ar.: *kollaj*; me ù: *faj, fajkua, jo*; me ι në togjet përpara –a, –e, –o: *ba-jame, dhjamë, bijë, jorgan*;

- **k** me κ: *kam*; njësoj si ar.: *kamare, kanistrë, kanon, kapon, kartë, kondil*;

- **I** në mes e në fund të fjalëve del me dyshkronjësh  
λλ: *baltë, dal*; por me një λ para -i dhe -e: *laj, lakruar, të blem, të blerë, leh; bilbil*; njësoj si ar.: *flakë, limë, luftë*;
- **ll** me një λ: *allçi, asllan*; njësoj si ar.: *kallamar, kallup*;
- **m** me μ: *hurma*; njësoj si ar.: *majmun, mellan, merimangë, mistri, monedhë*;
- **n** me ν: *anë, nip*; njësoj si ar.: *nam, naollë, nom*;
- **nj** me νν: *arrinj, nji, njeri*;
- **p** me π: *pajë, pemë*; njësoj si ar.: *pallat, panijir, paradhis, parmak, patë, potir, pulpë*;
- **q** me κ përpara -e dhe -i: *koqe, faqe, fqinj, qaj*; njësoj si ar.: *qivour, qoshie, qyp*;
- **r** me ρ: *ar, erë*; njësoj si ar.: *reze, rus*;
- **rr** me ρρ: *arrë, derr, rri* (gabim te: *arri për ariun*);
- **s** me të njëjtin përdorim si greq. σ dhe ς: *hasër*; njësoj si ar.: *sardhele, sinap, skumbri, stomach, sisam, stih, spastrë, stambë*;
- **sh** me σσ: *i zbutshim, shërbëtoj, esh, shaj*;
- **t** me τ: *tetë, ti*; njësoj si ar.: *top, trap, trup*;
- **th** me θ: *ethe, thikë*; njësoj si ar.: *themel*;
- **v** me β: *hava, havan*; njësoj si ar.: *kurdhuvan, virgjir*;
- **x** në dy raste me ντϕ: *gaxitem, xe*;
- **xh** mungon;
- **z** me ζ: *buzë, dyzet*; njësoj si ar.: *zanat, zili*;
- **zh** me ζζ: *myzhde, lëvozhgë, zhabë*.

Janë edhe dy shkronja greke, që nuk janë të nevojshme për shqipen: φ dhe χ: *haps, lipsië, taksith, taks*; njësoj si ar. *apsith, stips*.

Gjëja e parë që bie në sy është jo vetëm prania e një numri të madh fjalësh, të cilat shkruhen njësoj ose mjaft ngjashëm shqip dhe arumanisht, por edhe prir-



ja, e vetëdijshme ose jo, e autorit për të përfshirë pikërisht fjalë të afërta me të njëjtën prejardhje qofshin nga greqishtja (diçka e kuptueshme), qofshin nga turqishtja. Po marr si shembull me interes mbiemrin *rus*. E. Çabej e vë në dyshim etimologjinë e G. Majerit si huazim sllav dhe e sjell nga greqishtja e re. Por të dy etimologët nuk flasin për dokumentimin e saj. Më del se për herë të parë e ka dhënë pikërisht Kavalioti; prej tij e kanë marrë së pari Martin-Liku, pastaj Ksilanderi dhe Hani. Është domethënëse që nuk e ka Kristoforidhi. Çabej e hedh poshtë prejardhjen nga arumanishtja, duke mos e quajtur fjalë baritore. Më duket se vërteton pikërisht këtë dukuri: Kavalioti nisej nga arumanishtja dhe e kanë tërhequr fjalët, të cilat i shihte të afërta me shqipen. Psikologjikisht kjo është dukuria më e zakonshme e çdo njeriu, të cilit i bëjnë përshtypje fjalët e njëjta në një gjuhë tjetër, e cila nuk është amtare për të; në rastet kur nuk ka përputhje të plotë kuptimore, atëherë ai e projekton vetvetiu çdo aspekt amtar te gjuha tjetër. Këtu vijnë si mbështetje të gjitha rastet, që kanë ngjallur edhe diskutime.

E quaj të drejtë mendimin e A. Hecerit se tre raste, që nuk i pranonte A. V. Desnickaja, e nxjerrin hapur Kavaliotin një arumun, që sidoqoftë ndonjëherë ngec në kompetencën me shqipen. Kavalioti ka: *mollë faqesë, qira shtëpisë, e re lopë*, trajta të cilat nuk do t'i rrëshqisnin një shqiptari. Sipas lëndës së një punimi diplome dhe jo me hulumtimin e vet, J. Kastrati ka sjellë një varg shembujsh për poliseminë.<sup>12</sup> Shqyrtimi i tyre nxjerr tjetër gjë. Dy fjalët e greqishtes *κρισταλι* dhe *παγος* janë dhënë arumanisht me një fjalë, rrjedhi-

misht Kavalioti ka dhënë gjithashtu vetëm një fjalë shqipe: “akull”. Edhe A. Heceri nuk e ka kapur dhe gabimisht e ka përkthyer fjalën e parë me *Eis* gjermanisht. Fjala e arumanishtes vjen prej latinishtes dhe në gjuhët neolatine ka ndodhur kalimi prej akullit te kuptimi i gotave të qelqta (fr. *glace, glacerie, glacière*). Përkthimi i drejtë për shqipen do të kishte qenë ‘gastare’ dhe aspak ‘akull’, e papranueshme për një shqiptar. Vetëm fjala e dytë greke e mësipërme do të ishte shqip ‘akull’. Gjithashtu, për J. Kastratin vijnë si shembull greqisht *μαλαμα* dhe *χρυσοφι* lidhur me poliseminë. Asnjë polisemi nuk ka këtu, fjala e parë është e greqishtes popullore dhe që të dyja duan të thonë shqip ‘ar’. Për arumanishten njëra fjalë është huazim i drejtpërdrejtë nga greqishtja, sikurse në kushte dygjuhësie edhe shqipja ka “krisaf”. Edhe për dy fjalë të tjera të greqishtes Kavalioti ka dhënë një përkthim të vetëm arumanisht dhe po ashtu njësoj ka dhënë të njëjtin përkthim për shqipen, ndërsa do të duheshin dy fjalë shqipe: *dell* dhe *damar* (vena). Shembuj të tillë vërtetojnë se pikënisja për përkthimin shqip nuk ka qenë greqishtja, por arumanishtja, gjë që e vulos rasti me togfjalëshin *e re lopë* për ‘mështjerrë’, i cili duhet përsëritur, sepse nuk ka asnjë përlijje tjetër, që janë përpjekur ta kërkojnë disa autorë, përveçse moszotërimin të përsosur të shqipes nga ana e këtij arumuni. Sipas arumanishtes janë shkruar shqip: *nepërtkë, shtik, spastrë, spanak* etj. dhe prandaj, me gjithë vlerën e madhe të punës së Kavaliotit, ajo nuk mund të merret si dokumentim autentik prej një shqiptari, sepse është prej një dygjuhëshi. Ndërkaq do shënuar si fakt mjaft

domethënës, se Kavalioti ka 34 raste kur po për ato 68 fjalë të greqishtes, edhe në arumanishten ai ka dhënë vetëm një fjalë, si edhe për shqipen. Po të kufizoheshim vetëm te ky fakt, do të arrinim te përfundimi se Kavalioti i njihte njësoj të dyja gjuhët përballë greqishtes së shkruar, domethënë të lëvruar e me pasuri sinonimike, të cilën nuk e kishin dy gjuhët e tjera, të arumunëve e të shqiptarëve, në atë periudhë. Janë gjithsej 44 raste, domethënë një të katërtën më shumë se për arumanishten, në të cilat për dy fjalë greke ka dhënë të njëjtën fjalë shqipe, si për shembull: *afër, akull, ar, baltë, bar, bie, dell, dhe, fre, laj* etj. Leksikun e shqipes e ka pasur më të varfër.

Në dritën e këtyre vëzhgimeve, pohimi i "Historisë së Shqipërisë" më 1959, se: "Vetë Theodor Kavalioti ndërmoi për këtë qëllim, sikurse thuhet, përkthimin e 'Dhiatës së re' shqip," është një hamendësim qesharak, të cilin nuk ka përse ta rimarrin autorë të tjerë. Asnjë lloj përgatitjeje nuk kishte ai për të bërë një përkthim të atillë. Kurse bashkëkohësit e tjerë, për të cilët thuhet se gjithashtu kishin bërë përkthime nga tekstet bibilike, nuk kanë përdorur asnjëri alfabetin e Kavaliotit.

Përfundimisht, Kavalioti ka gjetur zgjidhje për arumanishten dhe i ka ndjekur me vijimësi edhe për shqipen. Këto zgjidhje kanë qenë:

- ka shkronja të thjeshta greke për 18 tinguj, që vlejné njësoj për tingujt përkatës të shqipes: a, dh, e, f, h, i, k, ll, m, n, o, p, r, s, t, th, v, z;

- sipas përdorimit në alfabetin e greqishtes ka omikron dhe omega; tri 'i' të ndryshme dhe kombini-

met e tjera të greqishtes për dallimin nga 'j'; dy 's' të ndryshme; shenjat për 'ps', 'ks' dhe 'st';

- dyshkronjëshat janë për: *b, c, d, g, l, nj, rr, sh, u, zh*; zanorja 'e' jepet me epsilon, por edhe me togun α si në greqishten; grupi γκ, ashtu si dhe për greqishten, në krye të fjalëve lexohet edhe 'ng';

- ka edhe një trishkronjësh për: *y*;

- tingujt e palatalizuar 'q', 'gj' dalin rregullisht sipas parimit të drejtshkrimit të greqishtes përpara -i dhe -e, po ashtu si dhe 'l';

- përshtatja duke ndjekur përdorimin pozicional të shkronjave në alfabetin e greqishtes ka sjellë që të lexohet gjithë grupi greqisht -αυκ-; për 'j' shfaqen ndërlikime me diftongje dhe me γ gjithashtu përpara diftongjeve;

- e vetmja shkronjë e përshtatur ka qenë alfa greke me një pikë poshtë për tingullin 'ë'.

Nuk mund të bëj hamendësime për gjendjen reale të shqiptimit në arumanishten e asaj periudhe, por është e qartë, se Kavalioti nuk i ka dhënë shqipes tingujt 'ç' dhe 'xh', ndoshta nuk e ka kapërcyer këtë problem edhe nga ndikimi i fortë i greqishtes në mosdallimin shkrimor c-ç-xh. Në pak raste ka bërë akrobacira të mirëfillta drejtshkrimore për të dhënë dallime të panevojshme, si te fjalët: *bie, të blem, derr, dhe, hidhënim, lagjin, lakër, i lik, qëndis, sjetullë*.

Në ribotimet e ndryshme këto zgjidhje të ndërlikuara të Kavaliotit nuk janë kuptuar gjithmonë drejt. Ribotimi më i pari dhe më i rëndësishmi ishte ai që bëri studiuesi suedez, J. Thunmann-i (1746-1778) në pjesën e dytë të librit për historinë e shqiptarëve e të

vllëve (1774). Sipas A. Hecerit,<sup>13</sup> të Thunmani janë bërë disa korigjime, të cilat në këto rrethana besoj se janë sugjeruar, siç e përmenda, prej Kostë Haxhi Xhehanit (Çekanit), që ishte student në Universitetin e Hales, përsëri një voskopojar, që dinte shqipen e arumanishten dhe prandaj ishte ai, që ia dha librin dhe i kumtoi për ato dy gjuhë, madje edhe për shqiptarët përgjithësisht. F. Miklosich-i më 1882 ka ribotuar prej J. Thunmanit vetëm pjesën arumune, sepse ajo i interesonte në veprën 'Gjurmime rumune'. Ribotim më besnik, për mendimin e A. Hecerit, mund të quhet ai i Gustav Majerit në vëllimin IV të "Studimeve shqiptare" më 1895 sipas origjinalit, duke shtuar pjesën gjermanisht. Ka dhënë një tabelë të transkriptimit prej tij me alfabetin e K. Lepsiusit, po gjithësesi i ruajti tri shkronja greke: ε, δ, θ. Tashmë e kam thënë, se Majeri mbështeste përdorimin e alfabetit latin dhe prandaj nuk kaloi te alfabeti i Stambollit. Ndërkaq, ai ka bërë disa vërejtje. Mendonte se kishte pasaktësi të fjalët: *burë, riesthë, rëmbëj*. Në të vërtetë jemi në të folmet juglindore, ku duke shkuar drejt Korçës, bie dallimi ndërmjet 'r' dhe 'rr', prandaj kjo nuk përbën ndonjë pasaktësi të Kavaliotit. Edhe vërejtja se dallimi ndërmjet 'l' dhe 'll' është bërë me mangësi, nuk qëndron, për arsye të zgjidhjes së ndjekur nga Kavalioti, që e paraqita më sipër. Nuk është gabim të Kavalioti φκινν për 'fqinj'. Nuk është thjesht v për 'nj' të fjala *shient*, sepse kjo ishte forma prej së cilës në Elbasan është arritur të *Shin*, që në të folur ka dhënë *Shijon* për Shën Jon. Disa raste kur ka dalë vetëm τ në fillim fjale në vend të ντ, janë për t'u riparë dhe jo aq thjesht për t'u

marrë si gabime shtypi. Që J. Tunmani kishte vënë re se Kavalioti kishte nganjëherë thjesht v në vend të vt. A. Heceri ka vënë re se G. Majeri e ka gabim 'shije' për 'shtijë'. Ilo Mitkë Qafëzezi e ribotoi pjesë-pjesë në revistën "Leka" gjatë viteve 1936-1938; e ktheu kolonën shqipe në alfabetin e sotëm, ndërsa për pjesën tjetër u mbështet te J. Thunmani, domethënë vuri së pari latinishten.

Së fundi, më 1981 Armin Heceri bëri një ribotim shumë të mirë, duke u nisur nga gjuha e sotme shqipe. Ai vuri në radhë të parë fjalën sipas shqipes së sotme, poshtë me alfabetin e greqishtes të tria gjuhët e origjinalit dhe nën to dha përkthimin gjermanisht, por jo të arumanishtes. Ndërkaq, grupi -ie- nuk ka te Kavalioti thjesht çështjen e theksit të ndryshëm në dy dialektet tona, si e paraqet A. Heceri, por shqiptimi real është i ndryshëm, domethënë dallimi nuk është *zîej* – *ziéj*, por *zîej* – *zjéj*. Nuk e quaj me vend të zgjatëm këtu për interpretimet e pasakta që ka A. Heceri lidhur me fjalë të veçanta, si: *shkamb*, *shtytkë*, *kurban* etj. Por *rraj* për të cilën thotë (faqe 33) se e ka gabim dhe duhej ta kishte shkruar *rrah*, mund të shtoj se edhe sot dëgjohej në krahinën e Korçës pikërisht *do t'të rraj*. Më tej e quan gabim shtypi grafinë  $\eta\kappa\alpha\epsilon\kappa\iota$  për mbiemrin *i keq*, sepse me interpretimin e Hecerit ka dalë: *i këeqi*. Në shënim shton se duke ndjekur Joklin, edhe M. Camaj e zbërthen fjalën në *kë-eq*. Të gjitha këto nuk kanë të bëjnë me ndonjë gabim të Kavaliotit, por me interpretuesit e tij. Ai ka qenë i detyruar ta shkruante kështu, sepse po të hiqet "ë", sipas parimit

të leximit pozicional të shkronjave të greqishtes fjala do të lexohej *i qeqi*, si të *qerë*, *qendis*, *qendroj*.

E kam shqyrtuar hollësisht punën e Martin-Likut në librin e vitit 1814, e cila dëshmon se nuk ishte një ribotim i tipit të J. Thunmanit, porse duke e pasur në themel lëndën dhe strukturën e Fjalorit të Kavaliotit, i ngërthen të gjitha çështjet e diskutueshme për gjuhën shqipe të Kavalioti. Në traditën leksikografike europiane për një libër të tillë do të thuhej: Kavalioti i ri, redaktuar dhe plotësuar nga Liku, me ndihmën e shqiptarit Evstrat.

Kavalioti është nisur nga fjalësi greqisht, ndërsa për shqipen gjithë kohën ka qenë ndërmjet arumanishtja. Kjo është njëra ndër arsyt përse në pjesën shqipe mungojnë mjaft greqizma. Shfaqet disa herë parapëlqimi për huazime me prejardhje latine (ose italiane) kundrejt huazimeve me prejardhje greke, diçka e kuptueshme për folësin e arumanishtes si gjuhë neolatine, por në këtë rast e pashkëputshme nga kuadri tërësor i tij. Me këtë vështrim do të kuptojmë përse te ai gjejmë italianizmat *latugë*, *lottoj*, ndërsa është mjaft e dyshimtë që këto të ishin fjalë të zakonshme të shqipes. Shumica e turqizmave të shqipes i kanë dalë edhe në arumanishten, sepse prej saj nisej, prandaj janë të shkruara njësoj shqip me alfabetin e përshtatur për arumanishten: *ahçi*, *asllan*, *bilbil*, *borç*, *çark*, *fital*, *haps*, *haraç*, *hurma*, *hyzmeqar* etj., po ashtu edhe fjalë të tjera të përbashkëta, sidomos me greqishten, si: *dafinë*, *delfin*, *diamant*, *dhiatë*, *fener*, *honi*, *nisi* etj. Natyrisht, i ka ruajtur veçoritë e trajtave në gjuhët përkatëse, por si përdorim alfabeti kemi të njëj-

tën gjë, p.sh. gr. *dhaskalos*, ar. *dhaskalu*, shq. *dhaskal*; ose ar. *avae*, shq. *hava* dhe ar. *avane*, shq. *havan*.

Këto ndreqje e vlen të mbahen para sysh edhe kur trajtohet alfabeti i dokumenteve të tjera të shqipes së shkruar, sidomos kur interpretimi është bërë nga autorë të huaj dhe kur gabimet e shtypit kanë qenë të natyrshme në botime të bëra në shtypshkronja të vendeve të huaja, pa ndreqës shqiptarë të bocave.

Pas këtij zbërthimi hapet rruga për t'u kthyer prapa e për të shpjeguar një rast tjetër të shkrimit të shqipes.

Ndërmjet mbishkrimeve të shekullit XVIII paraqet interes të veçantë ai i vitit 1731 mbi gravurën e Shën Mërisë prej Manastirit të Ardenicës afër Fierit, bërë nga Nektar Tërpoja për botimin e librit të tij në Venedik. Edhe ky ishte një voskopojar, shërbestar (jo igumen) i manastirit, me prejardhje arumune, e po të thuhet me përpikëri, ishte një vllah shqiptar, ortodoks i rritit grek, por në trevat e kontaktit me katolicizmin. Historiografia jonë nuk është marrë seriozisht me vllëhtë, e për këtë arsye gjuhësia jonë nuk i ka trajtuar as gjuhën e tyre, as marrëdhëniet në kushtet e dygjuhësisë me shqipen, marrëdhënie që siç del, kanë edhe aspekte kulturore e do të ishin një fushë kërkimore interesante, po ashtu si të folmet e pakicës greke në Shqipëri. Në ditët tona në këtë çështje është ndërlikuar edhe qëndrimi grek, i cili vllëhtë i quan grekë dhe i numëron në shifrën e përgjithshme të grekëve në Shqipërinë e sotme

Dh. Shuteriqi<sup>14</sup> shton se klishe të tilla ka pasur edhe në Shën Gjon Vladimirin e Elbasanit, edhe në Shënepremten e Kavajës. Mirëpo është e pasaktë të



thuhet se fraza është greqisht-shqip-arumanisht-latinisht, ajo në të vërtetë është greqisht, latinisht, arumanisht, shqip. Kjo nuk është një vërejtje pedante, por ka të bëjë me thelbin e diskutimit. Përpara se të flas për alfabetin, e vlen të vë në pah disa veçanti të tjera.

Gravura në radhë të parë është greqisht. Nuk e di përse studiuesit nuk përmendin se fjalia kryesore paraqitëse e figurës është në krye greqisht me shkronja të mëdha me kuptimin: “Virgjëresha dhe perëndilindësja e Ardenusës.” Po ashtu me shkronja të mëdha poshtë thuhet greqisht: “Mbretëreshë nënë virgjëreshë / ndihmo shërbëtorët e tu.” Në cepin majtas poshtë është me shkronja të vogla fraza latinisht: “Regina Mater et Virgo auxiliare Servis tuis.” Po kështu me shkronja të vogla janë edhe fraza arumanisht e shqip në dy cepat sipër, domethënë kjo është një gravurë greqisht, por që i drejtohet një bashkësie, ku përdoren gjuhë të tjera. Autori e ka dhënë me shkronja greke të vogla poshtë identifikimin e vet: “Ieromonahu Nektarios.” Brenda gravurës janë greqisht shkurtimet e zakonshme të ikonave ortodokse. Është një tekst, që do të përfshihej në një libër të paracaktuar për perceptim pamor nga lexues shumëgjuhësh, por gjithsesi një tekst greqisht. Dëshmon dëshirën e mrekullueshme të këtij shërbestari që t’u bënte të kuptonin diçka në gjuhën amtare anëtarëve dygjuhësh të bashkësisë së tij, të cilët nënkuptohet se e rroknin alfabetin e greqishtes, por nuk ishin të thekur në vetë greqishten.

Para së gjithash, ky fakt, i përdorimit të greqishtes dhe latinishtes në tekste fetare të njërit rit është një dukuri tejet domethënëse, sepse nuk shfaqet gjetkë në

dokumentet e kohës. Shkrimi i latinishtes është i përpiktë. Nuk do të ketë qenë diçka e panjohur për vllëhtë alfabeti i latinishtes. Konkretisht ne e dimë gjithashtu se T. Kavalioti dhe N. Tërpoja bënë botime në Venedik. Në kopertinën e librit të Kavaliotit është shënuar në fund "Superiorum permissu" dhe nuk do të ishte pa interes të gjurmohej cili ishte kuptimi i lejes nga eprorët.

Gjuha e këtij teksti nga Dh. Shuteriqi, botuesi i parë i tekstit të ne, dhe nga të tjerë pas tij është quajtur e dialektit verior. Ndonëse është një frazë e shkurtër, ajo kërkon një shtjellim të gjerë për ta rrokur anën gjuhësore. Tashmë lidhur me veprën e Martin-Likut kam tërhequr vëmendjen, se këto janë shkrime, jo regjistrime të gjuhës së folur. Pasi të vihet në dukje baza dialektore, është e domosdoshme të studiohet çfarë përfaqëson teksti, cili është kuptimi i tij dhe si është realizuar gjuhësisht, në çfarë komunikimi ligjërimitor bën pjesë etj., si dhe të vihet në dukje shkalla e përpunimit si tekst i gjuhës së shkruar. E njëkohësisht për gjuhën e shkruar pyetja themelore lidhet me paratekstin: a ka pasur një traditë apo është përpjekja për herë të parë e shkrimit; a ka pasur paraardhës, apo janë orvatje origjinale, vetjake. Me një vështrim të tillë, duke iu drejtuar teorisë së tekstit e pragmatikës, stilistikës e teorisë së komunikimit, dalin përfundime të tjera.

N. Tërpoja ishte nga Voskopoja, punonte afër Fierit, midis një popullsie toske, kurse e folmja e tekstit anon nga ajo e Elbasanit. Kjo dëshmohet te fjala *mamë*. Nga ana tjetër, kemi përemrin *nee* që vjen qartë nga

një traditë shkrimi më veriore. Ruajtja e zanores 'ë' te *Virgjinë, mamë* është e periudhës kur rënia e saj nuk kishte përparuar shumë dhe e folmja kalimtare e El-basanit ishte një pikë lidhjeje e vlefshme për shkrimin.

Argumenti më qenësor në gjykimin e kësaj fraze vjen prej përbërjes së saj leksikore. Kemi diçka të përkthyer, por nga cila gjuhë është bërë përkthimi? Th. Popa, punën e të cilit e kam vlerësuar mjaft këtu në punimin për shkronjat e greqishtes, në këtë rast i ka ngatërruar të gjitha.<sup>15</sup> Ndonëse ka riprodhuar gravurën, pas transliterimit e përfshin frazën shqipe si përkthim(!). Në të vërtetë, ka bërë një kthim të parregullt të tekstit në shqipen e sotme. Në botimin e vitit 2005 të librit të Dh. Shuteriqit, për faj të mungesës së një redaktori, riprodhimi është tërësisht me gabime dhe i pavlefshëm.<sup>16</sup> Te botimi i vitit 1976 gjithashtu ka gabime, të kuptueshme për vështirësitë e shtypshkronjave tona me shkronja greke dhe të posaçme.

*Te N. Tërpoja kemi një fjali shqipe të përkthyer jo nga greqishtja dhe jo nga latinishtja, por nga arumanishtja.* Greqishtja dhe latinishtja përputhen plotësisht: "Mbretëreshë nënë virgjëreshë ndihmo shërbëtorët e tu." Fjalja arumanisht do të thotë: "Virgjinë Mëmë e perëndisë luto për ne mëkatarët." Kam bindjen se kjo ka qenë stilemë standarde fetare e arumanishtes. Përkthyesi është nisur pikë për pikë prej saj për të dhënë përkthimin shqip: "Virgjinë Mamë e perëndis uro për ne fajtorët." Në rend të parë vjen 'Virgjina', kurse në greqishte e latinishte vjen "Mbretëresha". Virgjinë quhet Mëma, kurse gr. e lat. Mëma së pari quhet mbretëreshë. Me fjalë të tjera, arumanisht e

shqip flitet për 'mëmën e perëndisë', kurse greqisht e latinisht për mëmën mbretëreshë apo sundimtare. Asaj arumuni i drejtohet të lutet, të bëjë uratë, kurse gr. e lat. i kërkohet të ndihmojë. Arumuni e quan veten mëkatar dhe shqip fajtor, kurse gr. e lat. flitet për shërbëtorët e saj. Më domethënëse është folja 'uro'. Ajo është e njëjta fjalë në tekstin arumanisht dhe shqip e me të njëjtin kuptim. Ne e përdorim me tjetër kuptim sot, por Tërpoja e ka marrë se po ashtu mund të thuhet shqip, meqë edhe "bëj uratë" do të thotë lutem. Fjala e fundit 'fajtorët' ka një problem, që nuk është vënë re deri më sot. Pjesa deri te 'fajtorë' është e qartë, por nuk e di si do të interpretoheshin tri shkronjat e fundit. Për çudi, dy shkronjat e fundit janë të njëta edhe në fjalën arumune për mëkatarët.

Fjala e parë për 'mbretëreshën' te fjalia greqisht është e greqishtes së vjetër, sot shihet si fjalë librore. Kurse në fjalinë sipër ikonës greqisht niset me "Virgjëreshën" dhe vijohet me kompozitën: perëndilindësja. Më duket se prej këndeje vjen përkthimi i pjesës së parë të fjalisë arumanisht. Rendi shqip: *virgjinë mamë e perëndis* ndjek arumanishten e jo dy gjuhët e tjera.

Fraza arumanisht dhe shqip është me alfabetin e greqishtes të përshtatur. Tingulli 'd'i i arumanishtes është dhënë me 't' në krye të fjalës. Te fraza shqipe vëmendjen qendrore e tërheq shkronja latine 'e' për tingullin "ë" të shqipes, ndërsa për 'e' është përdorur epsilon pa asnjë luhatje. E njëjta zgjidhje është për arumanishten dhe pa kurrfarë dyshimi është zbatuar në fillim për arumanishten dhe pastaj është kapërcyer te shqipja. Tingulli 'gj' i shqipes është dhënë me dy-

shkronjësh γκ përpara 'i', ndryshe nga arumanishtja; grupi vt nuk është përdorur për 'd'; nuk është përdorur ou për 'u', por shenja që edhe në arumanishten aty vjen nga alfabeti sllav; së fundi, për 'j' është dhënë kjo shkronjë me dy pika sipër.

Ndonëse është shumë pak për të dhënë një gjykim të sigurtë, për mendimin tim është një alfabet i greqishtes i përshtatur nëpërmjet arumanishtes për shqipen, ku përzihet një shkronjë e rëndësishme latine, ndoshta dhe dy, por kjo nën ndikimin e alfabetit të arumanishtes aty, sepse po ashtu bëhet po ai dallim *ë-e*; është po e njëjta shkronjë për 'u'. Ka të ngjarë që Tërpoja kishte përvojë me këtë alfabet dhe me shkrimin në të dyja gjuhët. Do ta përsëris, se Tërpos meriton t'i vihet në dukje që ka bërë një përkthim mjaft të mirë nga arumanishtja, me një shqipe të shkruar jo si fillestar. Është një përkthim jo duke ndërtuar një fjali të shqipes nga gjuha e folur, jo duke ndjekur greqishten, por me një paratekst të shkruar arumanisht. Kjo analizë për fjalinë e Tërpos shërben si një çelës i sigurtë edhe për disa interpretime të gjuha e Fjalorit të Kavaliotit, i cili si autor përfshihet kështu në një traditë të besueshme, të provuar dhe jo hipotetike për shkrimin e gjuhës shqipe. Ungjilli i pashkëve, pak rreshta të përkthyer aty nga shek. XVI, ka edhe fjalët: *pri shin Matthe*, të cilat gjuhësisht janë të po asaj natyre si dhe fjalia e N. Tërpos. Edhe A. Heceri e pranon se ka pasur një traditë të mëparshme të gegërishtes së shkruar ndër ortodoksët shqiptarë, por ai nuk e ka vënë re as se Tërpoja mbështetej në gegërishten e mesme, as se ndërmjet tij dhe Kavaliotit ka një ecuri evoluimi e jo identitet.

Pas trajtimit të hollësishëm për alfabetin e Kavaliotit, mund të flitet shkurt për një arumun tjetër: **Dhanil Mihal Adam Haxhiun** (1754 -1822), të quajtur edhe mjeshtri Dhanil ose Dhanil Voskopojari. Siç shihet nga nofka, ishte nga Voskopoja. Kishte qenë nxënësi i Kavaliotit dhe më pas u bë prift e mësues. Mendohet se u largua nga vendlindja pas shkatërrimit të Voskopojës. Më pas del si drejtor shkolle pranë mitropolisë në Voskopojë në vitet 1800-1811. Nuk mund të mos përmendet, që Dhanili erdhi sërish në Voskopojë pas një ndryshimi domethënës. Pas djegies së Voskopojës, Patrikana i zëvendësoi mësuesit me priftërinj të rinj, të lidhur me të dhe për të sjellë një frymë krejt tjetër greko-ortodokse. Ishte po ashtu arumun shqiptar, një folës dygjuhësh, arumanishten e kishte gjuhën e parë amtare, por edhe shqipja kishte rëndësi për të si në jetën e përditshme, edhe për punën me nxënësit në shkollë. Bullgarishten nuk e njihte mirë, prandaj kërkoi ta shkruante dikush tjetër pjesën përkatëse të Ushtrimeve. Greqishtja ishte gjuha e arsimit dhe e kulturës për të, gjuha me prestigj deri në atë shkallë, sa kërkonte të çrrënjoseshin gjuhët e tjera. Vetëm pak kohë më parë Shën Kozmai (që u vra më 1779 afër manastirit të Ardenicës, me të cilin lidhet mbishkrimi i N. Tërpos) bënte propagandë të zellshme fetare dhe vepronte për ta ndaluar edhe përdorimin e arumanishtes në kishë. Në këtë atmosferë është përgatitur edhe punimi i tij.

Duket se nuk ka hartuar ndonjë vepër tjetër, veç libërthit *Eisagogike Didaskalia*. Përshkrimin e tij e kam dhënë të plotë në paraqitjen e përkthimit të veprës së

Martin-Likut dhe nuk do ta përsëris këtu. Dhanili përgatiti një libër mësimor, të llojit që ne sot e quajmë libër bisedimesh për t'u përdorur në klasa me nxënës shumëgjuhësh, shqiptarë e vllëh. U botua më 1802 në Venedik dhe ky fakt gjithashtu e lidh drejtpërdrejt me N. Tërpon dhe Kavaliotin. Dhanili, po ashtu si Kavalioti e të tjerë, i ka quajtur si variante më të drejta për normën e shkruar disa trajta të elbaskanishtes, prej të cilave më përshtypjelenëse është *nji* për numërorin 'një', për të cilin edhe Kavalioti ka *njizet*. Për shkak të orientimit të vet, Dhanili është përpjekur që shqipja dhe arumanishtja të përshtateshin sa më shumë sipas greqishtes.

Për alfabetin e Dhanilit, nga shkak i qëndrimit negativ ndaj tij, nuk janë bërë shqyrtime të mirëfillta. Edhe T. Osmani e ka përmendur kalimthi, duke u mbështetur në fjalët e P. Janurës, i cili pa prova arrin në përfundimin se: "Të dy këta iluminista s'qenë të qëndrueshëm në përdorimin e këtyre shenjave."<sup>17</sup> Nuk e di mbi çfarë bazash mund të quhej iluminist Dhanil Voskopojari, por edhe riprodhimi i disa germave të tyre nga P. Janura është përplot me gabime, e këtë radhë jo për faj të vështirësive të shtypit, të cilat janë të pranishme për të gjithë ne. Alfabeti i Dhanilit është një përshtatje e alfabetit të greqishtes, por besoj nën ndikimin edhe të T. Kavaliotit. Kjo duket para së gjithash te zgjidhja për zanoren më ngatërrestare të shqipes: 'ë'. Ashtu si dhe Kavalioti, e jep me një alfa që ka poshtë një pikë. Si zakonisht, nuk ka pasur ndonjë vështirësi për shkronjat, si: *dh, e, m, n, p, r* etj. Po marr vetëm faqen e parë të Dhanilit. Duhet lënë mënjane rastet e shkronjës 'i', që del me disa shenja në

greqishten. Fjala e parë është 'Perëndia'. Është dhënë shqip krejt njësoj si te Kavalioti, por arumanishtja nuk përputhet plotësisht. Vijon 'bëri'. Për 'b' fare thjesht ka togun 'mp' të greqishtes si Kavalioti dhe alfën me pikë poshtë po si ai. 'QieLL' është njësoj te të dy, me përjashtim të faktit se ndoshta Kavalioti ka gabimisht dy 'k' greke. Parimi është po ai: k+i lexohet 'q'. "Dhe' del lehtësisht njësoj.

Por te 'dielli' nisin dallimet: Dhanili përdor 't' në fillim të fjalës për 'd'; siç e kam vënë në dukje, ndër-hyn gjithnjë dallimi ndërmjet 'd' e 'dh', që nuk e përballon greqishtja. Zgjidhja është e njëjtë me N. Tërpon. Kavalioti e jep me 'nt', por tani sqarohet përse disa herë edhe Kavalioti ka vetëm 't': *tialë* (djalë), *tiall* (djall), *tiathhtë* (djathhtë), *drec* (dreq). Fjalës për 'i dyfish-të' A. Heceri e ka vënë një (sic!), sepse e transkriptuar i del 'i mtyshim', por mund të shihet ose si gabim shtypi (domethënë ka 'm' në vend që të kishte 'n' për togun 'nt'), ose jo si gabim, domethënë 'i mdyshim'. Ndërkaq, po te 'diell' Dhanili ka dy lamda për 'll' të shqipes, kurse Kavalioti nuk ka gjetur po atë zgjidhje për ngatërresën tjetër të përhershme me dallimin nëpërmjet shkronjave greke midis 'l' dhe 'll'.

Fjalën e pestë për hënën, Dhanili e ka në trajtën zvogëluese. Ndryshon nga Kavalioti, sepse ka dy 'n' dhe më duket se edhe herë të tjera Dhanili e përdor këtë dyfishim për të mos i ngatërruar takimet e 't' me 'n'. Për këtë shkak e ka transkriptuar gabim edhe J. Kristofsoni.<sup>18</sup> . Përgjithësisht ribotimi nga Kristofsoni është përgatitur me shumë kujdes. Tekstet e të katra gjuhëve janë dhënë dy herë: së pari sipas origjinalit të



Dhanilit, pastaj tri gjuhët e tjera janë dhënë me alfabetin latin, ndërsa në kolonën e greqishtes është vënë me alfabetin e sotëm pjesa e marrë nga Martin-Liku më 1814. Kjo mënyrë dëshmon se Kristofsoni i ka dhënë më shumë peshë gjuhës shqipe, madje ka nxjerrë veçan edhe fjalët që i ka shtuar Liku.

Te fjala pasuese 'yll' është shfaqur nevoja e shkronjës 'y', të cilën Kavalioti e kishte me tri shkronja bashkë: *iov*. Edhe Dhanili këtë ka pranuar, veçse ky nuk e ka marrë zgjidhjen me dy shkronja të greqishtes për zanoren 'u' të shqipes, por ka përdorur shenjën me prejardhje sllave për të, të cilën e gjejmë që te Buzuku e këtu edhe te Tërpoja, prandaj i del me dy shkronja. Nuk po vijoj më tej, sepse edhe me kaq del shkoqur se Dhanili nuk ka zbatuar tërësisht alfabetin e Kavaliotit dhe ky fakt është i mjaftë për të mënjanuar shumë mendime të nxituara mbi ndikimin e Kavaliotit, kur as dhe një njeri kaq afër me të nga shumë pikëpamje, nuk e ka ndjekur me besnikëri. Njëkohësisht janë të padyshimta disa zgjidhje të zbatuara nga të tre këta autorë njësoj. Alfabeti është i greqishtes, i përshtatur për arumanishten dhe i zbatuar për shqipen. Mjafton për ta dëshmuar këtë qoftë edhe një togfjalësh i krahasuar në të dyja gjuhët: *edhe eshtë dheu*. Por nuk është e njëjta përshtatje, që kishte bërë Kavalioti, mjafton të krahasohet një fjalë, si "agjëroj" te të dy autorët.

Përfundimi më i rëndësishëm nga shqyrtimi i alfabetit të Dhanili është se ai gjithashtu ka ndërtuar një alfabet të përshtatur prej greqishtes për të shkruar arumanishten dhe pastaj këtë alfabet e ka përdorur

edhe për bullgarishten, edhe për shqipen. Një e vërtetë kaq e qartë dhe e vetëkuptueshme është shpërfillur në studimet tona për një periudhë të gjatë vetëm e vetëm sepse i është bërë bisht një të vërtete tjetër po aq të qartë e të vetëkuptueshme: këta kanë qenë arumunë shqiptarë. Dëshiroj t'i përsëris fjalët e Eqrem Çabejt: "Me Teodor Kavaliotin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në Shqipëri.", vetëm se duke bërë një ndreqje: periudha kishte nisur përpara Kavaliotit.

Po i rimarr edhe një herë përfundimet e përgjithshme. Me Voskopojën kemi një vatër ku shkruhet shqipja me ndihmën e alfabetit të greqishtes. Ajo paraqet një ndarje më vete të traditës së përdorimit të atij alfabeti. Ishte një trevë që shtrihej që nga Korça deri në Elbasan e Durrës në veri, deri në Berat e Fier në perëndim, kurse drejt jugut e jugperëndimit shkonte deri në bregdet e Gjirokastër. Nga ana gjuhësore kishte një ndikim të së folmes së Elbasanit, gjë është dëshmi se Elbasani kishte një përparësi në lëvrimin e shqipes së shkruar (pavarësisht nga alfabetet), duke dhënë trajta që shiheshin si normë për gjuhën e shkruar. Këtu janë ndërthurur edhe shfaqjet e shkrimit të shqipes me alfabete origjinale. Në këtë trevë u përftuan dy reagime të kundërta: njëri për t'u shkëputur nga alfabeti i greqishtes dhe tjetri për të hequr dorë prej shqipes. Këto dy reagime na sjellin ndër mend dallimet ndërmjet qendrës kishtare të Stambollit dhe qendrës kishtare të Ohrit. Njëkohësisht në këtë trevë është e pranishme një përbërëse vllahe, e cila është nisur nga alfabeti i greqishtes i përshtatur për arumanishten dhe pastaj këtë alfabet e ka përdor-

zur edhe për shqipen. Kjo përvojë më vonë është zhdukur tërësisht, por ajo ka interes, sepse na ndihmon të shpjegohen disa veçori të teksteve e të fjalëve shqipe të dokumentuara. Interpretimet e reja që dalin me këtë rrugë vlejné edhe për arsyetimet etimologjike rreth fjalëve të shqipes.

Edhe kur kanë pasur si synim parësor mësimin e greqishtes, edhe kur u janë drejtuar së pari arumunëve dygjuhësh, këto tekste anasjelltas ndikuan për të përvetësuar shkrimin e shqipes. Ato mbeten me vlerë për dokumentimin historik të shqipes. Me Dhanilin përfundon mirëfilli një etapë dhe një orientim në shkrimin e shqipes. Për një farë kohe vatra e produkteve të rëndësishme gjuhësore bëhet Janina e Ali Pashë Tepelenës. Bashkë me rënien e Voskopjës shkon edhe rënia e pjesëmarrjes së arumunëve dygjuhësh në lëvrimin e shqipes së shkruar. Kjo pjesë e traditës së shkruar mbi bazën e gegërishtes së mesme shuhet, pa përjashtuar shfaqje të rastit. Kur hyn në këtë fushë K. Kristoforidhi, tashmë i duhet të ndjekë dy variante mbi dy baza dialektore të dallueshme qartë.

### Shënimet:

1. ÇABEJ, E. (1936): *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë, f. 31.
2. *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe. Tekst për kl. e III-të të shkollave të mesme*, Tiranë, 1952, f. 7.
3. SHUTERIQI, DH. S. (11956): *Histori e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*, Tiranë.
4. *Historia e Shqipërisë, I*. Tiranë, 1959, f. 417.
5. BUDA, A. (2000): *Shkrime historike, 4*, Tiranë, f. 369.
6. SHUTERIQI, DH. (1976): *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë; *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitete 879-1800*, Tiranë, 2005.
7. A. Canarache në librin "Leksikografia gjatë shekujve", Bukuresht, 1970, nuk e përmend Kavaliotin, por shënon si punim të parë leksikografik për rumanishten fjalorin vllahisht-latinisht *Anonymus Caransebesiensis* të vitit 1700. Autori tjetër, Mircea Seche, në vëllimin e parë të "Skicë e historisë së leksikografisë rumune" (1966) e gjurmon traditën e leksikografisë rumune që nga glosarët sllavisht-rumanisht të shek. XVII. Në f. 16 autori shkruan: "Përmendet edhe ekzistenca e një *Fjalori greqisht-rumanisht*, redaktuar në vitin 1770 nga një *Calioti*, të cilin për fat të keq nuk e njohim dhe nuk kemi asnjë të dhënë për atë punë." Njoftimin autori e ka marrë nga revista "Amiculi scolaei", 1865 dhe nga një revistë tjetër e po atij viti. Kjo do të thotë se nuk kishte dëgjuar gjë as për J. Tunmanin dhe as për G. Majerin, nuk kishte lexuar as P. Papahaxhin. Në vëllimin e dytë, botuar më 1969, autori e ka ndrequr veten (f. 216, shënimi 1), por është përpjekur ta ulë vlerën e punës së Kavaliotit e të Voskopjarit. Ai nuk pajtohet me mendimet e shprehura, se ata kanë hapur rrugën e leksikografisë arumune, dhe e quan se nga cilësia nuk i përlligjin vlerësimet e dhëna. Besoj se këto ndryshime kanë ardhur pasi autori ka njohur me vonesë veprën e P. Papahaxhit (1909).
8. KASTRATI, J. (2000): *Historia e albanologjisë*, vëll. I, f. 304-308.

9. LLOSHI, XH. (2006): *William Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, në: William Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, Tiranë, f. 3-115.
10. KASTRATI, J. (2000): *vep. e cit.*, f. 286 ka paraqitur mundësinë që ndonjë gegë e ka ndihmuar autorin për hartimin e veprës, ose se ka dashur t'u hynte në punë jo vetëm nxënësve toskë, por edhe atyre gegë. Me hamendësime të tilla gjurmimi shkencor nuk mund të shkojë larg. Para së gjithash, është e domosdoshme të thuhet me përpikëri, se Kavalioti nuk ka "trajta geqe" përgjithësisht, por trajta nga e folmja e Elbasanit.
11. OSMANI, T. (1999): *Udha e shkronjave shqipe*. Shkodër, f. 89-90. Autori e përmend kalimthi Kavaliotin dhe për alfabetin e tij nisat nga thëniet e P. Janurës në: *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup 1969, për të pranuar se aty për herë të parë shqipja është shkruar gjerësisht me alfabetin grek. Data e botimit nga T. Osmani është dhënë gabim, duke marrë atë të ribotimit nga J. Tunmani më 1774.
12. KASTRATI, J. (2000): *vep. e cit.*, f. 287.
13. HETZER, A. (1981): *Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis*, Hamburg,, f. 11-14.
14. SHUTERIQI, DH. (2005): *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitete 879-1800*, Tiranë.
15. POPA, TH. (1999): *Mbishkrime të kishave të Shqipërisë*, Tiranë, f. 95. Për gabimet e rënda të botimit janë përgjegjës edhe redaktorët.
16. SHUTERIQI, DH. (2005): *vep. e cit.*, f. 249.
17. JANURA, P. (1969): *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, f. 39.
18. KRISTOPHSON, J. (1974): *Das Lexicon Tetraglosson des Daniil Moschopolitis*, në: *Zeitschrift für Balkanologie*, Jhr. X, Heft 1.



## *Alfabeti i shqipes për shkrimin e gjuhëve të tjera*

Paraqitjen<sup>1</sup> dhe përkthimin e pjesës për gjuhën shqipe të veprës së W. Martin-Leake-ut<sup>2</sup> tashmë e kam botuar më 2006. Këtu do të rimarr vetëm çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe të përdorur prej tij.

Pas kërkimeve të shumanshme diturore në pjesën jugperëndimore të Ballkanit, të lidhura me detyrat e tij ushtarake e politike të nivelit më të lartë, Martin-Liku vendosi të botonte një libër, ku të jepte të dhëna historike që nga antikiteti dhe, në frymën e romantizmit gjuhësor të kohës, të përshkruante edhe gjuhët përkatëse. Ai kishte qenë më parë në Egjipt, ku Napoleon Bonaparti në fushatat e veta kishte marrë edhe dijetarë, që i dhanë trajtë një fushe të gjerë gjurmimesh, e cila është njohur me emrin Orientalizmi. Krahas me luftërat e njohura ndërmjet francezëve e britanikëve deri në thyerjen përfundimtare të Bonapartit, dijetarët e të dyja fuqive ndesheshin edhe në fushën e gjurmimeve shkencore. Në rastin e Martin-Likut kjo është shprehur deri në ndeshjen e drejtpërdrejtë me Fransua Pukëvilin, i cili qe po ashtu si ai konsull pranë Ali Pashë Tepelenës. Sidomos me shënimet në fund të librit të vet Martin-Liku është përpjekur t'i zhvlerësojë nga çdo anë njoftimet e Pukëvilin. Dhe njëkohësisht i vuri vetes si qëllim të merrte kurorën e

parësisë në përshkrimin e gjuhëve të trevës, e cila në thelb ishte treva e pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës.

Ishin disa gjuhë në këtë zonë, e cila në atë periudhë bënte pjesë në Orient, në Perandorinë Osmane. Greqishten e vjetër ai e njihte, por tashmë flitej një gjuhë tjetër në periudhën e saj të re. Europeanët po ndesheshin me greqishten e re, aq sa e shihnin si një gjuhë që duhej përshkruar dhe dokumentuar si të ishte e pazbuluar. Sipas autorit, publiku kishte njohuri fare të mangëta për dialektin e sotëm grek, por ky kishte rëndësi si nga ana praktike, ashtu edhe për synimet akademike. Nuk duhet harruar se lidhur me alfabetin dilyn çështjet e ndërlikuara të drejtshkrimit. Ky ka qenë një aspekt shumë i zhurmshëm i greqishtes së re dhe mjafton të përmend se ishte etapa kur merrej me katharevusën A. Koraisi. Martin-Liku e ka cilësuar qartë, se ka pasiguri në drejtshkrimin e greqishtes, meqë vetë i drejtohej trajtës popullore.

Turqishten Martin-Liku e përjashtoi, sepse e quante se gjendej si gjuhë e folur në Stamboll e në Azinë e Vogël, por vetëm në pak qytete të mëdha të Ballkanit.

Me bullgarishten ai kuptonte trevën jugperëndimore të saj, të cilën e vendos në një mënyrë jo aq të përcaktuar “në disa krahina veriore të Maqedonisë”. Me këtë përvijim në të vërtetë ai e kishte fjalën për atë që sot mund ta quanim maqedonishtja, por do ruajtur termi i tij, pasi e kishte fjalën për një të folme gjithashtu të pashkruar. Ndërkaq dihet që bullgarishtja e vërtetë kishte alfabetin e vet që në kohën e Cirilit e të Metodit. Atë Martin-Liku nuk e njihte dhe do të përbënte



vështirësi të pakapërcyeshme për ta shtypur librin në Londër. Shkurt, për autorin ishte një idiomë tjetër që duhej shkruar. Po me cilin alfabet?

Për arumanishten e quan se ndeshet në disa ngulime të shpërndara përgjatë Pindit dhe në kreshtat që e lidhin me Olimpin. Edhe për të nevojitej një alfabet. Provat e mëparshme për ta shkruar me alfabetin e greqishtes duke bërë përshtatje e përzierje të ndërlikuara nuk mund t'i merrte si të kënaqshme e të lehta për lexuesin europian.

Të bën përshtypje vlerësimi i rëndë, që u bën Liku vllëve dhe bullgarëve si “popullsi të palëvruara e të izoluar”. Nga kjo përbuzje, me sa duket, përjashtohen grekët e shqiptarët, sepse në gjithë bashkëtekstin nuk përmenden as ata, as gjuhët e tyre. Edhe vetë e ka ndier se i ka kushtuar vëmendje shumë më të madhe gjuhës së shqiptarëve, të cilën e quan sipas gjithë gjasave të prejardhur nga ilirishtja. E ka hasur të shkruar me shkronjat greke, por ai alfabet nuk është në gjendje të paraqesë gjithë tingujt e shqipes. Madje në “Udhëtimet” e vitit 1835 ka vënë në pah, se mesazhet e Ali Pashës, kur i drejtoheshin popullit, shkruheshin shqip me shkronja të greqishtes. Kishte vënë re, se në mjaft raste shtresat e larta më shpesh për komunikimin e shkruar përdornin greqishten. Ky është kuptimi i shprehjes së tij, se “shqipja nuk është gjuhë e shkruar”, që do të thoshte se nuk ishte me shkrim në përdorim të zakonshëm e të përditshëm si anglishtja e greqishtja, se nuk kishte shkolla e nuk botoheshin libra, por jo në kuptimin absolut, se nuk ishte shkruar ndonjëherë. Aq më tepër kur kishte lexuar edhe vep-

rën e J. Tunmanit e kishte mësuar prej tij se ishte botuar edhe një fjalor e një gramatikë në dialektin verior. Për Fjalorthin e Kavaliotit shënon se i kishte dhënë në mënyrë të papërpiktë tingujt e shqipes. Kishte dëgjuar për Fjalorin latinisht-shqip të Bardhit dhe për veprën e P. Budit, por nuk i kishte parë, që të mbështetej te alfabeti i tyre. Edhe Gramatikën e F. da Leçes e njohu tepër vonë nga libri i Xh. Hobhauzit.

Këto rrethana e shtynë Martin-Likun që t'i përvishet ndërtimit të një alfabeti për gjuhën shqipe. Merita e Likut është se u përpoq ta shkruante shqipen me shkronjat latine, ndonëse kishte qenë në një mjedis, ku e haste të paraqitur me shkronja të greqishtes.

Paraprakisht duhet përjashtuar, që ai ndoqi ndonjë traditë të mëparshme, madje as të Xhon Kam Hobhauzit. Porse të dy e kishin të përbashkët arsyen, që libri i drejtohej një publiku evropian, i cili vështirë se do ta merrte mundimin të mësonte alfabetin e greqishtes me qëllimin për të lexuar një botim udhëtimesh a kërkimesh. Prandaj ai madje përdori shkronja latine edhe për greqishten e re. Nga praktika e vet ishte bindur dhe e ka shënuar, se alfabeti i greqishtes nuk ishte në gjendje t'i shprehte gjithë tingujt e shqipes. Ndërkaq, një alfabet nuk është thjesht çështje shkronjash, sepse duhen parime të brendshme për ta zbatuar në një gjuhë të caktuar.

Si përgjithësim, do të theksoj, se Martin Liku ndërtoi për shqipen një alfabet me shkronja latine, duke u nisur nga mënyra që kishte vendosur për të shkruar fjalë të greqishtes së re, te e cila e dërgon lexuesin në pjesën e parë të kreut të parë të librit. Kjo e

lejoj t'i përmbliidhte shkurt shpjegimet për shqipen. Ndjekja e mënyrës së vet për greqishten me shkronja latine duket fare qartë, po të shihet për shembull, si është shkruar edhe greqisht fjala shqipe: *tzintzife*. Autorët shqiptarë, të cilët kanë shkruar rreth alfabetit të tij, nuk i kanë vënë re të gjitha këto gjëra, të shkruara të zezë mbi të bardhë. Disa parime, rrjedhimisht, i mbajti nga shkrimi i greqishtes që e shpiku vetë, dhe prandaj përpara se të kalonte te gramatika, ka dhënë disa shpjegime për alfabetin në paragrafin "Tingujt e shqipes" (faqe 260-262).

*e* është një zanore ndërmjet italishte a dhe e, që shqiptohet thellë në grykë, duke qenë e njëjtë me zanoren e anglishtes në fjalët si *burn, son*, por përgjithësisht mjaft e shkurtër.

*u* i ngjet u të frëngjishtes, por ky tingull është më i hollë dhe sikur ngjitet lart drejt flegrave të hundës.

*k'* është k e zakonshme, e shqiptuar ndërmjet majës së gjuhës dhe dhëmbëve të sipërm.

*k* përdoret për të paraqitur një k grykore jo të aspiruar, e cila është e afërt ose pothuaj e njëjtë me tingullin e arabishtes *kof*.

*kh* është  $\chi$  e greqishtes së re, e shqiptuar nëpër hundë, ose mund të shprehet me h-në tonë, të shqiptuar në të njëjtën mënyrë.

*l* paraqet një l të shqiptuar me grykë dhe afërsisht ngjet me italishten *gl*.

*n* është afërsisht me italishten *gn*, por e shqiptuar pak si në flegra.

*s* është sh e anglishtes, por jo aq e ashpër dhe shqiptohet më afër dhëmbëve.

*z* paraqet mjaft afër j të frëngjishtes në fjalën *jamais*.

Shkronjat e tjera, që janë përdorur në faqet vijuese, mendohet se lexohen në po atë mënyrë si te fjalët e greqishtes së re, të shkruara me alfabetin tonë; kështu dh përfaqëson tingullin e romaikes  $\delta$ ; th për  $\theta$ ; kh për  $\chi$ ; tz për anglishten *ch* te *child*; dz për anglishten *j* te *John*; të gjithë këta tinguj i ka shqipja.

Tipari kryesor i veçantë i shqiptimit të shqipes është parapëlqimi për tingujt hundorë. Përveç atyre të përmendur, të shurdhëtat e zakonshme, që në gjuhët e tjera shprehen me b, d, g, d, përgjithësisht në gjuhën shqipe kanë një tingull të formuar nga ngritja e tyre lart drejt flegrave. Kjo ndodh sidomos në fillim të një fjale dhe mund të ishte paraqitur si me ato shkronjat kursive, ose dhe me ndonjë mënyrë më përshkruese për shqiptimin e tyre me anë të mb, nd, ng; por e menduam më mirë të mos i shtonim vështirësitë e leximit të fjalëve shqipe, duke shtuar shkronja të tjera ose ndërthurje të tjera, veç atyre të lartpërmendura.

Në mjaft fjalë të huazuara nga turqishtja, greqishtja e re, latinishtja, frëngjishtja etj. tingujt origjinalë të këtyre gjuhëve përgjithësisht shqiptarët i kanë zëvendësuar me tingujt e tyre të parapëlqyer hundorë ose grykorë.

Meqë është e qartë se shënimi i theksit është një nga gjërat e rëndësishme për ta zbatuar në shkrimin e fjalëve të një gjuhe të huaj me alfabetin tonë, edhe ne e kemi ndjekur në veçanti këtë kërkesë në faqet vijuese."

Mbi gjysmat e shkronjave përputhen me alfabetin e sotëm: a, b, d, dh, e, f, g, i, k, m, n, o, p, r, s, t, th, u, v, z.

I mbeteshin dy zanore. E para ishte si gjithmonë 'ë'. Për këtë ka përdorur një 'e' kursive. Për 'y' ka përdorur 'u' kursive.

Ndër bashkëtingëlloret e tjera vështirësinë më të madhe e ka pasur me shkronjat *c, ç, x, xh, zh*, për të cilat e ka ngatërruar pikënisja nga parimi i greqishtes. Kështu dyshkronjëshi 'tz' shfaqet edhe për 'c', edhe për 'ç' (*krastavec, karkalec; çallëstis, bekçi*), ndonëse shkruan se e ka vetëm për 'ç', si te *child*. Do të pritej që 'dz' të shërbente për 'x' (siç e ka te: *xgjedhurë*), mirëpo ai e shënon se është për 'xh' (*John*), kështu që vijnë përsëri te mosdallimi c-ç-x-xh.

Dallimin l-ll nuk ka arritur ta bëjë dhe përdor për të dy rastet vetëm një 'l' (*vëla, miel dhe lëkurë, dhëlpër*), ose 'l' përpara -i, -e (*plak, pleqëri*) dhe përndryshe 'll' (*pill, polla*).

E vetmja shkronjë me një shenjë diakritike shtesë është 'k' me pikë sipër për 'q' të shqipes, por sipas greqishtes e ka edhe pa pikë të palatalizuar përpara -i, -e (*kira, Shqipëri; qenj, q*, por e ka pa pikë po aty: *qengji, si dhe te: qelq*).

Dy tingujt e tjerë të palatalizuar 'gj' dhe 'nj' i ka dhënë ndryshe. Të parin e jep me 'g' përpara -i, -e, -ë, ndërsa të dytin me 'n' kursive.

Si anglez, e ka pasur të lehtë të përdorte shkronjën "h" me rol diakritik për dyshkronjëshat *th, dh*, por nuk e ka ndjekur këtë si e kemi sot për *sh, xh, zh*, ndërsa e ka vënë në togjet *gh, kh*. Për 'sh' e ka bërë kursive shkronjën 's'.

Me *kh* e shpjegon se ka dhënë një lloj 'h', por në disa raste del edhe jo kursive (*khapënj*). Ka pasur vazhdimisht vështirësi për një tingull "h" të aspiruar, karakteristik te arbëreshët e Greqisë. Vetëm dhjetë vjet më pas në rastin e përcaktimit të alfabetit për shtypjen e Dhiatës së Re të V. Meksit, përsëri botues me gjuhë amtare anglishten janë orvatur ta japin si fonemë të veçantë të shqipes.

Për "j" ka togun 'kh' (*paskëta*), por edhe 'khi' (*faj*), edhe në diftongjet (*dialë buiari, yie, veie, guai, atië*), edhe 'gh' (te: *javë*), edhe 'khi' (te: *kundrej*).

Parimi kryesor, i shpikur nga Liku, është përdorimi i disa shkronjave kursive: *e, u, k, kh, l, n, s, z*. Është një parim i dobët, sepse do të sillte vështirësi të kota

përgjithësisht e i ka shkaktuar plot gabime te vetë botimi i tij. Një dallim i tillë është në kundërshtim me funksionin semiotik të ndarjes së shkronjave në të drejta, kursive dhe të zeza. Të gjitha shkronjat mund të dalin të atilla dhe nuk mund të shfrytëzohet për të dalluar tingujt brenda të njëjtit alfabet.

Ka përfshirë *x* me leximin [ks], sepse edhe greqishtja e ka një shkronjë të tillë. Për tingujt *b, d, j, g* sigurisht nuk do të gjente me lehtësi shkronja dalluese në greqishten, por ka marrë parimet pozicionale të shkronjave të greqishtes dhe ndërthurjet me “n” ose “m” përpara. Edhe për këto ka luhate gjatë zbatimit konkret..

Ka zbatuar shkrimin e sotëm me dy shkronja të njëjta për *ll, rr*, të dalluara nga *l, r*, por në shembujt konkretë ka luhate.

Pasi ka bërë zgjedhjen e vet për parimet e alfabetit të shqipes, do të përballej me ndërlikimet pasuese. Për shembull, për të dhënë shurdhimin e bashkëtingëlloreve në fund të fjalës, ne do të shkruanim sot: *zok – zogu*. I shtrënguar nga zgjedhja e vet, atij i është dashur ta stërhollonte, duke u shprehur se shtohen shkronja të tjera si rrokje, prandaj i del *zok – zongu*.

Alfabeti i krijuar prej Martin-Likut për shqipen ka qenë kështu i ndërlikuar dhe me parime të papranueshme në përdorimin praktik. Si pasojë, ka raste në të cilat interpretimet e mëpastajme nuk përputhen te studiues të ndryshëm në botimet e tyre serioze. Kështu ka ndodhur me J. Kristofsonin<sup>3</sup> që ka ndrequr edhe të meta të botuesve të mëparshëm. Në librin e përkthyer prej meje më 2006 jam përpjekur të jap disa in-

terpretime, që më janë dukur më të drejta kundrejt autorëve të tjerë. Për shembull, J. Kristofsoni jep këtë interpretim të Likut: “edhe gaha qëto ça haenë edhe ça punonjnë pre ihtaza tanë”, ndërsa për mua do të jetë: “edhe ngaha këto ca haenë edhe ca punonjnë pre ihtiza tanë”.

Një nga ngacmimet më joshëse për Martin-Likun gjatë ekspeditave të veta ka qenë gjurmimi i dorë-shkrimeve për t’i botuar më pas. Gjurmoi skuta ku nuk kishte qenë më parë asnjë udhëtar european përpara tij, por nuk pati sukses të veçantë. Megjithatë për shqipen gjeti botimet e dy autorëve arumunë shqiptarë, të cilat i kam zbërthyer hollësisht më sipër nga pikëpamja e alfabetit. Ishte shumë pak për të plotësuar ambicien e tij dhe prandaj, siç e kam theksuar tashmë në paraqitjen e libri të tij të vitit 1814, ai është përpjekur t’i nënçmojë, madje Dhanil Voskopojarin nuk e ka përmendur dhe ka kaluar deri te një manipulim për librin e tij, që t’i humbiste autorësinë.

Fjalorin e T. Kavaliotit e quan latinisht-vllahisht-shqip, të bërë për ta përdorur grekët dhe shtypur në Venecie më 1770. Që këtu ka pasaktësi jo të vogla. Kavalioti nuk e kishte latinishten dhe këtë gjuhë e shtoi J. Tunmani në botimin e vitit 1774 dhe jo më 1770. Kavalioti nuk e bëri fjalorin për grekët, sepse nuk kishte grekë që të mësonin shqipen në atë kohë në shkollë, por përkundrazi, për vllehtë e shqiptarët, që të mësonin greqishten në shkollat greke.

Ndonëse titulli në faqen 293 të Likut është “Fjalor greqisht-shqip, me shpjegime anglisht”, në të vërtetë ai është përfshirë si pjesë përbërëse e paraqitjes së gju-

hës shqipe dhe në shënimin e shkurtër në krye flitet gjithë kohës për fjalorë dhe për fjalë të shqipes. Përfshirjen e greqishtes autori e arsyeton se i erdhi më e përshtatshme që ta ndërtonte fjalorin duke u nisur nga greqishtja. Pa ia mohur aspak vlerën e madhe të punës së tij, për të cilën e ndihmoi bujarisht edhe E. Vithkuqari, nuk mund të mos e vë në pah se ky është një mistifikim. Ai u nis nga greqishtja, sepse mori për bazë Fjalorthin e Kavaliotit. E fshiu tërësisht pjesën arumanisht të Kavaliotit dhe në vendin e saj vuri anglishten. Kështu që përsëri është një truk, kur thotë se është “me shpjegime anglisht.”; në këtë rast do të duhej që anglishtja të vinte në vendin e tretë. Shkurt, atë që është përpjekur Liku të na bëjë të besojmë, ka qenë thjesht dëshira e tij, por një dëshirë të cilën nuk kishte përgatitjen e nevojshme që ta realizonte. Liku ka bërë redaktim të mirëfilltë edhe për fjalësin e greqishtes të Kavaliotit: ka ndrequr variantet fonetike, ka hequr fjalë me gabime. Ndërsa për shqipen ka sjellë lëndë të re të vlefshme, ka bërë përmirësim e saktësime të përkthimeve shqip me sinonime, por sidomos ka një kthesë të vendosur për t’iu larguar traditës me ndikim nga gegërishtja. Nga ana leksikografike, për një varg pikash ka ndjekur Kavaliotin, por ka sjellë edhe risi, si vendosja e shënimeve gramatikore pas fjalëve shqipe në fjalor, si dhe paraqitja e disa trajtave të parregullta, shkurtimet në fjalën hyrëse (ne sot i japim në një listë veçan).

Puna më e parë dhe më e rëndë ka qenë transkriptimi i shqipes me alfabetin e Likut. Kavalioti e shkroi shqipen me alfabetin e greqishtes, të përshtatur



për të shkruar arumanishten, siç e shtjellova imtësisht më lart. Po e sjell edhe një herë një shembull të thjeshtë, sepse më ka dalë me një gabim shtypi më 2006: fjala “jeta” arumanisht është dhënë αίτα, kurse përkthimi shqip ka pasur nevojë vetëm për tingullin “j”, prandaj e shohim γαίτα. Tani te Liku, me ndërlikimet e tij, ka dalë: ghiéte. Të gjitha ato vështirësi që kishte hasur Kavalioti, i kanë dalë edhe Likut, kur ka bërë transkriptimin me shkronjat e alfabetit të vet latin.

Vetëkuptohe, një alfabet i tillë nuk do të kishte ndjekës të tjerë. Por përsëri ai përbën një dukuri të jashtëzakonshme në historinë e alfabetit tonë: është ***një alfabet i shqipes, që është përdorur për të shkruar gjuhë të tjera të huaja.***

Vllahishten dhe bullgarishten Liku e pranon se i njihte pak. Për ilustrimin e tyre thotë se, duke i ndryshuar shkronjat, nxori shembuj “nga një libër i vogël me titullin Leksikon në Katër gjuhë, botuar me shkronja greke (besoj në Voskopoje një pesëdhjetë vjet më parë).” Në faqet 383-402 ka përfshirë një tekst me “Ushtrime në pesë gjuhë” (anglisht *Pentagloss Exercises*). Ky titull vendos lidhje me pjesën *Leksikon tetraglosson*, që përmbahet në librin *Eisagogike didaskalia* të Dhanil Voskopojarit të botuar më 1802, por shënon edhe një ndryshim të ndjeshëm kundrejt tij.

Para së gjithash, dëshiroj të vë në dukje, se këtë pjesë Liku e ka përfshirë në vijim të kreut të tretë të librit për arumanishten e bullgarishten, domethënë jo të kreut të dytë kushtuar tërësisht shqipes. Bashkë me këtë të bën përshtypje termi “Ushtrime”. Liku nuk e ka ruajtur emërtimin e fjalorit, sepse vërtet nuk është i

tillë, por edhe sepse tashmë e kishte një fjalor të gjerë në librin e vet. Me të drejtë A. V. Desnickaja<sup>4</sup> vë në dukje se Liku bëri të mundur, që vepra e Dhanilit të hynte në qarkullimin shkencor. Por duke e parë me një sy kritik, del se Liku nuk e ka vlerësuar, madje do të shtoja se e ka trajtuar me shpërfillje Dhanilin. Janë shprehur hamendësime për shkak të mistifikimit nga Liku, por tashmë e kam argumentuar katërcipërisht se Liku e ka pasur në dorë tekstin e plotë të Dhanilit. Ka gjasa që të ketë ndodhur ndryshe: me lëndën e Dhanilit ai ka punuar vetëm pasi është kthyer në Angli, kur nuk do t'i drejtohej më Evstratit ose tjetërkuj për informata. Me heqjen e disa pjesëve nuk i mbeteshin as dy faqe dhe e ka quajtur të padenjë për ta përmendur si burim me peshë. Qëllimisht nuk e ka dhënë me emër autorin, kurse për datën ka thënë se është shtypur me shkronja greke rreth pesëdhjetë vjet më parë në Voskopojë. Është thjesht një shkarje, në të vërtetë ai ka dashur të thoshte nja pesëmbëdhjetë vjet më parë. Të gjitha këto janë një orvatje për ta përligjur trajtimin e tekstit origjinal ashtu si të dëshironte vetë e kështu e quante se i kishte duart të lira ta manipulonte tekstin.

Kolonën për shqipen e ka ruajtur për ta krahasur me gjuhët e tjera, një ide e dobishme kjo. Por këtu vëmendjen kryesore dua ta tërheq te këto radhë: "Fjalët e kolonave të vllahishtes e të bullgarishtes në Ushtrimet duhet të shqiptohen në përputhje me rregullat që kam dhënë për gjuhën shqipe."<sup>5</sup> Rrjedhimisht, alfabetin e vet për shqipen e zbatoi për arumanishten dhe bullgarishten, kështu po e tërheq vëmendjen te kjo

dukuri e posaçme, e cila zë fill me të: përdorimi i alfabeteve të shqipes për shkrimin e gjuhëve të tjera.<sup>6</sup> Ndoshta do ta vrente të ndërmerreshin gjurmime të tjera nëse ka edhe raste të tjera të kësaj natyre, që do të përbënin një faqe interesante në historinë e alfabetit të shqipes.

*Shënimet:*

1. LLOSHI, XH. (2006): *William Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, në: William Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, Tiranë, f. 3-115.
2. MARTIN-LEAKE, W. (1814): *Researches in Greece*, London.
3. KRISTOPHSON, J. (1974): *Das Lexicon Tetraglosson des Daniil Moschopolitis*, në: Zeitschrift für Balkanologie, Jhr. X, Heft 1.
4. DESNICKAJA, A. V. (1987): *Albanskaja literatura i albanskij jazyk*, Leningrad, f. 293.
5. MARTIN-LEAKE, W. (1814): *vep. cit.*, f. 382.
6. Shih edhe: LLOSHI, XH. (2006): *Gjuhë të huaja janë shkruar me alfabetin e shqipes*, në: Korrieri, 5 nëntor, f. 18.

*Copyright©Logos-A, 2008*

[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)

